

EMRAT DHE CILËSITË E

ALLAHUT

ISMAIL BARDHOSHI

الرَّحْمَنُ	الرَّحِيمُ	الْمَلِكُ
الْمُهَيَّمُ	الْعَزِيزُ	الْجَبَّارُ
الْمُصَوِّرُ	الْغَفَّارُ	الْقَهَّارُ
الْعَلِيمُ	الْقَابِضُ	الْبَاسِطُ

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Pasqyra e lëndës

Hyrje

Kreu 1. Rëndësia e njohjes së emrave të bukur të Allahut dhe cilësive të Tij të larta

Pastrimi i shpirtit dhe edukimi i tyre që të adhurojnë

Allahun, Një, të Vetëm

Dija më e lartë është njohja e Allahut

Njohja e emrave dhe cilësive të Allahut, është themeli (baza)

për njohjen e çdo gjëje tjetër

Shtimi i Besimit

Ai që i mëson përmendësh emrat e Allahut, kupton domethënien e tyre

dhe punon sipas saj, merr shpërblim të madh

Të madhërosh Allahun dhe t'i lutesh Atij me emrat e bukur

dhe cilësitë e larta

Njohja e Allahut në përputhshmëri me metodën e Kur'anit

dhe Sunetit është shkak për mëkëmbjen në tokë dhe devijimi

nga kjo rrugë është shkak për humbje, poshtërim dhe dekadencë

Kreu 2. Emrat e Allahut

Bazat e emrave të Allahut të Lartësuar

Baza e parë. Emrat e Allahut janë të gjithë të bukur,

të përkryer dhe të përsosur

Baza e dytë. Besimi në emrat e Allahut ka tri kushte.

Nëse këto kushte nuk plotësohen, besimi në emrat dhe cilësitë e Allahut

nuk është i saktë

Baza e tretë. Të gjithë emrat e Allahut janë "teukifje" (d.m.th. merren

vetëm nga Kur'ani dhe Suneti i saktë).

Baza e katërt. Emrat e Allahut nuk janë të kufizuar

me ndonjë numër të caktuar

Baza e pestë. Devijimi në emrat e Allahut (ilhad)

Nëntëdhjetë e nëntë emrat e Allahut të marrë

nga Kur'ani dhe Suneti i saktë.....

Dijetarët i kanë ndarë emrat e Allahut në disa grupe,

për sa i përket kuptimeve dhe cilësive që ata përmbajnë

Emri më i madh i Allahut

Disa dobi në lidhje me emrat e Allahut

Kreu 3. Cilësitë e Allahut

Bazat e cilësive të Allahut

Baza e parë. Të gjitha cilësitë e Allahut janë të përkryera e të plota

dhe nuk ka në to asnjë mangësi e të metë

Baza e dytë. Tema e cilësive të Allahut është më e gjerë

se tema e emrave të Tij
Baza e tretë. Cilësitë e Allahut ndahen në: Cilësi “thubutije” - صفات ثبوتية - të pohuara dhe cilësi “selbije” - صفات سلبية (منفية) - të mohuara
Baza e katërt. Cilësitë “thubutije” që ia ka atribuar Allahu Vetes së Tij në Kur’an dhe në Sunet, janë më të shumta se cilësitë “selbije” që Ai ia ka mohuar Vetes së Tij
Baza e pestë. Cilësitë “thubutije” ndahen në cilësi “dhatijeh” - صفات ذاتية - të qenies dhe “fi’lijeh” - صفات فعلية - të veprimrit
Baza e gjashtë. Cilësitë e Allahut të Lartësuar, për sa i përket argumenteve të pohimit të tyre, ndahen në cilësi “haberijeh” - صفات خبرية dhe cilësi “semijetun-aklijetun” - صفات سمعية عقلية
Baza e shtatë. Në pohimin e cilësive të Allahut duhet të ruhem nga dy gjëra të ndaluara rreptësisht: “temthijli” - التمثيل - përngjasimi dhe “tekjifi” - التكيف - përshkrimi i formës së cilësisë ose i mënyrës se si ajo është
Baza e tetë. Cilësitë e Allahut të Lartësuar janë “teukifije” - توقيفية, d.m.th. merren vetëm nga Kur’ani dhe Suneti i Profetit, dhe nuk lejohet që njeriu, me anë të mendjes së tij, t’i dedikojë Allahut cilësi që nuk kanë ardhur në këto dy burime
Disa parime të rëndësishme të cilat ndihmojnë për të detyruar mohuesit e disa, ose të gjitha cilësive, për t’i pohuar ato
Parimi i parë. Besimi ynë në cilësitë e Allahut është si besimi ynë në “Dhatull-Ilah” (Qenien e Tij)
Parimi i dytë. Besimi në disa cilësi është i njëjtë me besimin në cilësitë e tjera
Baza e nëntë. Nëse objekte të caktuara kanë të njëjtin emër, nuk do të thotë detyrimisht që në realitet formën dhe përmbajtjen e kanë të njëjtë
Parimet e argumenteve nga të cilat merren emrat dhe cilësitë e Allahut
Parimi i parë. Argumentet në të cilat bazohemi për të pohuar emrat dhe cilësitë e Allahut, merren vetëm nga Kur’ani dhe Suneti i saktë i Profetit (salallahu alejhi ue selam)
Parimi i dytë. Është detyrë që tekstet e Kur’anit dhe Sunetit që kanë të bëjnë me emrat dhe cilësitë e Allahut, të besohen sipas domethënies së tyre të drejtpërdrejtë, pa u bërë “tahri” dhe “ta’til” emrave dhe cilësive për të cilat ato tregojnë
Parimi i tretë. “Dhahir”-i i teksteve të cilësive, ka një aspekt të njohur për ne dhe një aspekt tjetër të panjohur
“Te’uil”-i (interpretimi)
“Thkam”-i dhe “teshabuh”-i i Kur’anit
Qëndrimi ynë ndaj përshkrimeve që Allahu i ka bërë Kur’anit dhe mënyra e pajtimit ndërmjet tyre
Cilësitë e Allahut
Fjalë dhe shprehje të cilat përdoren për të treguar diçka rreth Allahut
Gjëra që i janë atribuar Allahut, por nuk janë cilësi të Tij

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Kundërpërgjigjja ndaj esharijve dhe të tjerëve që mashtrohen prej tyre
Gjykimi ndaj mohuesit (keqinterpretuesit) të cilësive

Besimi i Ehli Sunetit

në

Emrat dhe Cilësitë e Allahut

“Dhe të Allahut janë të gjithë emrat më të bukur, kështu që luteni Atë me ta...” (El A’raf: 180)

“Ai fillon krijimin, pastaj do ta përsërisë atë (pasi të jetë zhdukur) dhe kjo është shumë e lehtë për Të. Atij i takon El Methelul A’la (përshkrimi më i lartë) në qiej dhe në Tokë. Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues.”
(Err-Rrum: 27)

“Asgjë nuk i përngjan Atij dhe Ai është i Gjithëdituri, Gjithëshikuesi.” (Esh-Shura: 11)

Ismail BARDHOSHI

Me emrin e Allahut, Të Gjithëmëshirëshmit, Mëshirëplotit

Me të vërtetë falenderimi i takon vetëm Allahut! Atij i kërkojmë ndihmë, i kërkojmë të na falë gjynahet dhe të na mbrojë nga të këqijat e veteve dhe të punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu në rrugën e drejtë, nuk ka kush e humb dhe atë që Ai e humb, nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, të vetëm e pa shokë, dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë me të, familjen dhe shokët e tij.

“O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun ashtu siç duhet pasur frikë Ai dhe mos vdisni ndryshe, veçse duke qenë muslimanë.” (Ali Imran: 102)

“O njerëz! Jini të bindur (dhe përmbushni detyrimet) ndaj Zotit tuaj, i Cili ju krijoi nga një njeri i vetëm (Ademi), prej tij Ai krijoi bashkëshorten e tij dhe nga ata të dy krijoi burra e gra të shumtë, dhe kijeni frikë Allahun nëpërmjet të Cilit ju kërkonte të drejtat e ndërsjellta dhe mos i ndërprisni marrëdhëniet me të afërmit. Sigurisht Allahu është kurdoherë Gjithëvëzhgues përmbi ju.” (En-Nisa: 1)

“O ju që keni besuar! Plotësoni detyrimet tuaja ndaj Allahut dhe kijeni frikë Atë dhe flisni (gjithnjë) të vërtetën. Ai do t’ju drejtojë tek veprat e mira e të drejta dhe do t’ju falë gjynahet tuaja. Dhe kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij (Muhamedit alejhi selam), me të vërtet ka arritur fitoren më të madhe.” (El Ahzab: 70-71)

Fjala më e mirë është libri i Allahut, udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit (salallahu alejhi ue selam), gjërat më të këqija janë shpikjet në fe, çdo shpikje është bidat, çdo bidat është humbje dhe çdo humbje përfundimin e ka në zjarr.

Tema e emrave dhe cilësive të Allahut është prej temave më të rëndësishme të Akides. Grupe të ndryshme kanë ndjekur rrugë dhe metoda të ndryshme, prej të cilave janë shfaqur humbje, besime të kota dhe përfytyrime të gabuara. Allahu i Lartësuar i udhëzoi selefët e këtij Umeti, sahabët, tabiinët dhe ata që ecën në gjurmët e tyre, për tek e drejta, gjë të cilën nuk e arritën të tjerët.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Për këtë arsye, mora iniciativën të sqaroj besimin e të parëve të këtij Umeti, “ehlul suneh uel xhemaah”, në lidhje me këtë temë. Ndjekja e tyre, padyshim është si një anije, ku ai që hipën shpëton dhe ai që nuk hipën mbytet.

Allahu ka dëshmuar për shokët e Profetit të Tij (salallahu alejhi ue selam) me dëshminë më fisnike dhe ka lajmëruar se është i kënaqur me ta:

“Dhe me ata të cilët të parët përqaftuan Islamin nga muhaxhirunët (emigruesit nga Meka) dhe ensarët (ndihmuesit medinas), si dhe me ata që i ndoqën besnikërisht ata, Allahu është mjaft i kënaqur dhe ata janë më se të kënaqur me Të. Ai ka përgatitur për ta kopshte të begata, nën të cilët rrjedhin lumenj, për të banuar atje ngaherë. Ky është ngadhënjimi madhështor.” (Teube: 100)

Ai që merr rugën e tyre, do të arrijë nderim dhe kënaqësi siç e arritën ata:

“Dhe ata që besojnë dhe pasardhësit e tyre i ndjekin ata në besim, Ne do t’ua shoqërojmë pasardhësit e tyre dhe nuk do t’ua pakësojmë aspak shpërblimin e veprave të tyre. Çdo njeri është peng i asaj që ka fituar.” (Et-Tur: 21)

Kundërshtimi i të parëve dhe ndjekja e një rruge tjetër që bie ndesh me rrugën e tyre, të largon nga ata dhe të çon në zjarrin e Xhehenemit:

“Dhe kushdo që kundërshton të Dërguarin, pasi t’i jetë treguar qartë rruga e drejtë dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne do ta lëmë atë në drejtimin që ka zgjedhur dhe do ta djegim në zjarr. Dhe sa përfundim i keq!” (En-Nisa: 115)

Profeti = ka lajmëruar në një hadith se Umeti do të përçahet në 73 grupe. Të gjitha do të përfundojnë në zjarr, përveç njërit, dhe ai është grupi që ecën në rrugën e Profetit = dhe shokëve të tij, dhe e kupton e praktikon fenë siç e kanë kuptuar dhe praktikuar ata.

Allahu i Lartësuar ka theksuar në Kur’an, se ai që ndjek një popull në madhërimin dhe në rrugën e tyre, është njësoj si ata:

“O ju që keni besuar! Mos i zini çifutët dhe kristianët për eulija (miq). Ata janë shokë, miq e mbrojtës vetëm për njëri-tjetrin, dhe nëse ndonjë prej jush i bën ata eulija (miq), atëherë nuk ka dyshim se ai është një prej tyre. Sigurisht që Allahu nuk e udhëzon atë popull që është dhalimun (i padrejtë).” (El Maide: 51)

Ai që ka ndjekur në Dynja udhëheqësit e humbjes, të devijuarit dhe keqinterpretuesit, do të tubohet me ta në Ditën e Gjykimit. Populli i Faraonit, i cili e ndoqi atë në rrugën e tij, do të udhëhiqet në Ditën e Gjykimit nga Faraoni për në zjarr:

“Por ata ndoqën urdhërin e Faraonit dhe urdhëri i tij nuk ishte udhëzim i drejtë. Ai do të shkojë t’i prijë popullit të tij në Ditën e Kijametit, duke e udhëhequr për në zjarr.” (Hud: 97-98)

Në një hadith të saktë është transmetuar se Allahu do t’i shfaqë çdo umeti në Ditën e Gjykimit, atë që e adhuronin në dynja, si p.sh. gurin, pemën, njeriun, hënën etj.. Pastaj ata do ta ndjekin atë që adhuronin, derisa të shkojnë me të në zjarr, përveç atyre që sinqerisht adhuruan Allahun.

Po kështu, kushdo që ndjek një prijës në Sunet ose në bidat në Dynja, do të tubohet me të në Ahiret. Kush dëshiron që të jetë me të parët e mirë të Umetit në Ahiret dhe t’i shoqërojë ata në Mahsher dhe në Xhenet, le të ndjekë rrugën e tyre.

Ndoshta ndonjëri mendon se kjo Akide, kështu siç e sqaruar, është besimi të cilit i janë përmbajtur vetëm Ibnu Tejmije dhe disa dijetarë të medhhebit hambeli, por në këtë studim, do të shtjellohet me argumente të padiskutueshme për çdo çështje, se ky është besimi i selefëve të Umetit dhe Ibnu Tejmije nuk ka bërë gjë tjetër, veçse e ka shfaqur, e ka publikuar dhe e ka mbrojtur fuqimisht me argumente të qarta.

Megjithëse Ibnu Tejmije ka bërë përpjekje të mëdha dhe ka dhënë kontribut të rrallë në këtë lëmë, ai nuk është i vetmi në sqarimin, shpjegimin dhe mbështetjen me argumente fetare e logjike të besimit të selefëve. Ai nuk është i vetmi, sepse ka pasur edhe shumë dijetarë të tjerë, të cilët kanë punuar për sqarimin dhe shfaqjen e besimit të selefëve.

Dijetari, hafizi dhe historiani i njohur El Hatibul Bagdadi, për sa i përket diskutimit rreth cilësive, ka thënë: “Besimi i selefëve, është të besohen dhe të pohohen sipas domethënies së tyre të drejtpërdrejtë, cilësitë që kanë ardhur në hadithe të sakta, të mos u përshkruhet formë dhe të mos përngjasohen me krijesat. Disa njerëz i kanë mohuar dhe i kanë bërë të pavlefshme ato që ka pohuar Allahu. Disa të tjerë i kanë pohuar, por duke i përngjasuar me krijesat dhe duke u përshkruar atyre formë. E vërteta është rruga e mesme ndërmjet dy grupeve, pra, të pohohen cilësitë dhe të mohohet përngjasimi me krijesat.”

El imam el Hatabi ka thënë: “Besimi i selefëve, është pohimi i cilësive sipas domethënies së drejtpërdrejtë të teksteve të tyre, mohimi i përngjasimit me krijesat dhe mohimi i përshkrimit të formës së tyre.”

Në faqen 94, do të jepet thënia e Ibnu Abdil-Berr, i cili deklaroi unanimitetin e “ehli sunetit” në këtë besim.

Në një dialog që u zhvillua rreth “Akides uasitije”, ndërmjet dijetarit të Islamit Ibnu Tejmije dhe dijetarëve të kohës së tij, në praninë e të parit të Damaskut, Ibnu Tejmije ka thënë: “Nuk kam shkruar në këtë libër, veçse besimin e të gjithë selefëve të mirë të këtij Umeti. Ky besim nuk është diçka e veçantë e imam Ahmedit. Ai thjesht ka përcjellë dijen që ka ardhur nga i Dërguari i Allahut. Sikur

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

ai të thoshte diçka nga vetja e tij që nuk ka ardhur nga i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam), nuk do ta pranonim. Kjo që kam shkruar në libër, është besimi i Muhamedit (salallahu alejhi ue selam).

Disa herë kam thënë se i kam dhënë tre vjet afat çdonjërit që më kundërshton në diçka nga kjo Akide, e nëse më sjell qoftë edhe një shkronjë të vetme nga ndonjë dijetar i tre shekujve të parë - për të cilët ka dëshmuar Profeti (salallahu alejhi ue selam) - që bie në kundërshtim me këtë që kam përmendur, kthehem dhe e pranoj fjalën e tij.”

Materiali që keni në dorë, është përpiluar dhe përshtatur në gjuhën shqipe nga ana jonë, ndërsa njohuritë që gjenden në të, janë marrë nga librat e autorëve të përmendur tek referencat. Për t’i lehtësuar punën vetes, shpesh nuk i kam përmendur referencat në libër, sepse origjinali i këtij libri përbëhet nga leksione të mbajtura në institutin “El Hagri”.

E lus Allahun që ta bëjë këtë punë të dobishme, të sinqertë dhe të pranueshme.

Uel hamdu lil-lahi rrab-bil alemine.

Ismail BARDHOSHI

Kreu 1. Rëndësia e njohjes së emrave të bukur të Allahut dhe cilësive të Tij të larta

Si mundet të nxjerrë në pah pena e robit të dobët e të paaftë, dobitë e mëdha që përfiton njeriu me anë të studimit të kësaj teme!?

Ata që e njohin Allahun dhe janë të vetëdijshëm për Madhërinë dhe Përsosmërinë e Tij, kanë diskutuar rreth mirësisë së madhe që kanë arritur duke njohur Allahun, cilësitë dhe emrat e Tij. Megjithëse me retorikën e tyre në këtë fushë, i kanë mahnitur mendjet, dituria e tyre që ka ndriçuar zemrat dhe ka udhëzuar mendjet, është si një pikë uji në oqeanin e pamatë të dijes.

Tekstet e Kur'anit dhe të Sunetit, mbartin sekrete dhe një dritë të tillë që i shushat mendjet dhe i ndriçon zemrat e njerëzve.

Mjafton për të kuptuar këtë që po sqarojmë, fakti se njeriu më i ditur rreth Zotit të Tij, Muhamedi =, i cili i trembej më tepër se kushdo tjetër Atij, ka theksuar se nuk mund t'i llogarisë lavditë që meriton Zoti i robërve. Ai ka thënë duke iu drejtuar Zotit të tij: *“Nuk i llogaris dot lavditë e Tua.”*

Në rreshtat që vijojnë, do të përmendim disa pika, ku do të sqarojmë frytet dhe dobitë që arrijnë robërit me anë të njohjes së emrave dhe cilësive të Allahut.

Rruga për njohjen e Allahut, është njohja e emrave dhe cilësive të Tij

Në qoftë se robërit dëshirojnë ta njohin Zotin e tyre dhe të shtojnë dijen e tyre rreth Tij, nuk kanë rrugë tjetër, veçse ta njohin Atë me anë të argumenteve të Sheriatit që e përshkruajnë dhe deklarojnë emrat dhe veprat e Tij, sepse Allahu nuk mund të shihet në këtë botë.

Shikoni fjalën e Allahut ku na bën të njohur veten e Tij:

“Allahu është Ai që nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij. Ai është El Haj-ju, El Kaj-jum (i Përrjetshmi, i Pafillim dhe i Pambarim, Mbajtësi dhe Mbrojtësi i gjithçkaje që ekziston). As kotje as gjumë nuk e kap Atë, e Atij është çdo gjë në qiej dhe në tokë. Kush është ai që mund të ndërmjetësojë tek Ai përveçse me lejen e Tij? Ai e di se çfarë u ndodh krijesave të Tij në këtë botë dhe çfarë do t'u ndodhë atyre në botën tjetër. Ata kurrë nuk do të përfshijnë ndonjë gjë nga dija e Tij, përveç asaj që Ai dëshiron. El Kursij-ja e Tij përfshin qiejt dhe tokën. Ai nuk ndjen aspak lodhje në ruajtjen dhe në mbrojtjen e tyre. Ai është më i Larti, më Madhështori.” (El Bekare: 255)

Ky ajet njihet me emrin “Ajetul Kursijj”. Ai është ajeti më madhështor i Kur'anit, siç ka ardhur në një hadith të saktë. Mbi madhështinë e këtij ajeti,

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

dijetarët kanë thënë: “Ai përmban besimin e drejtë në adhurimin e Allahut dhe në emrat e cilësitë e Tij.” Për më gjerë, shiko hadithet që ka përmendur ibnu Kethiri në komentimin e këtij ajeti, si dhe shpjegimin që u ka bërë atyre.

Shikoni gjithashtu tri ajetet e fundit të sures “Hashër”:

“Allahu është Ai, veç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër me meritë, por vetëm Ai, i Gjithëdituri i gajbit (i çdo të fshehte dhe të panjohure) dhe i së shfaqurës (i çdo të njohure). Ai është i Gjithmëshirëshmi, Mëshirëploti. Allahu është Ai përveç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër të merituar, por vetëm Ai, Mbizotëruesi, i Shenjti, i Gjthëpërsosuri pa asnjë të metë, Gjithëdhuruesi i sigurisë (besimit), Gjithëvëzhguesi mbi krijesat e Tij, i Gjithëfuqishmi, Urdhëruesi i Papërballueshëm, më i Larti Suprem. Lavdi i qoftë Atij. I Lartë është Ai nga gjithë çfarë i mveshin dhe i bashkojnë Atij. Ai është Allahu, Gjithëkrijuesi, Shpikësi i pashembullt i çdo gjëje, Formësuesi i gjithçkaje. Të Tij janë emrat më të bukur dhe më të lartë. Gjithë ç’është në qiej dhe në tokë lavdërojnë vetëm Atë. Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues.” (Hashër: 22-24)

Shikoni çfarë thotë Allahu për veprat e Tij në Univers:

“A nuk e kanë ditur ata që mohojnë se qielli dhe Toka ishin të bashkuar, pastaj Ne i ndamë ata dhe kemi bërë çdo gjë të gjallë, çdo lloj gjallesë prej ujit!? A nuk do të besojnë atëherë, pra!? Ne kemi vendosur në tokë male të qëndrueshëm, se përndryshe ajo do të dridhej me gjithë ato. Ne vendosëm në të edhe vendkalime të gjera (qafa malesh) për të kaluar, që të mund të udhëzohen. Ne e kemi bërë qiellin çati të sigurtë dhe të mbrojtur më së miri, megjithatë ata u kthejnë shpinën shenjave të tij (dielli, hëna, yjet erërat, retë e tj.).” (El Enbija: 30-33)

Kur e pyeti Faraoni për Zotin e Tij që e ka dërguar tek njerëzit, Musai ia bëri të njohur Atë me anë të emrave, cilësive dhe veprave të Tij:

“Faraoni tha: ‘E çfarë është Zoti i botëve?’ Musai tha: ‘Zoti i qiejve dhe i Tokës dhe i gjithçkaje që ndodhet ndërmjet tyre, nëse kërkonit të bindeni plotësisht.’ Faraoni u tha njerëzve përreth tij: ‘A nuk e dëgjoni se çfarë thotë?’ Musai u tha: ‘Zoti juaj dhe Zoti i baballarëve tuaj të parë!’ Faraoni tha: ‘Vërtet i Dërguari që është sjellë tek ju është i çmendur!’ Musai u tha: ‘Zoti i lindjes e i perëndimit dhe i gjithçkaje që ndodhet ndërmjet tyre, veç sikur ta kuptoni!’” (Esh-Shuara: 23-28)

Tekstet e Sheriatit që kanë ardhur në lidhje me këtë temë janë të shumta. Madje i gjithë Kur’ani bën fjalë për Allahun. Thelbin e mesazheve të larta qiellore, Allahu e ka përmbledhur në një ajet të vetëm të Kur’anit:

“Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se nuk ka Zot tjetër përveç Meje, pra më adhuroni vetëm Mua.” (El Enbija: 25)

Allahu i Lartësuar ka thënë, duke përmbledhur thelbin e asaj që ia shpalli të Dërguarit Tij, Muhamedit (salallahu alejhi ue selam):

“Thuaju: ‘Mua më është shpallur se i adhuruari juaj është Një i adhuruar i Vetëm. A do t’i nënshtroheni Atij pra?’” (El Enbija: 108)

Robërit nuk munden ta konceptojnë realitetin e adhurimit e ta zbatojnë atë në fjalët dhe punët e tyre, në qoftë se nuk do të njohin cilësitë e Krijuesit të Lartësuar.

Nga kjo që sqaruam, arrijmë të kuptojmë krimin e madh që kanë bërë ata të cilët mohojnë cilësitë e Allahut, emrat dhe veprat e Tij, ose një pjesë të tyre. Në këtë mënyrë ata bllokojnë rrugën e njohjes së Tij.

Pastrimi i shpirtave dhe edukimi i tyre që të adhurojnë Allahun, Një, të Vetëm

Mesazhet e zbritura nga Allahu synojnë të rregullojnë gjendjen e njeriun dhe rruga drejt këtij qëllimi është edukimi i robërve në adhurimin e Allahut. Çelësi me të cilin të Dërguarit hapën zemrat e njerëzve, ishin ajetet e Allahut të cilat flisnin rreth Zotit të tyre dhe i lidhnin zemrat e tyre me Të. Kështu drejtohen zemrat dhe fytyrat e robërve për tek një Zot i Vetëm.

Boshti rreth të cilit sillet i gjithë Kur’ani, është përmbledhja e cilësive të Allahut, përmbledhja e veprave të Tij në Univers, sqarimi i Madhësisë së Tij, ftimi i njerëzve për t’iu përgjigjur ligjeve të Allahut dhe për t’iu larguar gjërave që tërheqin zemërimin e Tij, si dhe sqarimi i shpërblimit që u jep Allahu atyre që i binden dhe i ndëshkimit me të cilin do t’i ndëshkojë ata që e kundërshtojnë.

Ky konstatim, siç ka ardhur në Kur’an, ka qenë dhe do të jetë faktori kryesor që lëviz zemrat, trondit nefset (vetet) dhe zhduk ndyrësitat e të këqijat që i pengojnë njerëzit nga e mira.

Lexojeni fjalën e Allahut, e cila tregon për ndikimin që lënë në shpirtat e të mirëve të Umetit, këto ajete të zbritura prej Tij:

“Allahu zbriti fjalët më të shkëlqyera, një Libër, pjesët e të cilit i përngjajnë njëra-tjetrës, në mirësi e vërtetësi, shpesh i përsëritur. Lëkurat e atyre që kanë frikë Zotin e tyre, dridhen prej tij. Pastaj lëkura dhe zemra e tyre zbutet me përkujtimin e Allahut”. (Ez-Zumer: 23)

Njohja e emrave dhe cilësive të Allahut, të mbron nga rrëshqitja në gabime, të ngre pas rënies në gabim (gjynah), të hap derën e shpresës, të ndihmon për durim dhe të mbron nga pesimizmi dhe dembelizmi.

Zemrat e njerëzve, ndoshta dëshirojnë të veprojnë gjynahe, por kur kujtojnë se Allahu i sheh dhe se do të dalin para Tij, tërhiqen dhe largohen nga ato. Njeriu bie

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

në gjynah, e pastaj kujton mëshirën e madhe të Allahut dhe nuk vazhdon më në veprimin e tij, nuk zhytet më shumë në rrugën e shkatërrimit, por kthehet tek Zoti i Tij, i Cili e pranon teuben (pendimin) e robërve dhe i mëshiron ata.

Robin e prekin fatkeqësi dhe gjëra të urryera, por ai nuk shqetësohet dhe nuk shfaq panik. I mbështetet Allahut dhe i përballon gjërat e urryera me zemër të kënaqur. Ibnul Kajim ka thënë: “Prej sekreteve të Kur’anit të madhërisëm, është se ai u drejtohet njerëzve me shprehje të cilat u shfaqin atyre Zotin e Lartësuar nëpërmjet cilësive të Tij. Në disa ajete, Allahu u shfaqet njerëzve me anë të cilësive të madhërisë dhe lartësisë. Këta i bëjnë njerëzit që të nënshtrohen, t’u thyhen zemrat, t’i drejtohen Atij me zëra të përkushtuar dhe t’u shkrihet mendjemadhësia, siç shkrihet kripa në ujë. Në disa ajete u shfaqet me anë të cilësive të bukurisë dhe përsosmërisë, të cilat tregojnë për bukurinë dhe përkryerjen e qenies. Kjo bën që njerëzit ta duan Allahun me të gjithë fuqinë e dashurisë që kanë, sipas njohurive të tyre rreth bukurisë dhe përsosmërisë së cilësive të Tij. Kështu që zemra e robit boshatiset nga çdo gjë tjetër, përveç dashurisë për Allahun.

Kur u shfaqet me anë të cilësive të mëshirës, bamirësisë dhe butësisë, lëviz fuqia e shpresës në zemrat e robërve dhe angazhohen për të punuar sa më shumë që të arrijnë mirësitë e Allahut.

Kur u shfaqet me cilësitë e drejtësisë, hakmarrjes, zemërimit, urrejtjes dhe ndëshkimit, frenohet nefsia që urdhëron për të keqen, dobësohet fuqia e tij për epsh, zemërim, lojë, lakmi dhe haram, e i shtohet frika nga ndëshkimi i Allahut.

Kur u shfaqet Allahu me anë të cilësive të urdhërimit, ndalimit, besës, porosisë, dërgimit të të dërguarve, zbritjes së librave dhe ligjëvënies, atëherë lëviz dëshira dhe fuqia e robërve për ta zbatuar e përcjellë të vërtetën dhe për të besuar lajmet me të cilat kanë ardhur të dërguarit.

Kur u shfaqet me anë të cilësive të dëgjimit, shikimit dhe dijes, rigjallërohet dhe aktivizohet tek robi fuqia e turpfit. Ai turpërohet që Zoti i tij të shikojë e të dëgjojë atë që e urren Ai, ose të fshehë në zemrën e tij atë që e bën të urryer tek Allahu. Kështu që lëvizjet, thëniet dhe mendimet e tij, do të rendin sipas kritereve dhe standardeve të Sheriatit.

Kur u shfaqet me anë të cilësive të mjaftimit, dashurisë, rregullimit të gjërave në interes të tyre, shmangies së fatkeqësive prej tyre, ndihmimit të të dashurve të Tij dhe mbrojtjes së tyre, rigjallërohet tek robi fuqia për t’iu mbështetur Allahut, për t’i dorëzuar sukseset dhe rezultatet e punëve në dorë të Tij, si dhe për t’u kënaqur me atë që vepron Allahu ndaj tij.”¹

1) Marrë në mënyrë të përmbledhur nga “Esmaul-llahi ue sifatuhu” (El Eshkar).

Dija më e lartë është njohja e Allahut

Që në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen, njerëzit kanë pasur zell të madh për dije dhe njohuri. Ata kërkojnë nëpër gërmadha dhe shpella, për të njohur ngjarjet e popujve të kaluar dhe gjendjet e tyre, studiojnë profecitë që flasin për të fshehtën që të njohin ngjarjet që do të ndodhin, shpikin satelitë për të studiuar yjet dhe planetet, madje kanë dërguar anije kozmike, të cilat lëvizin në hapësirë, për të zbuluar e sqaruar të fshehtat e Universit.

Njerëzit kanë studiuar tokën dhe shtresat e saj, malet, kodrat etj., janë zhytur në dete për të njohur kafshët dhe sekretet që gjenden në to, kanë studiuar njeriun, kafshët dhe bimët, kanë përpiluar libra për të regjistruar njohuritë që kanë marrë gjatë kohërave dhe kanë përpiluar dhe zbatuar shkenca të ndryshme, si historinë, gjeografinë, astronominë, kiminë, fizikën, mjekësinë etj..

Përderisa grada e dijes varet nga grada e asaj që kërkohet të njihet, atëherë padyshim dija që na njeh me Zotin tonë, është dija e gradës më të lartë. Ai që ka dituri dhe njohuri rreth Allahut, është më i mirë se ai që ka njohuri rreth njerëzve, kafshëve, shtresave të tokës, yjeve etj..

Ibnul Arabiu, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Grada e lartë e dijes, varet nga grada e lartë e asaj që dihet. Krijuesi është më i Lartë se të gjitha gjërat e tjera që mund të njihen, si rrjedhojë dituria rreth emrave të Tij, është dituria më e lartë.”

Islami i fton pasuesit e Tij për dituri, vëzhgim dhe hulumtim në Univers, por ai i kritikon ata njerëz, dituria e të cilëve qëndron në kufijtë e jetës dhe nuk i kalon ato, për të njohur Krijuesin e jetës dhe për të kuptuar qëllimin e krijimit të saj dhe të gjallesave:

“Ata dinë vetëm pamjen e jashtme të jetës së kësaj bote dhe janë krejt të pavëmendshëm për fundin e punëve në Jetën e Përtejme.” (Err-Rrum: 7)

Në qoftë se njohuritë fetare janë njohuritë më të mira dhe më të larta, padyshim dija që na bën të njohur Zotin tonë, është më e larta ndër të gjitha njohuritë. Prandaj ajetet që na japin njohuri rreth Allahut, emrave dhe cilësive të Tij, janë ajetet më të mira të Kur’anit. Ajeti “El Kursij”, sikurse është përcjellë në hadith të saktë, është ajeti më i mirë në librin e Allahut dhe sureja “Ihlas” është e barabartë me një të tretën e Kur’anit. Këto ajete janë madhëruar vetëm për faktin se bëjnë fjalë për Allahun, të Adhuruarin e Vetëm me të drejtë.

Njohja e emrave dhe cilësive të Allahut, është themeli (baza) për njohjen e çdo gjëje tjetër

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Allahu i Lartësuar është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është Urdhëruesi që jep urdhër, “El Keumijeh”, për krijimin dhe formimin e gjërave, si dhe urdhërat fetare që duhet të zbatohen:

“Padysim që i Tij është Krijimi dhe Komandimi (urdhërimi). (El A’raf: 54)

Kështu, ai që nuk e njeh Allahun me anë të emrave dhe cilësive të Tij, nuk njeh origjinën e krijimit dhe urdhërimit, pra, nuk njeh bazën që është e nevojshme për njohjen e çdo gjëje tjetër, përveç Allahut.

Shtimi i Besimit

Besimi shtohet me dije dhe punë. Sa më shumë dije të ketë rob rreth Allahut dhe ajeteve të Tij, aq më shumë i shtohet besimi. Po kështu, rob i shtohet besimi kur i përgjigjet urdhërave të Allahut.

Besimi, sikurse shtohet me dije dhe me punë, pakësohet për shkak të mangësisë së dijes dhe punës:

“Sa herë zbrit ndonjë sure, disa prej tyre (hipokritëve) thonë: ‘Cilit prej jush iu shtua besimi?’ Sa për ata që besojnë, ajo e ka shtuar besimin e tyre dhe ndjejnë kënaqësi. Por sa për ata, në zemrat e të cilëve ka sëmundje (mëdyshje, mosbesim, hipokrizi), ajo do të shtojë dyshim e mosbesim në mosbesimin e tyre. (Et-Teube: 124-125)

Besimtarët i besojnë ajetet e zbritura të Allahut dhe njohuritë e ligjet që përmbajnë ato, dhe vendosin të zbatojnë atë që ftohen për ta zbatuar. Kjo padyshim ua shton besimin. Ndërsa munafikëve ua shton kufrin, sepse ata përgënjeshtrojnë dhe nuk pranojnë t’i përgjigjen Allahut.

Nuk ka dyshim se emrat dhe cilësitë e Allahut janë nga gjërat më të madhërishme që janë sqaruar përmes argumenteve fetare. Kështu, ai që i beson, e kupton domethënien e tyre dhe punon sipas saj, i shtohet besimi.

Ai që i mëson përmendësh emrat e Allahut, kupton domethënien e tyre dhe punon sipas saj, merr shpërblim të madh

Ebu Hurejre ka transmetuar se i Dërguari i Allahut = ka thënë: *“Vërtet Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra, njëqind pa një emër, të cilët kush i mëson përmendësh, e kupton se çdo të thonë dhe punon sipas domethënies së tyre, hyn në Xhenet.”* (Trans. Buhariu)

Ibnul Kajim ka thënë se fjala “ihsa” – ادعاء, që është përmendur në hadithin e Buhariut: *“Me të vërtet Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra të cilëve kush u bën ‘ihsa’, hyn në Xhenet”,* ka për qëllim tri kuptime:

- 1) Mësimi i këtyre emrave përmendësh, siç ka ardhur në një transmetim tjetër: *“Kush i mëson ato përmendësh, hyn në Xhenet”*.
- 2) Kuptimi i domethënieve të këtyre emrave.
- 3) Lutja e Allahut me këta emra dhe adhurimi i Tij sipas domethënies së tyre.

Të madhërosh Allahun dhe t’i lutesh Atij me emrat e bukur dhe cilësitë e larta

Emrat e bukur dhe cilësitë e larta të Allahut, tregojnë për Madhështinë e Tij, prandaj ato janë të shumta. Përderisa emrat e Allahut dhe cilësitë e Tij u tregojnë robërve madhështinë e Krijuesit dhe përsosmërinë e Tij, nuk ka dyshim se ato janë rruga më e mirë dhe më e saktë që ndjekin robërit për madhërimin dhe lutjen e Tij.

Allahu i Lartësuar na ka urdhëruar në Kur’an që t’i lutemi Atij me anë të emrave të Tij të bukur dhe kjo është lutja më madhështore me të cilën robi i drejtohet Allahut:

“Dhe të Allahut janë të gjithë emrat më të bukur, kështu që luteni Atë me to...” (El A’raf: 180)

Një nga rregullat e lutjes është që robi të lutet me anë të emrave të bukur të Allahut. Madje nuk plotësohet besimi në emrat e bukur të Allahut, derisa robi ta lusë Allahun me ta.

Lutja ndahet në dy lloje: “lutja e kërkimit” (dua’ul mes’eletu) dhe “lutja e adhurimit dhe lavdërimit” (dua’ul ibadeti ue thena).

“Lutja e kërkimit” është kur robi kërkon arritjen e asaj që i bën dobi dhe largimin e shmangien e asaj që i bën dëm. Për sa i përket emrave të bukur të Allahut, “lutja e kërkimit” bëhet duke e lutur Allahun për një kërkesë apo nevojë që kemi dhe duke përmendur emrin e Tij që i përshtatet asaj nevojë. Gjithashtu duke iu drejtuar Allahut me anë të emrave të Tij të bukur në lutje, si për shembull: “O Allah, më fal mua dhe më mëshiro, se vërtet Ti je Mëkatfalës, Mëshirëbërës.”

Kështu na janë transmetuar lutjet në Kur’an dhe Sunet:

“Zoti ynë, mos i bëj zemrat tona të shmangen nga e vërteta pasi Ti na ke udhëzuar dhe na dhuro mëshirë nga mëshira Jote. Vërtet Ti je Dhuruesi më i Madh (El Uhab).” (Ali Imran: 8)

Profeti = i mësoi Aishes që të thoshte në Natën e Kadrit: “O Allah! Ti je Falës dhe e do faljen e gabimeve e të gjynaheve, prandaj më fal mua.” (Transmeton Tirmidhiu dhe të tjerë. Hadithi është i saktë.)

“Lutja e adhurimit” është kur robi e adhuron Allahun dhe e lavdëron Atë me anë të emrave të Tij të bukur. Pra, ta adhurosh dhe ta lavdërosh Allahun me çdo emër të Tijin, sipas domethënies së atij emri, p.sh. të pendohesh vazhdimisht sepse Ai është

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Et-Teuab - Pranues i pendimit, dhe të bësh dhikër vazhdimisht sepse Ai është **Es-Semië** - Gjithëdhëgues.

Ibnu Kajim el Xheuzije ka thënë: “Me të vërtetë njeriu që bën adhurimin më të përkryer ndaj Allahut, është ai i cili e adhuron Allahun me të gjithë emrat e Tij, të cilët i dinë njerëzit.

Në temat e ardhshme, inshallah, do të shohim shumë ajete dhe hadithe të cilat përbajnë madhërimin e Allahut me anë të emrave dhe cilësive të Tij, si dhe lutjen me anë të tyre.

Njohja e Allahut në përputhshmëri me metodën e Kur’anit dhe Sunetit është shkak për mëkëmbjen në tokë dhe devijimi nga kjo rrugë është shkak për humbje, poshtërim dhe dekadencë

Njohja e Allahut të Lartësuar sipas metodës së Kura’nit dhe Sunetit, e forcon besimin e drejtë në Allahun dhe i bën robërit të ecin në rrugën e drejtë. Ecja në rrugën e drejtë i afron robërit drejt Zotit të tyre, kështu që Allahu do të kënaqet me ta, do të zbresë mbi ta mirësitë e Tij dhe kjo do të bëhet shkak për triumf, fitore dhe mëkëmbje të muslimanëve në tokë. Si rrjedhojë, do të realizohet premtimi i Allahut të Lartësuar:

“Allahu u ka premtuar atyre nga mesi juaj që besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi, se Ai patjetër do t’u sigurojë vazhdimësi në tokë, ashtu siç ua siguroi këtë popujve përpara tyre, dhe se Ai do t’u sigurojë fuqinë për të zbatuar e përmbushur fenë e tyre, të cilën Ai e ka zgjedhur për ta. Dhe padyshim që Ai do t’u japë atyre në shkëmbim siguri e ruajtje pas frikës së tyre. Këta besimtarë të më adhurojnë vetëm Mua dhe të mos bashkojnë gjë tjetër me Mua. Por kushdo që nuk beson pas kësaj, këta janë fasikunë (të pabindur).”
(En-Nur: 55)

Në qoftë se muslimanët do të devijojnë nga e drejta që Allahu ka pëlqyer për ta, kjo do të jetë padyshim shkak për rënien e sovranitetit dhe pushtetit të tyre si dhe shkak i domonimit të armiqve mbi ta. Argumentet e Kur’anit dhe Sunetit tregojnë se përhapja e kufrit, shirkut dhe bidadit, moszbatimi i Islamit të saktë dhe përçarja, janë shkaqet kryesore të prapambetjes dhe poshtërimit të muslimanëve. Gjithashtu edhe ngjarjet tragjike që ka kaluar dhe vazhdon të kalojë bota islame, dëshmojnë se largimi nga Islami dhe përhapja e koncepteve të gabuara rreth tij, është shkaku kryesor i tyre.

Ibnu Tejmiye ka dhënë shembuj të shumtë për pasojat shkatërruese të humbjeve, devijimeve dhe bidadeve në botën islame. Ai ka thënë se: “Qeveria ‘Umuuije’ ka rënë për shkak të bidadit të Xha’d ibni Derhem, i cili mohonte cilësitë e Allahut.”

Në fundin e shekullit të pestë të hixhrit, kryqëtarët filluan të pushtonin fiset shame njërin pas tjetrit, derisa e morën “Bejtul Makdesin” dhe më pas e rrethuan Damaskun, kështu që banorët e Shamit ishin në gjendjen më të rënduar, të ndodhur midis kafirëve të krishterë dhe hipokritëve ateistë.

Ibnu Tejmije, në lidhje me këto ngjarje ka sqaruar: “Shfaqja e hipokrizisë, bidateve dhe shthurjes - gjëra që bien në kundërshtim me fenë e të dërguarve - ka qenë shkak i sundimit të armiqve mbi muslimanët.”

Nga ana tjetër ai ka sqaruar se si ka ndikuar shfaqja e devocionit fetar dhe ndjekja në mënyrë të përpiktë e fesë, në kohën e Nured-din esh-Shehid dhe Salahud-din Ejjubit, për luftimin e “el ubejdijin”, renegatëve, njerëzve të prishur dhe kryqëtarëve.

Dijetari i shekullit, shejh Albani, Allahu e mëshiroftë, pasi ka sqaruar rëndësinë e besimit sipas asaj që ka ardhur në Kur'an dhe Sunetin e saktë, ka thënë: “Shumica e thirrësve të Islamit sot, i lënë muslimanët të përçarë në idetë dhe mendimet e tyre dhe nuk interesohen për t'i bashkuar ata në Islamin e saktë që ka ardhur në Kur'an dhe Sunet. Disa prej tyre, kryesisht interesohen për t'i orientuar në sjelljen islame dhe disa të tjerë nuk bëjnë gjë tjetër tjetër, vetëm se i arsimojnë pasuesit e tyre në politikë, ekonomi dhe të tjera sfera, rreth të cilave vërtitet fjala e shumicës së publicistëve dhe analistëve të sotëm. Ndërmjet tyre vërejmë njerëz që nuk e falin namazin dhe megjithatë pretendojnë se do të krijojnë shoqërinë islame dhe do të gjykojnë me ligjin e Allahut! Sa larg që janë nga realizimi i kësaj ideje! Padyshim që një shoqëri e tillë, ku do të gjykohet me ligjin e Allahut, mund të realizohet, vetëm në qoftë se propaganduesit e saj do ta nisin nga ajo që e nisi i Dërguari i Allahut, duke ftuar në rrugë të Allahut sipas asaj që ka ardhur në Kur'an dhe sipas asaj që ka sqaruar i Dërguari i Tij.”

Kreu 2. EMRAT E ALLAHUT

Bazat e emrave të Allahut të Lartësuar

Baza e parë. Emrat e Allahut janë të gjithë të bukur, të përkryer dhe të përsosur

Allahu në Kur'an ka thënë: **“Me të vërtetë Allahut i takojnë emrat e përkryer e të bukur, prandaj luteni Atë me ta.”** (El Isra: 110)

Ata janë të tillë sepse përmbajnë kuptime dhe cilësi, të cilat janë të përkryera e të përsosura.

Shprehjet, për sa i përket kuptimit të tyre ndahen në tri grupe:

1) Shprehje apo fjalë, të cilat kanë në mënyrë absolute, gjithmonë kuptim të bukur e të përkryer. Emrat e Allahut janë të gjithë të tillë.

2) Shprehje apo fjalë, të cilat kanë herë kuptim të mirë dhe herë kuptim jo të mirë.

3) Shprehje apo fjalë, të cilat kanë gjithmonë kuptim të mangët, jo të mirë.

Nuk ka dyshim, se emrat e Allahut bëjnë pjesë në shprehjet e grupit të parë, sepse çdo emër i Allahut përmban cilësi të përsosura e të përkryera.

Le të sjellim disa shembuj për këtë:

- Një nga emrat e Allahut është **El Haj - لحي - i Gjalli, i Përjetshmi.**

Ky emër i Allahut, përmban në vetvete cilësinë e jetës së përsosur të Allahut të Madhëruar, e cila nuk ka fillim dhe mbarim, nuk i ka paraprirë Atij inekzistenca në të kaluarën dhe kurrë nuk do të ndodhë kjo në të ardhmen:

“Dhe mbështetu tek i gjalli i Cili nuk vdes.”

“Ai, Allahu, është Një, i Vetëm dhe i Pashok, i Gjallë, i Përjetshëm.”

Jeta e Allahut, në mënyrë të pashmangshme tregon për Dijen, Shikimin, Dëgjimin dhe të tjera cilësi të Tij të përsosura.

- Emri i Allahut **El Alim - العليم - i Gjithëdituri**, përmban në vetvete ekzistencën e dijes së përkryer të Allahut. Atij nuk i ka paraprirë padituria, asgjë nuk ka qenë jashtë dijes së Tij dhe asgjë nuk do të jetë në të ardhmen. Ai nuk mund të harrojë asgjë:

“Dija e tyre është tek Zoti im, në shkresën e duhur. Zoti im nuk është i pavetëdijshëm dhe Ai nuk harron.” (Ta Ha: 52)

“Dhe tek Ai janë çelësat e së fshehtës që askush nuk i di përveç Tij. Ai di çfarë ka në tokë dhe në det. Nuk ka asnjë gjethe që bie dhe Ai të mos ketë dijeni për të. Nuk ka asnjë grimcë në errësirën e tokës, asgjë të njomë ose të thatë, që të mos jetë shkruar në shkrim të qartë.” (El En Am: 59)

“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar furnizimin asaj. Ai e di vendbanimin dhe vendruajtjen e saj, e të gjitha këto janë në librin e qartë.” (Hudë: 6)

“Me të vërtetë Allahut nuk i fshihet asgjë në qiej e as në tokë.”

“Ai e di gjithçka që është në qiej e në tokë dhe e di atë të cilën e fshihni dhe e shfaqni. Me të vërtetë Allahu është i ditur për atë që fshehin gjokset.” (Et-Tegabun: 4)

- Emri i Allahut **Err-Rrahman - الرحمن - i Gjithëmëshirëshmi**, është një prej emrave të bukur të Allahut. Ai përmban cilësinë e mëshirës së përkryer, për të cilën Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Me të vërtetë Allahu është më i mëshirshëm për robërit e Tij se sa kjo grua për fëmijën e saj.”* Bëhet fjalë për një nënë që e gjeti foshnjën e saj ndërmjet robërve, e mori atë, e vendosi në prehrin e saj dhe i dha gji. Profeti (salallahu alejhi ue selam), pasi vuri re veprimin e saj, tha fjalët e lartpërmendura.

Emri **Err-Rrahman** tregon se Mëshira e Allahut është gjithpërfshirëse:

“Mëshira Ime ka përfshirë çdo gjë.”

Për lutjen që melekët bëjnë për besimtarët, Allahu ka thënë:

“Zoti ynë, ke përfshirë çdo gjë me mëshirë dhe dije.”

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Çdo emër i Allahut, duke e marrë parasysh më vete, ka bukuri dhe përsosmëri. Në qoftë se do të përmendet së bashku me një emër tjetër, ky bashkim përbën një bukuri dhe një përsosmëri edhe më të madhërishme se ajo që ka çdo emër më vete. P.sh., emri i Allahut **El Aziz** - العزيز, tregon për fuqinë dhe krenarinë e plotë dhe të përkryer të Allahut, ndërsa **El Hakim** - الحكيم, tregon për gjykimin me drejtësi të Allahut dhe për urtësinë e Tij. Përmendja e këtyre dy emrave së bashku, tregon për një përsosmëri edhe më të lartë. N.q.s. i Gjithëfuqishmi, Krenari, i Lartësuari, nuk do të ishte i Urtë dhe Gjykues i Drejtë, mund të bënte padrejtësi, sikurse ndodh me njerëzit e pushtetshëm në Dynja. E nëse Gjykuesi i Drejtë dhe i Urtë, nuk do të ishte i Lartë, i Fortë e Krenar, ai mund të cilësohej si i dobët e i paaftë, siç cilësohen njerëzit e drejtë dhe të urtë, por jo të fuqishëm (nuk do të pranohej gjykimi i tij).

Të gjithë emrat e Allahut kanë domethënie të qartë, pra të gjithë janë “muhkeme” - محكمة, që do të thotë: të qartë e të kuptueshëm.

Për sa i përket cilësive që përmbajnë këta emra, ato janë “muhkemetur” - محكمه nga njëra anë dhe “muteshabihe” - متشابه (të pakuptueshme) nga ana tjetër.

Cilësitë janë “muhkemetur” për sa i përket domethënies së tyre, dhe “muteshabihe” për sa i përket përshkrimit të formës dhe mënyrës se si ato janë. Më gjerë rreth kësaj teme do të flasim në kapitullin e cilësive.

Baza e dytë. Besimi në emrat e Allahut ka tri kushte. Nëse këto kushte nuk plotësohen, besimi në emrat dhe cilësitë e Allahut nuk është i saktë

Kushti i parë. Besimi në emrat e Allahut.

Ky kusht përmban dy rregulla:

1- Pohimi i emrave të Allahut në mënyrë konkrete.

Emrat **Err-Rrahman** - ehdi الرحمن **Err-Rrahim** - الرحيم, ia pohojmë realisht Allahut.

Shejhul islam ibnu Tejmije ka thënë: “Të gjithë ata, të cilët ia pohojnë emrat Allahut të Madhëruar, besojnë se Ai është me të vërtetë **El Haj** - الحى (i Gjalli, i Përjetshmi) dhe **El Alim** - العلي (i Gjithëdijshtëm), e kështu me radhë në të gjithë emrat e Tij.”

2- Pjesë e besimit në emrat e Allahut, është besimi që Ai nuk u përngjason krijesave:

“Asgjë nuk i ngjason Atij.”

Kushti i dytë. Besimi në domethënien (kuptimin) e emrave të Allahut dhe në cilësitë që përmbajnë ata.

Kur dikush beson vetëm në emrat e Allahut dhe nuk beson se këta emra kanë domethënie të kuptueshme për ne, besimi i tij në emrat e Allahut nuk është i saktë. Për këtë tregojnë dy fakte:

a- Mosbesimi në domethëniet që kanë emrat e Allahut është “ilhadî” (devijimi) më i madh nga e vërteta:

“Lëri ata të cilët devijojnë në emrat e Allahut, ata do të shpërblehen për atë që kanë vepruar.” (Araf: 180)

b- Kemi thënë në rregullin e parë se emrat e Allahut janë të bukur dhe me domethënie të përkryer. Siç dihet, një emër i bukur dallohet nga një emër tjetër jo i bukur, për shkak të domethënies së tij. Sikur emrat e Allahut të mos përmbanin domethënie dhe cilësi të përkryera, siç thonë grupet e humbura, atëherë nuk do të ishin të përsosur dhe në kulmin e bukurisë.

Çdo emër i Allahut është **Alem** – علم (emër i përveçëm që tregon për Qenien e Allahut) dhe **Uesfun** - وصف (atribut që tregon për një cilësi dhe domethënie të caktuar).

Emrat e Allahut janë të përveçëm, duke marrë parasysh faktin që ata tregojnë për Qenien e Allahut, dhe attribute, duke marrë parasysh domethëniet dhe cilësitë për të cilat ata tregojnë. Atëherë të gjithë emrat e Allahut kanë të njëjtën vlerë, për sa i përket faktit që ata tregojnë për një qenie të vetme (Allahun), kurse për sa i përket cilësive dhe domethënieve të tyre, janë të ndryshëm, sepse çdo emër tregon për një cilësi dhe një kuptim të vëçantë, për të cilin nuk tregon asnjë emër tjetër.

Ibnu Uthejmin ka thënë: “Për këtë tregon Kur’ani dhe gjuha arabe. Në një ajet të Kur’anit Allahu thotë:

‘Ai është Mëkatfalësi, Mëshirëbërësi.’ (Junus: 107)

‘Zoti yt është Mëkatfalësi (El-Gafurr) që ka mëshirë (rrahme).’

Emrin **Err-Rrahim** – رحيم, të përmendur në ajetin e parë, Allahu e ka shpjeguar në ajetin e dytë me fjalën e Tij: **‘që ka mëshirë’** - ذوالرحمة. Kjo tregon se emri i Allahut **Err-Rrahim** – الرحيم, ka kuptimin: Allahu ka mëshirë. Sikurse **Err-Rrahim**, po ashtu edhe çdo emër tjetër i Allahut, ka domethënien e tij.”

Të gjithë dijetarët e gjuhës arabe dhe të gjithë njerëzit me logjikë të shëndoshë, e mbështesin këtë që thamë. Mund t’i thuhet **El Haj** - الحى - **i Gjalli**, vetëm atij që ka jetë dhe mund t’i thuhet **El Alim** - العليم - **i Gjithëdituri**, vetëm atij që ka dije, e jo atij që nuk ka.

Nga kjo që sqaruam, del në pah (bëhet i qartë) devijimi dhe humbja e muëtezilëve, të cilët i kanë mohuar domethëniet dhe cilësitë që përmbajnë emrat e Allahut. Ata thonë se po t’i pohonim Allahut shumë cilësi, kjo do të thoshte se qeniet që nuk kanë fillim janë të shumta, kur dihet që i Pafillimtë është vetëm Allahu i Lartësuar. Kjo arsye është e pasaktë dhe e palogjikshme. Argumentet e Kur’anit dhe të Sunetit, si dhe logjika e shëndoshë e hedhin poshtë këtë:

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

1- *Kur'ani dhe Suneti.*

Allahu i Lartë e ka përshkruar Veten e Tij në Kur'an me shumë cilësi e attribute. Nëse këto cilësi do të tregonin se ka shumë qenie që nuk kanë fillim krahas Allahut, atëherë Allahu nuk do të kishte përmendur në Kur'an se Ai është i cilësuar me këto cilësi:

“Me të vërtetë goditja e Zotit tënd është e fortë. Me të vërtetë Ai është i Cili e fillon dhe e përsërit krijimin dhe Ai është që i fal mëkatet dhe është i dashur. Ai është Zot i Arshit madhështor dhe gjithëveprues i asaj që dëshiron e punon.” (Buruxh: 12-15)

“Madhëroje emrin e Zotit tënd më të Lartit, i Cili krijoi (gjithçka) dhe pastaj e përpjestoi drejt (këtë krijim).” (El A'la: 1-2)

Në këto ajete Allahu na ka bërë të njohur disa cilësi të Qenies së Tij. Sikur të ishte e saktë ajo që thonë muëtezilitët, Ai nuk do t'ia kishte atribuar Vetes së Tij këto cilësi.

2- *Logjika.*

Logjika e shëndoshë tregon se cilësia e një qenieje nuk është e shkëputur nga vetë qenia, por është veti (atribut) thelbësore dhe e përhershme e saj. Prandaj cilësitë janë veti (attribute) të Allahut, i Cili është përshkruar me to.

Mendja e njeriut nuk mund të përfytyrojë asgjë që ekziston, të pacilësuar me disa veti të saj. Çdo qenie, detyrimisht ka këto cilësi:

a- Ekzistencën.

b- Kjo ekzistencë është e mundshme ose e domosdoshme (e detyrueshme).

c- Kjo ekzistencë është cilësi e një qenieje ose është qenia vetë.

Pasi sqaruam që emrat e Allahut janë të gjithë të bukur sepse përmbajnë domethënie të përkryera, duhet të bëhet e ditur se “koha” (ed-dehru – الكوه), nuk është prej emrave të Allahut. Kjo fjalë nuk përmban ndonjë domethënie të bukur dhe të përkryer që të bejë pjesë në emrat e Allahut. “Ed-dehër” është emër i kohës, koha është e krijuar, ajo është *kalimi i ditëve dhe i netëve*. Allahu Teala thotë në Kur'an për mohuesit e ringjalljes:

“Ata thanë se kjo nuk është gjë tjetër vetëm se jetë e kësaj bote, vdesim e ngjallemi dhe nuk na shkatërron (zhduk) vetëm se ed-dehër (koha).”

Këtu bëhet fjalë se shkatërruese është **ed-dehr**, e cila është *kalimi i ditëve dhe i netëve*, prandaj **ed-dehër** (koha), nuk ka ndonjë domethënie të bukur e të përkryer që të jetë një nga emrat e bukur të Allahut.

Për sa i përket hadithit të Profeti (salallahu alejhi ue selam), ku thuhet se Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Më bën keq Mua biri i Ademit (më shan, nuk më lartëson, pastron, dlihtëson nga të metat), ai e shan kohën kur Unë jam koha. Në dorën Time është komandimi dhe rregullimi i çështjeve. Unë bëj ndryshimin e natës dhe të ditës.”, ai nuk tregon se koha është prej emrave të Allahut. Ajo që shanin disa nga bijtë e Ademit është koha në të cilën ndodhin ngjarje të ndryshme dhe e cila perceptohet nga kalimin i ditës dhe natës. Të gjitha këto janë të krijuara, prandaj fjala e Allahut **“...Unë jam koha...”**, është shpjeguar me fjalët **“...në dorën Time është komandimi dhe rregullimi i çështjeve, Unë bëj ndryshimin e natës dhe të ditës”**. Kjo tregon se Allahu me fjalën “ed-dehër”, ka pasur për qëllim kuptimin: “Unë jam krijuesi i kohës, bëj ndryshimin e ditës dhe të natës.” Në hadith, koha është përshkruar si diçka që ndryshon dhe kalon. Allahu nuk mund të jetë Ai që ndryshon dhe kalon, por Ai që bën të mundur ndryshimin dhe kalimin e kohës.

Kushti i tretë. Besimi dhe pohimi i veprimeve, ndikimeve dhe pasojave që rrjedhin nga emrat e Allahut.

Emri i Allahut **Err-Rrahim** - الرحيم - **Mëshirëbërësi**, tregon se Allahu ka rrahmet - حمير - mëshirë, dhe si rrjedhojë e Mëshirës së Tij është mirëbërja ndaj krijesave: futja e disave prej tyre në Xhenet, zbritja e shiut e të tjera pasoja, ndikime e veprime që rrjedhin nga kjo mëshirë, e të cilat nuk mund të numërohen. Por jo nga të gjithë emrat e Allahut rrjedhin veprime, ndikime, gjurmë dhe pasoja. Në lidhje me këtë çështje, emrat e Allahut ndahen në dy grupe:

Grupi i parë. Emra prej të cilëve rrjedhin veprime, pasoja e ndikime, domethënia e të cilëve mund të quhet *kalimtare* ose *veprorë*, si për shembull emri i Allahut **Err-Rrahim** - الرحيم - **Mëshirëbërësi**.

Në qoftë se domethënia e emrave të Allahut është *veprorë* ose *kalimtare* duhet të bëjmë tri gjëra.

a- Pohimin që ky është emër i Allahut.

b- Pohimin e cilësisë që përmban ky emër.

c- Pohimin e veprimit, ndikimit dhe pasojës që përmban ai.

Prandaj dijetarët e Islamit kanë thënë: “Nëse kaçakët (banditët) që dalin në rrugë për të frikësuar njerëzit, për t’i grabitur apo për t’i vrarë, pendohen para se t’i kapin organet kompetente, masa penale që e ka obliguar Sheriati në raste të tilla, nuk zbatohet kundër tyre, por ata falen.¹ Allahu thotë në Kur’an:

‘Përveç atyre, të cilët pendohen përpara se t’i kapni (të hyjnë nën pushtetin tuaj), atëherë dijeni se Allahu është Mëkatfalës, Mëshirëbërës.’”

¹) Më gjerë në lidhje me këtë çështje, le të vërehen librat e Fikhut, sepse edhe në rastin e pendimit dhe të dorëzimit të tyre para se të kapen, në qoftë se kanë shkaktuar ndonjë dëm, duhet ta dëmshpërblejnë atë.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Dijetarët, këta dy emra i kanë marrë si argument që tregon se Allahu ua ka falur mëkatet atyre dhe i ka mëshiruar me moszbatimin e dispozitës së Sheriatit mbi ta.

Ibn Kajim el Xheuzije ka thënë: “Vëreni në veprimet, ndikimet dhe gjurmët e përgjithshme dhe të veçanta të Mëshirës së Allahut. Ai, me Mëshirën e Tij na ka çuar të dërguarit dhe na ka zbritur Librin, na ka mësuar pasi ishim të paditur, na ka bërë të shikojmë pasi ishim të verbër e na ka udhëzuar pasi ishim të humbur. Me Mëshirën e Tij na ka lajmëruar për cilësitë, emrat dhe veprat e Tij, që ta njohim Atë nëpërmjet tyre. Me Mëshirën e Tij na ka mësuar atë që nuk e dinim, dhe me Mëshirën e Tij ka bërë për ne Diellin dhe Hënën, ditën dhe natën.

Grupi i dytë. Emra prej të cilëve nuk rrjedhin veprime, pasoja dhe ndikime, domethënien e të cilëve mund ta quajmë *joveprore* ose *jokalimtare*. Në lidhje me këta emra duhet të pohojmë dy gjëra:

- a- Besimin e emrit të Allahut.
- b- Besimin e cilësisë që përmban ai.

Për sa i përket p.sh. emrit të Allahut **El Haj** - الـحـي - **i Gjalli, i Përrjetshmi**, në lidhje me të duhet pohuar:

- a) Emri: **El Haj** - الـحـي .
- b) Cilësia që ai përmban: **El Hajat** - الـحـيـاة - **Jeta**.

Baza e tretë. Të gjithë emrat e Allahut janë “teukifije” (d.m.th. merren vetëm nga Kur’ani dhe Suneti i saktë).

Njeriut nuk ka të drejtë që sipas mendjes ose logjikës së tij ta emërtojë Allahun me emra të cilët nuk kanë ardhur në Kur’an dhe Sunet, siç kanë bërë filozofët, disa prej muëtezilive dhe sufite, por duhet që këta emra të merren vetëm nga Kur’ani dhe Suneti i saktë.

Ta emërtojmë Allahun me emra që nuk kanë ardhur as në Kur’an dhe as në Sunet është padrejtësi kundrejt Tij. Është detyrë që të jemi të edukuar me Allahun Teala dhe të qëndrojmë në tekste të Kur’anit dhe të Sunetit:

“Dhe mos e thuaj atë për të cilën nuk ke dituri, se me të vërtetë të dëgjuarit, të parët dhe zemra, të gjitha këto janë përgjegjëse dhe secila prej tyre do të pyetet.” (El Isra: 36)

“Thuaj: ‘(Por në të vërtetë) gjërat që i ka ndaluar Zoti im janë El Fahisha (gjynahet e mëdha, çdo lloj afrimi me gratë jashtë martesës etj.) që kryhen hapur ose fshehur, gjynahet (e tjera të çdo lloji), shtypja pa të drejtë, vënia shok Allahut në adhurim (adhurimi i të tjerëve përkrah a përveç Atij), gjë për të cilën Ai nuk ka dhënë asnjë të drejtë dhe asnjë provë, si dhe përfolja e Allahut për gjëra që ju nuk keni asnjë dijeni.’” (El A’raf: 33)

“O njerëz! Hani nga ajo që është e ligjshme dhe e mirë në tokë dhe mos ndiqni gjurmët e shejtanit. Padyshim që ai është për ju armik i hapur. Shejtani ju urdhëron vetëm të keqen dhe Fahsha (ç’është gjynah dhe e dënueshme), (si) dhe që ju të thoni kundër Allahut çfarë ju nuk e dini.” (El Bekare: 168-169)

Baza e katërt. Emrat e Allahut nuk janë të kufizuar me ndonjë numër të caktuar

Për këtë tregon hadithi i transmetuar nga Abdullah ibn Mes’udi, se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Nëse ndonjërin e kap ndonjë brengë, pikëllim apo vështirësi dhe thotë: ‘O Allah unë jam rob i Yt, biri i robit Tënd dhe biri i robëreshës Tënde. Unë jam në dorën Tënde dhe në të drejtën time zbatohet gjykimi Yt. I gjithë caktimi Yt për mua është i drejtë. Të lus Ty me çdo emër që Ti ke, me të cilin e ke quajtur Vetën Tënde, ose e ke zbritur në librin Tënd, ia ke mësuar ndonjëres prej krijesave të Tua, ose e ke ruajtur në dijen Tënde të fshehtë, e cila është tek Ti, ta bësh Kur’anin e Madhëruar pranverën (gjallërimin, gjelbërimin) e zemrës sime dhe dritën e gjoksit tim, të tillë që të më largojë brengën, mërzitjen dhe vështirësinë time’, Allahu e zhdruk brengën, mërzitjen dhe vështirësinë e tij dhe ia zëvendëson atë me gëzim e lumturi.”* (Trans. Ahmedî, Hakimi dhe shejh Albani e ka bërë të saktë.)

Ky hadith tregon që emrat e Allahut nuk janë të kufizuar me ndonjë numër të caktuar, sepse emrat që i di Allahu dhe janë në dijen e Tij të fshehtë, nuk i di asnjë nga krijesat e Tij. Prandaj, nuk i lejohet askujt, që të kufizojë emrat e Allahut me ndonjë numër të caktuar.

Për sa i përket hadithit: *“Me të vertetë Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra, të cilët kush i mëson përmendësh hyn në Xhenet”* (Muslimi), në të nuk tregohet se emrat e Allahut janë vetëm nëntëdhjetë e nëntë.

Imam Neueuiu ka thënë: *“Të gjithë dijetarët janë të mendimit se ky hadith nuk tregon që emrat e Allahut janë të kufizuar në nëntëdhjetë e nëntë, sepse Profeti (salallahu alejhi ue selam) nuk thotë që emrat e Allahut janë vetëm nëntëdhjetë e nëntë dhe nuk ka emra të tjerë përveç tyre, por ka pasur për qëllim të thotë se Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra (ndër emrat e Tij), të cilët kush i mëson përmendësh Ai e fut në Xhenet.”*

Kjo nuk do të thotë që Allahu nuk ka emra të tjerë, por këta nëntëdhjetë e nëntë emra, janë të tillë që nëse njeriu i mëson, i kupton dhe punon me ta, hyn në Xhenet. Kjo është njësoj si të thuash se një njeri ka 100 derhemë të cilët do t’i japë sadaka. Kjo nuk do të thotë se ai nuk ka derhemë të tjerë, por do të thotë se këta 100 derhemë i ka llogaritur t’i japë sadaka. Pra, fjala e Profetit (salallahu alejhi ue

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

selam) në hadith: “...*kush i mëson ata përmendesh hyn në Xhenet*“, është plotësim i fjalisë së parë e jo fillim i një fjalie të re.

Si përfundim, qëllimi i Profetit (salallahu alejhi ue selam) është lajmërimi për hyrjen në Xhenet me anë të mësimit përmendësh të këtyre emrave dhe jo lajmërimi për kufizimin e tyre.

Përcaktimi i nëntëdhjetë e nëntë emrave nuk ka ardhur as në Kur'an e as në Sunetin e saktë, kurse hadithi që transmeton Tirmidhiu nga Uelid bin Muslim për përcaktimin e nëntëdhjetë e nëntë emrave është i dobët, sepse Uelidi konsiderohet transmetues i dobët.

Shejhul islam ibnu Tejmije ka thënë: “Të gjithë dijetarët që kanë dituri rreth shkencës së hadithit, janë të një mendimi se Profeti nuk i ka përcaktuar nëntëdhjetë e nëntë emrat, ndërsa hadithi që ka transmetuar Uelidi është i dobët.”

Në një fetva ai ka thënë: “Uelid bin Muslim i ka marrë këta emra prej disa mësuesve të tij nga Shami, siç është sqaruar në disa prej rrugëve të hadithit të tij.”

Ibn Haxher el Askalani ka thënë: “Ajo që e bën hadithin të dobët, sipas mendimit të Buhariut dhe Muslimit, nuk është vetëm fakti që atë e transmeton Uelid bin Muslim (i cili është transmetues i dobët), por ka edhe difekte të tjera si ‘idtirrab’ (mosmarrëveshje në lidhje me transmetimin e tij) dhe ‘idrraxh’ (shitesa në tekst) e gjithashtu Uelidi është ‘mudel-lis’.”

Baza e pestë. Devijimi në emrat e Allahut (ilhad)

Përkufizimi i termit “ilhad” është: *Devijimi në emrat e Allahut, duke mohuar ose shqetësuar vërtetësinë dhe domethëniet e tyre, ndryshe nga çfarë është përmendur në Kur'an dhe Sunet.*

“Ilhadi” në emrat e Allahut ndahet në katër lloje:

1- Ta emërtosh Allahun me emra të cilët nuk kanë ardhur as në Kur'an e as në Sunet.

Ky është devijim sepse ne kemi thënë që emrat e Allahut janë “teukifije”. Shembull i këtij devijimi janë kristianët që e quajtnë Allahun “Atë”, ose filozofët që e quajtnë “arsyeja vepruese”.

2- Të nxjerrësh nga emrat e Allahut emra për idhujt.

Ky është devijim gjithashtu, sepse këta emra janë të veçantë për Allahun, ashtu siç është ibadeti që i takon vetëm Atij. Prandaj, emërtimi i dikujt tjetër me këta emra, me qëllim që t'i kushtohet atij adhurimi përveç Allahut dhe t'i dedikohen cilësi që nuk i takojnë, është “ilhad”. Shembull për këtë është veprimi i mushrikëve, të cilët nxirrnin nga emri i Allahut **El Aziz** - العزيز - **I Potfuqishmi**,

emër për idhullin e tyre **El Uz-za**, nga emri i Allahut **El Ilah (I Adhuruari)** emrin **El-Lat** dhe nga emri i Allahut **El Menan (Dhuruesi)** emrin **Menat**.

3- Të mohosh emrat ose domethëniet dhe cilësitë që përmbajnë ata, si dhe të mohosh rregullat dhe veprimet që rrjedhin prej tyre.

Edhe ky është devijim, sepse besimi në emrat e Allahut nuk mund të plotësohet pa u besuar të gjitha këto. “Ilhadi” i xhehmijve, është mohimi i emrave dhe cilësive të Allahut, kurse “ilhadi” i muëtezilëve, është mohimi i cilësive që përmbajnë emrat e bukur të Allahut. Ata thonë p.sh. se: “Allahu është Mëshiruesi (Err-Rahman) pa mëshirë.”

4- Të përngjasosh cilësitë që përmbajnë emrat e Allahut me cilësitë e krijesave.

Ky është devijim, sepse përngjasimi i Allahut me krijesat dhe përngjasimi i cilësive të Tij me ato të krijesave, është diçka e pamundur dhe jo e saktë.

Allahu ka thënë në Kur'an: **“Asgjë nuk i përngjan Atij. Ai është Dëgjuesi, Shikuesi.”**

Nuejm bin Hamad el Huzai ka thënë: “Ai që e përngjason Allahun me krijesat e Tij dhe ai që i mohon cilësitë me të cilat Allahu ka cilësuar Vetën e Tij, bën kufër. Nuk ka dyshim se cilësitë me të cilat Allahu ka përshkruar Vetën e Tij, nuk janë të ngjashme me ato të krijesave.”

Këto ishin katër llojet e “ilhadi”, i cili si i tillë është i ndaluar, sepse Allahu i ka kërcënuar me një ndëshkim të rëndë ata që devijojnë në emrat e Tij:

“Allahut i takojnë emrat më të bukur, ndaj luteni Atë me ta dhe largojuni shoqërisë së atyre të cilët i përgënjeshtrojnë emrat e Tij. Ata do të shpërblehen për çfarë kanë vepruar.” (El A'raf: 180)

E kundërta e Njëshmërisë së Allahut në emrat dhe cilësitë e tij (Teuhidul esma ues'sifat), është “shirku” dhe “ilhadi”.

“Shirku” në cilësitë e Allahut, ndodh atëherë kur i vihet Atij ortak ose rival në cilësitë e Tij. Për të cilësuar një person të veçantë (i cili pretendon se është musliman ose “ehlul kible”, sipas termit të dijetarëve të akides) “kafir”, nuk lejohet të nxitohemi, derisa të plotësohen kushtet e “tekfirit”¹ dhe të eliminohen pengesat e tij, sepse jo kushdo që bën kufër, bëhet kafir. Njeriu mund të thotë një shprehje, ose të bëjë një vepër e cila është kufër, por nuk cilësohet “kafir”, përderisa në të drejtën e tij nuk janë plotësuar kushtet dhe nuk janë eliminuar pengesat e “tekfirit”. Prej pengesave më të rëndësishme të “tekfirit”, në lidhje me këtë temë, është interpretimi dhe imitimi. Për më gjerë rreth rregullave të “tekfirit” mund të shohim librat e Akides.

“Kufri” në emrat dhe cilësitë e Allahut, bëhet duke mohuar ndonjë emër ose cilësi që ka ardhur në argument të saktë, pas informimit rreth këtij argumenti.

¹) Tekfir do të thotë cilësimi i një personi “kafir” (mosbesimtar). (Shën. i redaktorit).

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Gjithashtu bëhet me “ilhad”, duke ndryshuar domethënien për të cilën tregojnë tekstet e Kuranit dhe Sunetit, pa pasur ndonjë dyshim ose arsye, me të cilën personi mund të justifikohet.” (Marrë nga Komisioni i Përhershëm i Fetvave)

Shejh ibn Uthejmin ka thënë: “Mohimi i emrave dhe i cilësive të Allahut ndahet në dy lloje.

1- Mohim me karakter përgënjeshtrimi.

Ky pa dyshim është kufër. Sikur ndonjëri të mohonte një nga emrat ose cilësitë e Allahut që ka ardhur në Kur'an dhe në Sunetin e saktë, si p.sh. të thotë se Allahu Teala nuk ka dorë, ai është “kafir”, pa kundërshtim tek të gjithë muslimanët. Përgënjeshtrimi i lajmit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij është kufër i cili të nxjerr nga feja.

2- Mohim me karakter keqinterpretimi (d.m.th. të mos përgënjeshtrohen por të mohohen).

Në këtë lloj kemi të bëjmë me dy raste:

a) Interpretimi të jetë i lejueshëm nga ana gjuhësore (d.m.th. interpretimi që i bëhet fjalës të jetë një ndër variantet e kuptimit të fjalës në gjuhën arabe¹). Në këtë rast interpretimi nuk është kufër.

b) Interpretimi të mos jetë i lejueshëm sipas gjuhës arabe (d.m.th. të mos ketë asnjë lidhje gjuhësore ndërmjet fjalës në gjuhën arabe dhe interpretimit që i është bërë). Në këtë rast interpretimi është kufër sepse mohimi është absolut. Ky interpretim në realitet është përgënjeshtrim. Shembulli i këtij rasti është sikur të thuhet për fjalën e Allahut: **“Përkundrazi, të dy duart e Tij janë gjerësisht të shtrira”** (El Maide 64), se dy duart janë qiejt dhe Toka. Me këtë keqinterpretim personi bëhet “kafir”, sepse ky interpretim nuk është i saktë në gjuhën arabe dhe personi në fjalë është mohues e përgënjeshtues.

Ndërsa shembulli për rastin e parë është sikur të thuhet se dy duart janë Mirësia dhe Fuqia e Allahut. Me këtë interpretim personi nuk bëhet “kafir”, sepse fjala “dora” në gjuhën arabe, përdoret edhe në kuptimin “en-nieme” (mirësia), por ky kuptim është në kundërshtim me kuptimin e saj të drejtpërdrejtë. (Marrë nga “El Mexhmeuth-Themin”, 2, 62-63)

(Shih në fundin e këtij libri “Gjykimi ndaj mohuesit të cilësive”)

¹) Thënë me fjalë të tjera, të ketë një farë lidhjeje gjuhësore, qoftë edhe të largët, ndërmjet fjalës dhe interpretimit që i është bërë asaj.

Nëntëdhjetë e nëntë emrat e Allahut të marrë nga Kur’ani dhe Suneti i saktë

Pasi sqaruam në bazën e pestë se nëntëdhjetë e nëntë emrat e Allahut nuk janë përcaktuar (përmendur) në ndonjë hadith të saktë, do të përpiqemi që të përmendim nëntëdhjetë e nëntë emra nga ata që kanë ardhur në Kur’an dhe Sunetin e saktë, sipas parimeve që kanë vendosur dijetarët për nxjerrjen e tyre nga këto dy burime. Por përpara se të fillojmë duhet të sqarojmë tri çështje:

1. Kemi përmendur që emrat e Allahut nuk janë të kufizuar me ndonjë numër të caktuar, sepse siç ka ardhur në hadithin e Ibn Mesudit, ka emra që i di vetëm Allahu dhe askush tjetër përveç Tij, si dhe emra që Allahu ia ka mësuar vetëm disa prej krijesave dhe jo të tjerave. Pas gjithë këtij sqarimi lind pyetja: Emrat e Allahut të përmendur në Kur’an dhe në Sunet (pa i llogaritur të tjerët), a janë të kufizuar në nëntëdhjetë e nëntë, apo janë më shumë? Dijetarët kanë dhënë dy mendime:

Mendimi i parë, është që në Kur’an dhe Sunet janë përmendur më shumë se nëntëdhjetë e nëntë emra, përderisa Ibnul Arabi në “Ahkamul Kur’an” ka përmendur 146 emra dhe ka thënë se ka edhe më shumë.

Pastaj, për sa i përket përcaktimit të nëntëdhjetë e nëntë prej tyre, kanë dhënë dy mendime:

a) Duhet t’i mësosh të gjithë emrat që kanë ardhur në Kur’an dhe Sunet që të qëllosh nëntëdhjetë e nëntë emrat për të cilët bën fjalë hadithi, sepse ata janë të përcaktuar, por janë të fshehur si: ora e ditës së xhuma në të cilën pranohet lutja, nata e Kadrit etj.

b) Mjafton që të mësosh nga të gjithë emrat, nëntëdhjetë e nëntë prej tyre. Kushdo që i mëson nëntëdhjetë e nëntë emra, e meriton shpërblimin e përmendur në hadith, sepse qëllimi është të mësohen nëntëdhjetë e nëntë emra nga ata që kanë ardhur në Kur’an Sunet, pa përcaktim.

Mendimi i dytë, është që emrat e ardhur në Kur’an dhe Sunet janë të kufizuar në numrin nëntëdhjetë e nëntë dhe nuk ka të tjerë veç tyre.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Prej studimit të tërësishëm të argumenteve të Kur'anit dhe Sunetit, rezulton se në to janë përmendur më shumë se nëntëdhjetë e nëntë emra, kështu që ai i cili mëson nëntëdhjetë e nëntë emra të papërcaktuar nga ata që janë përmendur në Kur'an dhe Sunet, shpresohet të arrijë shpërblimin e përmendur në hadithin e Ebi Hurejres.

2. Nëse kemi disa emra të cilët janë nxjerrë nga një cilësi e vetme¹, çdo emër do të numërohet si emër i veçantë, p.sh. emrat e Allahut: **El Kadir** - ال كادر, **El Kadijr** - ال كدير, **El Muktedir** - الم ق تدر, cilësia e të cilëve është “el kudretu” - القدرة (dhe pikërisht kjo është edhe rrënja e fjalës), ose emrat e Allahut të Lartësuar: **El Aëla** - الأعلى, **El Alij** - ال علي, **El Muteal** - الم تعال, cilësia e të cilëve është “el uluu” - العلو.

Ndryshimi në disa shkronja ose shtimi i disa të tjerave, bën që të ketë njëfarë ndryshimi edhe në kuptim, prandaj dijetarët janë të gjithë të një mendimi se **Rrahman** - الرحمن - **Mëshirues** dhe **Rrahim** - الرحيم - **Mëshirëbërës**, janë dy emra të veçantë, edhe pse janë marrë nga e njëjta cilësi (nga e njëjta rrënjë fjale), e cila është “rrahme” - الرحمة - mëshirë. (Ky sqarim është marrë nga dijetari i famshëm Ibnu Haxher el Askalani)

3. Kur përmenden dy emra të Allahut të Lartësuar të shoqëruar me njëri-tjetrin, atëherë duhet t'i përmendim të dy së bashku, por çdonjërin e numërojmë si emër më vete, sepse çdonjëri prej tyre ka një kuptim të veçantë nga tjetri, si p.sh. emrat e Allahut **El Kabid** - El Basit, القابض الباسط dhe **El Mukadim** - El Muekhirr - الم ق دم المؤخر.

Ata duhet të përmenden së bashku, sepse që të dy bashkë përbëjnë një domethënie e cila tregon se Allahu është **Gjithërregulluesi** i çështjeve, **Krijuesi** i vetëm dhe se nuk ka Zot tjetër përveç Tij, prandaj kjo domethënie mund të jetë e bukur dhe e përkryer vetëm duke u përmendur të dy këta emra së bashku.

Siç kemi thënë, Allahu ka emra të bukur dhe të përkryer dhe nëse ne do të përmendnim njërin emër pa e shoqëruar me tjetrin, nuk do të ishte lavdërim dhe përsosje për Zotin tonë.

Më poshtë po japim nëntëdhjetë e nëntë emra të nxjerrë nga Kur'ani dhe Suneti i saktë.

1- Allah - الله .

Është përmendur shumë herë në Kur'an: “**Thuaj: ‘Ai, Allahu është Një, i Vetëm.’**” (El Ihlas: 1) Disa dijetarë kanë thënë se ky emër nuk përmban ndonjë domethënie, por është një emër i përveçëm që tregon për Qenien e Allahut. Ky

¹) Bëhet fjalë për emrat që kanë të njëjtën rrënjë fjale.

mendim nuk është i saktë sepse origjina e këtij emri në gjuhën arabe është “ilah” - الإله, që do të thotë “i adhurar” dhe rrënja e fjalës “ilah” është “elihe, je’lehu, ilaheten dhe uluheten”- الإلهة و، ألوهة, që do të thotë “adhuroi, adhuron, adhurim”. Kështu që emri Allah - الله, është i përbërë nga pjesëza “eli” - أل dhe fjala “ilah” - الإله (i adhurar). Si rrjedhojë, kuptimi i emrit “**Allah**” është “**i Adhuruari**”.

Ibnu Abaz ka thënë: “Allahu është Ai të Cilët i takon ta adhurojnë të gjitha krijesat.”

2- El Ehad - الاحد - Një, i Vetëm.

Është përmendur në fjalën e Allahut: “**Thuaj, Ai, Allahu është Një, i Vetëm.**” (El Ihlas: 1)

3- El Eala - الأعلى - Më i Larti.

Është përmendur në fjalën e Allahut: “**Madhëroje emrin e Zotit tënd, Më të Lartit.**” (El A’la: 1)

4- El Ilah - الإله - i Adhuruari.

Është përmendur në fjalën e Allahut: “**Dhe Ilahu (i Adhuruari) juaj është Një i Adhurar i Vetëm.**” (El Bekareh: 163)

5- El Barri - البري - Shpikësi i Pashembullt i çdo gjëje.

Është përmendur në fjalën e Allahut: “**Ai, Allahu është Gjithëkrijuesi, Shpikësi i Pashembullt i çdo gjëje.**” (El Hashër: 24)

6- El Ekrem - الأكرم - Fisniku, Bujari.

Është përmendur në fjalën e Allahut: “**Lexo dhe Zoti yt është më Bujari.**” (El Alak: 3)

7- El Berru - البر - Bamirësi, Dhuruesi i madh.

Është përmendur në fjalën e Allahut: “**Me të vërtetë Ai është El Berr-rru (Bamirësi, Dhuruesi i madh, Mëshirëbërësi).**” (Et-Tur: 28)

8- El Basir - البصير - Gjithëshikuesi.

Është përmendur në fjalën e Allahut: “**Ai është Gjithëshikuesi, Gjithëdëgjuesi.**” (Esh-Shura)

9- Es-Semi - اسمع - Gjithëdëgjuesi.

Argument për të është ajeti i mësipërm.

10- Et-Teuab - التواب - Pranuesi i pendimit prej robërve të Tij.

Është përmendur në fjalën e Allahut: “**Me të vërtetë Ai është Et-Teuabu (Pranues i pendimit prej robërve të Tij), Mëshirëbërësi.**” (El Bekare: 38)

11- El Xheb-bar - الجبار -

Kuptimet e këtij emri janë:

a- Madhështori, i Gjithëfuqishmi.

b- Rregulluesi i çështjeve të robërve të Tij. E pasuron të varfërin, e shëron të sëmurin, ia mbyll plagën të plagosurit etj.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

c- **Urdhëruesi**, të Cilit nuk mund t'i kthehet urdhëri.

Argument është ajeti: “**Allahu është Ai përveç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër të merituar, Mbizotëruesi, i Shenjti, i Gjithëpërsosuri pa asnjë të metë, Gjithëdhuruesi i sigurisë (besimit), Gjithëvëzhguesi mbi krijesat e Tij, El Xheb-baru** (Urdhëruesi i papërballueshëm, i Gjithëfuqishmi).” (El Hashër: 23)

12- **El Xheuad** - الجواد - Ai që jep dhe dhuron shumë.

Argument është fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selam): “*Vërtet Allahu është Xheuad (Dhurues i Madh) që e do bujarinë dhe bujarin.*” (Transmeton ebu Nuajmi në “El hilje” dhe hadithi është përmendur në “Sahiul xhamië”)

13- **El Xhemil** - الجميل - **i Bukuri.**

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë në hadith: “*Me të vertetë Allahu është i Bukur dhe e do të bukurën.*” (Muslimi)

Prej këtij emri është marrë cilësia “dhatije” el xhemal - bukuria.

Allahut të Lartësuar i takon bukuria absolute. Bukuria e krijesave me të gjitha ngjyrat, llojet dhe artet e saj të shumta, është një pjesë e vogël nga gjurmët e bukurive të Tij. Allahu e meriton më tepër dhe është më i denjë që të jetë bukuria atribut i Tij, sesa atribut i çdo gjëje tjetër.

Ai që u ka dhuruar bukurinë qenieve, patjetër që është kulminacioni i bukurisë. Allahu është i Bukur në Qenien e Tij, emrat, cilësitë dhe veprat e Tij.

Bukuria e Qenies së Tij është aq e madhe, saqë asnjë krijesë nuk mund të përshkruajë qoftë edhe sado pak prej saj. Mjafton si argument për këtë, të dimë se banorët e Xhenetit - megjithëse gjenden në begati të përhershme, kënaqësi dhe gëzime që nuk mund të përshkruhen - kur të shikojnë Zotin e tyre, do të kënaqen me bukurinë e Tij dhe do t'i harrojnë të gjitha kënaqësitë e tjera, aq sa do të dëshirojnë që të qëndrojnë vazhdimisht vetëm duke parë Allahun.

Të gjithë emrat e Allahut janë emrat më të bukur dhe më të përkryer. Ata tregojnë për përsosmërinë e lavdisë, lartësisë, bukurisë dhe madhësisë, e pikërisht këtu qëndron bukuria e cilësive të Allahut.

Për sa i përket bukurisë së veprave të Allahut, ato vërtiten (sillen) ndërmjet bamirësisë, bujarisë, mirëbërjes dhe drejtësisë, për të cilat lavdërohet e falenderohet, dhe kjo është në përputhje me urtësinë dhe lavdinë e Tij.

Pra, në cilësitë e Allahut nuk ka kotësi, marrëzi dhe padrejtësi. Përkundrazi, të gjitha janë mirësi, mëshirë, udhëzim, orientim, drejtësi dhe urtësi:

“**Nuk ka dyshim që Zoti im është në udhën më të drejtë** (në të vërtetën).” (Hud: 56)

Përsosmëria e veprave të Allahut rrjedh nga përsosmëria e Qenies dhe cilësive të Tij, sepse veprat janë pasojë e cilësive. Këto cilësi - siç thamë - janë cilësitë më të

përkryera, prandaj nuk është e çuditshme që veprat e Tij të jenë veprat më të përkryera.

14- **El Hasib** - الحسيب - **Llogaritësi**. Ai që i kërkon llogari robërve të Tij për veprat e tyre. Ai që i mjafton robërve të Tij nëse do të mbështeten tek Ai:

“Allahu është i mjaftueshëm për Hasib (Llogaritës).” (En-Nisa: 6)

15- **El Hafidh** - الحافظ - **Ruajtësi** i çdo gjëje. **Mbikqyrësi** mbi çdo gjë. Nuk i humbet Atij asgjë nga punët e robërve të Tij:

“Me të vërtetë Zoti yt është mbi çdo gjë Hafidh (Ruajtës).” (Hud: 57)

16- **El Hak** - الحق - **i Vërteti, i Përherëshmi, i Pandryshueshmi**:

“Dhe ata do ta marrin vesh se Allahu, Ai është El Hak (i Vërteti, i Qarti).” (En-Nur: 25)

17- **El Hakem** - الحكم - **Gjykuesi**, të Cilit askush nuk mund t’ia kthejë dhe përballojë gjykimin dhe caktimin.

Argument është fjala e Profetit alejhi selam: **“Me te vërtetë Allahu është “El Hakem.”** (Transmeton Nesaiu. Albani ka thënë që “isnadi” është i mirë.)

18- **El Hakim** - الحكيم - **Më i Urti, Gjithëgjykuesi**:

“...Ai, Allahu është Aziz (i Gjithëfuqishëm), El Hakim (i Urti, Gjithëgjykuesi).” (Sebe’ë: 27)

19- **El Halim** - الحليم - **i Buti, i Durueshmi**, i Cili nuk nxiton në ndëshkimin e robërve të Tij:

“Dhe me të vërtetë Allahu është Alimun (i Gjithëdiqshëm), Halimun (i Durueshëm, i Butë).”

20- **El Hamid** - الحميد - **i Denji** për të gjitha lavdërimet. **I Lavdëruari** që i meriton të gjitha lavdërimet:

“Me të vërtetë Allahu është më i Pasuri (i lirë nga çdo nevojë), i Denjë për të gjitha lavdërimet.”

21- **El Hajj** - الحجي - **i Gjalli, i Përjetshmi**:

“Allahu la ilahe il-lahu uel Hajjul-Kajjum.” (Ali Imran: 2)

“Të gjitha fytyrat do të nënshtrohen para El Hajju, El Kajjum.” (Ta Ha: 111)

22- **El Hajij** - الحدي - **i Turpshmi**.

El Menave ka thënë: **“El Hajij është ai që ka shumë turp.”**

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Me të vërtetë Allahu është El Hajij (i Turpshëm)...”** (Trans. Ebu Daudi dhe Albani në “Sahihul xhami” ka thënë se është i saktë.)

23- **El Habir** - الخبير - **Njohësi** i çdo gjëje:

“Me të vërtetë Allahu është më i Buti, më Dashamirësi dhe Latifun Habirun (Njohësi i çdo gjëje).” (Haxh: 63)

24- **El Halik** - الخالق - **Gjithëkrijuesi**:

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

“Ai është Allahu, Gjithëkrijuesi ...” (El Hashër: 24)

Duhet të jemi të qartë se krijimi - si veprim i Allahut - është gjë tjetër dhe pasojat e krijimit (krijesat) janë gjë tjetër. Kështu që krijimi është veprim që i atribuohet Qenies së Allahut, ndërsa pasojat e krijimit (krijesat) janë të ndara e të shkëputura nga Ai. (Marrë shkurtimisht nga “Mexhmul fetua”, kap. 12, fq. 435-436.)

Një kuptim tjetër i këtij emri është **Përcaktuesi** i gjërave sipas dëshirës së Tij, siç ka thënë në tefsirin e tij Sheukani.

25- **El Halak** - الخلاق - **Krijuesi** i çdo gjëje:

“A nuk është Ai i Cili krijoi qiejt dhe Tokën i zoti të krijojë (përsëri) si ato?

Po. Nuk ka pikë dyshimi dhe Ai është El Halaku, El Alijm (Krijuesi, i Gjithëdituri).” (Ja Sin: 81)

26- **Err-Rrazik** - الرزاق - **Gjithëfurnizuesi**.

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Me të vërtetë Allahu është *El Halik, El Kavid, El Basit, Err-Rrazik* (Gjithëfurnizuesi), *El Musair* (Çmimvënësi, Ai që i vendos, i ngre dhe i ul çmimet e gjërave).”** (Trans. Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Albani ka thënë në “Sahihul xhami” se hadithi është i saktë.)

27- **Err-Rrab** - الرب - **Zoti, Gjithëkrijuesi, Sunduesi, Gjithërregulluesi** i çështjeve.

Argument është hadithi që transmeton Muslimi, ku Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Për sa i përket rukusë, në të madhëroni *Err-Rrab* (Zotin).”**

28- **Err-Rrahman** - الرحمان - **i Gjithëmëshirshmi**.

29- **Err-Rrahim** - الرحيم - **Mëshirëbërësi**:

“Lavdërimet dhe falenderimet i takojnë Allahut, Zotit të botëve, të Gjithëmëshirëshmit, Mëshirëbërësit.” (El Fatiha: 1-2)

30- **Err-Rrez-zak** - الرزاق - **Gjithëfurnizuesi**:

“Vërtetë që Allahu është Err-rrez-zak, Gjithëfurnizuesi, Zotëruesi i Fuqisë, më i Forti.” (Edh-Dharijat: 58)

31- **Err-Rrafik** - الرفيق - **Dashamirësi, i Buti**.

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Me të vërtetë Allahu është *Rrafik* (Dashamirësi, i Buti) dhe e do butësinë.”** (Muslimi)

32- **Err-Rrakib** - الركيب - **Mbikqyrësi** i çdo gjëje, **Gjithëvëshguesi**.

Allahu në Kur'an ka thënë: **“Me të vërtetë Allahu është Rrakijb (Mbikqyrës, Gjithëvëshgues mbi ju).”** (En-Nisa: 1)

33- **Err-Rrauf** - الرؤف - **Mëshirëshumi, Dashamirësi**.

Ibnul Farisi ka thënë: **“Err-Rrauf rrjedh nga fjala ‘rre’fetun’, e cila tregon për butësi dhe mëshirë.”**

Allahu ka thënë në Kur'an: **“Me të vërtetë Allahu është Rrauf, Rrahim.”** (Nur: 20)

34- **Es-Sub-buh** – ال سد بوح .

Profeti (salallahu alejhi ue selam) thoshte në ruku dhe në sexhde: “**Sub-buhun, Kud-dusun, Rab-bul** melaiketi ue Rr-rruh (Subuuhun, Kuduusun, Zoti i engjëjve dhe i Xhibrilit).” (Trans. Muslimi.)

Imam En-Neueui, në shpjegimin e këtyre dy emrave ka thënë se kuptimi i tyre është Museb-bah - مسد بح dhe Mukad-des - مقدس - **i Lartësuari, i Pastri, i Dliri, i Shenjti**, larg të gjitha mangësive dhe të metave. **I Përsosur**, pa të meta, pa mangësi, pa shok dhe pa rival.

35- **Es-Sit-tir** - ال سد تير - Ai që i mbulon dhe i fsheh të metat dhe gabimet e robërve.

Argument është fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selam): “**Vërtet Allahu është Hajjijun** (i Turpshëm), **Sit-tirun** (Mbulues i të metave dhe gabimeve të robërve) dhe e do turpërimin dhe mbulimin. Prandaj, çdonjëri prej jush kur të lahet, le të mbulohet (në mënyrë që të mos ia shikojnë të tjerët pjesët e turpshme).” (Trans. Ebu Daudi, Nesaiu e të tjerë dhe hadithi është i saktë.)

36- **Es-Selamu** - السلام

Argument është fjala e Allahut:

“**Ai është Allahu, nuk ka të adhuruar tjetër përveç Tij, El-Melikul Kud-dus-Selamu** (Gjithësunduesi, i Shenjti, i Gjithëpërsosuri pa asnjë të metë)...” (El Hashër: 23)

Kuptimet i këtij emri janë:

a- **i Pastri** dhe **i Dliri** nga të metat e mangësitë (**i Gjithëpërsosuri** pa asnjë të metë).

b- Ai që i përshëndet me selam robërit e Tij në Xhenet:

“(Do t’u thuhet): ‘**Selam** (Paqja qoftë mbi ju).’ **Fjalë nga Zoti** (Allahu), **Mëshirëbërësi**.” (Ja Sin: 58)

c- Ai që i ka shpëtuar robërit nga padrejtësia e Tij, sepse ia ka ndaluar padrejtësinë Vetes së Tij.

d- **Shpëtuesi** i robërve të Tij.

37- **Esh-Shafi** - ال شافي - **Gjithëshëruesi**.

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj) transmeton se kur ndonjëri ankohej nga sëmundja, i thërrisnin të Dërguarit (salallahu alejhi ue selam). Ai e fshinte (e prekte me të djathtën e tij) dhe pastaj thoshte: “O Allah, Zoti i njerëzve, zhduke këtë sëmundje dhe shëroje. Ti je **Esh-Shafi** (**Gjithëshëruesi**), nuk ka shërim tjetër përveç shërimit Tënd. Shëroje me një shërim që nuk lë aspak sëmundje.” (Buhariu & Muslimi)

38- **Esh-Shakir** - ال شاکر - **Vlerësuesi** i veprave të mira që punojnë robërit e Tij. Ai që shpërblen robërit e Tij për punët që veprojnë, qofshin pak apo shumë:

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

“Kushdo që bën mirë me vullnetin e tij, atëherë padyshim që Allahu është Shakirun (Vlerësues për gjithçka), i Gjithëditur.” (El Bekare: 158)

39- **Esh-Shekur** - الشکور - Ai që i vleron dhe i çmon punët e robërve, Ai që e shpërblen atë që i bindet, duke ia shumëfishuar shpërblimin:

“Allahu është Shekurun, i Duruari.” (Et-Tegabun: 17)

40- **Esh-Shehid** - الشهيد - **Gjithëdëshmuesi, i Dituri** për çdo gjë.

“Padyshim që Ti je Gjithëdëshmuesi, i Dituri për çdo gjë (Shehid).” (El Maide: 116)

41- **Es-Samed** - السامد

Kuptimi i këtij emri është:

a- Ai të Cilit i drejtohen krijesat për çdo nevojë, meqenëse është **i Fuqishëm** dhe ka mundësi ta bëjë atë që i kërkohet.

b- **I Përkryeri** që i ka të gjitha cilësitë të përsosura në shkallën më të lartë. **Ai i Cili** nuk ka asnjë të metë.

c- **I Përhershmi**. Ai nuk ka pasur fillim dhe nuk ka mbarim.

d- Ai që nuk ka nevojë për asgjë, por të gjitha krijesat kanë nevojë për Të.

e- Ai që nuk ka brendësi. Shumë nga selefët (të parët) kanë thënë se **Es-Samed** është Ai që nuk ka brendësi.

Ikrima ka transmetuar se ibnu Abaz ka thënë: **“Es-Samed** është Ai, të Cilit i drejtohen krijesat për nevojat e tyre. Domethënë për realizimin dhe arritjen e nevojave të tyre.”

Ibnu Abazi ka thënë: **“Es-samed** është **Zotëruesi** që është i përkryer në zotërimin e Tij, Ai është **i Shenjti**, i përkryer në shenjtërinë e Tij, është **Madhështori**, i përkryer në madhështinë e Tij. Ai është **i Buti** që është i përkryer në butësinë e Tij, është **i Urti**, i përkryer në urtësinë e Tij dhe është **i Dituri** që është i përkryer në diturinë e Tij.”

42- **El Gaf-far** - الغفار - Ai që u fal mëkatet robërve të Tij dhe ua mbulon të metat:

“Zotit të qiejve dhe të tokës dhe i gjithë çfarë gjendet ndërmjet tyre. I Gjithëfuqishmi, gjithnjë Falësi i Madh (El Azizul, Gaf-far).” (Sad: 66)

43- **El Gafurr** - الغفور - **Mëkatfalësi:**

“Me të vërtetë Zoti im është Gafurr (Mëkatfalës), Rrahim.” (Jusuf: 53)

44- **El Aziz** - العزيز - **i Gjithëfuqishmi, Ngadhnjimtari, Dominuesi** mbi çdo gjë.

Argument është ajëti i mësipërm.

45- **El Alim** - العالم - **i Gjithëdituri:**

“Për çdo gjë Ne jemi të Gjithëditur.” (El Enbija: 81)

46- **El Alijm** - العليم - **i Gjithëdituri:**

“...Me të vërtetë Ai është (Hakim, Alijm) i Urti, i Gjithëdituri.” (Edh-Dharijat: 30)

47- El Adhim - ال عظيم - Madhështori:

“...Dhe Ai është (El Alim, El Adhim) më i Larti, më Madhështori.” (El Bekare: 255)

48- El Alij-j - ال علي - i Larti.

Argument është ajeti i mësipërm.

49- El Kadir - ال قادر - i Gjithëfuqishmi, i Plotfuqishmi:

“Thuaj: ‘Ai është El Kadiru, i Fuqishëm të dërgojë ndëshkim mbi ju nga lart ose nën këmbët tuaja...’” (El En Am: 65)

50- El Kahir - ال قاهر - Ngadhnjimtari, i Papërballueshmi:

“Dhe Ai është El Kahiru (i Papërballueshmi), më i Larti përmbi robërit e Tij dhe Ai është më i Urti Gjithëgjykues, i Mirënjohuri me çdo gjë.” (El En Am: 18)

51- El Kah-har - ال قهار - i Papërballueshmi, Ngadhnjimtari.

“O shokët e mi të burgut! A janë më mirë shumë zota të ndryshëm, apo Allahu Një, i Vetëm, El Kah-har (i Papërballueshmi), më i Larti?” (Jusuf: 39)

52- El Kadir - ال قدير - i Gjithëfuqishmi, i Plotfuqishmi.

“...dhe Ai është El Kadir (i Plotfuqishëm për të bërë çdo gjë).” (El Mulk: 1)

53- El Afu-u - ال عفو - Ai që i fshin mëkatet e robërve të Tij.

“...Me të vërtetë Allahu është Afu-un, Gafurr (Ai që i fshin dhe i fal mëkatet).” (Haxh: 60)

54- El Gani - ال غني - Ai që nuk ka nevojë për krijesat, por të gjitha krijesat kanë nevojë për të:

“Dhe Allahu është Ganijun (Ai që nuk ka nevojë për asgjë), Halim (i Butë, Durimtar).” (El Bekare: 263)

55- El Fet-tah - ال فتاح - Gjithëgjykuesi i drejtë.

“Dhe Ai është El Fet-tah, El Alim.” (Sebe: 26)

56- El Kud-dus - ال قدوس - i Shenjti, i Pastri nga të gjitha të metat e mangësitë:

“Allahu është Ai, përveç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër të merituar. Mbizotëruesi, El Kud-dus (i Shenjti), i Gjithëpërsosuri pa asnjë të metë.” (El Hashër: 23)

57- Et-Taj-jib - ال طيب - i Miri.

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “Me të vërtetë Allahu është **Taj-jib** (i Mirë) dhe pranon vetëm të mirën.” (Muslimi)

58- El Karib - ال قريب - i Afërti ndaj atyre që dëshiron t’u afrohet prej krijesave të Tij:

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

“**Dhe kur robërit e Mi, të pyesin ty** (o Muhamed) **për Mua, atëherë** (përgjigju atyre): **“Vërtet Unë (Allahu) jam Karib, Unë u përgjigjem duave** (lutjeve) **të lutësit kur ai më drejtohet Mua me lutje.”** (El Bekare: 186).

Të qenët e Allahut **i Lartësuar** mbi krijesat dhe afërsia e Tij ndaj atyre që dëshiron t’u afrohet, janë dy cilësi të cilat nuk bien në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Ai është **i Larti** në afërsinë e Tij dhe **i Afërti** në lartësinë e Tij (për më gjatë, shiko në kapitullin e cilësive, cilësinë e afërsisë dhe të afruarit të Allahut ndaj krijesave që dëshiron t’u afrohet).

59- **El Muxhijb** - المجديب - Ai që i përgjigjet lutjeve të robërve të Tij:

“**Me të vërtetë që Zoti im është Karijb (i Afërti), Përgjigjësi** (që i përgjigjet thirrjes ndaj tij).” (Hud: 61)

60- **El Muhsin** - المحسن - **Mirëbërësi.**

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “**Me të vërtetë Allahu është Muhsin (Bamirës) dhe e do bamirësinë (mirëbërjen).**” (Trans. Taberani dhe e ka bërë të saktë shejh Albani në “Sahihul xhami” dhe në “El ir’ua”).

61- **El Muktedir** - المقدّر - **i Gjithëfuqishmi.**

“**Në kuvendin e së vërtetës (në Xhenet) pranë Melijk (Sunduesit), Muktedir (të Gjithëfuqishmit).**” (El Kamer: 55)

62- **El Melijk** - الملِك - **Mbisunduesi, Gjithësunduesi.**

Argument është ajeti i mësipërm.

63- **El Melik** - الملك - **Mbisunduesi.**

“**Allahu është Ai, veç të Cilit nuk ka të adhuruar të merituar, El Melik (Mbisunduesi) ...**” (El Hashër: 23)

64- **El Metijn** - المتين - **Shumë i Fuqishëm, shumë i Fortë.**

“**Vërtet që Allahu është Gjithëfurnizues, Zotëruesi i fuqisë, El Metijn (shumë i Fuqishëm).**” (Edh-Dharijat: 58)

65- **El Kaj-jum** - القويم - **I Vetëqëndrueshmi, Mbajtësi** që i mban të gjitha krijesat dhe i bën të qëndrojnë. Ai që rregullon çështjet e krijesave dhe i mbron ato, i ruan e kujdeset për to:

“**Allahu është Ai, i Cili nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij, El Haj-jul, El Kaj-jum...**” (El Bekare: 255)

66- **El-Latif** - اللطيف - **i Buti, Dashamirësi, Gjithënjohësi** që e njeh çdo gjë, qoftë e vogël apo e madhe:

“**Dhe Ai është El-Latifu, El Habiru.**” (El En Am: 103)

67- **El Muhijt** - المحيط - **Gjithëpërfshirësi** i çdo gjëje me dijen e Tij.

“**Dhe Allahu mbi çdo gjë është Muhijt.**” (En-Nisa: 108)

68- **El Musauir** - المصور - Ai që i ka dhënë formën çdo gjëje, **Formësuesi** i gjithçkaje:

“**Ai është Allahu, Gjithëkrijuesi, Shpikësi i Pashembullt i çdo gjëje, Elmusavir (Formësuesi i gjithçkaje).**” (El Hashër: 24)

69- **El Mubin** - المبین - **i Qarti.**

“**Dhe ata do ta kuptojnë se Ai, Allahu, është i Vërteti, El Mubin (i Qarti).**” En-Nur: 25)

70- **El Mexhid** - المجدد - **i Lavdishmi, Madhështori, më i Larti** në lavdi.

“**Vërtet Ai është Hamidun (Zotëruesi i të gjitha lavdërimeve), Mexhidun (i Lavdishmi, më Madhështori në lavdi).**” (Hud: 73)

71- **El Kebir** - الكبير - **i Madhi.**

“**...dhe se vërtet Allahu, Ai është më i Larti, më i Madhi.**” (Lukman: 30)

72- **El Mutekeb-bir** - المتركب - **i Larti, Suprem, i Pastër** nga çdo gjë e keqe dhe e mangët që nuk i përshtatet Madhërisë së Tij, **i Vetëm** në cilësitë e madhërishme.

Ky emër në gjuhën arabe, rrjeth nga fjala “el kibër”, domethënia e parme e së cilës është mospranimi dhe mosnënshtrimi. Kjo cilësi (el kibër), kur i dedikohet Allahut është lavdërim, kurse kur i dedikohet krijesave është sharje dhe poshtërim, pasi Allahu nuk i nënshtrohet askujt, por të gjitha krijesat i nënshtrohen Atij. Argument për këtë emër të Allahut është ajeti i parafundit i sures Hashër:

“**... Ai është El Xheb-bar, El Mutekeb-bir ...**” (El Hashër: 23)

73- **El Muteali** - المتعالي - **i Larti.**

“**I Gjithëdituri për çdo gjë, të padukshme dhe të dukshme, më Madhështori, El Muteali (i Larti).**” (Er-Rrad: 9)

Sheukani ka thënë se ky emër do të thotë: “**I Lartësuar**, larg nga çdo gjë që thonë mushrikët dhe **i Lartë** mbi të gjitha krijesat me madhësitinë dhe fuqinë e Tij.”

74- **El Kauij** - القوي - **i Forti, Fuqiploti.**

“**Me të vërtetë Allahu është Kauij-jun, Azizun.**” (El Muxhadele: 21)

75- **El Mukijt** - المقيت - **i Plotfuqishmi, Ruajtësi, Gjithëdëshmuesi.** Ai që i jep çdo njeriu ushqimin e tij. (Kuptimi i fundit është përmendur nga El Ferra.)

Argument është fjala e Allahut në suren En-Nisa: “**Dhe Allahu është mbi çdo gjë Mukijt (i Plotfuqishëm, Gjithëdëshmues, Ruajtës).**”

76- **El Muhejmin** - المهيمن - **Gjithëvëzhguesi** i çdo gjëje.

a- **Gjithëdëshmuesi** i çdo gjëje.

b- **Ngadhënjyesi, i Larti.**

“**...El Muëminul Muhejminu ...**” (El Hashër: 23)

77- **El Men-nan** - المنان - **Dhuruesi** i madh, i Cili jep pa kërkuar ndonjë shpërblim.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Argument është hadithi i Enes ibn Malik i cili thotë: “*Isha ulur me Profetin (salallahu alejhi ue selam) në xhami, ndërkohë që një burrë ishte duke u falur. Ai tha: ‘O Allah, unë të lutem Ty sepse Ty të takon lavdërimi. Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Teje, (El Men-nan) Dhuruesi i Madh, Krijuesi i qiejve dhe i Tokës. O Ti që je gjithë madhështi dhe gjithë lavdi. O i Gjalli, i Përjetshmi.’ Atëherë Profeti (salallahu alejhi ue selam) tha: ‘E luti Allahun me emrin e Tij më të madh, kur rob i lutet me të Allahut, Ai i përgjigjet dhe kur i kërkon me të, Ai i jep.’”* (Trans. En-Nesai, Ebu Daudi etj.. Albani në “Sahih sunnen Ebi Daud”, thotë që hadithi është i saktë.)

78- **El Mu'min** - المؤمن.

a- Ai që vërteton besnikërinë e Profetëve të Tij nëpërmjet mrekullive që u jep. **Ai** që e mban premtimin ndaj robërve të Tij.

b- Ai që i siguron nga frika robërit e Tij besimtarë, në Ditën e Gjykimit.

Allahu thotë në Kur'an: “...**Es-Selamu, El Muëminu...**” (El Hashr: 23)

79- **El Meula** - المولى - **Përkrahësi, Mbrojtësi, Ai, të Cilit i mbështetemi.**

“Atëherë dijeni se Allahu është Meula (Mbrojtësi, Përkrahësi) për ju. Sa Meula i Shkëlqyer dhe sa Nesijr (Ndihmues) i shkëlqyer është Ai!” (El Enfal: 40)

80- **En Nesijr** - النصير - **Ndihmuesi.**

Argument është ajeti i mësipërm.

81- **El Hadi** - الهادي - **Udhëzuesi, në dorën e të Cilit është udhëzimi.**

“...më se i Mjaftueshëm është Zoti yt, si Udhëzues dhe Gjithëndihmues.” (El Furkan: 31)

82- **El Uahid** - الواحد - **Një, i Vetëm (i Pashok).**

Allahu në Kur'an ka treguar fjalët e Jusufit (alejhi selam) në burg: **“O shokët e mi të burgut! A janë më mirë shumë zota të ndryshëm, apo Allahu, El Uahidu (Një, i Vetmi, i Papërballueshmi, më i Larti)?”** (Jusuf: 39)

83- **El Uarith** - الوارث - **Gjithëtrashëguesi, i Cili trashëgon Tokën dhe çdo gjë që ndodhet në të, pasi t'i shkatërrojë krijesat e Tij, sepse Allahu është i Përhershmi, i Përjetshmi.**

“Ne jemi që ngjallim dhe sjellim vdekjen dhe Ne jemi Gjithëtrashëguesit.” (El Hixhër: 23)

84- **El Uasi** - الواسع.

a- **I Gjithëmjaftueshmi** për të plotësuar nevojat e krijesave të Tij.

b- **Gjithëpërfshirësi** që përfshin çdo gjë me dijen e Tij:

“Ai e ka përfshirë çdo gjë me dijen e Tij.”

c- Sheukani ka thënë se ky emër tregon për mëshirën gjithëpërfshirëse të Allahut, i Cili nuk i ka ngarkuar robërit me atë të cilën nuk e veprojnë dot, dhe i ka bërë të gjitha ritet e fesë të lehta.

d- El Furadu ka thënë: “Ai është **Bujari** dhe **Dhuruesi më i Madh**, i Cili ka përfshirë çdo gjë me dhuntinë e Tij.”

“**Vërtet Allahu është Uasiun, Alijm.**” (El Bekare: 115)

85- **El Uekijl** - الوكيل.

a- Ai të Cilit i mbështetemi për të rregulluar të gjitha çështjet tona.

Imam Sheukani ka thënë: “**El Uekijl** është Ai, të Cilit i dorëzojmë punët (çështjet) tona.

b- **I Gjithëmjaftueshmi**, i Cili kujdeset për ne.

“...dhe thanë: ‘Allahu na mjafton neve dhe për ne Ai është **Rregulluesi më i mirë i punëve.**’” (Ali Imran: 173)

86- **El Uelij** - الولي - Ai, i Cili i rregullon çështjet, në mënyrë që t’i bëjnë dobi robët në këtë botë dhe në botën tjetër.

“**Dhe Ai është El Uelij, El Hamijl.**” (Esh-Shuara: 28)

87- **El Uiter** - الودع - **Teku (i Vetmi).**

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “**Me të vërtet Allahu është Uitër (Tek, i Vetëm) dhe e do tekun.**” (Trans. Buhari)

Ibn Haxher ka thënë: “Kuptimi i këtij emri është se Allahu nuk ka asnjë shok dhe është **i Pashembullt**. Ai është i Vetëm, i ndarë dhe i shkëputur nga krijesat, nëpërmjet Qenies dhe cilësive të Tij. Pra, Allahu është **Një, Tek**, ndërsa të gjitha krijesat e Tij janë çift. Ai ka thënë: ‘**Dhe nga çdo gjë Ne kemi krijuar dy palë.**’ (Dharijat: 49) Fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selam) në hadith ‘e do tekun’, do të thotë që Allahu e do tekun në çdo gjë, edhe sikur gjërat teke të bëhen të shumta. Prandaj, Ai ka urdhëruar që shumë vepra e adhurime të përfundojnë me numër tek, si p. sh. pesë namazet e obliguara, namazi i vitrit, numri i herëve të pastrimit, qefinosja e të vdekurit etj. Në numër tek janë krijuar edhe shumë krijesa, si p.sh. qiejtë dhe Toka etj. (Marrë nga “El feth”)

88- **El Uehab** - الوهب - **Dhuruesi më i madh.**

“**Me të vërtetë Ti je Uehab (Dhuruesi më i Madh).**” (Ali Imran: 8)

89-90- **El Eu-uelu & El Ahiru** - الآخر & الأول.

El Eu-uelu - i Pari, i Cili nuk ka pasur fillim dhe para të Cilit nuk ka pasur asgjë.

El Ahiru - i Fundit, i Cili nuk ka mbarim dhe pas të Cilit nuk ka asgjë.

Këta dy emra tregojnë se Allahu është **i Pafillim** dhe **i Pambarim. I Përhershmi, i Përvetshmi**. Ata tregojnë se Allahu e ka përfshirë kohën.

91-92- **Edh-Dhahir & El Batin** - الظاهر & الباطن.

Edh-Dhahiru - Më i Larti, mbi të Cilin nuk ka asgjë, **Ngadhënjyesi**.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

El Batin - Më i Afërti (nuk ka gjë më të afërt me krijesat sesa Ai, me dijen e Tij, nuk ka asnjë pengesë ndërmjet Tij dhe krijesave të Tij, Ai e di çdo gjë që ndodh apo fshihet në brendësi).

Këta dy emra tregojnë se Allahu i ka përfshirë krijesat e Tij. Ai është lart krijesave me Qenien e Tij dhe më afër tyre se çdo gjë tjetër, me dijen e Tij:

“Ai është më i Pari (s’ka asgjë para Tij, Ai është **i Pafillim**) **dhe më i Fundit** (s’ka asgjë pas Tij, Ai është **i Pambarim**), **më i Larti** (s’ka asgjë mbi Të) **dhe më i Afërti** (nuk ka gjë më të afërt me krijesat sesa Ai me dijen e Tij, nuk ka asnjë pengesë ndërmjet Tij dhe krijesave të Tij). **Dhe Ai është i Gjithëdituri për çdo gjë.**” (El Hadid: 3)

Komentimi i këtyre katër emrave, ka ardhur në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejre, në të cilin tregohet se Fatimja shkoi tek Profeti (salallahu alejhi ue selam) për të kërkuar një shërbëtor. Ai (salallahu alejhi ue selam) i tha: *“Thuaj: ‘O Allah, Krijuesi i shtatë qiejve dhe Tokës, Zotëruesi i Arshit madhështor, Zotëruesi ynë dhe Zotëruesi i çdo gjëje, Ti që bën të mundur çarjen e farës dhe të bërthamës, Zbritësi i Teuratit, Inxhilit dhe Furkanit! Kërkoj mbrojtje tek Ti nga e keqja e çdo gjëje, balli i së cilës është në dorën Tënde (prej sherrit të të gjitha krijesave). O Allah! Ti je i Pari (i Pafillim) dhe para Teje s’ka pasur asgjë. Ti je i Fundit (i Pambarim) dhe pas Teje s’ka asgjë. Ti je i Larti dhe mbi Ty s’ka asgjë. Ti je më i Afërti dhe gjë më të afërt me krijesat sesa Ti nuk ka. Laji borxhet tona dhe na pasuro që të mos jemi të varfër (nevojtarë).’”* (Muslimi)

Në këtë hadith, Profeti i ka sqaruar katër emrat me një koment të shkurtër dhe të qartë. Këta emra tregojnë se Allahu ka përfshirë çdo gjë.

Dy të parët, **El Eu-uel** dhe **El Ahir**, tregojnë se ka përfshirë kohën, kurse dy të tjerët, **Edh-Dhahir** dhe **El Batin**, tregojnë se Allahu ka përfshirë hapësirën (vendet) me dijen e Tij.

Ibnul Kajjim ka thënë: “Këta katër emra janë të kundërt (të ndërsjelltë). Dy të parët tregojnë se ai është **i Pafillim** dhe **i Pambarim**, ndërsa dy të tjerët tregojnë se Ai është më **i Larti** mbi të gjitha krijesat e Tij dhe më **i Afërti** ndaj tyre me dijen e Tij. Allahu është **i Pafillim**. Ekzistenca e Tij u paraprin të gjitha ekzistencave. Ai është **i Pambarim**. Pafundësia e Tij do të thotë që Ai është i qëndrueshëm përjetësisht, pas çdo gjëje tjetër.”

Emri i Tij **Edh-Dhahir**, tregon se Ai është lart, mbi të gjitha krijesat dhe emri i Tij **El Batin**, tregon se Ai e ka përfshirë çdo gjë me dijen e Tij. Ai me dijen e Tij, është më afër të gjitha gjërave sesa vetë ato ndaj vetvetes. Kjo afërsi nënkupton përfshirjen e përgjithshme.

93-94- **El Kabid & El Basit** - ال با سط & ال قاب ض .

El Kabit, është Ai i Cili ia ngushton rrizkun krijesave, kujtdo që të dëshirojë dhe si të dëshirojë.

El Basit, është Ai i Cili ia shton rrizkun krijesave, kujdo që të dëshirojë dhe si të dëshirojë.

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Me të vërtetë Allahu është **El Halik**, **El Kabid**, **El Basit**, **Err-Rrazik**, **El Musijr**.*” (Trans. Ebu Daudi dhe Tirmidhiu, hadithi është i saktë.)

95-96- **El Mukad-dim & El Muehir** - المؤخر & دمالمق.

Këta dy emra tregojnë se:

a- Allahu afron atë që dëshiron për ta mëshiruar e për ta udhëzuar, si dhe nuk mëshiron e udhëzon atë që dëshiron. Këtë e ka përmendur imam Neueui.

b- Allahu ngre në gradën e njerëzve të mirë e të parë, atë që dëshiron, si dhe ul nga grada e tij atë që dëshiron.

Argument për këtë është hadithi që transmeton Ebu Musa el Esh'ari, ku Profeti (salallahu alejhi ue selam) bënte lutjen e mëposhtme: “*O Allah, më fal mua gjynahun tim, paditurinë time, teprimin tim në punët e mia dhe më fal atë për të cilën je më i Ditur sesa unë. O Allah, më fal mua atë që e kam bërë vullnetarisht dhe atë që e kam bërë në mënyrë të pavullnetshme, atë që e kam bërë gabimisht dhe atë që e kam bërë me dashje, e të gjitha këto gjenden tek unë. O Allah, më fal mua mëkatet e kaluara dhe mëkatet e ardhshme, ato që i kam fshehur, ato që i kam publikuar dhe ato që Ti i di më mirë se unë. Ti je **El Mukad-dim** dhe **El Mueh-hir**, Ti je i Fuqishëm mbi çdo gjë.*” (Trans. Buhariu dhe Muslimi, por ky version është i Muslimit.)

97- **Es-Sej-jid** - السيد - **Zotëruesi**.

Abdullah ibn Shehijrr transmeton: “Shkova së bashku me delegacionin e Beni Amirit, për tek i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) dhe i thamë: ‘Ti je **sej-jidi** (zotëriu) ynë.’ Ai tha: ‘**Sej-jidi** ynë është Allahu i Lartësuar.’” (Trans. Ahmedi, Ebu Daudi dhe Albani e ka saktësuar hadithin në “Sahihul xhami”).

98- **Ed-Dej-jan** - الديان - **Shpërblyesi** që i shpërblen krijesat e Tij për veprat dhe punët e tyre.

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Do të tubohen njerëzit në Ditën e Gjykimit pa asgjë, të zhveshur e të pabërë sunet, pastaj Allahu u thërret me një zë që e dëgjon edhe ai që është larg, siç e dëgjon ai që është afër: ‘Unë jam **El Melik** (Sunduesi), **Unë jam Ed-Dej-jan**.*” (Trans. Ahmedi dhe Albani ka thënë se ky hadith është i saktë.)

99- **El Uedud** - الودود - **Dashamirësi** më i madh.

“*Dhe Ai është **El Gafurr** (Falësi i Madh), **El Uedud** (Dashamirësi i robërve të Tij).*” (El Buruxh: 14)

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Dijetarët i kanë ndarë emrat e Allahut në disa grupe, për sa i përket kuptimeve dhe cilësive që ata përmbajnë

I pari: Emri i përveçëm “**Allah**”.

Me të drejtë dijetarët këtë emër e kanë vendosur në një grup më vete, sepse ai përmban kuptimet e të gjithë emrave të bukur të Allahut dhe prandaj të gjithë emrat i atribuohen atij:

“**Allahu është Ai, veç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë, por vetëm Ai, i Gjithëdituri i gajbit (të fshehtës) dhe i së shfaqures. Ai është i Gjithëmëshirëshmi, Mëshirëploti.**”

“**Allahu është Ai, veç të Cilit nuk ka të adhuruar tjetër të merituar, por vetëm Ai, Mbizotëruesi, i Shenjti, i Gjithëpërsosuri pa asnjë të metë, Gjithëdhuruesi i sigurisë, Gjithëvëzhguesi mbi krijesat e Tij, i Gjithëfuqishmi, Urdhëruesi i papëballueshëm, më i Larti Suprem. Lavdi i qoftë Atij! i lartë është Ai nga gjithë çfarë i mveshin dhe i bashkojnë Atij!**”

“**Ai është Allahu, Gjithëkrijuesi, Shpikësi i pashembullt i çdo gjëje, Formësuesi i gjithçkaje. Të Atij janë emrat më të bukur e më të lartë. Gjithë çfarë është në qiell dhe në Tokë e lavdëron Atë. Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues.**” (El Hashër: 22-24)

I dyti: Emrat që tregojnë për cilësitë “dhatije”¹ si për shembull: **Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi** etj.

I treti: Emrat që tregojnë për cilësitë “fi’lijeh”² si për shembull: **El Halik** (Gjithëkrijuesi), **Err-Rrazik** (Gjithëfurnizuesi) etj.

I katërti: Emrat që tregojnë për dëlirjen dhe lartësimin e Allahut, të cilët përmbajnë mohimin e mangësive dhe të cilësive që nuk i përshtaten Atij.

Si shembull për këtë kemi emrat: **El Kud-dus, Es-Selam** etj.

Ibnul Kajim ka shtuar edhe dy grupe të tjera:

I pesti: Emrat që tregojnë për shumë cilësi dhe për shumë kuptime të larta njëherazi, si p.sh. **Es-Samed**.

I gjashti: Emrat që janë përmendur së bashku dhe tregojnë për një cilësi të cilën nuk mund ta tregojë secili prej tyre më vete, si p.sh. **El Azizul-Hakim**.³

¹) Shiko në faqen 65 për të njohur cilësitë “dhatije”.

²) Shiko në faqen 65 për të njohur cilësitë “filijeh”.

³) Shiko në faqen 19.

Emri më i madh i Allahut

Dijetarët, për sa i përket përcaktimit të emrit më të madh të Allahut, kanë dhënë disa mendime, por më të pranueshmit prej tyre janë dy.

1- **Allah** - الله

2- **El Haj, El Kaj-jum** - الـهـ يومـ الحـيـ

Mendimin e dytë e ka zgjedhur dijetari Ibnul Kajim el Xheuzije dhe disa dijetarë të tjerë.

Kanë ardhur disa hadithe, të cilat bëjnë fjalë për emrin më të madh me të cilin nëse rob i kërkon Allahut, Ai i jep, e nëse e lut, Ai i përgjigjet:

1) Transmeton Burejdetu (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) dëgjoi një burrë duke thënë: “O Allah, unë të lutem Ty dhe dëshmoj se vërtet Ti je Allahu, nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Teje, Një, i Vetëm, **Es-Samed** (Ai që i drejtohen krijesat për të gjitha nevojat e tyre dhe Ai nuk ka nevojë për asgjë, Absoluti me të gjitha cilësitë e përsosura në shkallën më të lartë), i Cili as nuk lind dhe as nuk është i lindur dhe s’ka asgjë të barabartë ose të krahasueshme me Ty.” Atëherë Profeti (salallahu alejhi ue selam) tha: *“Betohem në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im! Ai i ka kërkuar Allahut me emrin e Tij më të Madh, me të Cilin kur njeriu i lutet, Ai i përgjigjet lutjes së tij dhe kur i kërkon me të, Allahu i jep atë që kërkon.”* (Trans. Tirmidhiu, Ebu Daudi dhe El Hakimi ka thënë se hadithi është i saktë sipas kushtit të Buharit dhe Muslimit. Edhe Albani ka thënë se hadithi është i saktë.)

2) Transmetohet nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) i cili ka thënë: “Isha një ditë me Profetin (salallahu alejhi ue selam) në xhami, ndërkohë që një njeri ishte duke u falur dhe filloi ta luste Allahun duke thënë: ‘O Zoti im, unë të lus Ty, sepse Ty të takon falenderimi e lavdia, nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Teje, **El Men-nanu** (Dhuruesi i madh), Krijuesi i qiejve dhe i tokës. O Ti që je gjithë madhështi dhe lavdi, o i Gjalli, i Përjetshmi.’ Profeti atëherë tha: *‘I është lutur Allahut me emrin e Tij më të madh, me të të cilin kur rob i lutet Allahut, Ai i përgjigjet dhe kur i kërkon me Të, Ai i jep atë që kërkon.’* (Trans. En-Nesai, Ebu Daudi, Ahmedi dhe El Hakim e ka saktësuar. Dhehebiu e ka aprovuar gjykimin e Hakimit dhe Albani gjithashtu e ka konfirmuar gjykimin e tyre.)

3) Ebi Uname transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë:

“Emri më i madh i Allahut është në tri sure të Kur’anit: El Bekare, Ali Imran dhe Ta Ha.” (Trans. Ibn Maxheh dhe Albani ka thënë se hadithi është i saktë.)

Njëri nga transmetuesit e hadithit ka thënë: “E kërkoja emrin më të madh në këto tri sure dhe pashë se ai është **El Haj, El Kaj-jum.**”

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

4) Esmā bint Jezid transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Në këto dy ajete, është emri më i madh i Allahut*”, dhe lexoi ajetin 163 të sures “Ali Imran”: **“Dhe Allahu (i Adhuruari) juaj është një i Adhuruar i Vetëm. Nuk ka të Adhuruar tjetër të merituar përveç Atij, I Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti”**, si dhe fillimin e kësaj sureje: **“Elif, Lam, Mim. Allahu është Ai, i Cili nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij, i Gjalli, i Përvetshmi, i Pafillim dhe i Pambarim. Mbajtësi dhe Mbrojtësi i gjithçkaje që ekziston.”**

Duke vërejtur dhe duke bërë krahasimin ndërmjet haditheve të kaluara, bëhet e qartë se emri **“Allah”** është përmendur në të gjitha hadithet, ndërsa emri **“El Haj-El Kaj-jum”** është përmendur vetëm në disa prej tyre. Prandaj më afër së vërtetës është që të thuhet se emri më i madh i Allahut është **“Allah”**, e për sa i përket hadithit të Ebi Umames, përcaktimi i emrave në të, është thënie dhe “ixhtihad” (mendim) i transmetuesit.

Imam Tahaui ka thënë: “Ka mundësi që emri më i madh i Allahut në suren “Ta Ha”, të mos jetë në ajetin që ka përcaktuar transmetuesi, por mund të jetë në fjalën e Allahut: **‘Dhe nëse ti (o Muhamed) e thua me zë lutjen, nuk ka dyshim se Ai e di të pashfaqurën dhe atë çka është akoma më e fshehtë në thellësi. Allahu! La ilahe il-la Huue** (nuk ka asnjë të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Atij)...’ (Ta Ha: 7-8)

Si rrjedhojë, emri **‘Allah’** që është përmendur në fjalën e Tij: **‘Allahu la ilahe il-la Huue’**, është përmendur edhe në suren ‘Bekare’ dhe ‘Ali Imran’, prandaj emri më i madh gjendet në to. Nga kjo, kuptojmë se transmetuesi i hadithit është përpjekur që të caktojë emrin më të madh, por ka gabuar, sepse kemi hadithe të tjera në të cilat është theksuar se gjendet emri më i madh i Allahut, dhe në to nuk gjendet emri **‘El Haj-El Kaj-jum’**, ndërsa emri **‘Allah’**, është përmendur në të gjitha këto hadithe.”

Është transmetuar nga disa selefë, se emri më i madh i Allahut është **“Allah”**. Prej këtyre dijetarëve përmendim: Esh-Sha’bi dhe Xhabir ibni Zejd.

Sqarim: Këto hadithe nuk tregojnë se pranohet lutja e çdokujt që lutet me emrin më të madh, sepse që robët t’i pranohet lutja, duhet të plotësojë kushtet (p.sh. sinqeriteti dhe mosngrënia e haramit), si dhe të eliminojë (evitojë) pengesat e pranimit të saj.

Disa dobi në lidhje me emrat e Allahut

- Përfundimi i ajeteve kuranore me emrat e Allahut, ka një domethënie të madhe. Për të kuptuar se cila është kjo domethënie e urtësi, si dhe cila është lidhja ndërmjet emrave me të cilët ka përfunduar ajeti dhe kuptimit të ajetit, duhet t'i kthehemi librave të tefsirit.

- Kuptimi i domethënies së emrave të Allahut - siç thamë - futet tek “el ihsa” - الإحسا, prandaj është shumë e rëndësishme të interesohemi që të njohim domethëniet e emrave të Allahut, veprimet që rrjedhin prej tyre, si dhe ndikimin e tyre, t'i ndiejmë ata vazhdimisht dhe t'i bëjmë të pranishëm në vetet dhe në zemrat tona.

Eliz bin Abduselam ka thënë: “Njohja dhe kuptimi i emrave të Allahut, është mënyra me anë të së cilës bëhen lidhjet me Të, duke kuptuar mirë frytet që rrjedhin nga këta emra, si p.sh. mbështetja, shpresa, frika, dashuria etj.

- Nuk plotësohet besimi i robit në emrat e Allahut dhe nuk u bën “ihsa” atyre plotësisht, derisa ata të ndikojnë në adhurimin që bën ai me zemër dhe me gjymtyrët e tij.

P.sh., përderisa e dimë që Allahu është i Vetëm në krijim dhe furnizim, në sjelljen e dobisë dhe largimin e dëmit, duhet t'i mbështetemi vetëm Atij dhe të kërkojmë vetëm prej Tij; përderisa rob i di që Allahu është Shikuesi, Dëgjuesi, I Gjithëdituri, atëherë duhet t'i frikësohet Atij në të gjitha veprat, thëniet, mendimet dhe gjendjet, kur është vetëm dhe kur është në publik, kur është në vendin e tij dhe kur është jashtë tij, në udhëtim, kur është duke bërë ibadet apo ndonjë vepër a punë të kësaj dynjaje. Pra në të gjitha punët, të ndiejë se Allahu e shikon, e dëgjon dhe e di çka po punon.

- Ndryshimet ndërmjet emrit të Allahut dhe cilësisë së tij.

1) Emrat e Allahut tregojnë për Qenien dhe për cilësitë e Tij të përkryera që gjenden në këta emra, kurse cilësitë e Tij tregojnë vetëm për domethënien që është veti (atribut) e Allahut.

Pra, emri tregon për dy gjëra: a) për Qenien e Allahut, dhe b) për cilësinë që ai përmban.

Nga ana tjetër, cilësitë tregojnë vetëm për një gjë: që këto cilësi janë veti (attribute) të Allahut, si p.sh. dëgjimi, shikimi, urtësia etj.

2) Nga çdo emër rrjedh cilësi, por jo nga çdo cilësi rrjedh emër.

P. sh. zbritja dhe ardhja e Allahut janë dy cilësi nga të cilat nuk rrjedh ndonjë emër i Tij.

3) Emrave të Allahut u lutesh dhe kërkon prej tyre, sepse në këtë rast je duke lutur Allahun, kurse cilësive nuk lejohet në asnjë mënyrë që t'u lutesh apo të kërkoresh prej tyre.

Pra, lejohet të thuhet: “O Gafurr (Mëkatfalës), më fal mua”, por nuk lejohet të thuhet: “O fuqia e Allahut, o dëgjimi i Allahut, më fal mua.”

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Ibnu Tejmije, në librin e tij “Err-rred-du al-el bekrij”, ka thënë se të kërkosh prej cilësive është kufër.

Vërejtje: Të kërkosh prej cilësive nuk lejohet, por në lidhje me këtë, duhet të kemi parasysh këto gjëra:

E para, lejohet “el istigathetu” - الاستِغَاثَةُ (kërkimi i ndihmës dhe i shpëtimit), me anë të cilësisë, si p.sh. lutja e Profetit (salallahu alejhi ue selam): “*O Haj-ju, o Kaj-jum, me mëshirën Tënde kërkoi ndihmë dhe shpëtim! Rregulloje të gjithë gjendjen time dhe mos më lër mua për veten time, as sa një vezullim i syrit (sa një hapje e mbyllje e syrit).*”

Gjithashtu, lejohet “el istiadhetu” - الاستِعاذَةُ (kërkimi i mbrojtjes) me anë të cilësisë, si p.sh. lutja e Profetit (salallahu alejhi ue selam): “*Mbrohem me kënaqësinë Tënde, nga hidhërimi Yt.*”

E dyta, lejohet “et-teues-sul” (përafrimi, t’i drejtohesh Allahut gjatë lutjes) me anë të cilësisë, p.sh. hadithi i Profetit (salallahu alejhi ue selam): “*O Allah, me dijen Tënde rreth së fshehtës dhe me fuqinë Tënde mbi krijesat, më lër të jetoj, derisa jeta të jetë më e mirë për mua, dhe ma merr jetën, në qoftë se vdekja është më e mirë për mua.*” (Trans. En-Nesai dhe të tjerë.)

E treta, lejohet betimi në cilësinë e Allahut.

E katërta, lejohet t’i lutesh Allahut me anë të cilësive të Tij të veçanta, me të cilat nuk mund të cilësohet ndonjë tjetër përveç Tij, si p.sh. lutja e Profetit (salallahu alejhi ue selam): “*O Allah, Ti që ke zbritur librin, ke lëvizur retë dhe bën të humbasin grupet (e armiqve), mundi ata (bëji të mundur në luftë) dhe na ndihmo ne kundër tyre.*” (Buhariu)

4) Nuk lejohet që t’i dedikohet cilësisë së Allahut, mundësia e të vepruarit, kurse emrit lejohet.

Pra, nuk mund të themi: “Ka dashur **fuqia** e Allahut që të bëhej kështu”, por mund të themi: “Ka dashur **i Fuqishmi** që të bëhej kështu”.

- Ka ndryshim ndërmjet emrave të Allahut dhe lajmërimit rreth Tij.

Ndër më të rëndësishmit janë këta që vijnë:

I pari, emrat dhe cilësitë janë “teukifije”, kurse lajmërimi (dhënia e informacionit) rreth Tij është më i gjerë dhe nuk është kusht që të jetë “teukifije”. Nuk lejohet në fakt që të emërtohet dhe të cilësohet Allahu me diçka tjetër, përveç asaj që ka ardhur në Kur’an dhe Sunet, ndërsa lajmërimi rreth Allahut është më i gjerë.

P.sh., në qoftë se ndonjëri do të mohojë ekzistencën e Allahut, mund t’i përgjigjemi se Allahu është “**Meuxhud**” - موجود - **Ekzistues**, megjithëse kjo fjalë nuk është përmendur në Kur’an dhe Sunet; në qoftë se ndonjëri do të thotë se Allahu nuk është qenie, i themi se Allahu është **Qenie** - ذات.

Ibnul Kajjim ka thënë: “Emrat dhe cilësitë që ia dedikojmë Allahut janë ‘teukifije’, ndërsa fjalët dhe shprehjet që i përdorim për të treguar diçka rreth Allahut, nuk është e detyrueshme që të jenë ‘teukifije’, p.sh. **El Kadijm** - ال قديم - **i Pafillimtë, El Meuxhud** - الموجود - **Ekzistues** etj.”

I dyti, Allahut i lutesh me emrat e Tij, por nuk lejohet që të lutesh dhe të kërkosh nga shprehjet e përdorura për lajmërim rreth Tij.

Pra, lejohet të thuash: “**O i Gjallë, i Përjetshëm**”, por nuk lejohet të thuash: “**O Qenie, o Ekzistues**”, sepse këto janë shprehje që përfshijnë çdo ekzistencë (mund të përdoren për të treguar çdo qenie të gjallë që ekziston).

I treti, emrat e Allahut janë të gjithë të bukur dhe me domethënie të plotë. Përsosmëria dhe bukuria e tyre është absolute, kurse lajmërimi rreth Allahut, pa dyshim që nuk bëhet me fjalë të cilat kanë domethënie të keqe e të ulët, por mund të bëhet me fjalë ose shprehje, për të cilat mund të gjykohet se nuk kanë domethënie të përkryer.

Shejh islam Ibnu Tejmije ka thënë: “Lajmërimi rreth Allahut nuk bëhet me fjalë që kanë domethënie të keqe, por me fjalë që kanë domethënie (kuptim) të plotë e të përkryer. Gjithashtu, bëhet dhe me fjalë që domethënien nuk e kanë të keqe, edhe pse nuk mund të thuhet që e kanë të përkryer, si p.sh. Qenie ose Ekzistues.”

Kreu 3. Cilësitë e Allahut

Bazat e cilësive të Allahut

Baza e parë. Të gjitha cilësitë e Allahut janë të përkryera e të plota dhe nuk ka në to asnjë mangësi e të metë

Shembull i kësaj janë cilësi si: **Jeta** - الحياة, **Dija** - العلم, **Fuqia** - القدرة **Dëgjimi** - السمع, **Mëshira** - الرحمة, **Krenaria** - العزة, **Urtësia** - الحكمة **Lartësia** - العلو etj.

Për këtë bazë tregojnë tri lloje argumentesh:

1- *Argumentet e Kur'anit dhe Sunetit*

“Për ata që nuk besojnë në botën e përtejme, është përcaktuar shembulli i më të keqes, ndërsa për Allahun është ‘el methelul a’la’ (më i larti shembull dhe më i larti përshkrim) dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues.”
(En-Nahl: 60)

“Ai fillon krijimin, pastaj do ta përsërisë atë (pasi të jetë zhdukur) dhe kjo është shumë e lehtë për Të. Atij i takon ‘el methelul a’la’ (përshkrimi më i lartë)

në qiej dhe në Tokë. Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues.”
(Err-Rrum: 27)

El Halil, në komentin e këtij ajeti ka thënë: “Allahu është i njohur përmes cilësimit dhe përshkrimit më të lartë në qiej dhe në Tokë.

Ibnu Utthejmin ka thënë: “‘El methelul a’la’ është *përshkrimi më i lartë.*”

2- Argumenti logjik

Çdo gjë që ekziston ka patjetër cilësi. Këto cilësi, ose do të jenë të përkryera dhe të plota, ose në të kundërt do të jenë të mangëta. E dyta është absurde dhe e pamundur (e paarsyeshme logjikisht) për sa i përket Allahut, sepse Ai është i Plotë, i Përkryer dhe i Vetmi që meriton të adhurohet. Prandaj Allahu e ka hedhur poshtë adhurimin e idhujve në Kur’an me faktin që ata janë të mangët, të paafte dhe me të meta:

“Kush është më i humbur se sa ai i cili lut në vend të Allahut ata që nuk do t’i përgjigjen atij deri në Ditën e Ringjalljes dhe të cilët madje janë krejt të pavetëdijshëm për lutjet që u bëhen atyre.” (El Ahkaf: 5)

“Ata (të tjerë idhuj të adhuruar, çfardo e kushdo qoftë, veç Allahut, Një e të Vetëm) të cilët ata (mushrikët) i adhurojnë e i lusin në vend të Allahut, nuk kanë krijuar ndonjë gjë, madje ata vetë janë të krijuar. Ata (idhujt dhe të adhuruarit e tjerë) janë të vdekur, pa jetë dhe as nuk e dinë se kur do të ngrihen.” (En-Nahl: 20-21)

Gjithashtu Allahu na ka treguar se si Ibrahim (alejhi selam), i sillte argumente babait të tij duke i thënë:

“O babai im! Pse adhuron atë që as nuk dëgjon, as nuk sheh dhe nuk të sjell dobi për asgjë?” (Merjem: 42)

Ndërsa popullit të tij, Ibrahim (alejhi selam) i ka thënë:

“A adhuron atëherë ju, përveç Allahut, gjëra që nuk ju sjellin ndonjë të mirë dhe as nuk ju dëmtojnë? Turp për ju dhe përmbi ata që adhuron në vend të Allahut! A nuk keni mend, pra?” (El Enbija: 66-67)

Në të gjitha ajetet e lartpërmendura, vërejmë se Allahu e ka hedhur poshtë adhurimin e idhujve me faktin se ata janë të mangët, të paafte dhe me të meta: nuk dëgjojnë, nuk shikojnë, nuk përgjigjen, nuk sjellin dobi, nuk bëjnë dëm etj. Atëherë kjo tregon se Ai që meriton adhurimin, patjetër është i Plotë, i Përkryer dhe larg çdo të mete. Pastaj ne kemi vërtetuar me anë të shqisave dhe vështirimit se krijesat kanë cilësi të përkryera: shikimi, dëgjimi etj, dhe padyshim që këto cilësi të përkryera ua ka dhënë Allahu. Përderisa këto cilësi të përkryera ua ka dhënë Allahu, kjo tregon se Ai e meriton më tepër t’i atribuohen këto cilësi, sepse dhënësi i një cilësie të përkryer është më me meritë dhe më i denjë të përshkruhet nëpërmjet saj.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Një bazë tjetër logjike për të cilën kanë rënë dakort të gjithë njerëzit e ditur, është se ai që nuk e zotëron diçka, nuk mund t'ua japë atë të tjerëve. Kjo tregon se nëse Allahu nuk do të ishte i Përkryer në cilësitë e Tij, Ai nuk do mund t'ua jepte këto cilësi të përkryera krijesave.

3- “*El fitra*” (natyrshmëria)

Njerëzit, sipas natyrës së drejtë në të cilën janë krijuar, e duan Allahun, e madhërojnë dhe e adhurojnë. A mundet që të duash, të madhërosh dhe të adhurosh dikë tjetër përveç Atij i Cili ka cilësi të përkryera që i përshtaten Qenies së Tij si Krijues, Sundues, Gjithëregullues i çështjeve dhe i Adhuruar i Vetëm me të drejtë!?

Në qoftë se cilësia është e mangët dhe jo e përkryer, si p.sh. vdekja, padituria, harresa, pafhtësia, verbëria etj., është e pamundur që ajo të jetë cilësi e Allahut të Lartësuar. Më poshtë po përmendim disa ajete në të cilat Allahu ia mohon Vetes së Tij mangësitë dhe të metat.

“Dhe mbështetu e vari shpresat (O Muhammed) tek i Përrjetshmi, i Cili nuk vdes kurrë dhe madhëro Lavdinë e Tij.” (El Furkanë: 58)

“(Musai) i tha: ‘Dija për ta është me Zotin tim me shkresën e duhur. Zoti im as nuk është i pavetëdijshëm dhe as nuk harron.’ (Ta Ha: 52)

“...dhe Allahu nuk është i tillë që Atij t'i shpëtojë ndonjë gjë në qiej ose në Tokë...” (El Fatir: 44)

“Apo mos mendojnë se Ne nuk i dëgjojmë të fshehtat e tyre dhe këshillimet e tyre të ngushta? Patjetër (që Ne dëgjojmë gjithçka) dhe të dërguarit Tanë (melekë të caktuar me përgjegjësi për njerëzit, që të shënojnë çdo punë të tyre) janë pranë tyre duke shkruar.” (Ez-Zuhuf: 80)

Edhe Profeti (salallahu alejhi ue selam) i ka mohuar në thëniet e tij cilësitë e mangëta. Shembull për kemi tri hadithet që vijnë:

“Vërtet Dëxh-xhali është me një sy dhe Zoti juaj nuk është me një sy (d.m.th. Zoti ynë ka dy sy). (Buhariu & Muslimi)

“O njerëz, duke bërë dhikër uleni zërin, sepse ju nuk po i luteni ndonjë shurdhi dhe as ndonjë të papraninshmi.” (Buhariu & Muslimi)

“Allahu nuk fle dhe është e pamundur që Ai të fletë.”

Allahu i ka ndëshkuar ata që i atribuan Atij mangësi, siç ka thënë në ajetet e mëposhtme:

“Çifutët thonë: ‘Dora e Allahut është e lidhur (e shtrënguar, Ai nuk dhuron dhe nuk shpenzon nga begatitë e Tij). Qofshin të lidhura duart e tyre dhe qofshin të mallkuar ata për çfarë u nxori goja! Përkundrazi, të dyja duart e

Allahut janë gjerësisht të shtrira. Ai shpenzon nga begatitë e Tij, siç do Ai.”
(El Maide: 64)

“Nuk ka dyshim se Allahu e ka dëgjuar fjalën e atyre që thanë: ‘Vërtet Allahu është i varfër e ne jemi të pasur!’ Ne do ta regjistrojmë atë çfarë thanë ata, si edhe vrasjen padrejtësisht prej tyre të profetëve dhe Ne do t’u themi atyre: ‘Shijoni dënimin djegës.’” (Ali Imran: 181)

Në shumë ajete Allahu e ka lartësuar dhe pastruar Vetën e Tij nga mangësitë që ia atribuojnë të paditurit e të padrejtët:

“Lavdi Zotit tënd, Zotit të Nderimit dhe të Fuqisë, nga gjithë çfarë ata ia mveshin Atij. Dhe paqja qoftë mbi të dërguarit! (Es-Safat: 180-181)

“Asnjë fëmijë nuk lindi Allahu dhe nuk gjendet asnjë i adhuruar (ilah) tjetër përkrah Tij. Po të kishin qenë shumë zota atëherë ç’të shihje!? Secili do të kishte hequr mënjanë atë që do të kishte krijuar dhe disa do të përpiqeshin të mposhtnin të tjerët! I Lartësuar është Allahu mbi çdo gjë që ata ia mveshin dhe ia ngjisin Atij!” (El Mu’minun: 91)

Nëse cilësia është e përkryer në një rast dhe e mangët (e papërkryer) në një rast tjetër, nuk ia atribuojmë Allahut në mënyrë absolute dhe nuk ia mohojmë në mënyrë absolute, por patjetër bëjmë disa sqarime. Ajo cilësi i atribuohet Allahut në rastin kur është e përkryer dhe nuk i atribuohet Atij në rastin kur është e mangët, si p.sh cilësitë: **el mekr** (ngritja e kurtheve, grackave), **el kejd** (planifikim, kurdisje plane), **el hidaë** (mashtrimi) etj.

Këto cilësi janë të përkryera nëse përdoren kundër atyre që veprojnë me të njëjtën gjë, sepse në këtë rast ato tregojnë se vepruesi i tyre është i aftë dhe i fuqishëm për të përballuar armikun e tij duke përdorur të njëjtin veprim ose edhe më të mirë se kaq. Ndërsa në rastet e tjera, përveç rastit të mësipërm, cilësitë janë të mangëta, prandaj Allahu nuk i ka përmendur ato në mënyrë absolute, por vetëm në pozicionin e kundërvënies ndaj atyre që veprojnë kundër Tij dhe të dërguarve të Tij me të njëjtën mënyrë.

Në ajetet që vijnë janë përmendur disa nga këto cilësi:

“Kujto edhe kur mosbesimtarët thurën komplot kundër teje për të të mbajtur ty në pranga, për të të vrrarë, ose për të të përzënë nga shtëpia jote; ata po kurdisnin plane, por edhe Allahu po thurte plane, dhe Allahu është më i Miri Planifikues. (El Enfal: 30) Në këtë ajet është përmendur **el mekr** - المکر - ngritja e kurtheve.

“Ata që nuk pranojnë ajetet Tona, Ne, pak e nga pak do t’i mbërthejmë me dënim nga rrugë që as nuk do ta kuptojnë. Dhe Unë do t’u jap kohë. Padyshim që plani Im është i fuqishëm.” (El Araf: 182-183) Në këtë ajet është përmendur **el kejd** - الكيد - thurja e planeve.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

“Thonë: ‘Me të vërtetë jemi me ju, në të vërtetë ne vetëm talleshim. Allahu tallet me ta dhe ua shton më shumë të këqijat që të sorollaten verbërisht” (El Bekare: 14-15).

Duke marrë parasysh sqarimin që bëmë, del në pah arsyeja se përse nuk ka përmendur Allahu në Kur’an që Ai i tradhëton ata që e tradhetojnë¹, por ka thënë: **“Në qoftë se ata mundohen të të tradhetojnë ty, ata vërtetë që kanë tradhëtuar Allahun, kështu Ai tashmë të dha forcë mbi ta. Dhe Allahu është i Gjithëdhëituri, më i Urti, Gjithëgjykuesi.”** (El Enfal: 71) Pra ka thënë: **“Të dha forcë mbi ta”** dhe nuk ka thënë: **“Dhe Ai i tradhëtoi”**, sepse tradhëtia është mashtrimi në diçka që të është besuar dhe të është lënë amanet, kështu që ajo është mangësi (ves) në të gjitha rastet.

Baza e dytë. Tema e cilësive të Allahut është më e gjerë se tema e emrave të Tij

Cilësitë e Allahut të Madhëruar që janë përmendur në Kur’an dhe Sunet, janë më të shumta se emrat e Allahut që janë përmendur në këto dy burime, sepse çdo emër përmban në vetvete cilësi - siç është sqaruar në bazat e emrave të bukur të Allahut - dhe sepse cilësi të Allahut janë edhe veprat e Tij. Veprat e Tij nuk mbarojnë, sikurse edhe fjalët e Tij:

“Dhe sikur të gjitha pemët në tokë të ishin pena dhe deti me shtatë dete pas tij (të ishte bojë shkrimi), për t’ju shtuar atij, prapëseprapë fjalët e Allahut nuk do të shteronin. Me të vërtetë Allahu është i Gjithëfuqishëm, më i Urti Gjithëgjykues.” (Lukman: 27)

Nga cilësitë e Allahut të cilat janë edhe vepra (punë) të Tij, po përmendim këto që vijojnë:

1. **El Itjan** - الإتيان - **Ardhja.**

“A mos presin atëherë për ndonjë gjë tjetër veçse t’u vijë Allahu.” (El Bekare: 210) Në fjalën e Tij: **“T’u vijë Allahu”** bëhet fjalë për cilësinë e Tij **El Itjan.**

2. **El Batshu** - البطش - **Shtrëngimi, Ndëshkimi.**

“Vërtet shtrëngimi (ndëshkimi) i Zotit tënd është i ashpër.” (El Buruxh: 12) Në këtë ajet është përmendur **El Batshu.**

3. **El Imsak** - الإمساك - **Kapja, Mbajtja.**

“Ai e mban qiellin që të mos bjerë në tokë, veçse me dëshirën dhe lejen e Tij.” (El Haxh: 65)

¹) Tradhëtia në arabisht quhet “el hijanetu” - الخيانة.

4. **El Ehdhu** - الأخذ - **Marrja** (në ndëshkim, shkatërrimi i atij që Allahu dëshiron ta shkatërrojë për shkak të gjynaheve të tij)

“Kështu që Allahu i mori dhe i mbërtheu me ndëshkim e shkatërrim për shkak të mëkateve të tyre.” (Ali Imran: 11)

5. **El Irradetu** - الإرادة - **Dëshira**.

“Allahu dëshiron për ju të lehtën dhe Ai nuk dëshiron për ju të vështirën.” (El Bekare: 185)

6. **El Mexhi** - المجيء - **Ardhja**.

“Dhe vjen Zoti yt me melekët radhë-radhë.” (El Fexhër: 22)

7. **En-Nuzulu** - النزول - **Zbritja**.

Profeti (salallahu alejhi ue selam), në hadithin e transmetuar nga Ebu Hurejre, ka thënë: **“Zoti ynë zbret për në qiellin e dynjasë në 1/3 e fundit të natës.”** (Buhariu & Muslimi)

Këto vepra ia atribuojmë Allahut si cilësi të Tij, ashtu siç kanë ardhur në argumente dhe nuk e emërtojmë Allahun me to, p.sh.: nuk lejohet të themi se prej emrave të Allahut është Ardhës - الجائي , marrë nga vepra e Tij El Mexhi - Ardhja, dhe as En-Nazil - النازل - Zbritës, marrë nga vepra e Tij En-Nuzul - Zbritja, etj.

Megjithatë, është e lejuar të tregohet diçka me këto fjalë rreth Allahut, si p.sh. thuhet El Xhai - الجائي - Ardhësi ose En-Nazilu - النازل - Zbritësi, duke mos pasur për qëllim emërtimin e Allahut me to, por të treguarit e veprës që ato përmbajnë.

Baza e tretë. Cilësitë e Allahut ndahen në: Cilësi thubutije - صفات ثبوتية - të pohuara dhe cilësi selbije - صفات سلبية (منفية) - të mohuara

- Cilësi “thubutije” janë të gjitha cilësitë që Allahu ia ka pohuar (atribuar) Vetes së Tij me anë të Kur’anit dhe haditheve të sakta të Profetit (salallahu alejhi ue selam). Këto cilësi janë të gjitha të përsosura dhe nuk ka në to kurrfarë mangësie, p.sh. **El Ilm** - العلم - **Dija**, **El Kudretu** - القدرة - **Fuqia**, **El Istiu** - الاستواء على العرش - **Lartësimi mbi Arsh**, **En-Nuzul** - النزول إلى سماء الدنيا - **Zbirtja në qiellin e Dynjasë**, **El Uexhh** - الوجه - **Fytyra**, **El Jed** - اليد - **Dora**, etj.

Këto cilësi, është detyrë që t’ia pohojmë (atribuojmë) Allahut të Madhëruar, siç i përshtatet Madhësisë së Tij. Për këtë na tregojnë, si argumentet fetare, ashtu edhe ato logjike.

Argumenti fetar:

“O ju që keni besuar! Besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, librin të cilin Ai ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe librat e parë të cilët Ai ua zbriti atyre para tij. Dhe kushdo që mohon Allahun, melekët e Tij, librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Fundit, atëherë Ai vërtet ka humbur rrugën tepër larg.” (En-Nisa: 136)

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Besimi në Allahun, përmban edhe besimin në cilësitë e Tij; besimi në librin (Kur'anin) që e zbriti mbi të Dërguarin e Tij, përmban besimin në të gjitha cilësitë që janë përmendur në të; dhe besimi që Muhamedi (salallahu alejhi ue selam) është i Dërguari i Allahut, përmban besimin në çdo gjë rreth të Dërguarit, për të cilën na ka lajmëruar Allahu:

“Thuaju: ‘A ju e dini më mirë apo Allahu?’” (El Bekare: 140)

Për sa i përket të Dërguarit të Allahut =, ne e kemi detyrë të besojmë çdo gjë që ai na ka treguar rreth Allahut, sepse ai nuk ka folur nga dëshira e nefsit të tij, por ka folur atë që i shpallej:

“Ai nuk flet nga dëshira. Është vetëm shpallje që i frymëzohet.” (En-Nexhm: 3-4)

Argumenti logjik:

Allahu na ka treguar se i përkasin këto cilësi, dhe pa dyshim që Ai i di më mirë se çdokush tjetër cilësitë e Tij. Askush nuk mund të thotë fjalë më të drejta dhe më të vërteta sesa Allahu:

“Dhe kush është më i vërtetë në fjalë se Allahu?” (En-Nisa: 87)

Prandaj është detyrë që t’ia pohojmë cilësitë e Tij, ashtu siç Ai na ka lajmëruar, pa u lëkundur, sepse lëkundjet në besimin e një lajmi, lindin kur ky lajm buron nga një i paditur që mund të gënjenjë dhe të jetë i paaftë për të shprehur atë që dëshiron. Të gjitha këto të meta janë të pamundura në të drejtën e Allahut të Lartësuar, prandaj është detyrë që të pranohet lajmi i Tij pa hezitim.

Të njëjtën gjë themi edhe për cilësitë që Profeti (salallahu alejhi ue selam) ia ka atribuar Zotit të Lartësuar, sepse ai është njeriu që di më tepër rreth Zotit, më i drejti e më i besueshmi në lajmin që përcjell dhe më i afti për ta shprehur qartë atë që dëshiron. Atëherë është detyrë të pranohet lajmi rreth cilësive të Allahut, ashtu siç ai ka lajmëruar.

- Cilësi “selbije” janë të gjitha cilësitë që Allahu ia ka mohuar Vetes së Tij në Kur’an, ose me anë të haditheve të sakta të Profetit (salallahu alejhi ue selam). Të gjitha këto cilësi janë të mangëta në të drejtën e Allahut dhe Ai e ka mohuar që ato t’i atribuohen Atij, për shkak se Ai është i përkryer në Qenien dhe cilësitë e Tij.

Disa nga këto cilësi janë: **padituria** - الجهل , **harresa** - النسيان , **paaftësia** - العجز , **lodhja** - التعب , **vdekja** - الموت , etj.

Është detyrë që këto cilësi t’ia mohojmë Allahut, duke pohuar të kundërtat e tyre në mënyrën më të përkryer dhe më të plotë. Allahu, kur ia ka mohuar Vetes së Tij këto cilësi, ka pasur për qëllim jo vetëm mohimin e tyre, por edhe pohimin dhe theksimin e cilësive të kundërta me to. Kjo, sepse mohimi është i arrirë, vetëm nëse bëhet për të treguar të kundërtën e asaj që mohohet. Pra, mohimi i këtyre cilësive,

nuk bëhet thjesht për t'i mohuar ato, por për të pohuar dhe për të theksuar cilësitë e tyre të kundërta, të cilat janë të përsosura

Arsyet që tregojnë se mohimi i thjeshtë nuk tregon përkryeshmëri:

a) Mohimi i thjeshtë tregon për mosekzistencë (ëdem - عدم). Mosekzistenca tregon për hiçin, asgjënë, dhe ajo s'mund të tregojë për përsosmëri.

b) Mohimi i cilësisë së një objekti, mund të bëhet për shkak të paaftësisë së tij për të vepruar dhe ky mohim nuk tregon përsosmëri. Pra, sikur të thuash se muri nuk bën padrejtësi, kjo nuk tregon që muri është i drejtë, pasi padrejtësia nuk është mohuar për të treguar drejtësinë, por për të treguar paaftësinë e murit për të vepruar.¹

c) Mohimi mund të bëhet edhe për shkak të pamundësisë për të bërë diçka, siç ka thënë poeti:

Ekziston një fis që nuk e thyen besën,

Dhe njerëzve nuk u bën padrejtësi, qoftë edhe një grimë.

Ky varg nuk është lavdërim për këtë fis, sepse poeti dëshiron të thotë me këtë se ata nuk kanë mundësi ta thyejnë besën dhe të bëjnë padrejtësi, si pasojë e frikës nga fiset e tjera dhe jo sepse nuk duan ta bëjnë këtë gjë, sikur të mundin.

Atëherë, në të gjitha këto raste, mohimi tregon për mangësi dhe jo për përsosmëri, prandaj metoda e Kur'anit në mohim, është që të mos mohohet asnjë cilësi e Allahut me një mohim të thjeshtë që nuk përmban një cilësi tjetër të lavdëruar e të përkryer. Pra, në Kur'an dhe Sunet, një cilësi e mangët, mohohet vetëm nëse përmban një cilësi të përsosur që është për t'u lavdëruar, ndryshe nga ajo që veprojnë disa grupe, të cilat i mohojnë disa cilësi të Allahut me një mënyrë krejt të thjeshtë, pa marrë parasysh nëse cilësia që kanë mohuar tregon për përsosmërinë e të kundërtës së saj apo jo.

Le të sjellim disa shembuj në lidhje me këtë që përmendëm:

1- **“Mbështetuni tek i Përrjetshmi, i Gjalli (El Haj-j), i Cili nuk vdes kurrë.”** (El Furkan: 58). Pra, mohimi i vdekjes nënkupton përsosmërinë e jetës (**el hajat**).

2- **“Zoti yt nuk i bën askujt padrejtësi.”** (El Kehf: 49). Mohimi i padrejtësisë nënkupton përsosmërinë e drejtësisë.

3- **“Allahu nuk është i Tillë që ta bëjë të paaftë, (pa mundësi për të vepruar) ndonjë gjë në qiej ose në tokë.”** (El Fatir: 44). Mohimi i **“el axhz”** - العجز (paaftësisë, pamundësisë), nënkupton përsosmërinë e drejtësisë dhe të fuqisë së

¹) Nga ana tjetër, nëse do të thuhej: “Mbreti nuk bën padrejtësi”, ky mohim tregon për përsosmërinë e të kundërtës së padrejtësisë e cila është drejtësia, sepse mbreti është i aftë të bëjë padrejtësi, dhe përderisa ai nuk e bën një gjë të tillë, kjo tregon se ai është i drejtë.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Allahut, prandaj pas këtij fragmenti, ka thënë: **“Padyshim që Ai është i Gjithëditur, i Gjithëfuqishëm.”** Kjo sepse **“el axhiz”** shkaktohet ose nga injoranca rreth shkaqeve (faktorëve, elementëve) të krijimit, ose nga pamundësia për të krijuar. Nga kjo arrijmë në përfundimin se përsosmëria e dijes së Allahut dhe fuqisë së Tij, tregon se Ai është i Gjithëfuqishëm për të bërë atë që dëshiron dhe se asgjë nuk mund ta bëjë Atë të paaftë për të vepruar atë që dëshiron.

Nga shembulli i fundit, mësuam se ka cilësi **“selbije”** që nënkuptojnë më shumë sesa një cilësi të përsosur.

Në përfundimin të kësaj çështjeje, themi se çdo cilësi që Allahu i ka mohuar Vetes së Tij ose që ia ka mohuar Atij i Dërguari (salallahu alejhi ue selam), detyrimisht tregon për një ose më shumë cilësi **“thubutije”** të përkryera, me të cilat Ai lavdërohet. Allahu i Lartësuar nuk i ka mohuar diçka Vetes së Tij në mënyrë krejtësisht të thjeshtë, pa nënkuptuar njëkohësisht edhe cilësi **“thubutije”**. Kjo na bën të kuptojmë qartë, se ata që e teprojnë në përmendjen e mohimeve (të cilat i quajmë: es-sulub) gabojnë, sepse mohimi nuk përmban në vetvete lavdërim dhe përsosmëri, përderisa nuk nënkupton cilësi **“thubutije”**. Baza që vijon e sqaron edhe më shumë këtë.

Baza e katërt. Cilësitë “thubutije” që ia ka atribuar Allahu Vetes së Tij në Kur’an dhe në Sunet, janë më të shumta se cilësitë “selbije” që Ai ia ka mohuar vetes së Tij

Cilësitë **“thubutije”** janë të gjitha të përsosura. Sa më të shumta që të jenë ato dhe sa më të shumëllojshme që t’i kenë kuptimet, aq më shumë shfaqet përsosmëria e të cilësuarit përmes tyre.

Kryesisht ato janë përmendur në mënyrë analitike¹ (me **“tefsil”**). Shembujt e **“tefsilit”** për pohimin e cilësive të Allahut, janë të shumtë në Kur’an dhe në Sunet:

“Allahu është Ai, veç të Cilit nuk ka të adhurar tjetër të merituar, por vetëm Ai, i Gjithëdituri i gajbit (i çdo gjëje të fshehte e të panjohur) **dhe i së shfaqurës** (i çdo gjëje të njohur). **Ai është i Gjithëmëshirëshmi, Mëshirëploti. Allahu është Ai përveç të Cilit nuk ka të adhurar tjetër të merituar, por vetëm Ai, Mbizotëruesi, i Shenjti, i Gjithëpërsosuri pa asnjë të metë, Gjithëdhuruesi i sigurisë** (besimit), **Gjithëvëzhguesi mbi krijesat e Tij, i Gjithëfuqishmi, Urdhëruesi i Papërballueshëm, më i Larti Suprem. Lavdi i qoftë Atij. I Lartë është Ai nga gjithë çfarë i mveshin dhe i bashkojnë Atij. Ai është Allahu, Gjithëkrijuesi, Shpikësi i pashembullt i çdo gjëje, Formësuesi i**

¹) Në gjuhën arabe, për përmendjen e gjërave në mënyrë analitike përdoret fjala **“tefsil”**.

gjithçkaje. Të Tij janë emrat më të bukur dhe më të lartë. Gjithë ç'është në qiej dhe në tokë e lavdëron Atë. Dhe Ai është i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues.” (Hashër: 22-24)

Këto ajete përmbajnë më shumë se pesëmbëdhjetë emra dhe çdo emër përmban një, dy ose më shumë cilësi.

“Është e vërtetë se Ai do t'i bëjë ata të hyjnë në një vend në të cilin ata do të jenë të kënaqur, sepse Allahu është i Gjithëdituri, tepër i Durueshëm.”

“Kjo është kështu! Dhe kushdo që shpague me të njëjtën masë të asaj që ka vuajtur dhe pastaj përsëri i është bërë padrejtësi, është e sigurtë se Allahu do ta ndihmojë atë. Vërtet që Allahu është Ai që ju ndjen, gjithnjë Falës i madh.”

“Kjo ngaqë Allahu ndërfit natën në ditë dhe Ai ndërfit ditën në natë. Dhe vërtet Allahu është Gjithëdëgjues, Gjithëvëzhgues.”

“Kjo ngaqë Allahu është i Vërteti e i Përhershmi dhe gjithçka që ata lusin në vend të Allahut ose përkrah Tij, është batil (e pavlefshme). Dhe vërtet Allahu është më i Larti, më i Madhi.”

“A nuk e shihni se Allahu zbret ujë nga qielli dhe pastaj toka bëhet e blertë? Vërtet që Allahu është më i Buti dhe më Dashamirësi, i Gjithënjohuri për çdo gjë.”

“Të Atij janë gjithë çfarë është në qiej dhe gjithë çfarë është në tokë dhe me të vërtetë që Allahu është më i Pasuri, i Denjë për të gjitha lavdërimet.”

“A nuk e shihni se Allahu ka nënshtruar për ju gjithë çfarë është në tokë, se edhe anijet lundrojnë në det me urdhërin e Tij? Ai e mban qiellin që të mos bjerë në tokë, veçse me dëshirën dhe me lejen e Tij. Vërtet që Allahu është ndaj njerëzimit gjithë Mirësi, Mëshirëplotë.” (El Haxh: 59-65)

Të gjitha këto ajete përfundojnë me nga dy emra prej emrave të bukur të Allahut dhe çdo emër përmban një, dy ose më shumë cilësi. Ndoshta cilësitë “thubutije” mund të përmenden edhe në mënyrë të përgjithshme (me ixhmal)¹, por më tepër janë përmendur në mënyrë analitike.

Si shembull për “ixhmal” kemi fjalën e Allahut të Lartësuar:

“Të Allahut janë të gjithë emrat më të bukur, kështu që luteni Atë me ta.” (El A'raf: 180), si dhe fjalën e Tij: **“Atij i takon përshkrimi më i lartë.”** (Err-Rum: 27).

Ndërsa cilësitë “selbije”, që Allahu ia mohon Vetes së Tij, kryesisht janë mohuar në mënyrë të përgjithshme, sepse kjo është më e mirë në Madhërimin e Allahut dhe më e përkryer në Lartësimin e Tij. Nuk ka dyshim që mohimi në mënyrë analitike, pa ndonjë shkak domethënës, është tallje dhe mangësim ndaj atij që kërkon të

¹) Në gjuhën arabe, për përmendjen e gjërave në mënyrë të përgjithshme, përdoret fjala “ixhmal” e cila është antonim i fjalës “tefsil”.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

përsërkruash. Si do të ishte sikur të lavdëroje një mbret duke i thënë: “Ti je bujar, trim, i fortë, i papërballueshëm nga armiqtë, etj.? Kjo do të ishte ndër mënyrat më të madhërisme për lavdërimin e tij dhe për vënien në dukje të të mirave të tij, gjë e cila e bën atë të dashur dhe të respektuar, sepse ia ka pohuar cilësitë e mira në mënyrë të drejtpërdrejtë. Nga ana tjetër, sikur t’i thuhet: “Ti nuk je as koprac, as frikacak, as i varfër, as shitës në pazar, as pastrues mbeturinash etj. - duke i mohuar atij të metat dhe gjërat e papërshtatshme - kjo do të konsiderohej si tallje dhe nënçmim ndaj tij.

Një poet ka thënë:

*Vallë, a s’e vë re që shpatës i ulet vlera,
Nëse thuhet se është më e mprehtë se shkopi!?*

Shembujt e mënyrës së përgjithshme të mohimit, janë të shumtë në librin e Allahut. Ne po shkëpusim vetëm disa prej tyre:

“Adhuroje Atë dhe bëhu i durueshëm e i vazhdueshëm në adhurimin e Tij. A mos di ndonjë që është i ngjashëm me Të (që të meritojë si emri i Tij)?” (Meriem: 6)

“Dhe s’ka asnjë të barabartë ose të krahasueshëm me Të (Një, i Vetëm, i Pashok).” (El Ihlas: 4)

“Atëherë, mos i vini shok Allahut (në adhurim) kur ju e dini (se vetëm Ai ka të drejtë të adhurohet e askush tjetër).” (El Bekare: 22)

“Asgjë nuk i ngjason Atij.” (Esh-Shura: 11)

Mundet që cilësitë “selbije” të përmenden në mënyrë analitike (tefsil) për disa shkaqe:

1- Mohimini i asaj që pretendojnë gënjeshtarët në lidhje me Allahun:

“Që ata i mveshin dhe i emërojnë bir të Gjithëmëshirëshmit. Dhe kurrë nuk i shkon të Gjithëmëshirëshmit që Ai të lindë e të ketë bir.” (Merjem: 91-92).

2- Shmangia e imagjinatës, për sa i përket mangësive në përsosmërinë e Allahut:

“Dhe me të vërtete që Ne i krijuam qiejt e Tokën dhe gjithçka ka ndërmejt tyre në gjashtë ditë, dhe nuk na preku e nuk ndjejmë aspak lodhje.” (Kaf: 38).

“Dhe Ne nuk i krijuam qiellin e Tokën dhe gjithë çfarë është ndërmjet tyre pa qëllim! Ky është Gjykimi i atyre që nuk besojnë. Pra, mjerë për ata që nuk besuan, nga zjarri.” (Sad: 27)

Si përfundim, nga sqarimi i kaluar dalim në konkluzionin se kryesisht mohimi në Kur’an dhe Sunet, ka ardhur vetëm në rastet e mëposhtme:

1) Për të treguar tërësinë dhe mënyrën e përgjithshme të përsosmërisë së Allahut. Ky është mohimi i të metave dhe mangësive në mënyrë të përgjithshme (ixhmal).

2) Për të mohuar atë që pretenduan gënjeshtarët në lidhje me Të.

3) Për shmangien e imagjinatës, për sa i përket mangësive në përsosmërinë e Tij. Të gjithë këtë bazë, mund ta përmbledhim në pikat e mëposhtme:

a) Cilësitë “thubutije” që Allahu ia ka atribuar Vetes së Tij, janë më të shumta se cilësitë “selbije” që Ai ia ka mohuar Vetes së Tij.

b) Cilësitë “thubutije” kanë ardhur në Kur’an në mënyrë analitike dhe në mënyrë të përgjithshme, por mënyra e parë (tefsili), është përdorur më shumë se mënyra e dytë (ixhmali).

c) Cilësitë “selbije” kanë ardhur në mënyrë analitike dhe në mënyrë të përgjithshme, por mënyra e dytë (ixhmali), është përdorur më shumë sesa mënyra e parë (tefsili). Cilësitë “selbije” janë përmendur vetëm në rastet e mësipërme dhe çdo cilësi e tillë, patjetër nënkupton përsosmërinë e të kundërtës së saj.

Shejhul islam Ibnu Tejmije, në librin e tij “Et-Tedmurij-je”, ka thënë në lidhje me këtë çështje: “Allahu i ka çuar të dërguarit e Tij, me pohimin analitik dhe mohimin e përgjithshëm, prandaj ata ia pohuan Allahut cilësitë e përkryera në mënyrë analitike dhe ia mohuan Atij cilësitë që nuk i përshtaten, si përngjasimin me krijesat, përshkrimin e formës dhe mënyrës se si këto cilësi janë.”

Shtojcë: Ibnu Tejmije, në “Bazën e gjashtë” të librit të tij “Et Tedmurij-je”, ka thënë: “Cilësitë e Allahut vërtiten ndërmjet mohimit dhe pohimit, prandaj duhet vendosur patjetër një parim (rregull, normë) për mohimin dhe pohimin.

Parimi i mohimit, është që t’i mohohet Allahut:

- Së pari, çdo cilësi e metë, si verbëria, gjumi, shurdhimi, vdekja, etj.: **‘Allahut i takon ‘el methelul a’la’** (përshkrimi, cilësimi më i lartë).’ (Err-Rrum: 27) Fakti që Ai është cilësuar me cilësitë më të larta, detyrimisht tregon mosekzistencën e të metave.

- Së dyti, çdo mangësi në përsosmërinë e Tij, si mangësia e jetës së Tij, dijes së Tij, fuqisë së Tij, urtësisë së Tij, etj.: **‘Dhe me të vërtete që Ne i krijuam qiejt dhe Tokën dhe gjithçka ka ndërmejt tyre në gjashtë ditë, dhe nuk na preku e nuk ndjejmë aspak lodhje.’** (Kaf: 38)

- Së treti, ngjashmëria e Tij me krijesat. Pra, të mos besohet p.sh. se dija e Tij është si dija e krijesave, fytyra e Tij si fytyra e krijesave, Lartësia e Tij mbi Arsh (“istiu”) si lartësia e krijesave, etj. **‘Asgjë nuk i përngjan Atij.’** (Esh-Shura)

Ndërsa parimi (rregulli) i pohimit është që t’i pohohen Allahut ciësitë e përkryera me të cilat ka përshkruar Vetën e Tij, pa asnjë lloj mangësie: **‘Allahut i takon ‘el methelul a’la’.**’ ‘Methelul a’la’ është përshkrimi ose cilësimi më i lartë të cilit nuk i përngjan asgjë.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Por nuk mjafton që për ta lartësuar e pastruar Allahun nga mangësitë, të bazohemi vetëm në mohimin e përngjasimit ('teshabih'). Lidhur me këtë temë, kemi dy parime të lidhura ngushtë e që s'mund të shkëputen nga njëri-tjetri.

I pari: Përshkrimi i Allahut me ato cilësi që ia ka atribuar Vetes së Tij dhe me ato që i ka përshkruar Atij i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selam).

I dyti: Mohimi i përngjasimit të cilësive të Allahut, me ato të krijesave.

Nuk është e mjaftueshme që pohuesit e cilësive, të bazohen krejtësisht në mohimin e përngjasimit, pa marrë parasysh parimin e parë: ta cilësojmë Allahun vetëm me cilësitë që kanë ardhur në argumente. Në qoftë se kjo do të ishte e lejueshme, atëherë do të lejohej që t'i atribuoheshin Allahut gjymtyrë ose vepra, që është e pamundur të jenë cilësi të Tij dhe këto cilësi nuk mund të llogariten dhe t'i mohohet përngjasimi me krijesat. Pra, që të bazohesh vetëm në parimin e dytë, do të thotë t'i atribuosh (përcaktosh) Allahut mangësi me të cilat nuk lejohet ta cilësosh Atë, dhe nga ana tjetër të mohosh përngjasimin e tyre me krijesat. Është njësoj si të thuash se Ai qan, por jo siç qajnë njerëzit; Atë e merr uria, por jo siç merr uria njerëzit; Ai pi, por jo siç pijnë njerëzit, etj. Atij që e cilëson Allahun me të tilla mangësi, duhet t'i themi se ka gabuar rrugë dhe ka devijuar nga e drejta, sepse nëse i atribuon Allahut të meta e mangësi, nuk i bën dobi mohimi i përngjasimit të tyre me krijesat. Në refuzimin e këtyre cilësive, nuk ka nevojë për mohimin e përngjasimit, por duhen mohuar krejtësisht, sepse ato janë cilësi të mangëta."

(Marrë në mënyrë të përmblendhur nga "Mexhmuul fetaua")

Baza e pestë. Cilësitë "thubutije" ndahen në cilësi "dhatijeh" - صفات ذاتية - të Qenies dhe "fi'lijeh" - صفات فعلية - të veprimit

- Cilësitë "dhatijeh" janë ato me të cilat Allahu ka qenë dhe do të jetë vazhdimisht i cilësuar, dhe nuk mund të përfytyrohet shkëputja e tyre nga Qenia e Tij. Disa nga këto cilësi janë p.sh. **Dija, Shikimi, Urtësia, Lartësia, Madhëria**, etj.

- Cilësitë "fi'lijeh" janë cilësitë që varen nga dëshira e Allahut, nëse Ai dëshiron i vepron dhe nëse nuk dëshiron nuk i vepron, si psh. **Lartësimi mbi Arsh dhe Zbritja për në qiellin e Dynjasë**. Këto cilësi janë quajtur "fi'lijeh" sepse janë vepra të Allahut.

- Cilësitë "fi'lijeh", duke pasur parasysh faktin që janë attribute të Qenies së Allahut, mund të quhen edhe cilësi "dhatijeh", dhe duke pasur parasysh faktin që ato kanë të bëjnë me veprat dhe fjalët që rrjedhin prej Qenies së Tij, quhen

“fi’lijeh”¹, si p.sh. cilësia e të folurit “el kalam”. Të folurit, për sa i përket origjinës dhe llojit, është cilësi “dhatijeh” (atribut i qenies), sepse Allahu ka qenë dhe do të jetë vazhdimisht **Mutekelim - Folës**, dhe për sa i përket një të folure të vetme, është cilësi “fi’lijeh”, sepse “el kalam” (të folurit) varet nga dëshira e Allahut. Ai flet kur dëshiron dhe për atë që dëshiron:

“Sigurisht që urdhëri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është t’i thotë asaj: ‘Bëhu!’ dhe ajo menjëherë bëhet.” (Ja Sin: 82)

Veprat e Allahut nuk kanë fund: **“... dhe Allahu vepron atë që dëshiron.”**

Si rrjedhojë, cilësitë “fi’lijeh” të Allahut, janë të pakufizuara. Çdo cilësi “fi’lijeh” Allahu e vepron me urtësi. Ndoshta mund ta njohim urtësinë e veprës së Allahut dhe ndoshta nuk mund ta njohim atë, por jemi të bindur se çdo gjë që dëshiron Allahu, është në përputhshmëri me urtësinë e Tij:

“Por ju nuk mund të dëshironi, veçse po të dëshirojë Allahu. Vërtet Allahu është i Gjithëditur, i Urtë.”

Baza e gjashtë. Cilësitë e Allahut të Lartësuar, për sa i përket argumenteve të pohimit të tyre, ndahen në cilësi “haberijeh” - صفات خبرية dhe cilësi “semijetun-aklijetun” - صفات سمعية عقلية .

- Cilësitë “haberijeh”, janë ato për të cilat nuk ka mënyrë tjetër pohimi, përveç lajmeve të Kur’anit dhe Sunetit. Këto cilësi mund të jenë “dhatijeh”, si p.sh.

Fytyra dhe Dy Duart, ose mund të jenë “fi’lijeh”, si p.sh. **Gëzimi dhe Qeshja**.

- Cilësitë “semijetun-aklijetun” janë ato të cilat i pohojnë argumentet fetare (Kur’ani dhe Suneti) dhe argumentet logjike. Edhe këto mund të jenë “dhatijeh”, si p.sh. **El Hajat - Jeta, El Ilm - Dija, El Kudretu - Fuqia**, ose mund të jenë “fi’lijeh”, si p.sh. **El Halk - Krijimi dhe El I’ta - Dhënia**.

Baza e shtatë. Në pohimin e cilësive të Allahut duhet të ruhem nga dy gjëra të ndaluara rreptësisht: “temthijli” - التمثيل - përngjasimi dhe “tekjifi” - التكيف - përshtetja në formën e cilësive ose i mënyrës se si ajo është

- “Temthijli” është besimi që cilësitë e Allahut u përngjasojnë cilësive të krijesave, si p.sh. besimi që **Dy Duart** e Allahut janë si dy duart e krijesave, **Fytyra** e Tij, si fytyra e krijesave, **Shikimi** i Tij, si shikimi i krijesave etj. Ky besim është i pasaktë dhe i kotë, pasi atë e hedhin poshtë argumentet e Kur’anit dhe të logjikës.

Argumentet e Kur’anit:

¹) Pra këto cilësi, në një aspekt janë “dhatijeh” dhe në një aspekt tjetër janë “fi’lijeh”.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

“Asgjë nuk i përngjan Atij dhe Ai është i Gjithëdituri, Gjithëshikuesi.” (Esh-Shura: 11)

“A është njësoj atëherë Ai i Cili krijon, me atë që nuk krijon? A nuk do të përkujtoni pra (begatitë e Allahut) e të vini mend!?” (En-Nahl: 17)

“A mos di ndonjë që është i ngjashëm me Të (që të meritojë si emri i Tij)?” (Merjem: 65)

“S’ka asnjë të barabartë ose të krahasueshëm me Të (Një, i Vetëm, i Pashok).” (El Ihlas: 4)

Argumentet logjike:

a) Në mënyrë të sigurtë e të pakundërshtueshme, dihet që Qenia e Allahut (Dhatull-llah) ndryshon nga qeniet e krijesave. Kjo tregon që edhe cilësitë e Allahut ndryshojnë (dallojnë) nga ato të krijesave, sepse cilësia (atributi) i përshatet qenies së cilës i dedikohet dhe i përket. Ne e konceptojmë shumë qartë ndryshimin (dallimin) ndërmjet cilësive të krijesave të ndryshme, si p.sh. dallimin midis forcës së devesë dhe forcës së milingonës. Përderisa ndryshimi ndërmjet krijesave është i qartë, megjithëse ekzistenca e të gjithave është e mundshme, por jo e detyrueshme dhe e domosdoshme, atëherë ndryshimi ndërmjet krijesave dhe Krijuesit është edhe më i qartë.

b) Atë që e përngjason Allahun me krijesat, mund ta kundërshtojmë duke i thënë se si mundet që Gjithëkrijuesi dhe i Përsosuri, t’i përngjajë në cilësitë e Tij krijesës së robëruar, të dobët e të mangët dhe që ka nevojë për dikë që ta përsosë!? A mundet të jetë gjë tjetër ky besim, përveçse mangësim për sa i përket Allahut,¹ sepse përngjasimi i të përsosurit me jo të përsosurin, e ul të parin në rangun e të dytit.

c) Ne shohim gjëra të cilat kanë emra të njëjtë, por në të vërtetë, format dhe mënyrat se si ato janë, ndryshojnë. Shohim p.sh. që njeriu ka dorë, por ajo ndryshon nga dora e elefantit; njeriu ka fuqi, por ajo ndryshon nga fuqia e devesë. Pra, megjithëse kanë të njëjtët emra, dora ose fuqia e një krijese, ndryshon në formë dhe përshkrim nga dora ose fuqia e një krijese tjetër. Nga kjo kuptojmë qartë se kur gjërat kanë emër të njëjtë, kjo nuk tregon detyrimisht që edhe forma dhe përmbajtja e tyre janë të njëjta.

- “Tekjifi” është besimi që cilësitë e Allahut kanë një formë të caktuar² ose një mënyrë të caktuar sesi ato ndodhin, pa e krahasuar këtë formë ose mënyrë me ato të

¹) Ky besim do të thotë që Allahu ka mangësi. I Lartë është Allahu nga ajo që ia përshkruajnë të paditurit.

²) D.m.th. ta përshkruash formën e cilësive të Allahut.

ndonjë krijese.¹ Ky besim është i pasaktë dhe për këtë tregojnë argumentet e Kur'anit, si dhe ato logjike.

Argumentet e Kur'anit:

“Ata kurrë nuk do të përfshijnë gjë nga Dija e Tij.” (Ta Ha: 110)

“Mos ndiq (mos fol, mos bëj) atë gjë për të cilën s’ke dijeni. Me të vërtetë që për të dëgjuarit, të shikuarit dhe zemrën, për secilën prej tyre do të pyetet (nga Allahu në Ditën e Llogarisë).” (El Isra: 36)

Dihet që ne nuk kemi dije rreth “kefijes” (formës, mënyrës se si ato janë) së cilësive të Allahut, sepse Ai na ka lajmëruar për cilësitë dhe nuk e ka bërë këtë për “kefijen”, kështu që dhënia e formës cilësive të Allahut, ose përshkrimi i mënyrës se si ato janë, do të thotë të ndjekësh atë për të cilën nuk ke dijeni dhe të thuash diçka që nuk mund ta përfshijë dija jote.

Argumenti logjik:

Njohja e formës së diçkaje ose mënyrës se si është ajo, mund të arrihet vetëm me anë të njërës prej këtyre tri mundësive:

1- Të njohësh formën e qenies së saj.

2- Të njohësh diçka të ngjashme që është e barabartë me të.

3- Të marrësh dije nga një burim i besueshëm rreth formës së saj.

Por asnjë nga këto mundësi nuk ekziston për të njohur formën e cilësive të Allahut, sepse askush nuk e njeh formën e Qenies së Tij, Ai nuk ka të ngjashëm dhe nuk ka ndonjë burim të besueshëm që na tregon për formën e cilësive të Tij. Prandaj është detyrë që “tekjif”-i të hidhet poshtë e të konsiderohet i pasaktë dhe kufër. Çfardolloy forme që mund të imagjinojmë apo të përfytyrojmë për cilësitë e Allahut, duhet ta dimë se Ai është i Pastër dhe mjaft larg nga forma që i jepet. Për cilëndo nga format që mund të përcaktojmë për cilësitë e Allahut, do të jemi gënjeshtarë, sepse për këtë nuk kemi dije.

Nga kjo rezulton se është detyrë që të ndalohemi nga “tekjif”-i reптësisht, në të gjitha rastet.

Fakti që ne nuk e njohim “kefije”-n e cilësive të Allahut, nuk do të thotë që ato nuk kanë “kefije”. Ato kanë “kefije”, por atë e di vetëm Allahu. Kështu që në këtë kapitull, mohohet dija jonë rreth “kefije”-s dhe jo vetë ajo.

Kur u pyet imam Maliku se si u ngrit (Isteua) i Gjithëmëshirëshmi mbi Arsh, nga nevrikosja dhe sikleti e uli kokën e tij, i dolën djersë e pastaj tha: “El Isteua”

¹) Nëse do t’i japim formë cilësive, duke shtuar që i ngjan kësaj apo asaj krijese, kemi të bëjmë me “temthijl” i cili u hodh poshtë më lart. Pikërisht ky është dallimi ndërmjet “temthijl”-it dhe “tekjif”-it. Në rastin e “temthijl”-it përmendet ose besohet ngjashmëria ndërmjet Allahut dhe krijesës, ndërsa në rastin e “tekjif”-it, thjesht u jepet formë cilësive ose përmendet mënyra se si ato janë, pa përmendur ngjashmëri të tyre me ndonjë krijesë.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

(lartësimi mbi Arsh) është e njohur (si cilësi, si domethënie), mënyra dhe forma e saj është e panjohur, besimi në të¹ është vaxhib dhe pyetja rreth saj² është bidat.³” (Kjo thënie është transmetuar gjithashtu edhe nga mësuesi i imam Malikut, Rebia.)

Ruhu nga “tekjif”-i ose përpjekja për ta bërë atë, sepse nëse e bën, futesh në një labirinth prej të cilit nuk mund të dalësh lehtë. Nëse shejtani e hedh këtë gjë në zemrën tënde, dije se ajo është prej ngacmimeve të tij, prandaj kërkoji Allahut të të ruajë nga ngacmimet e shejtanit:

“Dhe nëse ndonjë pëshpëritje e ligë nga shejtani mundohet të të largojë ty, atëherë kërko mbrojtje tek Allahu. Vërtet Ai është Gjithëdhëguesi, i Gjithëdituri.” (Fusilet: 36)

Baza e tetë. Cilësitë e Allahut të Lartësuar janë “teukifije” - توقيفية, d.m.th. merren vetëm nga Kur’ani dhe Suneti i Profetit (salallahu alejhi ue selam), dhe nuk lejohet që njeriu, me anë të mendjes së tij, t’i dedikojë Allahut cilësi që nuk kanë ardhur në këto dy burime

Imam Ahmedi ka thënë: “Allahu përshkruhet (cilësohet) vetëm me anë të cilësive që Ai e ka përshkruar Vetën e Tij dhe me ato që e ka përshkruar i Dërguari i Tij (salallahu alejhi ue selam). Pra, nuk mund të tejkalohet Kur’ani dhe hadithi.” (Për më gjerë rreth kësaj teme, shih në bazën e tretë të emrave të bukur të Allahut të Lartësuar.)

Për pohimin e cilësive të Allahut të Lartësuar në Kur’an dhe Sunet, gjejmë tri mënyra:

1- Të deklarohet qartë cilësia, si p.sh. **Err-Rrahmetu - Mëshira, El Iz-zeh - Krenaria, El Kuue - Forca, Fytyra, Dy Duarte**, etj: **“Ai është Mëkatfalësi që ka Rahmeh (Mëshirë).”**

2- Të përmendet emri që përmban cilësinë, sepse çdo emër përmban cilësi, p.sh. **El Gafur** përmban cilësinë **El Magfireh - Mëkatfalja, Es-semi’** përmban cilësinë **Es-semë - Dëgjimi**, etj.⁴

3- Të deklarohet një veprim i Allahut që tregon për cilësitë e Tij, si p.sh. **“Lartësimi mbi Arsh”**: **“I Gjithëmëshirëshmi lart mbi Arsh u ngrit.”** (Ta Ha: 5), ose **“Zbritja në qiellin e Dynjasë”**. Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Zoti ynë zbret në qiellin e Dynjasë.”** (Buhariu, Muslimi etj.)

¹) D.m.th. të besosh se “Isteua” e Allahut ndodh.

²) D.m.th. “kefije”.

³) E ka trans. Edh-Dhehebi në “Uluv” dhe e ka saktësuar Albani.

⁴) Shih bazën e tretë në Emrat e bukur të Allahut.

Në temën e emrave të bukur të Allahut dhe cilësive të Tij të larta kanë devijuar dy grupe:

Grupi i parë, “El muatilih”.

Janë ata që i kanë mohuar cilësitë e Allahut të Lartësuar, duke pretenduar se pohimi i cilësive të Tij, do të thotë ta përngjasosh Atë me krijesat. Në këtë grup bëjnë pjesë sektet xehmije, mu’tezilije, esharije, maturidije, etj.

Grupi i dytë, “El mushebihe”.

Janë ato grupe që i kanë pohuar cilësitë e Allahut, duke besuar se ato u përngjajnë cilësive të krijesave.

Ndërsa haku, e vërteta, është rruga e mesme ndërmjet këtyre dy grupeve. Ne i pohojmë cilësitë e Allahut dhe mohojmë përngjasimin e tyre me krijesat, siç ka thënë Allahu në Kur’an: **“Asgjë nuk i përngjason Atij, dhe Ai është Gjithëdëgjues, Gjithëshikues.”**

Ky është besimi i “ehli sunneh uel xhemaah” në lidhje me këtë temë.

Disa parime të rëndësishme të cilat ndihmojnë për të detyruar mohuesit e disa, ose të gjitha cilësive, për t’i pohuar ato

Parimi i parë. Besimi ynë në cilësitë e Allahut është si besimi ynë në “Dhatull-llah” (Qenien e Tij)

Allahu i Lartësuar ka “Dhat”, (Qenie) që nuk i përngjan qenieve të krijesave. Po ashtu edhe cilësitë dhe veprat e Tij nuk u përngjajnë cilësive të krijesave dhe veprave të tyre. Ai që pohon se Allahu është Qenie konkrete e cila nuk i përngjan krijesave, është i detyruar të pohojë gjithashtu se Allahu flet, shikon, dëgjon, etj., dhe në të gjitha këto, nuk u përngjan krijesave të Tij. Në qoftë se ndonjëri do të thotë se e mohon lartësinë e Allahut mbi Arsh, dëgjimin, shikimin etj., nga frika se po e përngjason Allahun me krijesat, i thuhet se atëherë duhet ta mohojë edhe ekzistencën e Allahut dhe Qenien e Tij, pasi edhe krijesat ekzistojnë dhe kanë qenie, kështu që pohimi i ekzistencës dhe i qenies (sipas tij) do të thotë ta përngjasosh Allahun me krijesat e Tij. E nëse thotë se ekzistenca dhe Qenia e Allahut është e veçantë dhe nuk i përngjan asaj të krijesave, i thuhet se të tilla janë edhe cilësitë e Tij: të veçanta dhe nuk u përngjajnë cilësive të krijesave.

Parimi i dytë. Besimi në disa cilësi është i njëjtë me besimin në cilësitë e tjera

Në këtë parim u kundërvihemi disa grupeve:

1- Atyre që pohojnë disa cilësi dhe mohojnë disa të tjera.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Ata p.sh. pohojnë **Jetën, Dijen, Fuqinë, Dëgjimin, Shikimin, Të Folurit, Dëshirën** etj. Këto cilësi i besojnë si cilësi reale, dhe kundërshtojnë nga ana tjetër pohimin e **Dashurisë, Kënaqësisë, Zemërimit, Urrejtjes** etj., duke i besuar si shprehje alegorike ose duke thënë se interpretimi i tyre është: dëshira për të bërë mirësi ose dëshira për të ndëshkuar.

Këtyre u thuhet se nuk ka ndryshim ndërmjet cilësive që kanë pohuar dhe ature që kanë mohuar, sepse ajo që mund të thuhet për cilësitë e pohuara, mund të thuhet edhe për të mohuarat. Me fjalë të tjera, mund t'u thuhet se parimi që kanë vendosur për pohimin e disa cilësive, përfshin edhe cilësitë që kanë mohuar. Prandaj, për të mos qenë kontradiktorë, ose duhet t'i pohojnë të gjitha, ose t'i mohojnë të gjitha.

Në qoftë se thonë që **Jeta** e Tij është si jeta e krijesave, atëherë duhet të thonë të njëjtën gjë edhe për **Kënaqësinë, Dashurinë** dhe **Zemërimin** e Tij, dhe në qoftë se thonë që **Jeta** e Tij nuk i përngjan jetës së krijesave, atëherë duhet të thonë të njëjtën gjë edhe për **Kënaqësinë, Dashurinë** dhe **Zemërimin** e Tij.

Në qoftë se thonë që **El Gadab - Zemërimi**, është qarkullimi i furishëm (i vrullshëm) i gjakut në zemër gjatë dëshirës për hakmarrje,¹ u thuhet se sipas të njëjtës logjikë, edhe dëshira është animi i zemrës drejt asaj që i sjell dobinë ose i shmanget dëmin.

Në qoftë se do të thonë që kjo është dëshirë krijese,² atëherë u thuhet se sipas asaj që ata thanë për **El Gadab**, edhe ai i përket krijesës, ndërsa Zemërimi i Krijuesit ndryshon nga ai i krijesës.

2- Atyre që pohojnë emrat dhe mohojnë cilësitë.

Ata thonë p.sh. se Allahu është **Hajj (I Gjallë)** pa **hajat (jetë), Alim (i Dijshëm)** pa **ilm (dije)** etj.

Këtyre u thuhet se nuk ka ndryshim ndërmjet pohimit të emrave dhe pohimit të cilësive.

Nëse do të thonë që pohimi i **Jetës, Dijes, Fuqisë**, etj., tregon për përngjasim me krijesat (teshbih) dhe për trupëzim (texhsim), pasi cilësitë i atribuohen vetëm diçkaje që është trup (xhism),³ u thuhet se edhe emrat, si p.sh. **Hajj (i Gjallë)**,

¹) Me anë të sqarimit që i kanë bërë “El Gadab”, duan të thonë se ai është veti e krijesës e cila tregon për nevojë dhe mangësi, kështu që atribuimi i Allahut me të, do të thotë ta cilësosh me një cilësi që nuk i përshtatet Madhërisë së Tij dhe ta përngjasosh me krijesat.

²) D.m.th. dëshira në këtë mënyrë është veti e krijesës, ndërsa dëshira e Allahut ndryshon nga ajo e krijesës.

³) Sipas tyre, trupa ose të trupëzuar janë krijesat, ndërsa Allahu nuk është trup, prandaj i kanë mohuar cilësitë e Allahut, sepse, sipas tyre, pohimi i këtyre cilësive, tregon se Allahu është trup (xhism). Sipas “ehli sunetit”, kjo fjalë nuk është përmendur në Kur'an dhe Sunet as me pohim, as me mohim. Për rrjedhojë, fjalën trup (xhism) nuk e përdorim në të drejtën

Alim (i Dijshëm), Kadir (i Fuqishëm) etj., përdoren për emërtimin e objekteve të trupëzuara. Prandaj, duhet që sipas kësaj logjike, të mohojnë edhe emrat, që të mos jenë kontradiktorë.

Në qoftë se do të thonë që këto janë emra të cilët i përshtaten përsosmërisë së Allahut dhe Madhërisë së Tij, u thuhet se të tilla janë edhe cilësitë e Tij.

3- Atyre që mohojnë emrat dhe cilësitë e Allahut, duke pretenduar se mohimi i tyre bëhet për të mos e përngjasuar Allahun me objektet ekzistuese.¹

Ata i mohuat emrat si p.sh. **“Alim” (i Dijshëm), “Hajj” (i Gjallë)** etj, si dhe mohuan cilësitë si p.sh. **Dijen** dhe **Jetën**, nga frika e përngjasimit të Allahut me objektet ekzistuese. Por në fakt, besimi i tyre do të thotë ta përngjasosh Allahun me objektet inekzistente, pasi nuk mund të ekzistojë diçka, pa pasur emër dhe cilësi. Pra, ata u larguan nga njëra rrugë - që sipas tyre ishte e keqe - dhe hynë në një rrugë tjetër e cila është akoma më e keqe dhe më e rrezikshme se e para, dhe ky është përfundimi i atyre që devijojnë nga Kur’ani dhe Suneti.

Baza e nëntë. Nëse objekte të caktuara kanë të njëjtin emër, nuk do të thotë detyrimisht që në realitet formën dhe përmbajtjen e kanë të njëjtë

Për të sqaruar këtë bazë do të japim disa shembuj:

1) Ne jemi të bindur se gjërat për të cilat Allahu na ka lajmëruar se ndodhen në Xhenet, si p.sh. hyrijet, pallatet, qumështi, mjalti etj, ekzistojnë realisht. Por këto gjëra, edhe pse kanë emra të njëjtë me gjërat që ekzistojnë në dynja, nuk u përngjasojnë atyre, por janë kryekëput të ndryshme. Se sa i madh është ky ndryshim (dallim), e di vetëm Allahu:

“Askush nuk e di se çfarë është ruajtur për ta nga kënaqësitë e syrit, si shpërblim për çfarë ata punuan.” (Es-Sexhde: 17)

e Allahut, prandaj në këtë libërth përdorim fjalën “Dhat” (Qenia e Allahut), ose “nefs” (Vetja). Ndërsa, për sa i përket qëndrimit të “ehli sunetit” ndaj atyre që e mohojnë këtë fjalë në të drejtën e Allahut, ose e pohojnë, do të flasim më vonë, por shkurtimisht mund të themi se për sa i përket të shprehurit të fjalës “xhism”, është detyrë të ndalemi dhe as të mos e pohojmë e as të mos e mohojmë, sepse nuk ka ardhur në Kur’an dhe Sunet pohimi apo mohimi i kësaj fjale. Për sa i përket domethënies së fjalës “xhism”, kërkojmë prej atij që e përdor që ta sqarojë: nëse ka për qëllim një domethënie të drejtë që i përshatet Allahut, pranohet, dhe në të kundërt, nëse ka për qëllim një domethënie që nuk i përshtatet Allahut, refuzohet.

¹⁾ Sipas tyre, objektet ekzistuese kanë emra dhe cilësi. Si rrjedhojë, ata i mohojnë emrat dhe cilësitë e Allahut që të mos e përngjasojnë Atë me këto objekte. Në realitet, mohimi i emrave dhe cilësive të Allahut, do të thotë të mos besosh në ekzistencën e Tij, siç është sqaruar në këtë libër.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Gjithashtu, Allahu ka thënë në një hadith “kudsi” të transmetuar nga Profeti (salallahu alejhi ue selam): **“Për robërit e mi të mirë kam përgatitur atë që nuk e ka parë ndonjëherë syri, nuk ka dëgjuar për të ndonjëherë veshi, dhe nuk ka menduar për të mendja e ndonjë njeriu.”**

Ibnu Abas ka thënë: “Në Dynja nuk ka asgjë nga ato që gjenden në Xhenet, përveç emrave.”

Emrat e gjërave të Xhenetit, megjithëse janë të njëjta me ato të gjërave të Dynjasë, nuk tregojnë që gjërat e Ahiretit dhe Dynjasë janë të njëjta, por përkundrazi, ndërmjet tyre ka një ndryshim të tillë, masën e të cilit e di vetëm Allahu. Atëherë, ndryshimi ndërmjet Krijuesit dhe krijesës është më i madh, më i qartë dhe më i arsyeshëm logjikisht.

2) Shpirti, i cili është shkaku i jetës në trupin e njeriut dhe që është gjëja më e afërt te njeriu, është përshkruar në tekstet e Kur’anit dhe Sunetit me shumë attribute (cilësi), si p.sh. kapet nga trupi, bëhet ngritja e tij në qiellin e Dynjasë, kthehet në trup etj, dhe askush nga muslimanët nuk e mohon ekzistencën e tij reale. Por njeriu mund ta konceptojë (ta njohë) realitetin e tij, vetëm nëpërmjet cilësive që janë bërë të njohura me anë të shpalljes. Pra, megjithëse shpirti ekziston dhe argumentet fetare na kanë njohur me disa cilësi të tij, ne nuk mund ta konceptojmë relitetin e tij, siç ka thënë Allahu në Kur’an:

“Dhe të pyesin ty për rruhun (shpirtin). Thuaj: ‘Rruhu është prej atyre gjërave, dija e të cilave është vetëm tek Allahu, ndërsa nga kjo dije juve ju është dhënë vetëm se fare pak.’” (Isra: 85)

Shpirti është një realitet i veshur me cilësi reale të përmendura në Kur’an dhe Sunet, i cili nuk u përngjan trupave që ne i shikojmë dhe njerëzit janë të paaftë për ta konceptuar ekzistencën e tij. Atëherë, atribuimi (cilësimi) i Allahut me cilësitë e përkryera që Ai meriton, e të cilat ndryshojnë nga ato të krijesave, është shumë më i arsyeshëm dhe shumë më i logjikshëm. Në të njëjtën linjë mendimi, edhe paaftësia e mendjes së njeriut për ta përkufizuar ose për t’i përshkruar formë Allahut, është më e qartë sesa paaftësia e saj për të përkufizuar shpirtin dhe për t’i përshkruar formë atij.

Përderisa ai që mohon cilësitë e shpirtit ose i përngjason ato me krijesat që shikon është përgënjeshtues, mohues, injorant dhe përngjasues, atëherë është më e logjikshme dhe më e arsyeshme që të jetë i tillë edhe ai i cili mohon cilësitë e Allahut ose i krahason (barazon) ato me cilësitë e krijesave të Tij.

Parimet e argumenteve nga të cilat merren emrat dhe cilësitë e Allahut

Parimi i parë. Argumentet në të cilat bazohemi për të pohuar emrat dhe cilësitë e Allahut, merren vetëm nga Kur’ani dhe Suneti i saktë i Profetit (salallahu alejhi ue selam)

Pra, atë emër ose cilësi që është pohuar në Kur’an dhe Sunet, e kemi detyrë që ta pohojmë. Nga ana tjetër, atë emër ose cilësi që është mohuar në Kur’an dhe Sunet, e kemi detyrë që ta mohojmë, por duke pohuar njëkohësisht edhe përsosmërinë e të kundërtës së saj.

Fjalët dhe shprehjet që as janë pohuar dhe as janë mohuar në Kur’an dhe Sunet, e kemi detyrë që të mos i shprehim¹. Këto, as i pohojmë dhe as i mohojmë (në të drejtën e Allahut) përderisa nuk ka ardhur në Kur’an dhe Sunet pohimi dhe mohimi i tyre, por, për sa i përket domethënies dhe kuptimit që kanë për qëllim këto fjalë ose shprehje, kërkojmë që kjo të sqarohet: Në qoftë se nëpërmjet përmendjes së tyre është synuar një kuptim i drejtë që i përshtatet Allahut të Lartësuar, ato pranohen, dhe në të kundërt, nëse është synuar një kuptim që nuk i përshtatet Madhërisë së Allahut, ato refuzohen.

Cilësitë që i janë pohuar Allahut të Lartësuar në Kur’an dhe Sunet, janë të gjitha ato cilësi për të cilat tregojnë emrat e bukur të Allahut dhe veprat (punët) e Tij, si p.sh. **“isteua”** (Lartësimi) mbi Arsh, **Zbritja** në qiellin e Dynjasë, **Ardhja** në Ditën e Gjykimit e të tjera prej veprave të Allahut të cilat nuk kanë fund, siç ka thënë Ai në Kur’an: **“Dhe Allahu vepron atë që dëshiron.”** (Ibrahim: 27)

Prej këtyre cilësive mund të përmendim këto që vijnë: **Fytyra, Dy Sytë, Dy Duart, të Folurit, Dëshira, Kënaqësia, Dashuria, Zemërimi, Urrejtja** etj.

Nga cilësitë që i janë mohuar Allahut në Kur’an dhe Sunet, duke pohuar përsosmërinë e të kundërtës së tyre janë: **gjumi, vdekja, kotja, paaftësia** etj.

Nga fjalët dhe shprehjet që as janë pohuar dhe as janë mohuar në Kur’an dhe Sunet, është fjala **“el xhihetu”** - الجهة - ana.²

Sikur një person të pyeste nëse e pohojmë apo jo që Allahu është në ndonjë anë të caktuar, do t’i përgjigjeshim se fjala “xhihetun” (anë) nuk është përmendur për Allahun në Kur’an dhe Sunet, as me pohim dhe as me mohim. Argumentet e Kur’anit dhe Sunetit që tregojnë se Allahu është në lartësi, e bëjnë të panevojshme përdorimin e kësaj fjale. Ndërsa, për sa i përket domethënies së saj, ajo mund të

¹) D.m.th të mos i përdorim si fjalë apo shprehje as me pohim dhe as me mohim.

²) Të qenët e Allahut në një anë, drejtim të caktuar.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

ketë pasur për qëllim: 1) anën e poshtme, 2) anën e lartësisë që e përfshin Allahun, ose 3) anën e lartësisë që nuk e përfshin Allahun.

- E para është e pasaktë, e papranueshme dhe e pamundur, sepse bie në kundërshtim me argumentet e Kur'anit, Sunetit, logjikës, fitres (natyrshmërisë) dhe "ixhmait", të cilat tregojnë se Allahu është në lartësi.

- E dyta është përsëri e pasaktë, e papranueshme dhe e pamundur gjithashtu, sepse Allahu është më i Madhërishmi dhe nuk mund ta përfshijë asnjë nga krijesat e Tij.

- E treta është e saktë, e vërtetë dhe e pranueshme, sepse Allahu është i Lartësuar mbi të gjitha krijesat e Tij dhe Atë nuk e përfshin asgjë.

Për këtë parim, kemi argumente si nga Kur'ani, ashtu edhe nga logjika.

Argumente nga Kur'ani:

"Edhe ky është Libër i bekuar të cilin Ne e kemi zbritur, kështu që ndiqeni atë dhe kijeni frikë Allahun, me qëllim që të merrni mëshirën." (El En Am: 155)

"Thuaj: 'O njerëz! Vërtet unë jam sjellë tek ju të gjithë si i Dërguari i Allahut, të Cilin i takon mbisundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij. Ai është që jep jetën dhe sjell vdekjen. Kështu pra, besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e as këndim, i cili beson në Allahun dhe në fjalën e Tij, dhe ndiqeni pra atë që të mund të jeni të udhëzuar." (El A'raf: 158)

"Dhe çfardo që t'ju japë i Dërguari, merreni, dhe çfardo që ai jua ndalon juve, hiqni dorë prej saj dhe kini frikë Allahun. Vërtet që Allahu është i Ashpër në ndëshkim." (El Hashr: 7)

"Ai që i beson dhe i bindet të Dërguarit, vërtet ai i ka besuar dhe i është bindur edhe Allahut, por për atë që shmanget, Ne nuk të kemi dërguar ty si roje e vëzhgues për ta." (En-Nisa: 80)

"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit dhe atyre prej jush, të cilët janë në drejtimin dhe udhëheqjen tuaj. Nëse keni mosmarrëveshje për ndonjë gjë mes jush, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni në Allahun dhe në Ditën e Fundit. Kjo është më e mirë dhe më e përshtatshme për përcaktimin e fundit." (En-Nisa: 59)

"Dhe në këtë mënyrë gjyko mes tyre me atë që të ka shpallur ty Allahu dhe mos u shko pas dëshirave të tyre të kota, por tregohu i vëmendshëm ndaj tyre që mos të të kthejnë e të të largojnë nga disa gjëra, të cilat Allahu t'i ka zbritur ty. Por nëse ata largohen, atëherë dije se është dëshira e Allahut për t'i

ndëshkuar ata për disa mëkate të tyre. Dhe vërtet shumica e njerëzve janë fasikunë (të prishur).” (El Maide: 49)

Përveç këtyre ajeteve, ka edhe të tjera të cilat tregojnë se është detyrë të besojmë në atë që ka ardhur në Kur'an dhe Sunet.

Çdo argument që tregon se është detyrë të besojmë në atë që ka ardhur në Kur'an, është njëkohësisht edhe argument që tregon se është detyrë të besojmë në atë që ka ardhur në Sunet. Kjo argumentohet me urdhërin që ka ardhur në Kur'an për ta ndjekur Profetin = dhe për t'iu referuar atij në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjatë jetës së tij, kthimi dhe referimi bëhej tek ai vetë, ndërsa pas vdekjes së tij, kthimi dhe referimi bëhet tek Suneti i tij.

Ku e ka besimin në Kur'an ai që nuk kthehet tek Profeti = për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, megjithëse Allahu ka udhëruar për këtë!?

Argumenti logjik:

Sqarimi i asaj që është detyrë t'i atribuohet Allahut, i asaj që është e pamundur t'i atribuohet, ose i asaj që është e lejueshme t'i atribuohet Atij, bën pjesë në çështjet e “gajbit” (të fshehtës), të cilat nuk mund të perceptohen logjikisht. Për këtë, mbetet detyrë që t'i referohemi Kur'anit dhe Sunetit.

Parimi i dytë. Është detyrë që tekstet e Kur'anit dhe Sunetit që kanë të bëjnë me emrat dhe cilësitë e Allahut, të besohen sipas domethënies së tyre të drejtpërdrejtë,¹ pa u bërë “tahrif” dhe “ta'til” emrave dhe cilësive për të cilat ato tregojnë

- “Tahrif” është: *ndryshimi i fjalëve (shprehjeve) të emrave dhe cilësive, ose ndryshimi i domethënies (kuptimeve) të tyre.*

Xhehmijet për shembull, e kanë ndryshuar fjalën **Isteua** - استوى, duke shtuar një “lam” (shkronjën [l]) në të dhe duke e bërë: “isteula” - استولى².

Disa bidatçinj të tjerë, e kanë ndryshuar kuptimin e **El Gadab** (Zemërimit), duke thënë se është dëshira për hakmarrje, si dhe kuptimin e **Err-Rrahmeh** (Mëshirës), duke thënë se është dëshira për të bërë mirë.

Të gjitha këto quhen “tahrif” (keqinterpretim, deformim) dhe ai është dy llojesh:

a) “Tahrif lafzhi” - تحريف لفظي - ndryshimi i shprehjes duke shtuar shkroja në të, duke pakësuar ose duke ndryshuar zanoret e fjalës.

¹) Në gjuhën arabe, domethënia e drejtpërdrejtë e një fjale quhet “dhahir”, ndërsa antonimi i saj është domethënia e interpretuar. Ai që e ndryshon domethënien e drejtpërdrejtë të cilësive, nuk quhet thjesht interpretues, por keqinterpretues, deformues dhe ndryshues.

²) Pra, e kanë ndryshuar kuptimin “u ngrit mbi Arsh”, duke e bërë “mbizotëroi Arshin”.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Çifutët e ndryshuan fjalën e Allahut nga “Hit-tatun” - حطة në “Hintatun” - حنطة duke shtuar në të shkrojtën: ن - “nun”, kurse xhehmijet e ndryshuan fjalën e Allahut “isteua” në “isteula” duke i shtuar një “lam”, siç e përmendëm më lart.

b) “Tahrif ma’neui” - تحريف معنوي - ndryshimi i domethënies së saktë të teksteve të emrave dhe cilësive, si p.sh., thënia që **El Gadab** (Zemërimi) i Allahut është dëshira për hakmarrje etj.

- “Ta’til” është: *mohimi i cilësive të Allahut, duke i keqinterpretuar tekstet e Kur’anit dhe Sunetit.*

Xhehmijet dhe grupet që kanë ndjekur rrugën e tyre, ia kanë mohuar Allahut cilësitë e Tij, prandaj janë quajtur “el muatileh”.

Parimin për të cilin po flasim e vërtetojnë argumentet e Kur’anit, argumenti logjik dhe “ixhmai” i selefëve

Argumente nga Kur’ani:

“Të cilin rruhu (Xhibrili) i besueshëm e ka zbritur në zemrën tënde që të mund të jesh prej këshilluesve, në gjuhën e qartë arabe.” (Esh-Shuara: 193-195)

“Nuk ka dyshim që Ne e zbritëm Kur’anin arabisht, me qëllim që ju të mund ta kuptoni.” (Jusuf: 2)

“Me të vërtetë, Ne e bëmë atë (Kur’anin) në arabisht, që të keni mundësi ta kuptoni.” (Ez-Zuhruf: 3)

Këto argumente, tregojnë se duhet ta kuptojmë Kur’anin sipas domethënies së tij të drejtpërdrejtë në gjuhën e qartë arabe, përveç rastit kur ekziston ndonjë argument, i cili na pengon që ta bëjmë këtë. Allahu i ka poshtëruar çifutët për shkak të “tahrifit” të tyre dhe ka sqaruar se “tahrifi” që ata i bënë argumenteve, i bëri që të jenë ndër njerëzit më të larguar nga besimi:

“A lakmoni ju që ata do të besojnë në fenë tuaj, edhe pse një grup prej tyre gjithnjë e dëgjuan fjalën e Allahut (Teuratin), pastaj ata vetë e ndryshuan atë vazhdimisht me dije të plotë pasi e kishin kuptuar atë?” (El Bekare: 75)

“Ka nga çifutët edhe prej atyre të cilët ua ndërrojnë vendin e vërtetë fjalëve dhe thonë: ‘Ne e dëgjuam fjalën tënde dhe nuk bindemi’, ‘Dëgjo dhe mos dëgjo asgjë ti (Muhamed)’ dhe ‘raina’ (me një përdredhje të gjuhës dhe si përqeshje për fenë). Dhe sikur të kishin thënë: ‘Dëgjuam dhe u bindëm’ dhe: ‘Na bëj që të kuptojmë’, do të kishte qenë më e mirë për ta dhe më e drejtë, por Allahu i ka mallkuar ata për shkak të mosbesimit të tyre, kështu që ata nuk besojnë, përveçse fare pak.” (En-Nisa: 46)

Argumenti logjik:

Ai, i Cili i ka formuluar tekstet që tregojnë rreth cilësive, e di më mirë se kushdo tjetër atë që ka pasur për qëllim. Ai na ka folur në gjuhën e qartë arabe, prandaj duhet t'i pranojmë fjalët e Tij sipas domethënies së tyre të drejtpërdrejtë, sepse në të kundërt, do të kishte mendime të ndryshme në interpretimin e tyre dhe Umeti do të përçahej.

Të gjithë selefët e Umetit i kanë besuar tekstet e cilësive sipas domethënies së tyre të drejtpërdrejtë, pa u bërë atyre “tahrif” dhe “ta’til”.

Mësuesi i Buhariut, Nuajm ibn Ham-mad el Huzai, ka thënë: “Kush e përngjason Allahun me krijesat ka bërë kufër dhe kush i përgënjeshton cilësitë me të cilat Allahu ka përshkruar Vetën e Tij, ka bërë kufër. Vërtet cilësitë që Allahu ia ka atribuar Vetes së Tij, ose që ia ka atribuar Atij i Dërguari (salallahu alejhi ue selam), nuk tregojnë për përngjasim me krijesat.”

Imam Esh-Shafiu ka thënë: “Kam besuar në Allahun dhe në atë që ka ardhur nga Allahu, sipas qëllimit të Allahut, si dhe kam besuar në të Dërguarin e Allahut dhe në atë që ka ardhur nga i Dërguari i Allahut, sipas qëllimit të të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selam).”

Në lidhje me domethënien e drejtpërdrejtë të teksteve të cilësive, njerëzit janë ndarë në tri grupe:

Grupi i parë, “Ehli suneti”.

Ata që e kanë kuptuar se me të vërtetë “dhahir” (domethënia e drejtpërdrejtë që të vjen menjëherë ndërmend nga argumenti), është ajo që i përshtatet Madhështisë së Allahut. Me fjalë të tjera, ata i janë përmbajtur kuptimit që të shkrep menjëherë në mendje pasi dëgjon argumentin. Ky kuptim, i përshtatet me të vërtetë Madhërisë së Allahut.

Këta janë selefët (të parët e këtij Umeti), të cilët janë të bashkuar në ndjekjen e asaj që ka ardhur nga Profeti (salallahu alejhi ue selam) dhe sahabët, këta janë “ehli sunneh uel xhemaah”.

Kjo që u përmend më lart është besimi unanimitet i të gjithë selefëve. Ibnu Abdilberr-ri ka thënë: “Ehli suneti i pohon unanimitet cilësitë që kanë ardhur në Kur’an dhe Sunet. Ai i beson duke u dhënë atyre kuptim real dhe jo alegorik, vetëm se nuk u përshkruan formë dhe as nuk i kufizon ato. Ky është besimi i vërtetë për dy arsye:

1- Vetëm në këtë mënyrë zbatohen tërësisht argumentet e Kur’anit dhe Sunetit që e obligojnë besimin në çdo emër dhe cilësi që është përmendur në këto dy burime. Ai që e studion këtë temë me dije dhe paanësi, e pohon patjetër këtë që thamë.

2- A qëndron e vërteta në atë që kanë thënë selefët, apo qëndron në atë që kanë thënë të tjerët!? Varianti i dytë është i pavlefshëm (i pasaktë), sepse ai do të thotë se sahabët dhe tabiinët, në fjalët e tyre të qarta ose në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalëve të tyre, kanë shprehur besimin e pasaktë dhe asnjëherë besimin e vërtetë. Si

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

rrjedhojë, kjo tregon se ata ose nuk e dinin të vërtetën, ose e dinin atë, por e fshehën. Që të dyja këto janë të pavlefshme, sepse selefët kanë qenë më të diturit e këtij Umeti rreth së vërtetës dhe më besnikët në përcjelljen e saj. Si përfundim, e vërteta gjendet tek ajo që kanë thënë selefët, dhe jo tek ato që kanë thënë të tjerët.”

Grupi i dytë, “El Mushebihe”.

Ata që “dhahir” e kanë bërë të pavlefshëm dhe e kanë përngjasuar Allahun me krijesat e Tij.

Mënyra e tyre në të kuptuarit e argumenteve, është e pavlefshme dhe e pasaktë për shkak të argumenteve që vijnë:

a) Ky është krim ndaj argumenteve dhe mohim i kuptimit të vërtetë që është synuar nëpërmjet tyre. Si mund të jetë synuar nëpërmjet “dhahir” përngjasimi, ndërkohë që Allahu ka thënë:

“Krijuesi i qiejve dhe i Tokës. Ai ka bërë për ju shoqet nga vetë ju, dhe po kështu edhe për bagëtitë. Në këtë mënyrë Ai ju krijon ju. Asgjë nuk i përngjet Atij dhe Ai është Gjithëdhëgjuesi, Gjithëshikuesi.” (Esh-Shura 11)

b) Përmes logjikës, arrijmë në përfundimin se Krijuesi ndryshon nga krijesat në Qenien dhe cilësitë e Tij. Atëherë si mund të gjykohej se tekstet tregojnë për përngjasim ndërmjet tyre!?

c) Kuptimi që ka nxjerrë përngjasuesi nga argumentet, bie në kundërshtim me kuptimin që kanë nxjerrë selefët prej tyre, dhe si rrjedhojë ajo është e pavlefshme.

Në qoftë se dikush do të thotë që **Zbritja** e Allahut dhe **Dora** e Tij janë si ato të krijesave, sepse Allahu na ka folur vetëm përmes fakteve që ne i njohim dhe i kuptojmë, i përgjigjemi si më poshtë:

E para, Ai që na është drejtuar përmes ajeteve dhe haditheve që tregojnë për cilësitë, është po Ai, i Cili ka thënë për Vetën e Tij: **“Asgjë nuk i përngjan Atij”**. Fjalët e Allahut janë të gjitha të vërteta, vërtetojnë njëra-tjetrën dhe nuk bien në kundërshtim mes tyre.

E dyta, pyetet nëse arrin ta konceptojë që Qenia e Allahut nuk i përngjan qenieve të tjera apo jo? Nëse thotë po, i thuhet se në të njëjtën mënyrë duhet ta konceptojë edhe që cilësitë e Allahut nuk u përngjajnë cilësive të krijesave dhe ai që bën dallimin ndërmjet Qenies dhe cilësive të Tij është kontraditor.

E treta, i thuhet se ka krijesa me emra të njëjtrë, por forma dhe përmbajtja e tyre ndryshojnë. Pra, përderisa konceptohet ndryshimi ndërmjet krijesave në formë dhe përmbajtje, përse nuk bëhet e njëjta gjë edhe për sa i përket ndryshimit ndërmjet Krijuesit dhe krijesës, megjithëse ky ndryshim është më i madh dhe më i qartë!? Në fund të fundit, përngjasimi ndërmjet Krijuesit dhe krijesës është i pamundur (i papranueshëm logjikisht), siç është sqaruar në bazën e gjashtë të cilësive.

Grupi i tretë, “El Muatilih”.

Ata që “dhahir” e konsiderojnë kuptim të pavlefshëm që nuk i përshtatet Allahut. Sipas tyre “dhahir” është “teshbih” (përngjasim). Për këtë arsye, ata i kanë mohuar domethëniet e teksteve të cilësive që i përshtaten Allahut.

Në këtë grup futen ata që i kanë mohuar emrat dhe cilësitë krejtësisht ose pjesërisht, ata që kanë mohuar emrat dhe cilësitë dhe ata që kanë mohuar vetëm cilësitë ose disa prej tyre.

Këta i ndryshuan domethëniet e drejtpërdrejta të teksteve dhe u dhanë atyre kuptime të ndryshme sipas mendjes së tyre. Në përcaktimin e këtyre kuptimeve të ndryshuara, kanë pasur shumë lëkundje e mosmarrëveshje. Këtë ndryshim të kuptimeve, ata e emërtuan “te’uil” (interpretim), por në realitet ai është “tahrif” (keqinterpretim, deformim).

Mënyra e tyre në të kuptuarit e argumenteve të cilësive dhe në interpretimin e tyre, është e pavlefshme për arsyet që vijnë:

1- Ky është krim ndaj argumenteve, pasi ata kanë thënë se ato tregojnë për një domethënie të pavlefshme, e cila nuk i përshatet Allahut dhe Ai nuk e ka patur për qëllim.

2- Kjo që kanë bërë ndaj argumenteve të cilësive, konsiderohet ndryshim i “dhahir”-it të fjalës së Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selam), edhe pse dihet se Allahu na ka folur në gjuhën e qartë arabe, që të konceptohet fjala e Tij dhe të kuptohet sipas domethënies së saj të drejtpërdrejtë gjuhësore. Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka folur më qartë se çdo njeri tjetër, prandaj është detyrë që fjala e Allahut dhe e të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selam), të kuptohet sipas domethënies së saj të drejtpërdrejtë në gjuhën arabe, duke pasur parasysh që të mbrohet nga “tekfijj” dhe “temthijli”.

3- Ndryshimi i “dhahir”-it të fjalës së Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selam), duke i dhënë asaj një kuptim të ndryshëm, është e folur rreth Allahut pa dije dhe kjo është haram, sepse Allahu ka thënë në Kur’an:

“Thuaj: ‘Gjërat që i ka ndaluar Zoti juaj janë: el fahisha (gjynahet) që kryhen hapur ose fshehur, gjynahet, shtypja pa të drejtë, vënia shok Allahut në adhurim, gjë për të cilën Ai nuk ka dhënë asnjë të drejtë dhe asnjë provë, si dhe përfolja ndaj Allahut për gjëra që ju nuk keni asnjë dijeni.’” (El Araf: 33)

“Dhe mos ndiq atë gjë për të cilën nuk ke dijeni. Me të vërtetë që për të dëgjuarit, të shikuarit dhe zemrën, për secilën prej tyre njeriu do të pyetet.” (El Isra: 36)

Ai që e ndryshon “dhahir”-in e fjalës së Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selam), duke i dhënë një kuptim tjetër, ka ndjekur atë për të cilën nuk ka dijeni dhe ka thënë për Allahun atë që nuk e di, për dy arsye:

E para, sepse ka pretenduar se qëllimi i fjalës së Allahut është i ndryshëm, megjithëse ka dëgjuar “dhahir”-in e fjalës së Tij.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

E dyta, sepse ai ka pretenduar se qëllimi i fjalës së Allahut është i ndryshëm, duke dhënë një kuptim tjetër, për të cilin nuk tregon “dhahir”-i i fjalës së Tij, kur dihet që nëse do të kemi një fjalë me dy variante të njëjta intepretimi dhe i jepet përparësi njërit prej tyre, kjo do të thotë të interpretosh pa dijeni. E çfarë mund të mendojmë kur i jepet përparësi një varianti që ka mundësinë më të vogël për të qenë i saktë, përpara kuptimit të drejtpërdrejtë të fjalës!?

Si shembull për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar drejtuar Iblisit:

“Allahu i tha: ‘O Iblis! Çfarë të ndaloj ty që të mos i biesh në sexhde atij që Unë e krijova me dy Duart e Mia? A je tepër kryelartë apo je prej të lartësuarve?’” (Sad: 75)

Në qoftë se do të ndryshojë tekstin nga “dhahir”-i i tij, duke thënë se nuk ka pasur për qëllim dy duar reale, por dy duar që kanë një formë tjetër të caktuar (duke e përshkruar atë), pyetet se nga e mori argumentin për atë që mohoi dhe për atë që pohoi. Nuk ka dyshim se nuk do të sjellë ndonjë argument dhe si përfundim, del në pah se ka thënë për Allahun atë për të cilën nuk ka dije.

4- Ndryshimi i “dhahir”-it të teksteve të cilësive, bie në kundërshtim me rrugën e Profetit (salallahu alejhi ue selam), sahabëve, selefëve të këtij Umeti dhe dijetarëve të tij të njohur. Si rrjedhojë, ai është i pavlefshëm sepse e vërteta, padyshim është rruga dhe “menhexhi” i të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selam), sahabëve, selefëve dhe dijetarëve që i kanë pasuar ata.

Pasojat e metodës së “El Muatileh” në ndryshimin e teksteve, të cilat tregojnë pavlefshmërinë e saj

1) Ata kuptuan nga tekstet cilësi që u përngjajnë atyre të krijesave dhe menduan se ky është kuptimi i vërtetë i tekstit, por ky është kuptim i gabuar, sepse cilësia për të cilën tregon argumenti, i përshtatet Allahut dhe nuk u përngjan krijesave. Përngjasimi i Allahut me krijesat është kufër dhe lajthitje, sepse ai konsiderohet përgënjeshttrim i fjalës së Allahut të Lartësuar: **“Asgjë nuk i përngjan Atij”**. Nuk mundet që “dhahir”-i i teksteve të jetë kufër dhe humbje sepse Alalhu ka thënë:

“Kështu Allahu ju sqaron fjalët e Tij që të mos humbisni (të mos gaboni).” (En-Nisa: 176)

2) Ata kanë bërë krim ndaj teksteve, sepse kanë mohuar cilësitë e Allahut për të cilat ato tregojnë, dhe pastaj u kanë dhënë këtyre cilësive kuptime të ndryshme sipas mendjes së tyre, për të cilat nuk tregon kuptimi i drejtpërdrejtë i tekstit.

3) Ata i kanë mohuar cilësitë që përmbajnë tekstet e Kur’anit dhe Sunetit pa pasur njohuri, dhe për këtë arsye, kanë thënë rreth Allahut atë për të cilën nuk kanë

dije. Kjo është e ndaluar me argument të qartë nga Kur’ani dhe sipas “ixhmaul ummeh” (konsensusit të Umetit). Allahu i Lartësuar ka thënë në Kur’an:

“Thuaj: ‘Gjërat që i ka ndaluar Zoti juaj janë: el fahisha (gjynahet) që kryhen hapur ose fshehur, gjynahet, shtypja pa të drejtë, vënia shok Allahut në adhurim, gjë për të cilën Ai nuk ka dhënë asnjë të drejtë dhe asnjë provë, si dhe të folurit rreth Allahut e gjërave për të cilat ju nuk keni asnjë dijeni.” (El Araf: 33)

4) Nëse do të mohojnë cilësitë e përsosura të Allahut për të cilat tregojnë tekstet e Kur’anit dhe Sunetit, kjo tregon se Allahut i takojnë cilësi të kundërta me to, e që logjikisht i bie që të jenë të papërsosura, pra, të mangëta. Kjo arsyetohet me faktin se asgjë që ekziston s’mund të jetë e zhveshur nga cilësitë (pa cilësi), sepse përndryshe do të ishte inekzistente, dhe në qoftë se do të mohohet se cilësitë e saj janë të përsosura, kjo, detyrimisht tregon se ato cilësi janë të papërsosura. Si rezultat i kësaj, ata që i kanë mohuar cilësitë e përsosura për të cilat tregojnë argumentet, janë të padrejtë ndaj Allahut sepse i kanë mohuar cilësitë e Tij të përsosura dhe në të njëjtën kohë e kanë përngjasuar Atë me qeniet e papërsosura ose inekzistente, madje ndoshta e teprojnë edhe më tepër në mohim, derisa e përngjasojnë Allahun me ato qenie, ekzistenca e së cilave është e pamundur.

5) Sipas këtij mendimi, Libri që Allahu e zbriti si sqarim për çdo gjë, udhëzim dhe shërim për atë që gjendet në gjokse, nuk i ka sqaruar emrat dhe cilësitë e Allahut që duhet t’i besojnë robërit, por sqarimin e kësaj teme e ka lënë në dorë të arsyes dhe përfundimeve të tyre logjike, në mënyrë që t’i pohojnë dhe t’i mohojnë Allahut atë që ata dëshirojnë! Padyshim kjo është një metodë e pavlefshme dhe e pasaktë.

6) Sipas këtij besimi, Profeti (salallahu alejhi ue selam), shokët e Tij dhe selefët e Umetit, nuk e kanë njohur të vërtetën rreth cilësive të Allahut ose e kanë neglizhuar njohjen e saj, sepse nga ata nuk është transmetuar qoftë edhe një shkronjë në lidhje me ndryshimin e kuptimit të teksteve të cilësive, siç kanë bërë “El Muatilah”, duke e quajtur “teuil” (interpretim). Atëherë, ose Profeti (salallahu alejhi ue selam) dhe shokët e tij ishin të paditur rreth cilësive të Allahut dhe të paafte për t’i sqaruar ato, ose e kanë neglizhuar sqarimin e Umetit për këto terma. Nuk ka dyshim se edhe këto dy hamendësime, janë të pavlefshme e të pasakta.

7) Metoda e tyre në interpretimin e fjalës së Allahut dhe të të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selam) për të mohuar cilësitë, do të thotë se fjala e Allahut dhe e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selam) nuk është pikë (bazë) referimi për atë që njerëzit besojnë rreth Zotit dhe të Adhruarit të tyre, njohja e të Cilit është gjëja më e rëndësishme që përmbajnë shariatet e të dërguarve, madje është thelbi i mesazheve të Allahut, por pika e referimit janë mendjet e tyre të luhatshme dhe kontradiktore. Si rrjedhojë, çdo gjë që bie në kundërshtim me logjikën e tyre, ose

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

do ta përgënjeshtrojnë nëse u jepet mundësia, ose do ta keqinterpretojnë kur nuk mundën ta përgënjeshtrojnë atë.

Vërejtje: Nga sqarimi i mësipërm, mësuam se çdo mohues i cilësive është përngjasues dhe çdo përngjasues i Allahut me krijesat është mohues.

Për sa i përket mohimit që bën mohuesi, ai është i qartë, ndërsa për sa i përket përngjasimit të tij, ai rezulton në faktin se mohimi bëhet për arsye të besimit të tij se pohimi i cilësive do të thotë përngjasim me krijesat, prandaj fillimisht i përngjason ato dhe pastaj i mohon. Nga ana tjetër, nëpërmjet mohimit të cilësive, ai e përngjason Allahun me qeniet e papërsosura.

Përngjasimi i përngjasuesit është i qartë, ndërsa për sa i përket mohimit të tij, ai vërehet në tri aspekte:

- E para, ai ka mohuar vetë argumentin përmes të cilit ka pohuar cilësitë, sepse e ka bërë tregues për përngjasim, megjithëse argumenti nuk tregon për këtë, por për cilësi që i përshaten Madhësisë së Allahut të Lartësuar.

- E dyta, ai ka mohuar çdo tekst që tregon se Allahu nuk u përngjason krijesave.

- E treta, ai ia ka mohuar Allahut përsosmërinë absolute, sepse e ka përngjasuar Atë me qeniet e papërsosura.

Parimi i tretë. “Dhahir”-i¹ i teksteve të cilësive, ka diçka të njohur për ne dhe diçka tjetër të panjohur

Për sa i përket kuptimit të këtyre teksteve, ai është i njohur, ndërsa për sa i përket formës (kejfijes) së cilësive për të cilat tekstet tregojnë, ajo është e panjohur, dhe për këtë tregojnë argumentet e Kur’anit dhe argumenti logjik.

Argumente nga Kur’ani:

“Një libër gjithë bekime e mirësi, të cilin Ne ta kemi zbritur ty, me qëllim që ata të mendojnë e të thellohen në vargjet e tij dhe që njerëzit e brumosur me mendje të shëndoshë, të mund të përkujojnë.” (Sad: 29)

“Feja (adhurimi) e vërtetë dhe e sinqertë është vetëm për Allahun. Dhe ata që zgjedhin për mbrojtës e ndihmues, të tjerë në vend të Tij, thonë: ‘Ne i adhurojmë ata vetëm që të mund të na afrojnë tek Allahu.’ Padyshim që Allahu do të gjykojë mes tyre për çfarë ata dyshuan. Sigurisht që Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar, mohues.” (Ez-Zummer: 3)

¹) Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës ose i tekstit.

“Ne i çuam të dërguarit me shenja të qarta dhe me libra, ndërsa edhe ty me përkujtuesin me këshilla (Kur’anin), që t’u shpjegosh njerëzve qartë se çfarë u është zbritur atyre dhe që ata të mendojnë.” (En-Nahl: 44)

Përderisa Allahu na ka urdhëruar të mendojmë mbi Kur’anin dhe të thellohemi në hulumtimin e tij, kjo tregon se ne arrijmë ta kuptojmë atë. Fakti që Kur’ani është zbritur në gjuhën arabe, për ta kuptuar ai që e njeh këtë gjuhë, tregon se kuptimi i tij është i njohur, sepse ndryshe nuk do të kishte dallim ndërmjet zbritjes së tij në gjuhën arabe dhe zbritjes së tij në një gjuhë tjetër.

Sqarimi që Profeti (salallahu alejhi ue selam) i ka bërë Kur’anit për njerëzit, përfshin sqarimin e shprehjes (fjalës) dhe kuptimit të saj.

Argumenti logjik:

Është e pamundur që Allahu të zbresë një libër, ose i Dërguari (salallahu alejhi ue selam) të thotë fjalë, qëllimi i të cilave është udhëzimi i krijesave, dhe gjërat më të madhërishme, më të rëndësishme e më të domosdoshme t’i lënë të panjohura, në rangun e shkronjave alfabetike prej të cilave nuk kuptohet asgjë. Kjo është një marrëzi që e refuzon urtësia e Allahut, i Cili ka thënë për librin e Tij:

“Elif, Lam, Ra. Ky është një libër, vargjet e të cilit janë të përsosura dhe pastaj të shpjeguara me imtësi nga Ai që është më i Urti Gjithëgjykses, i Mirënjohur.” (Hud: 1)

Këto ishin pra, argumentet e Kur’anit dhe të logjikës që tregojnë se arrijmë të njohim kuptimet e teksteve të cilësive. Ndërsa argumentet fetare dhe logjike që tregojnë se ne nuk i njohim format e cilësive për të cilat këto tekste dëshmojnë, janë përmendur në bazën e gjashtë të cilësive të Allahut.

Në lidhje me ndalesën gjatë leximit të fjalës së Allahut të Lartësuar, e cila tregon se në Kur’an ka edhe ajete të paqarta (të pakuptueshme), kuptimin e së cilave nuk e di askush përveç Allahut:

“Është Ai që të ka zbritur ty Librin. Në të ka vargje plotësisht të qarta që janë themelet e Librit dhe të tjera jo krejt të qarta për t’u kuptuar nga njerëzit (muteshabihat). Kështu, sa për ata, në zemrat e të cilëve ka largim nga e vërteta, ata ndjekin atë që nuk është plotësisht e qartë, duke kërkuar në këtë mënyrë Fitneh (mosbesim, sprova, trazira, fatkeqësi etj.) dhe duke kërkuar interpretimin e saj, por askush nuk e di interpretimin e saj përveç Allahut. Ata që janë plotësisht të vendosur në dije thonë: ‘Ne besojmë se i tërë ai (ajetet e qarta e të paqarta) është nga Zoti ynë. (Ky kuptim është sipas variantit të ndalimit gjatë leximit të ajetit, në fjalën: “por askush nuk e di interpretimin e saj përveç Allahut”, ndërsa për sa i përket variantit të mosndalesës në këtë frazë dhe vazhdimin të leximit, ajeti merr tjetër kuptim dhe komenti i tij është: “por askush nuk e di interpretimin e tyre përveç Allahut dhe atyre që janë plotësisht të

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

vendosur në dije”). Nuk marrim mësim, veçse ata që janë të brymosur me mendje të shëndoshë.” (Ali Imran 7), selefët kanë dy mendime¹:

Mendimi i parë.

Ndalesa bëhet pas leximit të fjalës **“il-lallah”** - الإله - përveç Allahut, dhe ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

Pra, kuptimi i “te’uilit” (intrepretimit) në fjalën e Allahut: **“Dhe askush nuk e di ‘te’uilit’ e tyre përveç Allahut”**, është kuptimi i fjalës² dhe jo komentimi për të sqaruar domethënien e saj. Atëherë, duke u bazuar në këtë që sqaruam, “te’uili” i ajeteve të cilësive është ekzistenca e cilësive, forma e tyre dhe mënyra se si ato janë. Kjo është prej çështjeve të “gajbit”, të cilat nuk mund t’i konceptojë mendja dhe nuk janë përmendur në argumnetet fetare, prandaj ato nuk i di askush përveç Allahut.

Mendimi i dytë.

Nuk bëhet ndalesë pas fjalës **“il-lallah”** dhe vazhdohet leximi.

Ky është mendimi i disa prej dijetarëve nga selefët dhe halefët³. Sipas tyre, fjala “te’uil” në ajetin: **“Dhe askush nuk e di ‘te’uilit’ e tyre përveç Allahut dhe atyre që janë plotësisht të vendosur në dije”**, do të thotë: koment për të sqaruar kuptimin e ajeteve. Aftësia e komentit për nxjerrjen e kuptimit të fjalëve dhe shprehjeve të ajeteve, është një njohuri që e zotërojnë të fortët e mendjes, të siguarit dhe të mëkëmburit në dije, siç ka thënë Ibnu Abas: “Unë jam prej Err-Rasihin-ëve (të mëkëmburve, të fortëve, të siguarve në dije, të cilët e njohin ‘te’uilit’).” Muxhahidi ka thënë: “Ia kam treguar Mus’hafin Ibn Abasit që nga surja Fatiha e deri në fundin e tij, i kërkoja të qëndronte në çdo ajet dhe e pyesja për komentin (kuptimin, shpjegimin) e tij.”

Nga ajo që u përmend më lart, qartësohet fakti se ajeti nuk tregon që në Kur’an ka diçka, kuptimin e së cilës nuk e di askush tjetër përveç Allahut të Lartësuar, por ai tregon se në Kur’an flitet për gjëra, formën e të cilave dhe mënyrën se si ato janë, nuk e di askush përveç Allahut, dhe kjo sipas mendimit të ndalesës në frazën **“il-lallah”**. Sipas mendimit tjetër, ajeti tregon se të mëkëmburit në dije, i dinë kuptimet e ajeteve “muteshabihe” (të paqarta), të cilat nuk i dinë shumë njerëz të tjerë.

¹) Duhet të kemi parasysh se komenti i ajetit ndryshon sipas ndalesës gjatë leximit në frazat e tij, megjithëse të dyja komentet janë të pranueshme dhe nuk ka kundërshtim ndërmjet tyre, siç do ta shohim më poshtë.

²) Realiteti i kuptimit të fjalës është “el kejfijetu”, siç sqarohet më lart.

³) Dijetarët e mëvonshëm pas selefëve.

Pasi vërtetuar parimin që në Kur'an nuk ka gjëra të pakuptueshme, kuptimin e së cilave nuk e di askush tjetër përveç Allahut, mbetet të vëmë në dukje pavlefshmërinë e idesë së "El Mufeidah" - المفوضة¹, të cilët ia lënë Allahut dijen (njohurinë) rreth kuptimit të ajeteve të cilësive, sepse sipas tyre, atë e di vetëm Ai. Ata pretendojnë madje, se ky është besimi i selefëve. "El Mufeidah" kanë devijuar në besimin e tyre dhe kanë gënjyer për sa i përket qëndrimit të selefëve, sepse ata i kanë bërë "tefuid" (i kanë dorëzuar, i kanë lënë) Allahut vetëm dijen rreth "kejfije"-s (realitetit, formës) dhe jo dijen rreth kuptimit.

Thëniet e selefëve në lidhje me pohimin e kuptimit të teksteve të cilësive, herë në mënyrë të përgjithshme dhe herë në mënyrë të veçantë, janë të shumta.

Prej thënieve të përgjithshme është fjala e tyre: "Besojini ato siç kanë ardhur, pa diskutuar rreth 'kejfije'-s (formës së cilësive).", ndërsa prej thënieve të veçanta është fjala e Imam Malik, në lidhje me lartësinë e Allahut mbi Arsh.

Ibn Tejmije, në librin e tij "Diru tearudil akl uen-nakl" ka thënë: "Për sa i përket 'tefuid'-it, dihet se Allahu na ka urdhëruar në Kur'an për të medituar dhe na ka nxitur ta kuptojmë atë. Atëherë si kërkohet nga ne, me anë të idesë së 'tefuid'-it, që të mos e kuptojmë dhe të mos e njohim!?"

Më tej ka thënë: "Sipas thënies së tyre, të dërguarit nuk i dinin kuptimet e teksteve që ua zbriti Allahu, as melaiket nuk i dinin ato dhe as të parët e sahabëve. Si rrjedhojë, profetët nuk i dinin kuptimet e cilësive që Allahu ia ka atribuar Vetes së Tij, por thonin fjalë, domethënien e të cilave nuk e kuptonin."

Gjithashtu ka thënë: "Dihet që kjo është shpifje ndaj Kur'anit dhe profetëve, sepse Allahu e zbriti Kur'anin dhe ka lajmëruar se e ka bërë atë udhëzim dhe sqarim për njerëzit. Ai e urdhëroi të Dërguarin (salallahu alejhi ue selam) që ta përcjellë atë në mënyrën më të qartë dhe që t'ua sqarojë njerëzve atë që u është zbritur. Në shumë ajete në Kur'an na ka urdhëruar që të thellohem në meditimin e tij dhe ta kuptojmë atë. Me të gjitha këto që përmendëm, si mundet që kuptimin e

¹) "El mufeidah" është një nga rrymat e "ehli kelamit". Ithtarët e saj i besojnë tekstet e cilësive si fjalë dhe shprehje të zbritura nga Allahu, por i mohojnë cilësitë për të cilat ato tregojnë, me pretekstin se këto cilësi tregojnë për përngjasim me krijesat, dhe thonë se kuptimin dhe interpretimin e ajeteve dhe haditheve që flasin rreth cilësive, nuk e di askush përveç Allahut, prandaj dijen rreth tyre ia dorëzojnë Atij. Si përfundim, "ehlul kelam", pas mohimit të cilësive është ndarë në dy rryma për sa i përket interpretimit të teksteve. Njëra rrymë thotë se interpretimin e tyre e di vetëm Allahu, i besojnë si tekste të zbritura dhe nuk thellohen më shumë në kuptimet e tyre. Këta janë "El Mufuida". E dyta pretendon se e di kuptimin dhe interpretimin e tyre, dhe si rrjedhojë i ka keqinterpretuar. Këta janë "El Mu'uile" (keqinterpretuesit).

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

ajeteve më madhështore dhe më të rëndësishme të Kur'anit, ku Allahu na ka lajmëruar për cilësitë e Tij, për të qenët e Tij Krijuesi i çdo gjëje dhe i Gjithëdijshëm, ose për gjërat që kanë të bëjnë me botën tjetër, të mos e dijë asnjë njeri!? Kjo do të thotë të mos kuptohet Kur'anit, të mos meditohej rreth tij, si dhe i Dërguari (salallahu alejhi ue selam) të mos ua ketë sqaruar njerëzve atë që u është zbritur e të mos ua ketë përcjellë mesazhin në mënyrë të qartë.

Sipas kësaj ideje, çdo i devijuar (bidatçi) mund të thotë se e vërteta rreth çdo gjëje, është ajo tek e cila ai arrin përmes logjikës dhe mendimit të tij, dhe se tekstet e Kur'anit nuk bien ndesh me atë që ai ka kuptuar, sepse këto tekste janë të paqarta, të pakuptueshme, asnjëri nuk e di kuptimin e tyre dhe ato nuk lejohet që të merren si argument.

Si rezultat, kjo ide mbetet si një bllokadë që pengon udhëzimin dhe sqarimin që vjen nga ana e profetëve. Ajo i hap rrugën atij që i kundërshton profetët dhe thotë se udhëzimi dhe sqarimi vjen nga vetë ne dhe jo nga rruga e tyre, sepse ne e njohim atë që themi dhe e sqarojmë me argumente logjike, ndërsa profetët nuk e kanë njohur atë që kanë thënë, e jo më të sqaronin qëllimin e saj.

Si përfundim, bëhet e qartë se ideja e 'El Mufeuidah', të cilët mendojnë se ndjekin Sunetin dhe selefët, është prej mendimeve me të këqija të bidatçinjve dhe të devijuarve." Kështu përfundon fjala e Ibn Tejmijes, Allahu e mëshiroftë.

“Te’uil”-i (interpretimi)

Nga ana gjuhësore, “te’uil” do të thotë: *interpretimi ose komentimi i diçkaje (që mund të jetë një fjalë, fjali, tekst, ngjarje apo dukuri) për të nxjerrë në pah kuptimin që ajo ka pasur si qëllim.*

Nga ana terminologjike është: *gjetja e qëllimit të një fjale të dhënë, duke shpjeguar kuptimin e saj ose duke realizuar atë që kërkohet nëpërmjet saj.*

“Te’uili” është përdorur në tri kuptime:

1. **“Tefsiri”** (komenti), i cili është sqarimi i fjalës, duke treguar domethënien që ajo ka pasur si qëllim.

“Te’uil”-i me këtë kuptim, është përmendur në fjalën e Allahut të Lartësuar, ku dy shokët e burgut të Jusufit i thanë atij: **“Na trego për ‘te’uilin’** (shpjegimin, komentin) **e saj.”** (Jusuf: 36).

Gjithashtu, në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selam) për Abdullah ibn Abasin: “*O Allah, jepi atij ‘fikh’ në fe¹ dhe mësoji atij ‘te’uilin’ (komentimin).*”

Në kapitullin e kaluar përmendëm fjalën e Ibn Abasit: “Unë jam prej të mëkëmburve në dije, të cilët njohin ‘te’uilin’ e tyre.” (D.m.th. komentimin e ajeteve të paqarta.)

Këtë kuptim ka edhe fjala e Ibnu Xheririt dhe të tjerë komentatorëve të Kur’anit: “Te’ul’-i i fjalës së Allahut” (d.m.th. “tefsiri” - shpjegimi, komentimi i saj.) “Te’uil”-i me këtë kuptim është i njohur tek dijetarët.

2. Realiteti i diçkaje.

“Te’uil”-i sipas këtij kuptimi, për sa i përket Allahut, është realiteti i Qenies së Allahut dhe i cilësive të Tij, të cilën nuk e di askush përveç Tij.

Me këtë kuptim, “te’uili” është përmendur në fjalën e Allahut të Lartësuar: “**A mos presin ata, vetëm se ‘te’uil’-in e Tij.**” Kjo do të thotë se përgënjeshtresit nuk presin gjë tjetër, veçse që të ndodhin gjërat për të cilat janë lajmëruar, si ringjallja dhe shpërblimi.

Këtë kuptim ka “te’uili” në fjalën e Jusufit: “**O babai im! Ky është ‘te’uil’-i (realiteti) i ëndrrës sime të dikurshme.**” (Jusuf: 101)

Në këtë kuptim futet edhe zbatimi i diçkaje që kërkohet të veprohet. Si shembull për këtë kemi thënien e Aishes: “Profeti (salallahu alejhi ue selam) thoshte shpesh në ruku dhe në sexhde: ‘*Subhaneke allahum-me ue bihamdike, Allahum-me gfireli*’.”

Me këto fjalë ai i bënte ‘te’uil’ Kur’anit, d.m.th. zbatonte atë që ka urdhëruar Allahu në fjalën e Tij: “**Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi. Dhe kur t’i shohësh njerëzit të hyjnë në fenë e Allahut turma-turma, atëherë lartëso lavditë dhe madhërimet e Zotit tënd dhe kërko faljen e Tij. Vërtet Ai është i Cili pranon pendimin dhe Ai i Cili fal.**” (En-Nasr)

“Te’uil”-i në fjalën e Allahut të Lartësuar: “**Askush nuk e di ‘te’uil’-in e tyre përveç Allahut. Ata që janë plotësisht të vendosur në dije thonë: ‘Ne besojmë se ai i tëri është nga Zoti ynë.’**”, kjo sipas një varianti në komentin e ajetit, ndërsa sipas variantit tjetër: “**Askush nuk e di ‘te’uil’-in e tyre përveç Allahut dhe atyre që janë plotësisht të vendosur në dije.**” (Ali Imran: 7), mund të marrë kuptimin “tefsir” ose kuptimin “realiteti i diçkaje”. Këto dy variante kanë lindur si rrjedhojë e ndalesës ose jo gjatë leximit të ajetit, gjë të cilën e sqaruam pak më lart.

Sipas variantit të parë, fjala “te’uil” detyrimisht nënkupton realitetin e cilësive të Allahut dhe gjërave të botës tjetër, sepse realitetin e tyre nuk e njeh askush përveç Tij.

¹) D.m.th. bëje të kuptojë çështjet e fesë.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Sipas variantit të dytë, detyrimisht kuptimi i fjalës “te’uil” duhet të jetë “tefsir”-i (shpjegimi i kuptimit), sepse përveç Allahut, tefsirin e njohin edhe ata **“që janë plotësisht të vendosur në dije”**.

Ne e dimë që kuptimi i “isteua” është lartësimi, ngritja (mbi Arsh). Ky është “te’uil”-i i njohur për ne, ndërsa realitetin dhe formën (mënyrën) se si është ky lartësim mbi Arsh, ne nuk e njohim, prandaj ky është “te’uil”-i për të cilin ne nuk kemi dije. Po kështu ne e njohim kuptimin e të gjithë emrave dhe cilësive të Allahut, e dallojmë qartë se çfarë kuptimi ka çdo emër dhe çdo cilësi si p.sh. **El Hajat - Jeta, El Ilm - Dija, El Kudreh - Fuqia** etj., por ne nuk e njohim formën dhe mënyrën se si ato janë.

Vetëm këto dy kuptime të “te’uil”-it¹ gjenden në Kur’an, në Sunet dhe në fjalët e selefëve.

3. Kuptimi alegorik i fjalës.

Ky kuptim është i ndryshëm nga kutimi i drejtpërdrejtë (“dhahir”), por gjithmonë sipas një argumenti që këtë ndyshim e bën të detyrueshëm.

“Te’uil”-i sipas këtij kuptimi, është termi që përdorin shumë nga dijetarët e kohëve të fundit, të cilët kanë diskutuar rreth Fikhut dhe parimeve të tij. Pikërisht ky është “te’uil”-i që përdorin shumica e dijetarëve të shekujve të fundit në interpretimin e teksteve të cilësive.

Por a është ky lloj i “te’uil”-it për t’u lavdëruar apo për t’u kritikuar? A është ai i drejtë e i vlefshëm apo e kundërta?

E vërteta është siç vijon:

Nëse ka ndonjë argument të saktë që tregon për këtë lloj “te’uil”-i, ai është i saktë, i vlefshëm dhe punohet me të. Në këtë rast, ai konsiderohet “tefsir”, sepse “tefsir” i fjalës, do të thotë ta interpretosh atë sipas kuptimit për të cilin aludon thënësi i saj - qoftë ky kuptim në përputhshmëri me domethënien e saj të drejtpërdrejtë ose jo - përderisa ky aludim dihet me siguri.

Si shembull për këtë kemi fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Dhe kur të lexosh Kur’anin, kërkoji Allahut të të mbrojë nga shejtani i mallkuar”** (En-Nahl 98). Domethënia e drejtpërdrejtë (“dhahir”) është: **“Kur të përfundosh leximin”**, por qëllimi i ajetit është: **“Kur të dëshirosh të lexosh”**, sepse Profeti (salallahu alejhi ue selam) i kërkonte mbrojtje Allahut (thoshte: eudhubil-lahi...) para se të fillonte leximin dhe jo kur e mbaronte atë.

Por, nëse nuk ka argument të saktë që tregon për këtë lloj “te’uil”-i, ai është i pavërtetë e i pavlefshëm, kritikohet dhe e meriton që të quhet keqinterpretim (“tahrif”) dhe jo interpretim (“te’uil”).

¹) Bëhet fjalë për “tefsirin” dhe realitetin e diçkaje.

Si shembull për këtë është fjala e Allahut të lartësuar: **“Mëshiruesi që u lartësua (u ngrit) mbi Arsh.”** (Ta Ha: 5). Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës “isteua” mbi Arsh, është: Allahu u lartësua, u ngrit mbi Arsh me një lartësim (ngritje) që i përshtatet Madhërisë së Tij”. Interpretimi i kësaj fjale, duke thënë se ajo ka kuptimin: mbizotëroi (“isteula”), është “te’uil” i pasaktë dhe deformim i fjalëve të Allahut, sepse për këtë interpretim nuk tregon ndonjë argument i saktë.

“Ihkam”-i dhe “teshabuh”-i i Kur’anit

Allahu e ka përshkruar Kur’anin si më poshtë:

1. Që është i tëri “muhkem”¹:

“Ky është një libër, ajetet e të cilit janë të përsosura (d.m.th shprehjet dhe fjalët e Kur’anit janë më të përkryerat në stil, elokuencë dhe retorikë, si dhe përmbajnë kuptimet më të përkryera, më të madhërishme dhe më të dobishme për krijesat).” (Hud: 1)

“Këto janë vargjet e librit të përsosur (të përkryer në të gjitha aspektet).” (Lukman: 2)

2. Që është “muteshabih”²:

“Allahu zbriti fjalën më të shkëlqyer, një libër (muteshabih) pjesët e të cilit i përngjajnë njëra-tjetrës në mirësi, vërtetësi dhe përputhshmëri në tërësinë e Tij.” (Ez-Zumer 23).

3. Që një pjesë e tij është “muhkem” dhe një pjesë është “muteshabih”³:

“Ai është i Cili të ka zbritur ty librin, në të ka vargje plotësisht të qarta që janë themelet e librit dhe të tjera jo krejt të qarta (për t’u kuptuar)...” (Ali Imran: 7)

- Në përshkrimin e Kur’anit si i tëri “muhkem”, Allahu ka pasur për qëllim përsosmërinë e tij në shprehje dhe kuptim, sepse shprehjet e Kur’anit janë të gjitha në stilin, retorikën dhe elokuencën më të përkryer, si dhe kuptimet e tij janë më të përkryerat, më të madhërishmet dhe më të dobishmet për krijesat.

¹) Duke pasur për qëllim përsosmërinë e tij në të gjitha aspektet dhe jo thjesht qartësinë e ajeteve kryesore të tij, siç përmendet në përshkrimin e tretë.

²) D.m.th. pjesët e tij janë të ngjashme me njëra-tjetrën në vërtetësi, elokuencë, stilistikë, bukuri e retorikë dhe nuk ka për qëllim paqartësinë e disa ajeteve për të cilat bën fjalë ajeti i sures “Ali Imran”, siç përmendet në përshkrimin e tretë. Për më gjerë shiko komentin që i bën imam Sheukani këtij ajeti.

³) Që do të thotë se një pjesë e tij është plotësisht e qartë dhe një pjesë e tij ka kuptim të fshehtë e nuk është plotësisht e qartë.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Fjalët e Allahut janë të përkryera si në vërtetësinë e lajmeve, ashtu edhe në drejtësinë e ligjeve dhe rregullave që janë përmendur në to, siç ka thënë Allahu në Kur'an: **“Fjala e Zotit tënd është plotësuar me vërtetësi dhe drejtësi.”** (El En Am: 115)

- Në përshkrimin e Kur'anit si i tëri “muteshabih”, Allahu ka pasur për qëllim që pjesët, vargjet e Kur'anit, i përngjajnë njëra-tjetrës në përsosje, përputhshmëri dhe në harmoni (pra, teksti ka koherencë dhe kohezion). Rregullat e Kur'anit nuk kundërshtojnë njëri-tjetrin dhe lajmet e tij nuk përgënjeshtrojnë njëri-tjetrin: **“A nuk mendojnë thellë për Kur'anin? Po të kishte qenë prej dikujt tjetër e jo prej Allahut, sigurisht që do të kishin gjetur në të mjaft kundërtënie.”** (En-Nisa: 82)

- Në përshkrimin e një pjese të Kur'anit si “muhkem”, Allahu ka pasur për qëllim qartësinë e kuptimit të tij, në të cilën nuk dyshon askush. Ajetet e qarta janë të shumta, si në lajmërimin për diçka, po ashtu edhe në rregulla.

Si shembull për lajmërimin, kemi fjalën e Allahut:

“Muaji i Ramazanit në të cilin u zbrit Kur'ani..” (Bekare: 185). Të gjithë e njohin muajin e Ramazanit dhe Kur'anin.

Si shembull për rregullat mund të sjellim ajetin:

“Dhe me prindërit të sillesh mirë (t'i respektosh).” (El Isra: 23). Të gjithë e dinë se kush janë prindërit dhe çdo të thotë respektim i tyre.

- Në përshkrimin e një pjese të Kur'anit si “muteshabih” Allahu ka pasur për qëllim paqartësinë ose fshehtësinë e kuptimit për njerëzit, përveç atyre që janë plotësisht të vendosur në dije (err-rasihunë).

Qëndrimi ynë ndaj përshkrimeve që Allahu i ka bërë Kur'anit dhe mënyra e pajtimit ndërmjet tyre

E para, përshkrimi i Kur'anit si i tëri “muhkem” (i përkryer, i përsosur) dhe “muteshabih” (i përngjashëm), nuk është kontradiktor. Pajtimi ndërmjet dy përshkrimeve bëhet siç vijon: Fjala “muhkeme” (e përkryer, e përsosur) do të thotë se pjesët e tij i përngjajnë njëra-tjetrës në vërtetësi dhe përsosmëri. Kur'ani nuk është kontradiktor në rregullat e tij dhe ato gjëra që lajmërohen në të nuk e përgënjeshtrojnë njëra-tjetrën.

E dyta, përshkrimi i Kur'anit si një pjesë “muhkem” dhe një pjesë “muteshabih”, gjithashtu në mënyrë të sigurtë nuk është kontradiktor, sepse ajetet që janë përshkruar si “muhkeme”, nuk janë të njëjta me ato që janë përshkruar si “muteshabihe” (bëhet fjalë për ajete të ndryshme). Një pjesë e Kur'anit është

“muhkem” - me kuptim krejtësisht të qartë dhe një pjesë është “muteshabih” - me kuptim jo krejtësisht të qartë.

Njerëzit, për sa i përket qëndrimit të tyre ndaj ajeteve “muteshabihe” janë ndarë në dy grupe:

1- **“Err-rrasihunë”** (ata që janë plotësisht të vendosur në dije).

Ata i besojnë ato dhe besojnë se të gjitha janë nga Zoti. Përderisa janë nga Zoti, ato nuk mund të përmbajnë përzierje, dyshime që tregojnë për humbje dhe kundërtënie. Për të komentuar ajetet “muteshabihe” ata u referohen ajeteve “muhkeme”, sepse ato janë themelet e librit. Si rrjedhojë, ajetet që nuk janë plotësisht të qarta (muteshabihe) bëhen krejtësisht të qarta.

2- **Të humburit dhe të devijuarit.**

Ata u dhanë pas ajeteve “muteshabihe” dhe i bënë ato stimulues të dyshimeve, kështu që e humbën veten dhe pasuesit e tyre.

Ajeteve “muteshabihe” ata u dhanë kuptime që nuk i përshtaten Allahut, as librit të Tij dhe as të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selam).

Më poshtë po japim dy shembuj për të sqaruar metodën që ndoqën grupet e humbura në lidhje me ajetet “muteshabihe”:

Shembulli i parë:

Në shumë ajete të Kur’anit, Allahu i Madhëruar i ka dedikuar Vetes së Tij diçka, duke u shprehur në numrin shumë:

“Nuk ka dyshim se Ne u japim jetë të vdekurve.” (Ja Sin: 22)

“Vërtet Ne e kemi zbritur përkujtimin (Kur’anin) dhe padyshim që Ne do të jemi Gjithëruajtës të tij.” (El Hixhër: 9)

Të krishterët u kapën pas këtyre ajete “muteshabihe” dhe pretenduan se kjo tregon për më shumë se një Zot. Ata thanë se kjo është dëshmi e “trinitetit” dhe se Allahu është i treti i të treve. Nga ana tjetër, ajetet krejtësisht të qarta që tregojnë se Allahu është Një, nuk i marrin fare parasysh.

“Err-rrasihunë” në dije, thonë se të shprehurit në numrin shumë që Allahu ia dedikon Vetes së Tij, tregon për madhërim, për arsye se cilësitë e Allahut janë të shumta e të madhërishme. Ajetet me kuptim jo krejtësisht të qartë që u përmendën më lart, i kthejnë tek ajetet krejtësisht të qarta që tregojnë se Ai është Një i Vetëm: **“Dhe i Adhuruari juaj është Një i Adhuruar i Vetëm, nuk ka të adhuruar tjetër të merituar veç Atij, i Gjithëmëshirëshmi, Mëshirëploti.”** (El Bekare: 163).

Ata u thonë të krishterëve se për këtë pretendim që lindi nga ndjekja e asaj që nuk është krejtësisht e qartë dhe për të nxitur dyshime, Allahu ju përgënjeshtroi dhe ju bëri kafirë: **“Vërtet që mohuan edhe ata të cilët thanë: ‘Allahu është i treti i të treve (në trinitet). Por nuk ka Ilah (Zot, të adhuruar që ka të drejtë të adhurohet) veç Një Ilah (Një Zot të vetëm, Allah) të Vetëm. Dhe në qoftë se ata**

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

nuk ndalen nga ajo që thonë, padyshim se për ata nga mesi i tyre që nuk besojnë, do të ketë dënim të dhembshëm.” (El Maide: 73)

Shembulli i dytë:

Në fjalët e Allahut drejtuar të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selam): **“Vërtet ti nuk udhëzon atë që dëshiron”** (El Kasas: 56) dhe: **“Vërtet që ti udhëzon për në rrugën e drejtë”** (Esh-Shura: 52), mund të duket sikur ka kundërthënie. Për rrjedhojë, e ndjek këtë ai që ka në zemër devijim nga e vërteta dhe mendon që në ajetin e parë mohohet ajo që pohohet në ajetin e dytë. Si përfundim, njëri të tillë thonë se në Kur'an ka kundërthënie.

Ndërsa “err-rasihunë” në dije thonë se nuk ka kundërthënie ndërmjet dy ajeteve. Fjala “udhëzim” në ajetin e parë, ka për qëllim suksesin dhe mbarësinë, e këtë lloj udhëzimi nuk e zotëron askush tjetër përveç Allahut, ndërsa në ajetin e dytë, fjala “udhëzim” ka për qëllim orientimin dhe të treguarit e rrugës së drejtë. Lloji i dytë i udhëzimit bëhet nga Allahu, por edhe nga të tjerë dhe sipas këtij kuptimi, mund të udhëzojnë edhe profetët ose trashëgimtarët e tyre, dijetarët e singertë.

Në lidhje me ata që ndjekin ajetet jo krejtësisht të qarta, pa iu referuar ajeteve plotësisht të qarta, Profeti (salallahu alejhi ue selam), pasi ka lexuar ajetin 7 të surës “Ali Imran” ka thënë: *“Kur të shihni ata që ndjekin atë që nuk është krejtësisht e qartë, ruhuni prej tyre, sepse këta janë ata që i ka përmendur Allahu (në ajet).”*¹

Por cila është urtësia e të qenit të disa ajeteve të Kur'anit “muteshabihe” (jo krejtësisht të qarta)?

Urtësia qëndron në faktin se kjo është sprovë për robërit, që të dallohet ai i cili është i çiltër në besimin e tij, i vendosur plotësisht në dije, dhe që beson në Allahun dhe fjalën e Tij, e di se në fjalët e Allahut nuk ka kundërthënie, prandaj i kthen ajetet “muteshabihe” për tek ajetet “muhkeme” për t'i kuptuar mirë ato, që të bëhet i tërë Kur'ani “muhkem” (krejtësisht i qartë). Ai, pra, dallohet nga dyshuesi, injoranti dhe i devijuari, i cili ndjek atë që nuk është krejtësisht e qartë në Kur'an që t'i përplasë ajetet e Kur'anit me njëri-tjetrin, për të humbur vetë dhe për t'i humbur të tjerët, për të qenë prijës për në humbje dhe mjerim, për t'i nxjerrë njerëzit nga feja e tyre dhe për t'i zhytur ata në dyshime e mëdyshje, që të sprovonjë dhe të nxjerrin nga feja njëri-tjetrin:

“Është Ai i Cili të ka zbritur ty (o Muhamed) librin (Kur'anin). Në të ka vargje plotësisht të qarta të cilat janë themelet e librit (këto janë vargjet e “ahkamit” - urdhërat etj.; “faraidit” - detyrat dhe detyrimet; “hududet” - ligjet për ndëshkimet e vjedhësve, imoralëve etj.), dhe të tjera jo krejtësisht të qarta (për t'u kuptuar nga njerëzit). Kështu, sa për ata, në zemrat e të cilëve ka largim nga

¹) Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Aishja.

e vërteta, ata ndjekin atë që nuk është plotësisht e qartë, në këtë mënyrë duke kërkuar fitneh (mosbesim, sprovim, trazira, fatkeqësi etj.) dhe duke kërkuar për kuptimet e fshehta, por askush nuk i di kuptimet e fshehta veç Allahut. Dhe ata që janë plotësisht të vendosur në dije, thonë: ‘Ne besojmë në të, i tëri (ajetet e qarta e të paqarta) është nga Zoti ynë.’ Dhe nuk marrin mësim, veçse ata që janë të brumosur me mendje të shëndoshë. (Tefsir Et-Tabari). (Ata thanë) ‘Zoti ynë, mos na i lër zemrat tona të shmangen nga e vërteta pasi Ti na ke udhëzuar dhe na dhuro mëshirë nga Mëshira Jote. Vërtet Ti je Dhuruesi më i Madh.’ (Ali Imran: 7-8)

Shtojcë plotësuese:

“Teshabuh”-i (paqartësia, mosnjohja e kuptimit)¹ që gjendet në Kur’an, ndahet në: “teshabuh real” dhe “teshabuh relativ”.

“Teshabuh real” është ai që nuk e di askush tjetër përveç Allahut, si p.sh.: realiteti i cilësive të Allahut dhe i lajmeve rreth botës tjetër.

Ne, megjithëse i njohim kuptimet e cilësive dhe të lajmeve të botës tjetër, nuk i dimë realitetet e tyre, siç ka thënë Allahu për veten e Tij:

“Ai, Allahu, e di çfarë u ndodh atyre (krijesave të Tij) në këtë botë dhe çfarë do t’u ndodhë atyre (në jetën e fundit) dhe ata kurrë nuk do të përfshijnë gjë nga dija e Tij.” (Ta Ha: 110)

“Atë nuk e përfshijnë shikimet dhe Ai i përfshin shikimet (asnjë ide dhe asnjë përfytyrim nuk mund ta përfshijë Atë dhe ta mendojë se si është etj.) .” (El En Am: 103)

Për gjërat që gjenden në botën tjetër Ai ka thënë:

“Askush nuk di se çfarë është ruajtur për ta nga kënaqësitë e syrit, si shpërblim për çfarë ata punuan.” (Es-Sexhde: 17)

Në hadithin “kudsi” që është transmetuar në dy “sahihët” nga Profeti (salallahu alejhi ue selam), Allahu thotë: **“Për robërit e mi të mirë kam përgatitur atë që nuk e ka parë ndonjëherë syri, nuk ka dëgjuar për të ndonjëherë veshi dhe nuk ka imagjinuar për të ndonjëherë mendja.”**

Për këtë lloj “teshabuh”-i, të cilin nuk e di askush përveç Allahut, nuk pyetet, sepse njohja e tij është e pamundur.

Ndërsa, për sa i përket “teshabuhi-t relativ” (paqartësisë relative), ai është i njohur për disa njerëz dhe i panjohur për të tjerët. “Err-rrasihunë” në dije dhe në besim janë ata të cilët dinë çfarë nuk dinë të tjerët, për arsye të ndryshme, si p.sh. mangësi në dijen e tyre, neglizhencë në kërkimin e saj, paaftësi për të kuptuar, ose keqkuptim i qëllimtë. Ky është një lloj “teshabuh”-i për sqarimin e të cilit pyeten

¹) Paqartësia, mosnjohja e kuptimit.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

“err-rrasihunë” në dije, sepse ekziston mundësia për ta kuptuar atë, pasi nuk ka asgjë në Kur’an kuptimin e së cilës nuk e di askush prej njerëzve. E si mund të ndodhë kjo, kur Allahu ka thënë:

“(Dhe kujto) **Ditën kur Ne do të ngremë nga çdo popull dëshmues kundër tyre dhe Ne do të të sjellim ty (o Muhamed) si dëshmues kundër tyre. Dhe Ne ta kemi zbritur ty librin (Kur’anin) si pasqyrim të çdo gjëje, shpjegues të gjithçkaje si dhe udhëheqës, përkujtim, mëshirë dhe përgëzues për Muslimanët** (të nënshtroar ndaj vullnetit të Allahut).” (En-Nahl: 89)

“**Ky (Kur’ani) është fjalë e qartë për njerëzimin, udhëheqje dhe mëshirë për muttekinët** (të përkushtuarit në besimin e pastër).” (Ali Imran: 138)

Për këtë lloj “teshabuh”-i ka shembuj të shumtë në çështjet e Akides dhe të rregullave praktike dhe të gjitha ose shumica e çështjeve për të cilat njerëzit kanë mosmarrveshje, janë të këtij lloji.

Cilësitë e Allahut¹

1 & 2- **El Itjanu & El Mexhiu** - الإتيان والمجيء - **Ardhja.**

Të dyja janë cilësi “fi’lijeh”: **“A mos presin atëherë për ndonjë gjë tjetër, veçse t’u vijë Allahu?”** (El Bekare: 210)

“Dhe vjen Zoti yt me melaiket radhë-radhë.” (Fexhr: 22)

3- **El Ihata** - الإحاطة - E përmban emri i Allahut **El Muhit** dhe është cilësi “dhatijeh”: **“Dhe se vërtet Allahu e ka përfshirë çdo gjë me dijen e tij.”** (Et-Talak: 12)

Esbahani në “El huxhel” ka thënë: **“El Muhit** është Ai që ka përfshirë të gjitha krijesat me fuqinë e Tij, që ka përfshirë çdo gjë me dijen e Tij dhe që ka përfshirë çdo gjë në llogaritje e numër.

4- **El Ehadijetu** - الأحديّة - cilësi që e përmban emri i Allahut **El Ehad.**

5- **El Ehdhu** - الأخذ - cilësi “fi’lijeh” e përmendur në Kur’an dhe Sunet me dy kuptime:

a) Marrja me dore, e cila është e kundërta e dhënies.

b) Kapja, mbërthimi, shtrëngimi.

Argumente nga Kur’ani:

“Përkujto kur Zoti yt (nxori) mori nga shpinat e bijve të Ademit pasardhësit e tyre.” (El Araf: 172)

“Kështu që Allahu e kapi atë me ndëshkim për tejkalimin e fundit dhe të parin.” (En-Nazijat: 25)

Argumente nga Suneti:

Transmetohet nga Abdullah ibn Umer se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Allahu i Lartësuar i merr qiejt dhe Tokën me dy Duart e Tij dhe thotë: ‘Unë jam Allahu, Unë jam Sunduesi.’”* Duke thënë këtë fjalë, Profeti (salallahu alejhi ue selam) i mblodhi gishtërinjtë e dorës së tij dhe i hapi. (Muslimi)

¹⁾ Për arsye se nëntëdhjetë e nëntë emrat e Allahut i kemi përmendur dhe shpjeguar në pjesën e parë të këtij libri, cilësitë që i përmbjanë këta emra nuk i kemi përmendur, me përjashtim të disa rasteve të rralla, sepse ato kuptohen nga domethënia e emrave.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Ebu Hurejre transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue salam) ka thënë: “Nëse ndonjëri jep sadaka nga pasuria e tij hallall - dhe Allahu pranon vetëm atë që është hallall - i Gjithëmëshirëshmi e merr me të djathtën e Tij.” (Muslimi)

6- El Edhenu - الأذن - Dëgjimi me vëmendje.

Argument është hadithi i Ebu Hurejres ku Profeti (salallahu alejhi ue salam) ka thënë: “Allahu i Lartësuar nuk ka dëgjuar ndonjë gjë me aq vëmendje sa dëgjon një profet kur e këndon Kur'anin bukur dhe me zë të ngritur.” (Buhariu & Muslimi)

7- El Irradetu & El Meshietu - الإرادة و المشيئة - Dëshira.

Dy cilësi “fi’lijeh” që kanë ardhur në shumë argumente të Kur’anit dhe Sunetit. Në dy ajetet e mëposhtme është përmendur **El Irrade**:

“**Dhe atij që Allahu dëshiron ta udhëzojë, ia hap gjoksin për Islamin.**” (El En am: 125)

“**Sigurisht që Allahu urdhëron çfarë dëshiron.**” (El Maide: 1)

Në dy ajetet e mëposhtme është përmendur **El Meshietu**:

“**Por ju nuk mund të dëshironi, veçse po dëshiroi Allahu.**” (El Insan: 30)

“**Ti i jep mbretërim atij që dëshiron.**” (Ali Imran: 26)

8- El Istihzau bil kafirin - الاستهزاء بالكافرين - Tallja me kafirët.

Është cilësi “fi’lijeh” që nuk i pohohet Allahut në mënyrë absolute, por të kufizuar. Për të rikujtuar mënyrën se si bëhet kjo, shih “Bazën e parë” të cilësive të Allahut të Lartësuar.

“**Ndërsa kur takohen me ata që besojnë, u thonë: ‘Ne besojmë’, por kur janë vetëm me shejtanët e tyre thonë: ‘Në të vërtetë ne jemi me ju, në të vërtetë ne vetëm talleshim.’ Allahu tallet me ta dhe vetëm ua shton më shumë të këqijat që të sorollaten verbërisht.**” (El Bekare: 14-15)

9- El Isteua - الاستواء على العرش - Lartësimi, ngritja mbi Arsh.

Kjo është një cilësi “fi’lijeh” që përmendet në shtatë ajete kuranore dhe në disa hadithe të Profetit (salallahu alejhi ue salam):

“**I Gjithëmëshirëshmi u ngrit lart mbi Arsh.**” (Ta Ha: 5)

“**Pastaj Ai u ngrit lart mbi Arsh** (Fronin e Tij madhështor).” (El Araf: 54, Junus: 3, Rad: 2, Furkanë: 59, Es-Sexhde: 4 dhe El Hadid: 4)

Ebu Hurejre transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue salam) e mori për dore dhe i tha: “O Ebu Hurejre, vërtet Allahu i krijoi qiejt e Tokën dhe çdo gjë që gjendet ndërmjet tyre në gjashtë ditë dhe pastaj u ngrit mbi Arsh në ditën e shtatë.” (Trans En-Nesai dhe shejh Albani ka thënë se “isnadi” - zinxhiri i transmetimit - i tij është i mirë.)

Buhariu ka transmetuar nga Muxhahidi se “isteua” do të thotë “u ngrit lart mbi Arsh”. Në lidhje me këtë transmetim, shejh Albani thotë: “Kjo thënie është kundërpërgjigje ndaj disa publicistëve bashkëkohorë, të cilët i çorientojnë dhe

mashtrojnë njerëzit duke u thënë se selefët nuk kanë folur rreth ajeteve të cilësive dhe absolutisht nuk i kanë komentuar ato.

Sipas tyre, selefët vetëm i lexuan ato, pa u thelluar në meditim dhe në kuptimin e tyre. Kjo është ideja e “tefuid”-it, të cilën e ka hedhur poshtë Ibn Tejmije në librat e tij.

Është e vërtetë që selefët nuk i kanë bërë ajeteve të cilësive komente të shoqëruara me përngjasime dhe përshkrime të formës, madje këtë e kanë ndaluar reptësisht, siç është përcjellë nga imam Maliku dhe të tjerë.

El-Lalekaju në “Es-Sunneh”, ka transmetuar nga Bishër ibn Umer (i cili është “thikatur” - i besueshëm dhe ka vdekur në vitin 207 h.) se ai ka dëgjuar disa nga “mufesirët” (komentatorët e Kur’anit) duke thënë: “Mëshiruesi ‘isteua’ mbi Arsh, që do të thotë ‘u ngrit’ mbi Arsh.”

Shtojcë:

Arshi është krijesa më e madhe e Allahut të Lartësuar e përmendur në shumë ajete të Kur’anit:

“Zotëruesi i Arshit të lavdishëm.” (Buruxh: 15)

“Dhe melekët do të jenë në anën e Tij dhe tetë melekë atë ditë do të mbartin lart Arshin e Zotit tënd.” (El Hakah: 17)

Po ashtu edhe Profeti (salallahu alejhi ue selam) e ka përmendur atë në hadithe të sakta si p.sh.: *“Kur t’i kërkoni Allahut Xhenetin, kërkojini Atij Xhenetin ‘El Firdaus’, sepse ai është Xhenet më i lartë e më i mesëm dhe mbi të gjendet Arshi i të Gjithëmëshirëshmit.”*

Nuk është i saktë interpretimi i Arshit si diçka që nënkupton pushtetin e Allahut, sepse nëse do të ishte kështu, si do të komentoheshin fjalët e Tij: **“Dhe melekët do të jenë në anën e Tij dhe tetë melekë atë ditë do të mbartin lart Arshin e Zotit tënd.”** (El Hakah: 17) ose **“Dhe Arshi ishte mbi ujë.”** (Hud: 7)? A mund të thuhet: “atë ditë pushtetin e Tij do ta mbajnë tetë melekë” ose: “pushteti i Tij ishte mbi ujë”?! A mund ta bëjë këtë interpretim ai që arsyeton dhe e di çfarë thotë?

Është e rëndësishme që çdo njeri ta dijë se Allahu nuk e ka krijuar Arshin (Fronin) dhe nuk është lartësuar mbi të sepse ka nevojë për të, apo sepse Arshi e mban Atë ose e kufizon. Të gjitha këto janë imagjinata të pasakta dhe mund të përfytyrohen vetëm në raport me njeriun, sepse ai mund të ketë nevojë për fron, ndërsa Allahu është i përkryer dhe nuk ka nevojë për asgjë: **“Vërtet Allahu nuk ka nevojë për asgjë në gjithësi.”** (Ali Imran: 97)

Madje Arshi dhe të gjitha krijesat kanë nevojë që Allahu t’i mbajë. Imam Tahau i ka thënë: “Allahu nuk ka nevojë për Arshin dhe për asgjë tjetër përveç tij. Ai e ka përfshirë çdo gjë, është mbi çdo gjë dhe asgjë nuk mund ta përfshijë Atë.

Si përfundim, Allahu nuk është i lartësuar mbi Arsh sepse ka nevojë për të, por për shkak të urtësisë që vetëm Ai e di.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Vërejtje: Në lidhje me fjalën e Allahut: **“Ai është i Cili krijoi për ju gjithçka në Tokë, pastaj Ai ‘isteua ila’ (u ngrit lart mbi) qiell.”** (El Bekare), do të bëjmë dy sqarime:

E para, për fjalën “isteua ila”, nga dijetarët e selefëve janë transmetuar dy komente.

- Komenti i parë është: “U ngrit lart mbi qiell” dhe është transmetuar nga shumica e tyre.

- Komenti i dytë është: “Synoi krijimin e qiellit” dhe e ka përmendur Ibnu Kethiri në tefsirin e tij.

Megjithëse komenti i parë është më i saktë - siç ka thënë Ibnu Tejmije - nuk do të thotë se në komentin e dytë është ndryshuar kuptimi i drejtpërdrejtë i tekstit të cilësive të Allahut, sepse para fjalës “isteua” është përmendur parafjala “ila”, e cila e bën kuptimin “synoi”, të pranueshëm dhe të përshtatshëm. Dijetarët e selefëve për këtë arsye e kanë bërë këtë komentim. Atyre nuk u shkonte ndër mend se kuptimi i drejtpërdrejtë i teksteve të cilësive tregon për përngjasim dhe pastaj ta interpretonin, siç mendojnë të humburit! Këta dijetarë, megjithëse bënë këtë koment për ajetin, besojnë se Allahu është mbi Arsh dhe kjo tregon që qëllimi i tyre nuk ka qenë ai që mendojnë njerëzit e humbur.

E dyta, Allahu i Lartësuar, para se të krijonte krijesat dhe ndër to edhe Arshin, ka qenë në lartësi, sepse lartësia është cilësi “dhatijeh” (e përhershme, e pashkëputshme), kështu që pas krijimit të Arshit, u lartësua mbi të në një lartësi që cilësohet e veçantë. Kjo është përgjigjja që i jepet atij që mendon se lartësia e përhershme bie në kundërshtim me lartësimin mbi Arsh. (Marrë nga “Mexhmuul fetau”)

10- El Esefu - الأصف - **Zemërimi.**

Kjo është prej cilësive “fi’lijeh” të përmendura në Kur’an: **“Kështu kur ata na zemëruan, Ne i ndëshkuam dhe i mbytëm që të gjithë bashkë.”** (Ez-Zuhurf: 55)

11- El Esabiu - الأصابع - **Gishtërinjtë.**

Cilësi “dhatijeh - haberije” që janë përmendur në hadithe të sakta.

- Abdullah ibn Amer ibn el As-s, transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selam) duke thënë: **“Vërtet të gjitha zemrat e bijve të Ademit janë ndërmejt dy prej gishtërinjve të të Gjithëmëshirëshmit si një zemër e vetme, dhe Ai i rrotullon ato si të dëshirojë.”** (Muslimi)

Ibn Uthejmini ka thënë: “Ehli suneti” e beson kuptimin e drejtpërdrejtë të këtij hadithi dhe thotë se Allahu ka gishtërinj të vërtetë, duke ia atribuar Atij, ashtu siç ka bërë Profeti (salallahu alejhi ue selam).

Të qenët e zemrave ndërmejt dy prej gishtërinjve, nuk tregon se ato prekin njëra-tjetrën. Për këtë arsye nuk mund të thuhet se hadithi bëhet shkak për një perceptim

të gabuar që të shpie drejt idesë së panteizmit dhe prandaj duhet ndryshuar kuptimi i tij i drejtpërdrejtë e t'i jepet një kuptim tjetër. Kjo sepse ne p.sh. mund të themi që retë janë ndërmjet qiellit dhe tokës, megjithëse ato nuk e prekin as qiellin e as tokën. Po kështu mund të thuhet se hëna është mes Mekës dhe Medines, megjithëse ndërmejt hënës, Mekës dhe Medines ka largësi të madhe.

Atëherë, zemrat e bijve të Ademit janë ndërmjet dy prej gishtërinjve të të Gjithëmëshirëshmit dhe kjo nuk tregon për prekje mes tyre, unifikim apo panteizëm.

- Abdullah ibn Mesudi transmeton se një grua çifute erdhi tek Profeti (salallahu alejhi ue selam) dhe i tha: “O Muhamed, vërtet Allahu i mban (kap) qiejt me një gisht, tokët me një gisht, malet me një gisht, pemët me një gisht, krijesat me një gisht e pastaj thotë: ‘Unë jam Sunduesi’?” Profeti (salallahu alejhi ue selam) qeshi aq sa iu dukën dhëmballët e tij dhe pastaj lexoi fjalën e Allahut: **“Ata nuk e vlerësuan madhërinë e Allahut ashtu siç i takon që të vlerësohet.”** (Ez-Zummer: 67)

Në një transmetim tjetër thuhet se Profeti (salallahu alejhi ue selam) qeshi në shenjë habie dhe vërtetimi (konfirmimi) të fjalëve të saj. (Buhariu & Muslimi)

El Begau i në “Sherhu sunneh”, pasi ka përmendur këtë hadith ka thënë: “Gishti i përmedur në hadith është një nga cilësitë e Allahut dhe të tilla janë edhe të gjitha cilësitë e tjera që kanë ardhur në Kur'an dhe Sunet si **Nefsi, Fytyra, Syri, Dora, Këmba, Ardhja, Zbritja** në qiellin e Dynjasë, **Lartësimi** (isteua) mbi Arsh, **Qeshja dhe Gëzimi.**”

Ibn Kutejbe, pasi ka konfirmuar besimin e “ehli sunetit” në pohimin e këtyre cilësive, ka thënë: “Nuk themi se ky gisht është si gishtërinj të tanë. e as dora si dora jonë, sepse cilësitë (tiparet) e Allahut nuk u përgajnë cilësive tona.

12- El Emru - الأمر - Urdhërimi, Komandimi.

Urdhëri është një cilësi e Allahut:

“Padyshim që i Tij është krijimi, urdhërimi e komandimi.” (El Araf: 54)

“Sigurisht që urdhri i Tij kur Ai do një gjë, është vetëm t'i thotë asaj ‘Bëhu!’ dhe ajo bëhet.” (Ja Sin: 82)

Ebul Hasen el Eshari ka thënë: “Të gjithë dijetarët e selefëve besojnë se urdhëri dhe fjala janë nga cilësitë e Tij të pakrijuara.”

Duhet të kemi parasysh se jo gjithmonë kur përmendet fjala “el emru” (urdhëri) në Kur'an dhe Sunet dedikuar Allahut, është cilësi e Tij, sepse ka raste kur kjo fjalë ka për qëllim përsosjen e urdhërit të Allahut dhe jo vetë urdhërin e Tij. Pasoja e urdhërit është e krijuar me urdhërin e Tij, ndërsa urdhëri vetë është cilësi e Tij. Mund të bëjmë këtu analogji me mëshirën që është cilësi e Allahut, por ka raste kur pasojat e saj, quhen në përgjithësi: mëshirë. (Për më gjerë shiko në “Mexhmuul fetaua” të Ibn Tejmiyes, 6/17.)

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

13- **El Imsak** - الإمساك - **Kapja, Mbajtja.**

Allahu i mban qiejt e tokën dhe krijesat e tjera, në një mënyrë që i përshtatet Madhështisë së Tij: **“Sigurisht që Allahu i mban qiejt dhe tokën që të mos shkëputen (lëvizin) nga vendet e tyre.”** (El Fatir: 41)

Argument nga Suneti është hadithi i Abdullah ibn Mesudit që u përmend më lart, mbi gishtërinjtë e Allahut.

14- **El Enamilu** - الأذامل - **Majat e gishtërinjve.**

Cilësi “dhatijeh - haberije”, të përmendura në hadithe të sakta.

Muadh ibn Xhebel transmeton: “Një ditë, në kohën e sabahut, Profeti (salallahu alejhi ue selam) nuk doli për të falur namazin me ne, derisa gati po shihnim diellin. Atëherë ai doli me shpejtësi, u thirr ikameti dhe Profeti (salallahu alejhi ue selam) e fali namazin duke e shkurtuar shumë, ndryshe nga ç’vepronte zakonisht. Kur dha selam, u kthye nga ne, thirri me zërin e tij: *‘Qëndroni në rreshtat tuaj ashtu siç jeni.’* dhe pastaj tha: *‘Do t’ju tregoj arsyen që më pengoi të dilja herët këtë mëngjes. Unë u çova natën, mora abdes dhe u fala, aq sa më ishte caktuar për të falur. Në namaz u kota, derisa kotja më mundi. Atëherë, papritur, pashë Zotin tim të Lartësuar në formën më të bukur e më të përkryer dhe Ai më tha: ‘O Muhamed!’ Thashë: ‘Të përgjigjem o Zoti im.’ Tha: ‘Për çfarë debaton paria më e lartë?’¹ I thashë: ‘Nuk e di o Zoti im.’ Allahu e përsëriti tri herë pyetjen. Atëherë e pashë të vendosë shuplakën (pëllëmbën e dorës) ndërmjet dy shpatullave të mia, derisa ndjeva të ftohtin e majave të gishtërinjve të Tij (el enamil) në kraharorin tim. Pastaj m’u shfaq çdo gjë dhe unë e njoha.² (Në një transmetim tjetër ka ardhur: dhe mësova çdo gjë në qiell dhe në tokë, kurse në një tjetër: çdo gjë ndërmejt lindjes dhe perëndimit.) Pastaj më tha: ‘O Muhamed!’ I thashë: ‘Të përgjigjem o Zoti im.’ Tha: ‘Për çfarë debaton paria më e lartë?’ Thashë: ‘Për punët që fshijnë gjynahet.’ Tha: ‘Cilat janë ato?’ I thashë: ‘Ecja e këmbëve drejt xhemateve, ulja në xhami pas namazit dhe përsosja e abdesit në të ftohtin e madh.’ Tha: ‘Po pastaj*

¹) Melekët e afruar tek Allahu. Debatimi i tyre, ose nënkupton kërkesën, garimin dhe nxitimin për shkruajtjen e veprave të mira që do përmenden dhe për ngjitjen me to në qiell, ose bëhet rreth superioritetit e mirësisë së këtyre punëve, ose bëhet për arsye të zilisë, ngaqë këto janë vetëm për njerëzit.

²) Kjo nuk do të thotë që Profeti (salallahu alejhi ue selam) di të fshehtë, sepse kjo është mohuar në Kur’an, në fjalën e Allahut për të: **“dhe nuk e di të fshehtën”**, por ai mësoi në ato momente atë që i shfaqti Allahu. Allahu i ka shfaqur atij atë që ka dëshiruar prej “gajbit”, siç ka ardhur në fundin e sures “Xhin”. Prandaj edhe Profeti (salallahu alejhi ue selam) na ka lajmëruar për shumë gjëra rreth “gajbit”, por kjo nuk do të thotë se e ka njohur atë tërësisht.

për çfarë? Thashë: 'Për ushqimin e të varfërve, butësinë në fjalë dhe namazin natën kur njerëzit janë në gjumë.' Më tha: 'Kërko!' I thashë: 'O Allah, të kërkoj që të më mundësosh të veproj punë të mira dhe të largohem nga punët e këqija; të kem dashuri për të varfërit; të më falësh mua e të më mëshirosh, dhe nëse dëshiron ta sprovosh një popull me humbje ose ndëshkim, të ma marrësh shpirtin pa u prekur nga kjo sprovë; të kërkoj të më bësh që të të dua Ty (ose të më duash), të dua atë që të do ty, dhe të dua punën që të afron në dashurinë Tënde.' Në fund, Profeti (salallahu alejhi ue selam) tha: "Kjo ëndërr është e vërtetë (sepse ëndrrat e profetëve janë shpallje), mësojeni atë përmendësh dhe mësojeni kuptimin e saj." (Trans. Ahmed, Tirmidhiu, Ibnu Hurejme, Ibn ebi Asim. Tirmidhiu ka thënë se hadithi është i saktë e i mirë dhe se pasi ka pyetur për të Muhamed ibn Ismail el Buharin, i ka thënë se është i saktë. Prej dijetarëve të tjerë që e kanë saktësuar këtë hadith është Ibn Tejmije, Ahmed Shakir dhe Albani.)

15- **El Intikamu** - الاند - **Hakmarrja ndaj kriminelëve.**

Kjo është një cilësi "fi'lijeh" që i atribuohet Atij ashtu siç i përshtatet Madhështisë së Tij: "**Sigurisht që Ne do të hakmerremi ndaj kriminelëve.**" (Es-Sexhde: 22)

16- **Bedius-semauati uel erd** - اوت والارض بديع السم - **Krijuesi, Shpikësi i qiejve dhe i Tokës** (në kulmin e përsosmërisë, bukurisë dhe në një sistem të mahnitshëm): "**Krijuesi, Shpikësi i qiejve dhe i Tokës. Kur Ai vendos për një gjë, vetëm i thotë: 'Bëhu!' dhe ajo bëhet.**" (Bekare: 117)

17- **El Berekatu & Et-Tebaruku** - البركة وال تبارك -

"El bereke" do të thotë: bereqet, mirësi. "Tebarekell-llahu" do të thotë: i Bekuar është Allahu, gjithë bereqet dhe mirësi. Prandaj dijetarët kanë thënë se: "et-tebaruku" nënkupton se e gjithë mirësia dhe bereqeti vjen nga Allahu. Disa dijetarë kanë thënë se kuptimi i "tebaruk" është: Allahu është i Lartësuar me Madhësi. Argument për këtë cilësi (bereqetin) është fjala e Allahut: "**Mëshira e Allahut dhe bekimet e Tij qofshin mbi ju, o familja e Ibrahimit.**" (Hud: 73)

Ndërsa për cilësinë "tebaruku", argument është fjala e Allahut: "**I Bekuar, gjithë mirësi dhe bereqet është Ai, në dorë të të Cilit është mbisundimi, dhe Ai është i Gjithëfuqishëm për të bërë çdo gjë.**" (Mulk: 1)

Gjithashtu, mjafton si argument për këto dy cilësi përshëndetja islame: Es-selamu alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu (paqja, mëshira dhe bereqetet e Allahut qofshin mbi ju).

Ibnul Kajjim në "Bedaiul feuajid" ka thënë: "Ndërsa cilësia 'tebareke' është cilësi e Tij e veçantë¹, ashtu siç ia ka atribuar Ai Vetes së Tij."

18- **El Beshbeshetu** - البش بشة - **Gëzimi i plotë.**

¹) Që do të thotë se nuk lejohet t'u dedikohet krijesave.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Argument është hadithi i Ebu Hurejres, ku Profeti (salallahu alejhi ue salam) ka thënë: *“Nëse një burrë shkon vazhdimisht në xhami dhe qëndron në të, Allahu gëzohet me ardhjen e tij (çdo herë që ai vjen), ashtu siç gëzohet familja e kurbetliut kur ai vjen dhe takohet me të.”* (Trans. Ibn Maxheh, Ahmedi etj. dhe Albani thotë se hadithi është i saktë.)

Grupet e humbura, kur përballen me hadithe të tilla të sakta, përpiqen t'i keqinterpretojnë, ashtu siç i ka orientuar një nga të parët e tyre.

Imam Ed-Darim ka thënë: “Jemi informuar se disa shokë të Bishër el Meris i thanë atij: ‘Si vepron me këto ‘senede’ të mira të cilat i përdorin si argument për t’iu kundërvënë ideve tona, si për shembull: hadithet që transmeton Sufjan nga Mensur, ky nga Eh Zuhri dhe ky i fundit nga Salim, ose hadithet që i transmeton Ejubi nga Ibn Sirinë ose Amër ibnu Din-nari nga Xhabir etj.’” El Meris tha: ‘Mos i refuzoni ‘senedet’ sepse demaskoheni, por mashtrojeni dhe çorientojini njerëzit me anë të ‘te’uil’-it (keqinterpretimit). Në këtë mënyrë i keni refuzuar ato me urtësi.’”

19- El Bugdu - ال بفض - Urrejtja.

Cilsi “fi’lijeh” e përmendur në hadithe të sakta, ndër të cilët janë dy hadithet e mëposhtme:

- Ebu Hurejre transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue salam) ka thënë: *“Vërtet Allahu kur e do një rob, thërret Xhibrilin dhe i thotë: ‘Vërtet Unë e dua filanin, prandaj duaje atë.’ Atëherë Xhibrili e do atë e pastaj thërret në qiell dhe thotë: ‘Vërtet Allahu e do filanin, prandaj duajeni atë.’ Atëherë e duan banoret e qiellit atë, e pastaj ai bëhet i pranueshëm edhe në tokë. Ndërsa kur Allahu e urren një rob, e thërret Xhibrilin dhe i thotë: ‘Vërtet Unë e urrej filanin, prandaj urreje edhe ti. Atëherë Xhibrili e urren atë e pastaj thërret ndër banorët e qiellit: ‘Vërtet Allahu e urren filanin, prandaj urrejeni atë.’ Atëherë atë e urrejnë banorët e qiellit dhe si rrjedhojë e urrejnë edhe njerëzit në tokë.”* (Muslimi)

- Transmetohet nga Ebu Hurejre se Profeti (salallahu alejhi ue salam) ka thënë: *“Vendet më të dashura për Allahun janë xhamitë dhe vendet më të urryera për Të janë pazaret.”* (Muslimi)

Ibnul Kajjim ka thënë: *“Vërtet cilësitë që Allahu ia ka atribuar Vetes së Tij si Dashuria, Kënaqësia, Zemërimi, Gëzimi dhe Urrejtja, janë nga cilësitë më të madhërishtme.”*

20- El Bekau - ال بقاء - Përjetësia.

Cilësi “dhatijeh” e veçantë vetëm për Allahun: **“Ndërsa do të mbetet përgjithmonë fytyra e Zotit tënd, gjithë madhështi e lavdi.”** (Err-Rrahman: 27)

21- Et-Terred-dudu - ال تردد - Ngurrimi, Hezitimi.

Ngurrimi i Allahut do të thotë: kur një gjë duhet të bëhet, por nga ana tjetër ajo urrehet, megjithëse patjetër do të ndodhë ajo që dëshiron Allahu.

Kjo është cilësi “fi’lije”, ajo i pohohet Allahut ashtu siç i përshtatet Madhështisë së Tij dhe nuk i përngjan aspak ngurrimit të krijesave.

Argument për këtë cilësi është hadithi i Ebu Hurejres, ku Profeti (salallahu alejhi ue selam) tregon se vërtet Allahu ka thënë: **“Atë që armiqëson një nga të dashurit e Mi, Unë e kam paralajmëruar për luftë. Robi Im nuk më afrohet me diçka më të dashur për Mua sesa ato që Unë ia kam bërë farz (obligim). Ai vazhdon të kërkojë afrimin tek Unë me anë të nafileve (adhurimeve vullnetare) që vepron, derisa ta dua, dhe kur Unë e dua, atëherë bëhem dëgjimi i tij me të cilin dëgjon, shikimi i tij me të cilin shikon, dora e tij më të cilën kap, mësyn dhe vepron, dhe këmba e tij me të cilën ecën. Në qoftë se do të kërkojë prej Meje, unë do t’i jap atë që kërkon, dhe nëse kërkon që ta mbroj, Unë do ta mbroj. Nuk kam ngurruar në ndonjë gjë që do të bëj, siç ngurroj në kapjen e shpirtit të besimtarit. Ai e urren vdekjen dhe Unë e urrej t’ia bëj atë që është e keqe, e dëmshme.”** (Buhariu)

Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës së Tij në hadith: **“bëhem dëgjimi i tij me të cilin dëgjon”**, është që Allahu e drejton, e orienton dhe i jep sukses këtij eulijai (besimtari të devotshëm) në të dëgjuarit, të parët dhe në punën e tij, në mënyrë që të gjitha gjërat që arrin t’i njohë me anë të dëgjimit e shikimit, si dhe të gjitha punët që i bën me dorë dhe me këmbë, të jenë të sinqerta vetëm për Allahun dhe në përputhshmëri me Sheriatin e Tij.

Kuptimi i drejtpërdrejtë është ai që përmendëm më lart për dy arsye:

E para, sepse Allahu ka thënë: **“ai vazhdon të kërkojë afrimin tek Unë me anë të nafileve që vepron, derisa ta dua”** dhe në fund të hadithit ka thënë: **“në qoftë se do të kërkojë prej Meje, unë do t’i jap atë që kërkon, dhe nëse kërkon që ta mbroj, Unë do ta mbroj.”**

Në këto dy frgmente, Allahu ka theksuar se ka rob dhe të adhuruar; synues që kërkon të afrohet dhe të synuar për t’iu afruar me ibadet; të dashuruar dhe të dashur; kërkues dhe të kërkuar; kërkues mbrojtjeje dhe mbrojtës; lutës dhe të lutur. Të gjitha këto tregojnë për dy qenie të ndara, të shkëputura dhe të ndryshme nga njëra-tjetra. Ato tregojnë se është e pamundur që njëra prej tyre të jetë atribut i tjetrës ose një prej pjesëve të saj.

E dyta, dëgjimi i eulijasë, shikimi, dora dhe këmba e tij, janë të gjitha attribute të krijesës që është krijuar pasi nuk ekzistonte më parë. Asnjë i mençur nuk mund të mendojë që Krijuesi i pafillim të jetë dëgjimi, shikimi, dora dhe këmba e një krijese, madje kjo është diçka që njeriu neveritet ta përfytyrojë.

Komenti që përmendëm më lart është transmetuar nga selefët dhe siç e pamë, ai është kuptimi i drejtpërdrejtë i hadithit, kështu që nuk kemi të bëjmë as me “te’uil” (interpretim) dhe as me ndryshim të kuptimit të drejtpërdrejtë.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Në lidhje me fragmentet e fundit ku është përmendur “ngurrimi”, është pyetur Ibn Tejmije dhe në “El fetua mexhmua” është përgjigjur¹: “Ky është një hadith i lartë. Ai është hadithi më i lartë në përshkrimin e cilësive të eulijave. Disa njerëz e kanë refuzuar fragmentin ku përmendet ‘ngurrimi’ dhe kanë thënë se ai nuk është cilësi e Allahut, sepse është cilësi e atyre që nuk i njohin përfundimet e punëve (pra atë që do të ndodhë), ndërsa Allahu di çdo gjë. Por e vërteta është se fjala e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selam) është e drejtë dhe asnjëri nuk është më i ditur rreth Allahut, as më i sinqertë në këshillimin e Umetit dhe as më i aftë për t’u shprehur sesa ai. Përderisa është kështu, atëherë ai që e refuzon fjalën e tij është ndër njerëzit më të paditur, më të humbur dhe më të paedukuar. Këta njerëz duhet të edukohen dhe të merren masa ndëshkuese ndaj tyre. Është detyrë të mbrohet fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selam) nga mendimet e kota dhe besimet e prishura. Kjo që kanë kuptuar ata prej hadithit është e pasaktë, sepse lëkundja dhe ngurrimi lind tek krijesat si rrjedhojë e mosnjohjes së përfundimit të punëve, ndësa cilësitë që Allahu ia ka atribuar Vetes, nuk janë si cilësitë e krijesave të Tij. Allahut nuk i përngjason asgjë, as në Qenien, as në atributet dhe as në veprat e tij. Ngurrimi te njerëzit lind nga mosnjohja se si do të përfundojë një çështje dhe për këtë arsye, nganjëherë hezitojmë të bëjmë diçka, për shkak të konfliktit mes dëmit dhe dobisë që ajo mund të sjellë. Pra, dëshirojmë ta veprojmë për arsye të dobisë dhe interesit që realizohet përmes saj dhe e urrejmë ta veprojmë atë për arsye të dëmit që mund të shkaktohet. Por Allahu ngurron, jo për arsye se nuk e njeh përfundimin, por për arsye se e dëshiron diçka nga njëra anë dhe e urren nga ana tjetër.

I sëmuri i dëshiron ilaçet që i bëjnë dobi për shërimin dhe shëndetin, por i urren ato për shkak të shijes së tyre të keqe. Edhe punët e mira të robit, të cilat i urren nefsi, janë të tilla, prandaj Profeti (salallahu alejhi ue selam), në një hadith të saktë ka thënë: *‘Zjarri është i rrethuar me epshe dhe dëshira, ndërsa Xheneti është i rrethuar me gjëra të urreya.’*, kurse Allahu ka thënë në Kur’an: **‘Lufta (xhihadi) është bërë detyrim për ju, megjithëse ju nuk e pëlqeni atë.’** (El Bekare: 216)

Duke marrë parasysh arsyen e dytë të lindjes së ngurrimit, del në pah kuptimi i tij në këtë hadith. Robi, fillimisht u bë i dashur tek Allahu me veprimin e farzeve të cilat Ai i do, pastaj me përpjekjet e tij për të vepruar nafilet që Allahu i do dhe e do atë që i vepron. Allahu e urren atë që e dëshpëron robin dhe të dashurin e Tij. Vdekja është një gjë e keqe për robin, prandaj Allahu e urren atë, por për arsye se ajo është caktuar, Ai e dëshiron dhe ajo patjetër do të ndodhë. Pra, Allahu e dëshiron vdekjen e të dashurit të Tij sepse është diçka e shkruar (ecaktuar), por nga

¹) Përgjigjja e tij është përkthyer në mënyrë të përmbledhur.

ana tjetër, ai e urren atë sepse është diçka e keqe dhe dëshpëruese për robin e Tij. Si rrjedhojë, Allahu e dëshiron vdekjen e besimtarit të devotshëm nga njëra anë dhe e urren atë nga ana tjetër. Ky është kuptimi i ngurrimit të Allahut, ashtu siç është përmendur në këtë hadith.”

22- Et-Terrku - **الترك - Lënia.**

Kjo është cilësi e përmendur në Kur'an: **“Kjo ngjason me ata që ndezën zjarrin dhe pasi ai ndriçoi gjithandej rreth tyre, Allahu ua mori dritën dhe i la në errësirë (kështu që ata nuk mund të shihnin).”** (El Bekare: 17)

23. Et-Tekarrub-bu, El Kurrbu & Ed-Dunuvu - **ال تقرب و القرب و الذو - Afrimi dhe afërsia ndaj krijesave që Allahu dëshiron t'u afrohet.**

Këto cilësi janë përmendur në Kur'an dhe Sunet.

El Karrib është një nga emrat e bukur të Allahut, prej të cilit merret cilësia **El Kurrb** (Afërsia):

“Dhe kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, atëherë përgjigju atyre. Vërtetë Unë jam afër tyre, Unë i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më drejtohet Mua me lutje.” (El Bekare: 186)

Ebu Hurejre transmeton një hadith “kudsi” nga Profeti (salallahu alejhi ue salam), në të cilin Allahu thotë: **“Unë jam i Fuqishëm që të veproj ndaj robit Tim, atë që ai mendon se Unë do të veproj ndaj tij. Unë jam me të kur ai më përmend Mua. Nëse do të më përmendë me veten e tij (fshehurazi, jo në publik), Unë e përmend me Vetën Time dhe nëse do të më përmendë në një tubim, Unë e përmend në një tubim edhe më të mirë. Nëse më afrohet një pëllëmbë, do t'i afrohem një krah, nëse më afrohet një krah, Unë do t'i afrohem një pash dhe nëse do të më vijë duke ecur, do t'i vij duke ecur më shpejt dhe me nxitim (herueleten).”** (Buhariu & Muslimi)

Gjithashtu transmetohet nga Aishja se Profeti (salallahu alejhi ue salam) ka thënë: **“Nuk ka ndonjë ditë në të cilën Allahu lëshon më shumë robër nga zjarri, sesa ditën e 'Arafatit'. Ai afrohet (ndaj robërve të tij), pastaj krenohet me ta te melaiket dhe thotë: 'Çfarë kanë dashur këta?'"** (Muslimi)

Në këtë hadith është përmendur **Ed-Dunuvu - Afrimi.**

“Ehli sunneh uel xhamaah” - të cilët janë selefët dhe “ehlul hadithi” - besojnë se Allahu është afër krijesave që dëshiron t'u afrohet dhe se Ai me të vërtetë u afrohet atyre. Ky afrim është real, ashtu siç i përshtatet Madhërisë së Tij, dhe megjithëse është afër, Ai është mbi Arshin e Tij, i ndarë dhe i shpëputur nga krijesat.

Për sa i përket afërsisë së Allahut ndaj krijesave që Ai dëshiron t'u afrohet, duhet të kemi parasysh këto gjëra:

E para, me afërsinë dhe afrimin e Allahut ndaj besimtarëve nuk nënkuptohet se Ai është në tokë; që gjendet atje ku është njeriu; që është në çdo vend; që është i trupëzuar dhe i përzierë me krijesat, apo që Ai është i shkrirë me krijesat, siç

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

besojnë panteistët. Të gjitha këto janë kufër (mosbesim), sepse Allahu është lart mbi të gjitha krijesat, i ndarë e i shkëputur dhe jashtë krijesave, siç tregojnë argumentet e prera dhe të padiskutueshme që do t'i përmendim në cilësitë e Allahut.

E dyta, për sa i përket Allahut, duhet të kuptojmë se ekziston një lidhje ndërmjet të qenit të Tij mbi Arsh dhe afërsisë së Tij ndaj krijesave që Ai dëshiron t'u afrohet, për arsye të Madhështisë së Tij. Shtatë qiejt në Dorën e Tij janë si një farë mustarde në dorë e rob-it. Si mund të jetë e pamundur pra (kur kjo që përmendëm është vetëm një pjesë e Madhështisë së Tij), që Ai të jetë lart mbi Arshin e Tij dhe t'u afrohet krijesat që do, si të dëshirojë, duke qenë i Lartësuar mbi Arsh!? Afërsia e Allahut ndaj krijesave që do, nuk e kundërshton konceptin e qëndrimit të Tij mbi Arsh, sepse cilësitë e Allahut nuk u përngajnë atyre të krijesave. Lidhja që ekziston ndërmjet këtyre dy cilësive është një nga veçoritë e Tij. Ai është i Lartësuar në afërsinë e Tij dhe është i Afërt në lartësinë e Tij.

E treta, në qoftë se ndonjërit i shkon ndër mend (në pohimin e këtyre cilësive) të imagjinojë se si është e mundur që Allahu të jetë mbi krijesat e Tij dhe njëkohësisht t'u afrohet atyre që dëshiron, le ta dijë se kjo imagjinatë është diçka e gabuar, sepse ajo ka lindur nga krahasimi i Allahut me krijesat e Tij. Ky krahasim është i pasaktë, sepse Allahut nuk i përngjan asgjë.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Për sa i përket afrimit të Allahut tek disa nga robërit e Tij, këtë e pohojnë ata që pranojnë t'i atribuohen Allahut veprat e vullnetshme që Ai ia ka atribuar Vetes së Tij si: **Ardhja** në Ditën e Gjykimit, **Zbritja**, **Lartësimi** mbi Arsh etj., siç është besimi i dijetarëve të selefëve, dijetarëve të shquar të Islamit, ‘ehlul hadithit’.”

Thëniet dhe transmetimet e këtyre dijetarëve në lidhje me këtë çështje, janë të gradës “muteuatir”.

Vërejtje: Jo në çdo argument ku Allahu ka përmendur afërsinë ndaj krijesave, bëhet fjalë për afrimin e Tij real, sepse ka raste kur bëhet fjalë për afërsinë e melaikeve. Kjo varet nga konteksti, rendi i fjalëve dhe treguesit në tekst.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Fakti që **Afërsia** është një cilësi e Tij reale, nuk do të thotë se në çdo vend ku ajo përmendet, bëhet fjalë për afërsinë e Vetes së Tij. Kjo është prej gjërave që duhen studiuar në tekstin e transmetuar; në qoftë se tregon për afërsinë e Allahut, i japim këtë kuptim dhe nëse tregon për afërsinë e diçkaje tjetër, i japim kuptimin tjetër.

Si shembull për këtë që ka sqaruar Ibnu Tejmije, po marrim ajetet e mëposhtme kuranore:

“Sigurisht që Ne e kemi krijuar njeriun dhe Ne e dimë se çfarë i pëshpërit atij vetvetja (nefsi i vet). Dhe Ne jemi më afër atij sesa vena e qafës.

(Mbani mend!) **Se dy marrësit** (melekët shrues), **marrin** (shkтуajnë veprat) **të vendosur njëri në të djathtë e tjetri në të majtë.**” (Kaf: 16-17)

Fjala e Allahut: “(Mbani mend!) **Se dy marrësit** (melekët shkrues) **marrin** (shkruajnë veprat)”, tregon se bëhet fjalë për afrimin e dy melekëve.

“Por Ne jemi më afër atij sesa ju, por ju nuk shikoni.” (El Uakia: 85)

Në këtë ajet bëhet fjalë për afërsinë e melekëve, e pikërisht për melekun e vdekjes dhe ndihmësit e tij, sepse ata që i afrohen njeriut në kohën e daljes së shpirtit janë melekët, siç ka thënë Allahu në Kur’an: **“Derisa kur ndonjërit prej jush t’i afrohet vdekja, të dërguarit Tanë** (melekët e vdekjes) **ia marrin shpirtin atij. Ata kurrë nuk janë të pakujdesshëm ndaj detyrës së tyre.”** (El En Am: 61)

Pastaj, fjala e Allahut në fundin e ajetit, është argument i qartë që tregon për afërsinë e melekëve, sepse i afuari është në të njëjtin vend, por nuk e shikojnë. Kjo e përcakton në mënyrë të padiskutueshme se qëllimi është afërsia e melekëve, sepse në këtë rast nuk mund të bëhet fjalë për Allahun.

Arsyeja që Allahu ia ka dedikuar Vetes së Tij afërsinë - megjithëse bëhet fjalë për afërsinë e melekëve - është se ajo bëhet me urdhërin e Tij dhe ata janë ushtarët dhe të dërguarit e Tij.

Si në dy ajetet e kaluara, ashtu edhe në ajetin: **“Kur Ne ta lexojmë atë ty, atëherë ndiqe leximin e tij.”** (El Kijame: 18), nuk bëhet fjalë për Allahun. Këtu padyshim bëhet fjalë për Xhibrilin, i cili i lexonte Kur’anin Profetit (salallahu alejhi ue selam), por për arsye se e lexonte me urdhërin e Allahut, Ai ia atribuon leximin Vetes së Tij.

Për më gjerë rreth hadithit të Ebu Hurejres shiko cilësinë El Herueletu.

24- **El Xhelalu** - الجلال - **Madhështia, Lartësia.**

Kjo është cilësi “dhatijeh”: **“Ndërsa do të mbetet përgjithmonë fytyra e Zotit tënd, gjithë Madhështi e Lavdi.** (Err-Rrahman: 27)

Vërejtje: El Xhelil nuk është emër i Allahut - megjithëse disa e kanë konsideruar të tillë - sepse nuk ka ardhur si emër në ndonjë argument të saktë.

25- **El Hub-bu & El Mehabetu** - الحب و المدة - **Dashuria.**

“Bëni mirësi sepse vërtet Allahu i do mirëbërësit.” (El Bekare: 195)

26- **El Hathvu** - الحثو - **Dhënia me të dy grushtat e dorës.**

Kjo është cilësi “fi’lijeh” e përmendur në hadith të saktë.

Ebi Umametu el Bahili transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Më ka premtuar Zoti im se do të fus në Xhenet shtatëdhjetë mijë veta nga Umeti im, pa llogari dhe pa ndëshkim. Në çdo njëmijë (prej tyre), do të ketë edhe shtatëdhjetë mijë të tjerë dhe tre grushta prej grushtave të Zotit tim.”** (Trans. Et-Tirmidhi, Ibnu Maxheh, Ahmedi etj. Hadithi është përmendur në “Sahih sunen Et-Tirmidhi”).

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

27- **El Huxhzetu & El Haku** - الحجة والحق - **Ija**.¹

Janë dy cilësi “dhatijeh” të përmendura në hadithe të sakta.

Imam Ahemdi transmeton me sened të mirë nga Ibnu Abazi se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “Vërtet farefisnia është një degë e kapur pas Ijës² së të Gjithëmëshirëshmit (Rahmanit), i Cili e ndihmon dhe i bën mirë atij që mban lidhje me farefisnin (i viziton, i ndihmon) dhe e ndërpret bamirësinë dhe ndihmën ndaj atij që ndërpret lidhjet farefisnore.”

Në këtë hadith është përmendur cilësia **El Huxhzetu**.

Buhariu ka transmetuar nga Ebu Hurejre se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “Allahu i krijoi krijesat dhe pasi i përfundoi dhe i përsosi, u ngrit farefisnia dhe u kap pas Ijës së të Gjithëmëshirëshmit. I Gjithëmëshirëshmi i tha: ‘Mos!’ Farefisnia tha: ‘Këtu jam ngritur për t’u mbështetur Ty dhe për të kërkuar mbrojtje dhe strehim tek Ti prej atij që i ndërpret lidhjet farefisnore.’ Allahu i tha: ‘A nuk kënaqesh që t’i bëj mirësi dhe ta ndihmoj atë që të viziton dhe mban lidhje me ty, si dhe t’ia ndërpres ndihmën dhe bamirësinë atij që largohet nga ti?’ Tha: ‘Posi jo, o Zoti im.’ Atëherë Zoti tha: ‘Kjo do të të jepet ty.’” Pastaj Profeti (salallahu alejhi ue selam) tha: “Lexoni nëse dëshironi: ‘A do të bënit ju pabesi e të këqija në tokë dhe do të cënonit lidhjet e afërsisë, po t’u jepej sundimi?’ (Muhamed: 22).”

Në këtë hadith është përmendur **El Haku**.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Ky është një prej haditheve të cilësive, për të cilat dijetarët e selefëve tekstualisht kanë theksuar se ‘besohen siç kanë ardhur’.”

Një person, pas leximit të hadithit të lartpërmendur në praninë e imam Ahmedit, tha: “Kam frikë se mos ke bërë kufër.” Imam Ahmedi, pasi i dëgjoi fjalët e tij, tha: “Ky është xhehmij.”

28- **El Hafidh** - الحافظ - **Ruajtësi**.

“Allahu është Ruajtësi më i mirë.” (Jusuf: 64)

29- **El Hasib** - الحاسب - **Llogaritësi**.

“Dhe jemi më se të Mjaftueshëm Ne si Llogaritës.” (El Enbija: 47)

30- **El Hafijj** - الحافي - **Mirëpritësi, Bamirësi dhe Dashamirësi i Madh**.

¹) Për sa i përket njeriut, ija është vendi ku lidhet dhe shtrëngohet izari (rroba) në mes, ndërsa për sa i përket Allahut, e pohojmë si cilësi, ashtu siç i përshtatet Madhësitë së Tij, pa e përngjasuar me krijesat dhe pa u thelluar në përfytyrimin e saj. Në pohimin e kësaj cilësie dhe të gjitha cilësive të tjera, duhet të largojmë nga mendja jonë përfytyrimin e cilësive të krijesave. Çfarëdolloj forme që mendon njeriu për cilësitë e Allahut, le ta dijë se Allahu është i pastër dhe shumë larg nga ajo.

²) Nënkupton mbrojtjen që kërkon farefisi prej mosvizituesit (atij që ndërpret lidhjet dhe vizitat me farefisnin). Allahu e strehon dhe e mbron prej tij, siç sqarohet në hadithin që vijon.

“Se vërtetë që Ai është për mua gjithnjë (Mirëpritës) Bamirës, Dashamirës.”
(Merjem: 47)

31- El Hananu - الحنان - Mëshira, Mirëdashja, Dhembshuria, Përdëllimi dhe Dashuria.¹

Cilësi “fi’lijeh” e përmendur në Kur’an dhe në hadithe të sakta:

“O Jahja, mbahu fort pas librit të parë (Teuratit).² Ne i dhamë atij urtësi duke qenë akoma fëmijë dhe (e bëmë) atë të dashur, të dhembshur e të mëshirshëm ndaj njerëzve, si dashuri e mëshirë nga Ne. E bëmë të pastër nga gjynahet dhe ai që i drejtë, i devotshëm.” (Mejrem: 12-13)

Ebu Said el Hudri transmeton se e ka dëgjuar Profetin (salallahu alejhi ue selam) duke thënë: *“Vendoset Ura e Siratit mbi zjarrin e Xhehenemit, pastaj ndërmjetësojnë profetët për çdo njeri që ka dëshmuar sinqerisht se nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Allahut. I nxjerrin ata nga zjarri, pastaj Allahu i përdëllen (i mëshiron) me Mëshirën e Tij ata që gjenden në të³ dhe nuk le asnjë rob që ka besim në zemrën e tij sa një kokërr fare, pa e nxjerrë prej tij.”* (Trans. imam Ahmedi me “insad” të mirë, siç ka thënë Arnauti në recensimin e “senedit”).

El Hananu nuk është emër i Allahut, sepse nuk është përmedur në ndonjë hadith të saktë si i tillë.

32- الخداع لمن خادعه - Mashtrimi ndaj atij që përpiket të mashtrojë Allahun ose besimtarët.

Kjo është cilësi “fi’lijeh” e cila nuk i atribuohet Allahut në mënyrë absolute, por vetëm në rastin kur është lavdërim dhe tregon përsosmëri⁴: **“Padysim që hipokritët mundohen të mashtrojnë Allahun, por është Allahu Ai që i mashtron ata.”** (En-Nisa: 142)

33- El Huletu - الخلة - Dashuria e pastër dhe e madhe, **Miqësia** e ngushtë.

Është cilësi “fi’lijeh” e përmendur në Kur’an dhe në Sunet. Allahu do dhe afron me dashuri të madhe atë që dëshiron, si dhe urren atë që dëshiron: **“Vërtet Allahu e bëri Ibrahimin halil** (mik të ngushtë).” (En-Nisa: 125)

Muslimi ka transmetuar në “Sahihun” e tij se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Vërtet Allahu shokun tuaj e bëri halil (mik të ngushtë).”* (Profeti - salallahu alejhi ue selam - kishte për qëllim veten e tij.)

34- Err-Rru’jetu - الرؤية - Shikimi.

¹) Origjina e fjalës “hanan” në gjuhën arabe është: dashuria e zjarrtë dhe malli që ndjen nefsi për diçka, pastaj është përdorur me kuptimet që u përmendën më lart.

²) Ose bëhet fjalë për një libër të veçantë që ne nuk e dimë.

³) Bëhet fjalë për njësuesit që nuk i kanë bërë shirk Zotit.

⁴) Për më gjerë shiko “Bazën e parë” të cilësive të Allahut.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Cilësi “dhatijeh” e përmendur në shumë argumente: **“Ai u tha: ‘Mos u frikësoni! Padyshim që Unë jam me ju të dy, duke parë e dëgjuar çdo gjë.’”** (Ta Ha: 46)

35- **Shikimi i Allahut** në botën e përtejme, nga ana e besimtarëve.

“Ehli sunneh uel xhemaah” besojnë se besimtarët do ta shikojnë Allahun me sytë e tyre në botën e përtejme dhe për këtë tregojnë mjaft argumente nga Kur’ani dhe Suneti.

Argumente nga Kur’ani:

“Disa fytyra atë ditë do të shkëlqejnë (nadireh) duke parë Zotin e tyre (Allahun).” (El Kijame: 21-22)

“(Besimtarët) në frone të larta duke parë.” (Mutaфинinë: 35)

Fjala **“duke parë”**, përfshin edhe shikimin e tyre tek Allahu, sepse është e përgjithshme.

“Për ata të cilët punuan të mirën, është më i miri (Xheneti) dhe për më tepër (shikimi tek Allahu).” (Junus: 26)

Profeti (salallahu alejhi ue selam), për fjalën “zijade” (edhe më tepër), ka thënë se është shikimi tek Allahu, siç ka ardhur në hadithin e Suhejbbit, i cili thotë se ai e lexoi këtë ajet dhe tha: *“Kur futen banorët e Xhenetit në Xhenet dhe banorët e zjarrit në zjarr, dëgjohet një zë që thërret: ‘O banorët e Xhenetit! Vërtet juve ju është bërë një premtim nga Allahu që Ai dëshiron t’jua plotësojë.’ ‘Cili është ai? - thonë ata, - A nuk na i ka rënduar peshoret (me të mira, a nuk na i ka zbardhur fytyrat, a nuk na ka futur në Xhenet, a nuk na ka ruajtur nga zjarri)!?’ Atëherë Allahu e zbulon perden dhe ata e shikojnë. Allahu nuk u jep atyre ndonjë gjë më të dashur për ta sesa shikimin tek Ai. Kjo është ‘ez-zijade’.”* (Muslimi)

“Atje ata do të kenë çfarë të duan dhe Ne kemi (përveç kësaj) më tepër (për ta: shikimin tek Allahu).” (Kaf: 35)

“Sigurisht që kafirët do të pengohen nga shikimi drejt Zotit të tyre atë ditë.” (El Mutaфинinë: 15)

Imam Shafiu ka thënë: “Përderisa kafirët pengohen nga shikimi drejt Allahut për shkak se Ai është i hidhëruar me ta, kjo tregon se besimtarët e shikojnë Atë, sepse Ai është i kënaqur prej tyre.”

Ez-Zexhaxh ka thënë: “Ky ajet është argument që tregon se besimtarët e shikojnë Allahun në Ahiret, sepse sikur të mos ishte kështu, ky ajet nuk do të kishte dobi.”

Argumente nga Suneti:

- Transmetohet nga Xheriri se ai dhe disa sahabë të tjerë ishin ulur me Profetin (salallahu alejhi ue selam) në natën e 14-të të muajit, kur ai pa hënën (e plotë) dhe tha: *“Vërtet ju do ta shikoni Zotin tuaj siç shikoni hënën dhe nuk do të hasni asnjë*

*vështirësi (padrejtësi, dëmtim).*¹ Prandaj, nëse është e mundur që të përgatiteni për namazin para lindjes së diellit dhe para perëndimit të tij, si dhe të shmangni shkaqet që ju pengojnë nga falja e tyre (gjumi dhe preokupimet e tjera), veproni.” Pastaj Profeti (salallahu alejhi ue selam) lexoi ajetin e Kur’anit: **“Bëj durim pra, për gjithçka që ata thonë dhe lartëso Lavditë e Zotit tënd para lindjes së diellit dhe para perëndimit.”** (Kaf: 39). (Buhariu & Muslimi)

- Ebu Hurejre transmeton se disa njerëz pyetën: “O i Dërguari i Allahut, a e shikojmë Zotin tonë në Ditën e Gjykimit?” Profeti (salallahu alejhi ue selam) u përgjigj: “A hasni ndonjë dëmtim (vështirësi prej mbipopullimit, dyndjes së njerëzve) kur shikoni hënën e plotë?” “Jo, o i Dërguari i Allahut,” i thanë. Ai vazhdoi: “A hasni ndonjë dëmtim dhe vështirësi kur shikoni diellin në qiellin e pastër e pa re?” “Jo,” i thanë. Atëherë ai u tha: “Kështu do ta shikoni ju Zotin tuaj.” (Trans. Buhariu & Muslimi)

Dijetarët kanë thënë se hadithet e transmetuara nga Profeti (salallahu alejhi ue selam) dhe shokët e tij në lidhje me shikimin e Allahut në botën e përtejme, janë “muteuatir”. Këto hadithe i kanë transmetuar autorët e librave të saktë të hadithit të “mesanidëve” dhe të “suneneve”. Përafërsisht, hadithet e shikimit të Allahut nga besimtarët, i kanë transmetuar 30 sahabë dhe ai që përvetëson njohjen e tyre, bindet në mënyrë të prerë se Profeti (salallahu alejhi ue selam) i ka thënë ato me të vërtetë.²

Në hadithet e lartpërmendura, nuk është përngjasuar Allahu me Diellin dhe Hënën, por është krahasuar shikimi i Allahut nga muslimanët në Ahiret, me shikimin e hënës në Dynja, pra, është krahasuar shikimi me shikimin dhe nuk janë përngjasuar me njëra-tjetrën gjërat që shihen.

Disa devijime të grupeve të humbura në lidhje me këtë çështje

1- Kanë marrë si argument fjalën e Allahut: “(Musai) **tha: ‘O Zoti im! M’u shfaq që të të shoh Ty haptazi.’ Allahu tha: ‘Ti nuk do të më shikosh Mua, por shiko malin, nëse ai do të mundet të qëndrojë në vendin e tij, atëherë t’i do të mund të më shohësh Mua.’**” (El Arafë: 143), dhe kanë thënë se ky ajet tregon që Allahu nuk do të shikohet sepse kjo është e pamundur për njeriun.

¹) Kjo sipas varianteve të transmetuara nga Profeti (salallahu alejhi ue selam). Ndërmjet tyre nuk ka kundërshtim, sepse kuptimi është që nuk haset vështirësi në shikim për shkak të mbipopullimit dhe dyndjes së njerëzve, ashtu sikurse nuk haset vështirësi në shikimin e hënës.

²) Marrë nga “Sherh el akideti tahauije”.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Përgjigjja ndaj këtij aludimi është se ky ajet nuk tregon që Allahu nuk do të shikohet në botën e përtejme, por përkundrazi, tregon se Ai do të shikohet. Pra, ajeti është argument kundër tyre për arsyet që vijnë:

E para, nuk është e drejtë të mendohet se Musai (alejhi selam) i ka kërkuar Allahut diçka që është e pamundur të ndodhë, sepse ai është i Dërguar i Allahut dhe Allahu atij i ka folur me fjalë. Ai ka qenë njeriu më i ditur në kohën e tij rreth Zotit, kështu që nuk është e mundur të kërkojë diçka që bie ndesh me besimin. Përderisa ai këtë gjë e ka kërkuar prej Allahut, kjo tregon se ajo është e mundur.

E dyta, Allahu nuk e kritikoi dhe nuk e refuzoi kërkesën e tij, ndërsa kur Nuhu (alejhi selam) kërkoi shpëtimin e djalit të tij, Allahu e kritikoi me fjalët: **‘Unë të paralajmëroj që të mos jesh prej të paditurve.’** (Hud: 56).

E treta, Allahu i tha Musait (alejhi selam) **“ti nuk do të më shikosh”** dhe nuk i tha “nuk është e mundur të më shikosh”, apo “Unë nuk mund të shikohem”. Ndryshimi mes dy përgjigjeve është i qartë. Pra, kjo përgjigje që Allahu i dha Musait (alejhi selam), tregon se Allahu do të shikohet, por fuqia e Musait (alejhi selam) nuk e përballon shikimin e Tij në Dynja¹. Pretendimi i tyre se pjesëza mohuese “len” (nuk), tregon për mohim të përhershëm edhe në të ardhmen dhe se ajo tregon për mosshikimin e Allahut në Ahiret, është i pasaktë. Edhe sikur ajo të ishte përforcuar me fjalën “kurrë”, pra, “nuk do ta shikosh kurrë”, nuk tregon për mohim të përhershëm në Dynja dhe Ahiret. Atëherë, si mund të thuhet një gjë e tillë, kur ndajfolja kohore “kurrë” që është përforcuese e mohimit në të ardhmen, nuk ekziston!?

Allahu ka lajmëruar në Kur’an se çifutët kurrë nuk do ta dëshirojnë vdekjen: **“Por ata kurrë nuk do ta dëshirojnë atë...”** (Bekare: 95). Nuk ka dyshim se mohimi në këtë rast është i kufizuar vetëm për Dynjanë, sepse në Ahiret (në zjarr) kafirët do ta dëshirojnë vdekjen dhe zhdukjen, shfarosjen e tyre të plotë: **“Do të thonë: ‘O Malik! Le të na japë fund Zoti yt.’ Ai do t’u thotë: ‘Sigurisht që do të mbeten përjetë.’”** (Ez-Zuhruf: 77)

Atëherë fjala e Allahut: **“Ti nuk do të më shikosh”** do të thotë: Ti nuk do të më shikosh në Dynja.

2- Kanë thënë se fjala e Allahut në Kur’an: **“Atë nuk e përfshijnë shikimet dhe Ai i përfshin shikimet.”** (En Am: 103), tregon që Allahu nuk mund të shikohet.

Për sa i përket kësaj, sikurse edhe në rastin e kaluar, ky ajet tregon që Allahu do të shikohet, sepse kuptimi është: shikohet, por nuk përfshihet me shikim. Përfshirja me shikim është diçka më tepër se thjesht shikimi. Përderisa është mohuar përfshirja, kjo tregon se shikimi do të ndodhë. Krijesat nuk mund ta përfshijnë Atë

¹) Këto ishin disa arsye, të tjerat mund të shihen në “Sherhul tahauije”.

me shikimin e tyre, për arsye se Madhështia e Tij është e përkryer, por kjo nuk tregon që besimtarët nuk do të mund ta shohin Atë. Ashtu siç krijesat e dinë që Allahu ekziston dhe nuk e përfshijnë dot Atë me dijen e tyre, po ashtu e shikojnë (muslimanët prej tyre) Atë, megjithëse nuk e përfshijnë me shikimin e tyre. Përveç kësaj, ka krijesa të cilat njerëzit i shikojnë, megjithëse nuk i përfshijnë me shikimin e tyre, si për shembull Dielli. Atëherë si të mos e konceptojmë që sytë e shikojnë Allahun, Krijuesin e krijesave, në Ahiret, por nuk e përfshijnë me shikim Atë!?

Nga kjo që sqaruam, rezulton se çdo argument i saktë që përdorin grupet e humbura për t'iu kundërvënë të vërtetës, është kundër tyre. Ibn Tejmije, në “El akl ue en-nakl” ka thënë: “Unë jam i gatshëm që çdo argument të saktë që e përdor kushdo qoftë për diçka të pavërtetë, ta kthej kundër tij.”

Disa çështje që kanë të bëjnë me ketë temë

1- Të shikuarit e Allahut është argument se Ai është në lartësi mbi krijesat e Tij, sepse shikimi nuk mund të përfytyrohet pa qenë kundrejt njëri-tjetrit shikuesi me atë që do të shihet. Ai që mendon se Allahu do të shihet, por jo në ndonjë anë të caktuar, le të kontrollojë mendjen e tij, sepse ai, ose refuzon arsyen logjike, ose në mendjen e tij ka diçka që nuk shkon. Nëse do të thotë se Allahu shihet, por as përpara e as prapa, as djathtas e as majtas, as lart e as poshtë, këtë do t'ia refuzonte çdo njeri që e dëgjon, me natyrshmërinë e tij të pastër. Fakti që Allahu shihet në anën e lartësisë, nuk do të thotë që ajo e përfshin apo e kufizon Atë, sepse me fjalën “anë” nuk nënkuptojmë një vend apo diçka të kufizuar brenda krijesave, por kemi për qëllim hapësirën që i tejkalon të gjitha krijesat. (Për më gjerë shiko “Sherhut-tahauije” të Ibnu ebil Iz-z.)

2- Asnjëri nuk e shikon Allahun me sy në Dynja. Kjo sepse Profeti (salallahu alejhi ue salam) na ka thënë: “*Dhe se ju nuk do ta shikoni Zotin tuaj derisa të vdisni.*” (Ahmedi & Ebu Daudi)

Në lidhje me këtë çështje, dijetarët janë të gjithë dakord, përveç shikimit të Profetit (salallahu alejhi ue salam). Disa janë të mendimit se ai e ka parë me sy Allahun, ndërsa disa të tjerë janë të mendimit se nuk e ka parë me sy.

Të parët kanë marrë si argument një transmetim të Ibnu Abasit, i cili thotë se Profeti (salallahu alejhi ue salam) e ka parë Zotin me sytë e tij. Këtë transmetim e ka përmendur Ibnu Huzejme dhe ai është i dobët, siç thotë shejh Albani.

Dijetarët e mendimit të dytë kanë si argument hadithin e Ebu Dherrit: “*E pyeta Profetin (salallahu alejhi ue salam): ‘A e pe Zotin tënd?’ Ai tha: Ai ishte **Dritë**, si ta shikoja!’*” (Muslimi)

Pra, Profeti (salallahu alejhi ue salam) ka parë perden e dritës që e pengon shikimin drejt Allahut, prandaj ka thënë “si ta shikoja”.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Gjithashtu, kanë marrë si argument thënien e Aishes drejtuar Mesruhut: “Ai që të thotë se Muhamedi ka parë Zotin e tij, ka gënjyer.” (Buhariu & Muslimi)

Mendimi më i saktë është që Profeti (salallahu alejhi ue selam) e ka parë Zotin e tij me zemër dhe në ëndërr, por jo me sy. Kështu bëhet pajtimi ndërmejt argumenteve dhe thënieve të sahabëve në lidhje me këtë çështje. Sahabët që e mohuan shikimin e Allahut në Dynja nga ana e Profetit (salallahu alejhi ue selam), patën për qëllim shikimin me sy, ndërsa ata që e pohuan, patën për qëllim shikimin me zemër. A’ta, nxënësi i Ibnu Abasit, transmeton se ai ka thënë: “Profeti (salallahu alejhi ue selam) e ka parë Zotin e tij me zemër.” Muslimi ka transmetuar në “Sahihun” e tij se Ibnu Abasi ka thënë: “Muhamedi e ka parë Zotin e tij me zemër dy herë.” Ibnu Kethiri ka thënë se nuk ka ndonjë transmetim të saktë nga sahabët që tregon se Profeti (salallahu alejhi ue selam) e ka parë Zotin me sy. Ndërsa dy ajetet e sures “Nexhm”, nuk bëjnë fjalë për shikimin e Allahut, por për shikimin e Xhibrilit, sipas komentit më të saktë.

Ibnu Kethiri, pasi ka zgjedhur mendimin që dy ajetet tregojnë për shikimin e Xhibrilit në formën e tij reale, ka përmendur hadithin e transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi, ku Aishja e ka pyetur Profetin (salallahu alejhi ue selam) për atë që ka parë në Natën e Miraxhit dhe ai i ka thënë: “*Ai që pashë ishte Xhibrili.*”

3- Hadithet e sakta tregojnë se Allahu do të shihet në fushën e Mahsherit (vendtubimit, vendqëndrimit) në Ditën e Gjykimit, si dhe në Xhenet. Dijetarët, në lidhje me ata që do ta shohin Allahun në Ditën e Gjykimit në Mahsher, kanë disa mendime:

- I pari është se Atë do ta shohin vetëm besimtarët.

- I dyti është se do ta shohin të gjithë ata që qëndrojnë në Mahsher, si besimtarët, ashtu edhe kafirët, por pastaj këta të fundit do të privohen (pengohen) nga shikimi drejt Allahut.

- I treti është se do ta shohin së bashku me besimtarët edhe munafikët (hipokritët), ndërsa kafirët e tjerë nuk do ta shikojnë.

Mendimi i tretë është më i saktë, sepse Ebu Hurejre ka transmetuar se Profeti (salallahu alejhi ue selam), në një hadith të gjatë i cili nis me pohimin e shikimit të Allahut në Ditën e Kijametit, ndër të tjera ka thënë:

“*Mbetet ky Umet në të cilin janë edhe munafikët e tij. Atëherë Allahu vjen në një formë të ndryshme nga ajo që e njohin dhe u thotë: ‘Unë jam Zoti juaj.’ Ata thonë: ‘Allahu na ruajtë prej teje. Ky është vendi që do të qëndrojmë, derisa të na vijë Zoti ynë i Lartësuar. Kur të vijë Zoti ynë, ne do ta njohim.’ Pastaj Allahu i Lartësuar vjen në formën e Tij, të cilën ata e njohin dhe u thotë: ‘Unë jam Zoti juaj.’ Ata i thonë: ‘Ti je Zoti ynë.’”* (Buhariu & Muslimi)

Hafidh el Hakemi, pasi ka përmendur hadithe të shumta në lidhje me këtë temë, ka thënë: “Me këto hadithe ‘muteuatir’ të sakta dhe të qarta, vërtetohet se Allahu do të shihet në Ahiret, siç dëshiron Ai. Dëshmorët do ta shohin Atë pas vdekjes së tyre, melekët do ta shohin, Profeti do ta shohë kur t’i marrë leje Allahut për ndërmjetësimin dhe Umeti i Profetit (salallahu alejhi ue selam), të mirët dhe të prishurit prej tyre e shikojnë. Për të këqinjët dhe munafikët, shikimi do të jetë sprovë dhe një lloj ndëshkimi, ndërsa për të dashurit e Allahut, besimtarët veçanërisht, shikimi do të jetë gëzim dhe lumturi. Ata kënaqen duke parë Fytyrën e Allahut. Atyre u jepet dritë e plotë për të kaluar mbi Sirat (urë), pastaj u shfaqet në Xhenet dhe e shohin siç dëshiron Ai.”

Për më gjerë rreth kësaj teme, mund të shihet “Maarixhul kabul”. Atje janë përmbledhur mjaft hadithe dhe thënie të sahabëve, të tabiinëve dhe të dijetarëve të Umetit, të cilat e konfirmojnë këtë që sqaruam.

Si përfundim, po e mbyllim këtë temë me hadithin e transmetuar nga Nesaiu, Ahmedi dhe Ibnu Hibani nga Ammar ibni Jasir, në të cilin Profeti i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka bërë këtë lutje:

“O Allah! Me dijen Tënde rreth së fshehtës dhe fuqinë Tënde mbi krijesat, më jep jetë përderisa jeta është më e mirë për mua dhe ma merr jetën nëse vdekja është më e mirë për mua! Të kërkoj të më bësh që të të frikësohem Ty në vetmi dhe në publik! Të kërkoj të më bësh që të them të drejtën, si në çaste zemërimi, ashtu edhe në çaste kënaqësie! Të kërkoj që të më bësh modest (mesatar) kur jam i pasur dhe kur jam i varfër (kur të jem i pasur të mos shpërdoroj, dhe kur të jem i varfër të mos e shtrëngoј dorën)! Të kërkoj të më dhurosh kënaqësi të trupit që nuk zhduket dhe të kërkoj që të më japësh kënaqësi të zemrës që nuk ndërpritet! Të kërkoj që të më bësh të kënaqur pas caktimit Tënd! Të kërkoj që jetën pas vdekjes të ma bësh të qetë, pa brenga, dhimbje dhe pikëllime! Të kërkoj që të më bësh prej atyre që do të përjetojnë kënaqësinë e shikimit tek Fytyra Jote! Të kërkoj të më bësh të mallëngjyer për takimin me Ty, pa hasur ndonjë dëmtim në punët e Dynjasë dhe as ndonjë sprovë që të devijon nga feja! O Allah! Na zbukuro me stolinë e besimit dhe na bëj udhëzues, të udhëzuar.”

Ibnu Kajimi ka thënë: “Në këtë lutje me vlerë të madhe, Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka bashkuar gjënë më të mirë të Dunjasë, mallëngjimin për takimin me Allahun e Lartësuar, dhe gjënë më të mirë të Ahiretit, shikimin e Fytyrës së Allahut të Lartësuar.” (Marrë nga “Medarixhus salihine”).

36- Err-Rrixhlu & El Kademani - الرجل و ال قمان - Dy Këmbët.

Këto janë cilësi “dhatijeh - haberijeh” të përmendura në hadithe të sakta.

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë:

“Do të vazhdojë hedhja (e njerëzve dhe xhindëve) në Xhehenem dhe ai (Xhehenemi) do të thotë: ‘A ka më për t’u hedhur?’, derisa Zotëruesi i krenarisë të

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

vendosë Këmbën e Tij mbi të. Atëherë Xhehenemi do të ngjishet e do të mblidhet dhe do të thotë: 'Më mjafton, më mjafton.'" (Buhariu & Muslimi)

Ibn Abasi ka thënë: **"El Kursiju"** është vendvendosja e dy këmbëve, ndërsa për sa i përket Arshit, askush nuk e përcakton madhësitinë e tij."

(Trans. Ibnu ebi Shejbe në "El Arsh" dhe Ibnu Huzejme në "Teuhid". Albani ka thënë se fjala e Ibnu Abasit është e saktë.)

Kjo thënie, megjithëse nuk është fjalë e Profetit (salallahu alejhi ue selam), merr gjykimin e fjalës së tij, sepse bën pjesë në ato fjalë që sahabët nuk mund t'i thonin nga mendja e tyre. Si përfundim, hadithi dhe thënia e Ibnu Abasit, tregojnë se Allahu ka dy Këmbë, të cilat i përshaten Madhështisë së Tij dhe nuk u përngajnë krijesave, sepse Atij nuk i përngjan asgjë.

37- El Irshadu - الإرشاد - Drejtimi, Udhëzimi për në rrugën e drejtë, në dije dhe në të mirë.

Argument për këtë vepër është hadithi i Ebu Hurejres ku Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *"Imami është ai që ua ruan namazin njerëzve dhe kujdeset që*

¹⁾ Kjo thënie e Ibn Abasit është koment i fjalës së Allahut në Kur'an: **"El Kursiiju e Tij ka përfshirë qiejt dhe Tokën."** "El Kursij" është një krijesë reale, ndryshe nga Arshi. Ajo është krijesë shumë më e vogël se Arshi, edhe pse ka përfshirë qiejt dhe Tokën. Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: "Shtatë qiejt, të krahasuar me 'El Kursij', janë si shembulli i unazës së hedhur në shkretëtirë. Dhe Arshi është po aq më i madh në krahasim me 'El Kursij'." (Trans. Ibnu ebi Shejbe në "Kitabul Arsh" dhe Albani ka thënë se është i saktë.) Ata që kanë thënë se "El Kursij" është Arshi, kanë gabuar, sepse argumentet, sikurse i transmetuam, tregojnë se "El Kursij" është një krijesë tjetër më vete. Gjithashtu, edhe ata që e kanë interpretuar si "dija e Tij" apo "pushteti i Tij", i kanë kundërshtuar argumentet e lartpërmendura. Ibn Kethiri, pasi ka përmendur transmetimet dhe diskutimet në lidhje me "El Kursij", ka thënë: "E vërteta është se 'El Kursij' ndryshon nga Arshi dhe Arshi është më i madh, siç tregojnë transmetimet dhe lajmet në lidhje me këtë çështje." Sheukani, pasi ka përmendur atë që është thënë në lidhje me "El Kursij" ka thënë: "Thënia e parë është e drejtë. 'El Kursij' është një trup real i ndryshëm nga Arshi. Nuk ka arsye për të mos iu përmbajtur kuptimit konkret, përveç imagjinatës së lindur nga injoranca dhe humbja." Albani, në lidhje me "El Kursij", pasi ka vërtetuar se hadithi i lartpërmendur është i saktë, ka thënë: "Hadithi është komenti i fjalës së Allahut **'dhe El Kursij e Tij ka përfshirë qiejt dhe Tokën'**. Ky hadith, tregon në mënyrë të qartë se 'El Kursij' është krijesa më e madhe pas Arshit dhe është objekt konkret e jo abstrakt. Pra, hadithi u kundërvihet atyre që e interpretojnë 'El Kursij' si 'sundimi' apo 'pushteti', siç përmendet në disa tefsire. Ndërsa transmetimi që ka ardhur nga Ibnu Abasi në të cilin ai thotë se 'El Kursij' është 'dija', është i dobët." Pastaj Albani ka thënë: "Dije se çdo hadith që e përshkruan 'El Kursij', përveç këtij hadithi, është i pasaktë." (Shih "Es-silsileti", hadithi nr. 109, dhe për më gjerë në lidhje me "El Kursij", shih "Sherhul akideti tahauije".)

ai të kryhet në mënyrë korrekte, ndërsa muezinin i është besuar të kujdeset për kohët e namazit. O Allah! Drejtoji e udhëzoji imamët dhe fali muezinët.” (Trans. Tirmidhiu në “Sunenin” e tij)

38- **Err-Rrida** - الرضا - **Kënaqësia.**

Kjo është cilësi “fi’lijeh” dhe argumentet për të janë të shumta. Një prej tyre është fjala e Allahut: **“Allahu është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Të.”** (El Maide: 119)

39- **Err-Rreuh** - الروح -

Kjo fjalë merr disa kuptime në gjuhën arabe: mëshira, flladi i erës ose shplohja. Vetëm sipas kuptimit të parë ajo është cilësi e Allahut. Fjala “Rreuh” me kuptimin “mëshirë” si atribut i Allahut, është përmendur në fjalën e Tij: **“Kurrë mos e humbni shpresën për Rreuhi** (Mëshirën e Allahut). **Vërtet askush nuk humb shpresat për Mëshirën e Allahut, përveç popullit kafir** (mohues).” (Jusuf: 87)

Ibnu Xherir dhe El Begau, kanë thënë për **Rreuhi**-in e Allahut se ai është Mëshira e Tij.

Ebu Hurejre transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Era është nga Rreuh-i i Allahut.”** (Hadithi është i saktë. E trans. Ebu Daudi etj.)

Në komentin e fjalës “rreuh” që është përmendur në hadith, dijetarët kanë dhënë dy variante: a) Mëshira e Allahut dhe b) flladi i erës.

Sipas variantit të parë, **Err-Rreuh** është cilësi e Allahut, ndërsa sipas variantit të dytë, është krijesë e dedikuar Krijuesit të saj që e ka krijuar dhe nuk është cilësi e Tij.

40- **El Zariu** - الزارع - Ai që bën të mbijë bima dhe të rritet.

Kjo është një cilësi e Allahut, por nuk është emër i Tij: **“Më tregoni për farën që ju e mbillni në tokë! Ju e bëni atë që të mbijë e të rritet, apo jemi Ne?”** (El Uakiah)

41- **Es-Saku** - الساق - **Kërciri.**

Cilësi “dhatijeh-haberije”, e përmendur në Kur’an dhe hadithe të sakta: **“Kujto ditën kur Kërciri do të zbulohet** (Ditën e Ringjalljes) **dhe do të thirren të bien në sexhde para Allahut. Kur ata që kanë qenë muslimanë të gjithë do të bien me fytyrë përtokë para Allahut, por hipokritët nuk do të munden të bëjnë kështu.”** (El Kalem: 42)

Ebu Said el Hudri transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: **“Atëherë Allahu do të zbulojë Kërcirin dhe do t’i bjerë në sexhde çdo besimtar.”** (Buhariu & Muslimi)

Ibnu Tejmije ka sqaruar se nga sahabët nuk është transmetuar të kenë pasur ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me ajetet e cilësive të Allahut, përveç ajetit që është përmendur **Kërciri**. Disa prej sahabëve kanë thënë se bëhet fjalë për zbulimin

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

e vështirësisë, ndërsa disa të tjerë kanë thënë se bëhet fjalë për zbulimin e **Kërcirit** të Allahut. Arsyeja e kësaj mosmarrëveshjeje, nuk është kundërshtimi nga ana e sahabëve i parimit të përgjithshëm të mosndryshimit të domethënies së drejtpërdrejtë të ajeteve të cilësive, por është fakti që ajeti i Kur'anit nuk tregon në mënyrë të drejtpërdrejtë që bëhet fjalë për një cilësi të Allahut, sepse në të nuk është thënë **“zbulohet Kërciri i Allahut”**. Në ajet është përmendur fjala “kërci” në trajtën e pashquar dhe nuk i është atribuar Allahut, pra, nga shprehja e thjeshtë nuk kuptohet që **Kërciri** është cilësi e Allahut. Ata që e kanë besuar si të tillë, e kanë konfirmuar nga hadithi i saktë që komenton Kur'anin¹, në të cilin thuhet: **“Atëherë Allahu do ta zbulojë Kërcirin ...”**

Megjithëse përbërja e fjalëve të ajetit, konteksti i tyre dhe meditimimi rreth kuptimit të tij, të çojnë në përfundimin që bëhet fjalë për një cilësi të Allahut, kjo nuk do të thotë që kjo kuptohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, thjesht nga shprehja.

42- **Es-Suhrijetu bil kafirine** - سخرية بالكافرين - **Tallja, Përqeshja e kafirëve.**

Kjo është një cilësi “fi’lijeh” që i atribuohet Allahut vetëm në rastin kur është e përkryer, pra në mënyrë të kufizuar. Ajo është përmendur në shumë argumente: **“Ata tallen me këta (besimtarë), por Allahu tallet me ta dhe për ata do të ketë ndëshkim të dhimbshëm.”** (Teube: 79)

Për më gjerë shiko “Bazën e parë” të cilësive të Allahut.

43- **Es-Sahatu** - السخط - **Pakënaqësia dhe Zemërimi.**

Cilësi “fi’lijeh” e përmendur në Kur'an: **“Kjo ngaqë ata ndoqën atë që zemëroi Allahun dhe urryen atë që Ai donte. Kështu që Ai i bëri veprat e tyre të pavlera.”** (Muhamed: 28)

44- **Es-Sur’atu** - السرعة - **Shpjëtesia.**

Kjo është cilësi “fi’lijeh” e përmendur në një hadith të saktë.

Ebu Hurejre ka transmetuar nga Profeti (salallahu alejhi ue selam) se: **“Vërtet Allahu ka thënë: ‘Kush afrohet (me anë të punëve të mira) tek Unë një pëllëmbë, Unë afrohem drejt tij një krah; kush më afrohet një krah, Unë atij i afrohem një pash dhe kush më afrohet një pash, Unë atij i vij më shpejt.’”** (Muslimi)

El Hafidh ebu Abdilah ibnu Mendeh, në librin e tij “Kitabul Teuhid”, ka thënë se **Es-Seri’ - I Shpjëti**, është emër i Allahut dhe si argument ka marrë hadithin e sapopërmendur të Ebu Hurejres. Megjithëse mbështetja në këtë hadith për ta emërtuar Allahun **Es-Seri’**, nuk është e saktë, fakti që ai për këtë çështje i është referuar këtij hadithi, tregon se, sipas mendimit të tij, **Shpejtësia** është cilësi e Allahut.

¹) Pra, nuk ka përmendur për të ndonjë dispozitë hallall apo haram.

45- **Es-Sukutu** - ال سكوٲ - **Heshtja**.

Heshtja është një cilësi “fi’lijeh” që i atribuohet Allahut ashtu siç i përshtatet Madhështisë së Tij. Asgjë nuk i përngjan Atij dhe Ai është Gjithëdëgjues, Gjithëshikues.

Ebu Darda transmeton se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Ajo që e ka bërë të lejueshme Allahu në Librin e Tij, është hallall, ajo që Ai e ka ndaluar, është haram, dhe ajo për të cilën Ai ka heshtur, është e falur (e lejuar të përdoret ose të lihet), prandaj pranojeni prej Allahut atë që jua ka falur, sepse Allahu kurrë nuk mundet të harrojë ndonjë gjë.*” Pastaj Profeti (salallahu alejhi ue selam) lexoi ajetin: “**Zoti yt kurrë nuk mundet të harrojë.**” (Mejrem: 64). (Trans. El Hakim dhe Albani thotë se është “hasen”).

Ibnu Tejmije, duke vlerësuar punën që ka bërë ky dijetar i nderuar për ngadhënjimin e së vërtetës rreth të folurit të Allahut, ka thënë: “Ai përhapi, shkroi dhe mësoi që Allahu është Folës, nëse dëshiron flet dhe nëse dëshiron hesht. Allahu e shpërbleftë këtë imam dhe grupin që punoi për ndihmimin e fesë së Allahut dhe vlerësimin e respektimin e të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selam).”

Më tej, pasi përmend hadithet rreth **Heshtjes** ka thënë: “Është konfirmuar me argument nga Suneti dhe “ixhmai” (mendimi unanim i dijetarëve) se **Heshtja** është atribut i Allahut.”

46- **Es-Sultanu** - ال سلطان - **Sovraniteti, Pushteti**.

Allahu cilësohet si **Sovran, i Gjithëpushtetshëm**. **Es-Sultanu** është një cilësi me anë të së cilës njeriu kërkon mbrojtje nga të këqijat, ashtu sikurse i bën “istiadhe” (kërkon mbrojtje) Allahut dhe sikurse kërkon mbrojtje me anë të të gjitha cilësive të tjera. Kjo cilësi është përmendur në një hadith të saktë të transmetuar nga Abdulla ibnu Amer ibnul As-s, ku tregohet se Profeti (salallahu alejhi ue selam), kur futej në xhami thoshte: “*Mbrohem me Allahun e Madhërishëm, me Fytyrën e Tij fisnike dhe me Pushtetin e Tij të pafillimtë, nga shejtani i mallkuar.*” (Trans. Ebu Daudi në “Sunenin” e tij.)

47- **Esh-Shidetu** - ال شدة - **Forca ose Ashpërsia** në ndëshkim.

Kjo është një cilësi “dhatijeh”: “**Allahu i tha: ‘Padyshim që do të ta forcojmë krahun me vëllain tënd dhe do t’ju japim të dyve fuqi.’**” (El Kasas: 35)

“**Ai është i Fortë, i Ashpër në ndëshkim.**” (Err-Rrad: 13)

48- **Es-Sabër** - ال صبر - **Durimi, Sabri**.

Durimi është atribut i Allahut, siç ka ardhur në një hadith të saktë të transmetuar nga Ebu Musa, ku Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Asnjëri nuk është më durimtar sesa Allahu ndaj fyerjes (së keqes) që dëgjon. Pretendojnë që Ai ka fëmijë dhe Ai u jep shëndet e i furnizon.*” (Buhariu & Muslimi)

49- **Es-Sidku** - ال صدق - **Vërtetësia**.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Edhe kjo është një cilësi “dhatijeh”: **“Thuaj: ‘Allahu ka thënë të vërtetën, ndiqeni pra fenë e Ibrahimit.’”** (Ali Imran: 95)

“Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë folur të vërtetën.” (Ahzab: 22)

Ez-Zexhaxh, në shpjegimin e kësaj cilësie, ka sqaruar se ajo tregon që të gjitha lajmet dhe premtimet e Allahut janë të vërteta dhe se Ai do ta plotësojë atë për të cilën ka treguar.

50- Es-Sun’u - ال صانع - Bërja, Kryerja, Krijimi.

“Vepër e Allahut, i Cili përsosi çdo gjë.” (En-Neml: 88)

51- Es-Suretu - ال صورة - Forma. Kjo është një cilësi “dhatijeh-haberijeh” e cila është përmendur në hadithe të sakta. Argument janë dy hadithet që vijnë:

Transmetohet nga Ebu Seid el Hudri, se në hadithin e gjatë ku Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka përmendur që besimtarët do ta shikojnë Allahun, ndër të tjera ka thënë: *“Atëherë u vjen Urdhëruesi i Papërballueshëm (El Xhebar) në formën e Tij me të cilën e kanë parë për herë të parë dhe u thotë: ‘Unë jam Zoti juaj.’ Ata thonë: ‘Ti je Zoti ynë...’”* (Buhariu & Muslimi)

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“E kam parë Zotin tim në formën më të bukur.”* (Tirmidhiu & Ahmedi)

Hadithin e kanë vlerësuar si të saktë shumë dijetarë si Buhariu, Tirmidhiu etj. dhe ai bën fjalë për shikimin në ëndërr.

Ibnu Kutejbe ka thënë: “Unë mendoj se pohimi i formës nuk është më i çuditshëm sesa pohimi i dy duarve, dy syve dhe gishtërinjve. Por, për arsye se këto të fundit janë përmendur në Kur’an, njerëzit kanë kundërshtuar një ndjenjë sigurie dhe pëlqimi, ndërsa në lidhje me formën tjetërsohen, sepse ajo nuk është përmendur në Kur’an. Ne i besojmë të gjitha cilësitë dhe asnjërës prej tyre nuk i përshkruajmë formë (mënyrën se si ajo është) apo ta kufizojmë.

Ndërsa, për sa i përket hadithit të transmetuar nga Ebu Hurejre ku Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Allahu e krijoi Ademin në formën e tij, të gjatë gjashtëdhjetë krahë, e kur e krijoi i tha: ‘Shko e jepi selam atij grupi të ulur të melekëve dhe dëgjoje përshëndetjen që do të të japin, sepse ajo është përshëndetja jote dhe e pasardhësve të tu.’ Ademi shkoi dhe u tha: ‘Es-selamu alejkum!’ Thanë: ‘Es-selamu alejke ue rahmetullah!’ (Pra shtuan ‘ue rahmetullah’).* Kushdo që hyn në Xhenet do të jetë në formën e Ademit dhe pas Ademit vazhdoi mangësia e krijesave (bijve të tij) deri tani.” (Buhariu & Muslimi), kjo do të thotë që Allahu e krijoi Ademin në formën që kishte përcaktuar për ta krijuar atë, pa i kaluar fazat e ndryshme të formimit dhe krijimit, si puna e pasardhësve të tij në mitrat e grave. Allahu e krijoi Ademin të plotë e të përsosur që në momentin kur i fryu atij shpirtin. Përemri pronor “e tij”, në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selam) “në formën e tij”, i përket Ademit, sepse emri më i afërt

që është përmendur para tij është “Ademin”. Një nga rregullat gramatikore të gjuhës arabe, është që përmiri i përket emrit më të afërt me të. Meqenëse emri më i afërt është “Ademin”, kuptimi i hadithit është që Allahu e krijoi Ademin në formën që kishte përcaktuar për ta krijuar atë, dhe nuk do të thotë që Ademi është krijuar sipas formës së Krijuesit, siç e kanë komentuar hadithin disa dijetarë.

Një nga faktet që e përforcojnë më shumë komentin e përmendur më lart, është fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selam) “të gjatë gjashtëdhjetë krahë”, dhe kjo padyshim bën fjalë për Ademin. Hadithet dhe transmetimet në të cilat është përmendur shtojca: “Allahu e krijoi Ademin në formën e të Gjithëmëshirëshmit”, janë të dobëta, siç ka thënë Albani në serinë e haditheve të dobëta, nr. 1176.

(Për më gjerë rreth kësaj teme, shih “Fethul bari”, serinë e haditheve të sakta, nr. 449 dhe serinë e haditheve të dobëta, nr. 1175-1176.)

52- **Ed-Dahiku** - الضحك - **Qeshja**.

Kjo është cilësi “fi’lijeh” e përmendur në hadithe të sakta. Argument është hadithi i Ebu Hurejres ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Allahu i Lartësuar qesh me dy burra. Njëri prej tyre e vret tjetrin dhe që të dy hyjnë në Xhenet.*” (Buhariu & Muslimi)

Ibnu Huzejme, në librin e tij “Et-Teuhid”, në kapitullin “Vërtetimi që Zoti ynë qesh”, ka thënë: “Besojmë se Zoti qesh, siç na njoftoi Profeti (salallahu alejhi ue selam) dhe nuk e përshkruajmë mënyrën se si ndodh kjo, sepse Allahu nuk na ka treguar neve se si Ai qesh. Ne besojmë, e vërtetojmë me zemrat tona atë që ka thënë Profeti (salallahu alejhi ue selam) dhe heshtim për atë që ai nuk na e ka sqaruar, sepse ato janë gjëra që i di vetëm Allahu.”

Kuptimi i hadithit të lartpërmendur është që gjatë luftës, njëri prej burrave është kafir dhe tjetri musliman. Kafiri e vret muslimanin, pastaj e pranon Islamin dhe bëhen që të dy prej banorëve të Xhenetit.

53- **Et-Tabibu** - الطبيب - Ai që shëron dhe i jep shëndet të sëmurit.

Kjo cilësi është përmendur në një hadith të saktë.

Transmetohet nga Ebi Rimthetu se ai i ka thënë Profetit (salallahu alejhi ue selam): “Ma trego atë që ke në shpinë sepse unë jam tabib (mjek) dhe mjekoj.” Profeti (salallahu alejhi ue selam) i tha: “*Allahu është Ai që mjekon dhe shëron, por ti je vetëm një njeri që sillesh butë me të sëmurin (dhe vepron ndonjë shkak për ta shëruar). Ai që e mjekon dhe e shëron njeriun, është Ai që e krijoi.*” (Trans. Ebu Daudi dhe hadithi është i saktë, siç thotë Albani.)

54- **El Itab** ose **El Ateb** - العتاب أو العتب - **Hidhërimi** që pasohet me qortim të butë.

Cilësi “fi’lijeh” që i atribuohet Allahut ashtu siç i përshtatet Madhështisë së Tij. Argument për këtë është hadithi i Ibnu Abazit ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Musa mbajti një ligjëratë para Benu Israilëve dhe u*

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

pyet: *'Kush është njeriu më i ditur?'* Tha: *'Unë jam më i dituri.'* Allahu u hidhërua me përgjigjen e tij, sepse ai nuk ia atribuoi dijen Atij (pra të thoshte: Allahu e di). Atëherë Allahu i shpalli dhe i tha që: ***'Një nga robërit e Mi që gjendet në vendin ku bashkohen dy detet, është më i ditur se ti...'*** (Buhariu & Muslimi)

55- El Axhebu - العجب - **Habitja.**

Është një nga cilësitë "fi'lijeh - haberijeh" e cila është përmendur në Kur'an dhe në hadith të saktë:

"Por në të vërtetë Unë u habita (që më vunë shok dhe e përgënjeshtroan atë që zbrita) **kurse ata tallen me Kur'anin."** Kjo sipas variantit të leximit të foljes "axhibtu" me zanoren [u] - **u habita**, ndërsa sipas variantit të leximit të foljes axhibte me zanoren [e], kuptimi është: **"Por në të vërtetë ti, Muhamed, u habite, kurse ata tallen me Kur'anin."** (Es-Safat: 12)

Ibnu Xheriri ka thënë: "Të dyja këto lloje leximi janë të njohura e të sakta dhe çdonjërin prej tyre e kanë praktikuar dijetarët e 'kiraeteve' (llojeve të leximit të Kur'anit), kështu që cilëndo që të lexosh, e ke qëlluar të vërtetën."

Pastaj ka thënë: "Megjithëse këto dy kuptime janë të ndryshme, çdonjëri prej tyre është i saktë. Muhamedi është habitur me mirësinë që ia ka dhënë Allahu, ndërsa mushrikët u tallën me të. Zoti ynë u habit me fyerjen e madhe që i bënë mushrikët, ndërsa ata u tallën me atë që thanë."

Ebu Hurejre transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *"Vërtet është habitur Allahu i Lartësuar me veprimin e filanit dhe filanes."* ose: *"Vërtet Allahu ka qeshur për shkak të veprimit të filanit dhe filanes."* (Buhariu)

Ndërsa varianti i Muslimit është siç vijon: *"Vërtet Allahu është habitur me mikpritjen që i bëtë mikut tuaj këtë natë."*

Në një hadith tjetër, Ebu Hurejre transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *"Habitet Zoti ynë me disa njerëz të cilët hyjnë në Xhenet me zinxhirë në qafë."* (Buhariu) Bëhet fjalë për njerëzit e zënë rob në luftë nga muslimanët, të cilët pasi u robëruan, me zinxhirë në qafë e pranojnë fenë Islame. (Marrë nga "Fet'hul bari")

56- El Adël - العدل - **Drejtësia.**

Kjo cilësi e Allahut është përmendur në hadith të saktë.

Buhariu dhe Muslimi kanë transmetuar nga Ibnu Mesudi se pasi i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam), u ndau njerëzve një pjesë pasurie, një burrë tha: "Kjo është një ndarje e padrejtë." Atëherë Profeti (salallahu alejhi ue selam) tha: *"Kush do të mbajë drejtësi në qoftë se nuk do ta bëjë këtë Allahu dhe i Dërguari i Tij!?"*

57- El Azmu - العزم - **Vendosmëria.**

Transmetohet nga Ummu Seleme se ajo e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selam) të thotë: “Çdo rob që e godet një fatkeqësi dhe thotë: ‘Vërtet të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehem. O Allah, më shpërble mua në fatkeqësinë time dhe ma zëvendëso atë mua me diçka më të mirë se ajo.’, Allahu do ta shpërblejë për fatkeqësinë që i ka rënë dhe do t’ia zëvendësojë atë me diçka më të mirë se ajo.” Ummu Seleme thotë se: “Kur vdiq Ebu Seleme thashë: ‘Kush është më i mirë se Ebi Seleme, shoku i Profetit?’ Pastaj Allahu vendosi për mua që ta them lutjen e mësipërme dhe unë e thashë. Pasi e bëra këtë, u martova me të Dërguarin e Allahut.” (Muslimi)

Vendosmërinë ia atribuojmë Allahut ashtu siç i përshtatet Madhështisë së Tij dhe nuk themi se si është ajo, pasi atë e di vetëm Allahu.

58-59- **El Atau & El Menu** - العطاء و المنع - **Dhënia & Mosdhënia.**

Dy cilësi “fi’lijeh” të përmendura në Kur’an dhe Sunet:

“**Vërtet Ne të kemi dhënë ‘El Keuther’.**” (El Keuther: 1)

Muauije ibni ebi Sufjan, ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “Atij që Allahu i dëshiron të mirën, e bën që ta kuptojë fenë. Allahu është Ai që jep, ndërsa unë ndaj (ndërmjet jush atë që jep Allahu).” (Buhariu & Muslimi)

Profeti (salallahu alejhi ue selam), në një nga lutjet e tij të njohura, thoshte: “O Allah, nuk ka asnjë që ta pengojë dhënien e asaj që Ti e ke dhënë dhe nuk ka asnjë që ta japë atë që Ti e ke ndaluar të jepet.” (Buhariu & Muslimi)

Allahu i Lartësuar i jep ose jo atij që dëshiron dhe në të dyja rastet është i Drejtë.

60- **El Uluvu & Feukijetu** - العلو و الفوقية - **Lartësia** mbi të gjitha krijesat.

Kjo është një cilësi “dhatijeh”.

Lartësia e Allahut është tri llojesh:

1) Lartësia e Madhështisë.

Kjo nënkupton se Allahu është i Dlirë, i Pastër dhe i Lartë, larg të gjitha të metave.

2) Lartësia e pushtetit dhe fuqisë.

Çdo gjë ndodhet nën Pushtetin e Allahut, Ai është i Papërballueshëm. Asgjë nuk mund ta përballojë Vendimin, Gjykimin e Tij: “**Dhe Ai është i Papërballueshëm, më i Larti përmbi robërit e Tij.**” (En Aam: 18)

Për sa i përket këtyre dy llojeve të lartësisë, nuk ka asnjë kundërshtim midis muslimanëve.

3) Lartësia e Qenies (lartësia fizike).

“Ehli suneh uel xhemaah” besojnë se Allahu me Qenien e Tij, është mbi të gjitha krijesat dhe megjithatë di, dëgjon dhe shikon gjithçka.

Për lartësinë e Allahut tregojnë argumentet e Kur’anit dhe Sunetit, logjika, “el fitrah” dhe “ixhmai”.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Argumente nga Kur'ani:

- Deklarimi që Allahu është mbi krijesat me fjalën “feuk” - mbi:

“I frikësohen dhe i përulen Zotit të tyre lart mbi ta dhe bëjnë çfarë urdhërohen.” (En-Nahl: 50)

“Dhe Ai është i Papërballueshmi, më i Larti mbi robërit e Tij dhe Ai është më i Urti Gjithëgjykues, i Mirënjohuri për çdo gjë.” (El En Am: 18)

- Deklarimi i ngjitjes së disa krijesave tek Allahu:

“Melekët dhe Ruhë (meleku Xhibril) ngjiten tek Ai në një ditë, që zgjat sa për pesëdhjetë mijë vjet.” (El Mearixh: 4)

“Por Allahu e ngriti atë (Isain) lart (me trup dhe me shpirt) pranë Vetes së Tij (dhe Isai - alehi selam - është lart në qiej).” (En-Nisa: 158)

- Deklarimi i ngjitjes tek Ai të punëve të mira:

“...Tek Ai ngjiten të gjitha fjalët e pastra, ndërsa punët e drejta e të mira e lartësojnë atë (fjalën e mirë, d.m.th. fjalët e mira nuk pranohen nga Allahu në qoftë se nuk pasohen nga punë të drejta dhe të mira)...” (Fatir: 10)

- Deklarimi për lartësinë absolute që tregon për të gjitha llojet e lartësisë:

“Dhe Ai është më i Larti, më i Madhërishmi.” (El Bekare: 255)

- Deklarimi i zbritjes së Librit nga Ai:

“Zbritja (Shpallja) e Librit (Kur'anit) është nga Allahu, i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues.” (Ez-Zumer: 1)

- Deklarimi që Allahu është në lartësi, mbi qiej:

“A ndjeheni të sigurtë se Ai që është në lartësi, mbi qiell (Allahu), nuk do ta bëjë tokën të fundoset bashkë me ju dhe veç kur ta shihni të dridhet?” (El Mulk: 16)

Për të treguar që Allahu është në lartësi, mbi qiej, në ajet është përdorur parafjala e gjuhës arabe “fi” së bashku me fjalën “sema”. Parafjala “fi” merr disa kuptime, dy prej të cilave janë “në” dhe “mbi”. Fjala “sema” merr gjithashtu disa kuptime, dy prej të cilave janë “qiell” dhe “lartësi”, sepse rrënja e fjalës “sema” është “semuv” që do të thotë “lartësi”.

Si shembull nga Kur'ani ku parafjala “fi” është përdorur me kuptimin “mbi”, është ajeti: **“Thuaj ecni mbi (fi) tokë...”** (En Am: 11). Kuptimi i këtij ajeti nuk mund të jetë “në brendësi”, por “mbi tokë”.

Ndërsa si shembull për fjalën “sema” të përdorur me kuptimin “lartësi”, kemi fjalën e Allahut: **“...Ai ka zbritur nga lart (es-sema) ujë...”** (Err-Rrad: 17)

Duke marrë parasysh variantet gjuhësore të parafjalës “fi” dhe fjalës “sema” në komentin e ajetit të kaluar, ose do të thuash: “mbi qiej” ose do të thuash “në

lartësi”, dhe të dyja komentet kanë të njëjtin kuptim, sepse “mbi qiej” do të thotë “në lartësi”.

Nuk është e lejueshme të nxirret nga ajeti kuptimi që “Allahu është i kufizuar në qiell” dhe si rrjedhojë të keqinterpretohet për të mohuar lartësinë e Tij mbi krijesat, sepse kjo bie në kundërshtim me sqarimin gramatikor që bëmë më lart. Allahu na ka folur në gjuhën e qartë arabe, por në çdo ajet dhe hadith në të cilin përmendet fjala “fi sema” për të treguar që Allahu është në lartësi, duhet të kemi parasysh këtë sqarim.

- Deklarimi që Allahu është i Lartësuar (i ngritur) mbi Arsh në shtatë ajete të Kur’anit, të cilat i përmendëm në cilësinë **Isteua**.

- Allahu na ka treguar në Kur’an se Faraoni u përpoq të ngjitej në qiell për të vështruar të Adhuruarin e Musait (alejhi salam). Nëpërmjet kësaj, ai synonte të përgënjeshtronte Musain, i cili i kishte thënë atij se Allahu është mbi qiej:

“E Faraoni tha: ‘O Haman! Ndërto për mua një kullë që të mund të arrijë rrugët e qiejve dhe të mund të shoh Zotin e Musës, por unë me të vërtetë e quaj atë gënjeshtar.’” (Gafir: 36-37)

Ai që e mohon lartësinë e Allahut (nga sekti xhehmij) ecën në gjurmët e Faraonit, ndërsa ai që e pohon atë, ecën në gjurmët e Musait dhe Muhamedit (salallahu alejhi ue selam).

- Tekstet që tregojnë se banorët e Xhenetit do ta shohin Zotin e tyre.
(Shih cilësinë e të shikuarit të Allahut nga besimtarët.)

Argumente nga Suneti:

- Muauijje ibnil Hakem es-Sulemi thotë: *“Kam pasur një tufë bagëtish të cilat i ruante një robëresha ime. Një ditë, dola për ta kontrolluar tufën dhe pashë që ujku i kishte grabitur një prej tyre. Unë jam njëri prej bijve të Ademit (d.m.th. kam natyrë njerëzore), prandaj u zemërova dhe e godita rëndë robëreshën. Pastaj erdha tek i Dërguari, i tregova për atë që bëra dhe ai e cilësoi veprimin tim gabim të madh. Unë i thashë: ‘O i Dërguari i Allahut, a ta liroj nga robëria?’ Tha: ‘Ma sill këtu!’ E solla atë dhe atëherë Profeti e pyeti: ‘Ku është Allahu?’ Tha: ‘Mbi qiell (në lartësi).’ I tha: ‘Kush jam unë?’ Tha: ‘Ti je i Dërguari i Allahut.’ Pas kësaj më tha: ‘Liroje, sepse ajo është besimtare.’”* (Muslimi)

Dhehebiu, pas përmendjes së këtij hadithi në librin e tij “El Uluv”, ka thënë: “Ky është hadith i saktë. E ka transmetuar Muslimi, Ebu Daudi, En-Nesai dhe shumë dijetarë të tjerë në librat e tyre. Ata e besojnë siç ka ardhur dhe nuk e keqinterpretojnë atë.”

Kështu, ne kemi vënë re se çdo njeri që pyetet për vendndodhjen e Allahut, përgjigjet menjëherë me natyrën e tij të pastër dhe thotë se Ai është mbi qiell, në lartësi.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Ky hadith tregon për dy gjëra të rëndësishme:

E para, rëndësia e pyetjes: “Ku është Allahu?”

E dyta, përgjigjja: “Mbi qiell (në lartësi)”.

Ai që i mohon këto dy gjëra, i kundërvihet të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selam).

- Hadithi i Xhabirit për Haxhin e Lamtumirës, ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) u tha njerëzve: *“Ju do të pyeteni për mua, çfarë do të thoni?”*

Thanë: *“Dëshmojmë se ti e ke përcjellë mesazhin, e ke kryer misionin tënd dhe ke këshilluar sinqerisht.”* Atëherë filloi ta ngrinte gishtin e tij drejt qiellit, e pastaj ta drejtonte atë nga njerëzit duke thënë: *“O Allah, dëshmo!”*, duke e përsëritur këtë tri herë. (Muslimi)

Fakti që Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka bërë shenjë nga qielli duke thënë: *“O Allah, dëshmo!”*, tregon që Allahu është në lartësi dhe ky ishte besimi i tij, përndryshe, ai nuk kishte pse ta bënte një shenjë të tillë.

- Hadithi i Ebu Hurejres ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Melekët vijnë me radhë tek ju (të ngarkuar me detyrë). Ata vijnë natën e ditën dhe bashkohen në namazin e sabahut dhe në atë të ikindisë. Kur ngjiten ata që ishin me ju tek Ai (Allahu), i pyet (megjithëse e di më mirë se ata): ‘Si i latë robërit e mi?’ Thonë: ‘Shkuam dhe i gjetëm duke u falur, u ngjitëm dhe i lamë duke u falur.’”* (Buhariu & Muslimi)

Në hadith është deklaruar se melekët ngjiten tek Ai.

- Transmetohet nga Abdullah ibn Amër ibnul As-s, se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Mëshiruesit i mëshiron i Gjithëmëshirëshmi. Mëshironi ata që janë mbi tokë, t’ju mëshirojë Ai që është mbi qiell (në lartësi).”* (Trans. Ebu Daudi dhe Tirmidhiu. Albani thotë se ky hadith është i saktë.)

Ky hadith tregon për dy gjëra të rëndësishme:

E para, mbështet sqarimin gjuhësor të parafjalës “fi” që përmendëm më sipër, sepse “fil erdi” nuk do të thotë “në brendësi të tokës” por “mbi tokë” dhe rrjedhimisht, edhe fjala e tij në hadith dhe në shumë argumente të tjera “fis-sema”, do të thotë “mbi qiell” dhe jo “në qiell”.

E dyta, hadithi është argument i qartë për lartësinë e Allahut, sepse Ai që na mëshiron nga lart është vetëm Allahu, kështu që grupet e humbura e kanë të zënë rrugën për keqinterpretimin e këtij hadithi.

- Hadithi i Zejneb binti Xhehsh ku ajo mburret para grave të Profetit (salallahu alejhi ue selam) duke thënë: *“Ju martuan familjet tuaja me Profetin, ndërsa mua më martoi Allahu përmbi shtatë qiejtë.”* Në një transmetim tjetër thuhet se ajo i ka thënë të Dërguarit (salallahu alejhi ue selam): *“Mua më martoi me ty i Gjithëmëshirëshmi që ndodhet mbi Arshin e Tij.”* (Buhariu)

- Hadithi i Ebu Saidit ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“A nuk më besoni mua, kur unë jam i besuari i Atij që është mbi qiej dhe më vjen lajmi nga qielli mëngjes e mbrëmje!?”* (Buhariu & Muslimi)

- Hadithi i Ebu Hurejres ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Betohem për Atë në dorën e të Cilit është shpirti im! Nëse burri e fton gruan e tij në shtrat dhe ajo refuzon, Ai që është mbi qiej do të jetë i pakënaqur me atë grua, derisa burri i saj të kënaqet me të.”* (Muslimi)

- Hadithi i Ebu Hurejres, në të cilin tregon: *“I Dërguari i Allahut ka përmendur melekët që vijnë tek njeriu për t'i marrë shpirtin dhe në qoftë se është besimtar, ngjiten me të deri në qiellin mbi të cilin ndodhet Allahu i Lartësuar...”* (Hadithin e transmeton imam Ahmedi dhe El Hakimi në “El Mustedrek”. Ky i fundit ka thënë se është i saktë sipas kushtit të Buhariut dhe Muslimit. Albani e ka konfirmuar vlerësimin e tij.)

- Hadithet që tregojnë se punët e mira ngrihen tek Allahu, si p.sh. hadithi i Ebu Musës: *“Tek Ai ngrihet puna e natës para ditës dhe puna e ditës para natës.”* (Buhariu & Muslimi)

- Hadithet e shumta që tregojnë për ngjitjen e Profetit (salallahu alejhi ue selam) (Miraxhin), si p.sh. ai i Enesit që është transmetuar në “Sahihun” e Buhariut dhe të Muslimit.

- Hadithet që tregojnë për zbritjen e melekëve nga Allahu dhe për ngjitjen e tyre tek Ai.

- Hadithi i Ebu Hurejres ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Kur Allahu i krijoi krijesat, shkroi në një libër që gjendet tek Ai mbi Arsh: ‘Vërtet mëshira Ime i ka paraprirë zemërimin Tim.’”* (Buhariu e të tjerë)

- Hadithi i Selman el Farasi ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Vërtet Zoti juaj është i turpshëm e fisnik (bujar). Ai turpërohet prej robit të Tij që kur ai i ngre duart drejt Tij për t'iu lutur, t'ia kthejë ato bosh.”* (Trans. Ebu Daudi dhe Albani thotë se është i saktë.)

Ky hadith tregon qartë se duart ngrihen drejt qiellit, sepse Allahu është lart, mbi qiej. Rrjedhimisht, pretendimi i disave se duart ngrihen nga qielli për shkak se ai është kibla (drejtimi) e duasë (lutjes), është i pasaktë.

Ibnu ebil Iz-z el Hanefi thotë: *“Asnjë nga selefët nuk ka thënë që qielli është kibla e duasë dhe nuk ka asnjë argument që tregon për këtë. Kibla e duasë është kibla e namazit. Kush mendon se ka dy kible, një për namaz dhe një për dua, ai ka shpikur në fe dhe ka kundërshtuar Xhematin e muslimanëve.”*

- Hadithi i Imram ibni Husejn ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Allahu është i Lartësuar mbi Arsh, Ai është i Pafillim dhe ekzistenca e Tij i ka paraprirë çdo gjëje. Ai ka shkruar në ‘Leuhul Mahfudh’ çdo gjë që do të ndodhë.”* (Buhariu)

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Të njëjtën gjë tregojnë të gjitha hadithet që bëjnë fjalë për lartësinë e Allahut mbi Arsh.

- Ebu Hurejre transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “Zoti ynë zbret në pjesën e tretë të natës dhe thotë: **‘Unë jam El Meliku (Sunduesi). A ka kush që më kërkon Mua diçka, dhe Unë t’ia jap atë që kërkon? A ka kush që më lutet dhe Unë t’i përgjigjem lutjes së tij? A ka kush që më kërkon falje dhe Unë t’ia fal gjynahet?’** Dhe Ai vazhdon kështu, deri në agim.” (Hadithi është i gradës “muteuatir”).

- Profeti (salallahu alejhi ue selam) na ka urdhëruar që kur të jemi në sexhde të themi: “*Subhane rab-bijel A’ëla (i Lartësuar është Zoti im më i Larti).*” (Ebu Daudi e të tjerë.)¹

“Ixhmai” i selefëve:

Sahabët, tabiinët dhe tabiut-tabiinët, kanë besuar unanimisht se Allahu me Qenien e Tij është në lartësi. Në mënyrë të përmbledhur, inshallah, do të përmendim disa nga thëniet e tyre, të cilat e vërtetojnë “ixhmain” e lartpërmendur.

Thëniet e sahabëve:

- Transmetohet nga Ibnu Umer se kur vdiq i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam), Ebu Bekri tha: “O njerëz! Në qoftë se Muhamedi është ai të cilin e adhuronit, dijeni se ka vdekur. Dhe në qoftë se i Adhuruari juaj është Allahu, i Cili ndodhet në lartësi (mbi qiej), vërtet Ai nuk vdes.” Pastaj lexoi ajetin e Kur’anit: **“Muhamedi nuk është tjetër veçse i dërguar...”** (Ali Imran: 144)

- Transmetohet nga Salim se Ka’bi i tha Umerit: “Mjerë për sovranin e tokës nga Sovrani i qiellit (d.m.th. nga sovrani që është mbi qiej, në lartësi).” Umeri i tha: “Përveç atij që i kërkon llogari vetes së tij.” Atëherë edhe Ka’bi bëri një përjashtim dhe përsëriti: “Përveç atij që i kërkon llogari vetes së tij.” Umeri, pasi e dëgjoi fjalën e Ka’bit tha: “Allahu Ekber!” dhe ra në sexhde. (Ed-Darimi në “Err-rred-du al-el xhehmijeti” dhe ky transmetim është i saktë.)

- Umeri gjithashtu ka thënë: “Mjerë për sunduesit e tokës nga Sunduesi i lartësisë (i Cili u kërkon llogari njerëzve për punët e tyre dhe i shpërblen sipas asaj që kanë punuar), në Ditën (e Gjykitimit) kur do të dalin para Tij, përveç atij që urdhëron për drejtësi, gjykon me të dhe nuk gjykon sipas epshit të tij...” (Ed-Darimi)

- Thënia e Aishes: “Betohem në Allahun! Sikur të kisha dashur ta vrisja Uthmanin, do ta kisha vrarë, por Allahu mbi Arshin e Tij e di që unë nuk kam

¹) Për më gjerë në lidhje me lartësinë e Allahut, shih “El Uluv” të Dhehebiut, sepse ai ka përmendur më shumë se njëqind hadithe që flasin për këtë çështje.

dashur.” (Ed-Darimi në “Err-rred-du alel xhehmijeti” dhe transmetimi është i saktë.)

- Abdullah ibnu Mesudi ka thënë: “Arshi është mbi ujë, Allahu është mbi Arsh dhe Atij nuk mund t’i fshihet asgjë nga punët tuaja.” (Abdullah ibnu Ahmed në “Es-Suneh” dhe Dhehebiu thotë se “isnadi” i tij është i saktë.)

Thëniet e tabiinëve:

- Transmetohet nga Mesruhu se kur ai përcillte ndonjë thënie nga Aishja, thoshte: “Më ka thënë e sinqerta, bija e të sinqertit, e dashura e të dashurit të Allahut, e cila është shfaqësuar nga Allahu që ndodhet mbi shtatë qiej...” (Dhehebiu thotë se “isnadi” i këtij transmetimi është i saktë.)

- Sufjani transmeton se një burrë e pyeti Rebiate ibni Abdirr-Rahmanin: “Mëshiruesi që është i lartësuar mbi Arsh, si qëndron mbi të?” Ai iu përgjigj: “**El Istiua** (lartësimi) nuk është diçka e panjohur (si kuptim, si domethënie). Mënyra (forma se si është) e saj është e panjohur (e pakonceptueshme), besimi në të është vaxhib dhe pyetja (për mënyrën se si ajo është) rreth saj është bidat.” Në një transmetim tjetër ka ardhur se Rrebia ka shtuar: “Mesazhi është i zbritur prej Allahut. Detyra e të Dërguarit ndaj Tij ishte përcjellja tek njerëzit dhe detyra jonë është që ta besojmë.” (Transmetimi është i saktë, siç thotë Albani.)

- Ham-mad ibn Zejd transmeton se e ka dëgjuar Ejub es-Sihtijanin, i cili pasi përmendi mu’tezilët tha: “Këta njerëz vërtiten dhe thonë: ‘Në lartësi nuk ka asgjë.’” (Dhehebiu thotë se “isnadi” i këtij transmetimi është i qartë si dielli. Ejubi është zotni i banorëve të Basras dhe dijetari i tyre.)

- Mukatil ibn Hujan ka transmetuar se Ed-Dahaku, në komentin e fjalës së Allahut: “**Ai është me ju kudo që të jeni...**” (El Hadid: 4), ka thënë: “Ai është mbi Arshin e Tij dhe dija e Tij është me të gjitha krijesat.” (Ibnu Abdil-Berr me “senede” të mira.)

- El Euzai thotë: “Ne, në kohën kur tabiinët ishin të pranishëm dhe të shumtë, thonim se ‘Allahu i lartësuar është mbi Arsh’ dhe i besonim cilësitë e Tij të përmendura në Sunet.”

- Ibnu Abdil-Berr ka thënë: “Dijetarët e sahabëve dhe të tabiinëve, prej të cilëve është transmetuar komentimi i Kur’anit, gjatë komentit e fjalës së Allahut: ‘**Ai është me ta kudo që të ndodhen...**’ (El Muxhadele: 7), kanë thënë: ‘Allahu është mbi Arsh dhe Dija e Tij ka përfshirë çdo vend.’ Në këtë çështje ata nuk i ka kundërshtuar asnjë njeri, thënia e të cilit mund të merret në konsideratë.”

Thëniet e dijetarëve pas daljes së xhehmijve dhe shfaqjes së bidatit të tyre:
“Allahu nuk është në lartësi”.

- Dhehebiu në “El Uluv” thotë se na është përcjellë nga Ebi Muti’i el Hakem ibni Abdil-lah el Behkhi, autori i librit ‘El fikhul ekber’, se ai e ka pyetur Ebu Hanifen

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

për gjykimin ndaj atij që thotë: “Nuk e di nëse Zoti im është në lartësi (mbi qiej) apo në tokë”, dhe ai i ka thënë: “Ai ka bërë kufër, sepse Allahu thotë: **‘Mëshiruesi mbi Arsh është i Lartësuar.’** (Ta Ha: 5). Arshi i Allahut është mbi qiej.” I tha: “Por ai thotë se Allahu është i Lartësuar mbi Arsh, por nuk e di nëse Arshi është mbi qiej apo mbi tokë.” Ebu Hanifja tha: “Në qoftë se e mohon që Arshi është mbi qiej, ka bërë kufër.”

Ebil Muti’i ka qenë një nga nxënësit më të mëdhenj të Ebu Hanifes dhe njëri prej “fukahave” (dijetarëve të Fikhut) të medhhebit hanefi. Ai, edhe pse ka qenë prej dijetarëve të këtij medhhebi, nuk është i fortë në transmetimin e haditheve, sipas analizës së dijetarëve të hadithit, por ky transmetim duhet pranuar prej tij dhe sidomos nga hanefitë, sepse ata i kanë transmetuar mendimet e Ebu Hanifes në përgjithësi.

Megjithëse kjo thënie e Ebu Hanifes është shumë e qartë për sa i përket pohimit të lartësisë së Allahut, disa fanatikë të medhhebit hanefi (në çështjet e Fikhut) e kanë keqinterpretuar atë. Komentuesi i “Akides Tahauije”, Ibni ebil Iz-z el Hanefi, pasi e ka përmendur këtë transmetim ka thënë: “Nuk merret parasysh mohimi i kësaj çështjeje nga disa njerëz që e cilësojnë veten ‘hanefij’, sepse si anëtarë të këtij medhhebi e cilësojnë veten shumë grupe të muëtezilëve etj., të cilët bien ndesh në shumë çështje me besimin e Ebu Hanifes, siç mund ta quajnë veten pasues të Malikut, Shafiut dhe Ahmedit, shumë prej atyre që i kundërshtojnë ata në çështjet e besimit.”

Ngjarja në të cilën Ebu Jusuf i kërkoi Bishër el Merisi të pendohej ose ndryshe do të vritej për shkak se ai e mohonte faktin që Allahu është mbi Arsh, është e njohur. Atë e ka transmetuar Abdurr-Rahman ibnu ebi Hatem e të tjerë.

Albani ka thënë: “Çështja gjyqësore e transmetuar nga Ebu Jusuf është argument i qartë që shokët e Ebu Hanifes ishin me selefët në besimin që Allahu është në lartësi. Kjo i përforcon transmetimet nga Ebu Hanife në lidhje me këtë temë. Imam Ebi Xhaferr et-Tahaui el Hanefi, ka deklaruar në Akiden e tij (e cila është përmbledhje e besimit të Ebu Hanifes dhe shokëve të tij) se: “Allahu nuk ka nevojë për Arshin dhe për asgjë tjetër. Ai e ka përfshirë çdo gjë (me Dijen e Tij) dhe është mbi çdo gjë.”

- El Ezai është pyetur për fjalën e Allahut: **“Pastaj u lartësua mbi Arsh.”** dhe ka thënë: “Ai është mbi Arshin e Tij, siç e ka përshkruar Vetën.”

Gjithashtu, kur është pyetur për hadithet e cilësive ka thënë: “Besojini siç kanë ardhur.”

- Sufjan eth-Theuri ka thënë për hadithet e cilësive: “Të besohen ashtu siç kanë ardhur.”

- Malik ibnu Enes ka thënë: “Allahu është në lartësi (me Qenien e Tij), Dija e Tij është në çdo vend dhe nuk ka asgjë që të mos jetë përfshirë nga kjo dije.”

Një burrë erdhi tek imam Malik dhe i tha: “O Ebu Abdil-lah! I Gjithëmëshirëshmi është i Lartësuar mbi Arsh. Si është ky lartësim?” Transmetuesi thotë se nuk e kishte parë Malikun të nevríkosej ndonjëherë më shumë sesa nga kjo pyetje dhe filloi të dërsitej aq shumë, sa të pranishmit ulën kokat. Pasi u qetësua tha: “Mënyra (se si është ky lartësim) është e panjohur, **Istiua** (të lartësuarit e Tij si kuptim) është e ditur, besimi në të është vaxhib dhe pyetja për mënyrën e saj është bidat. Unë kam frikë mos jesh i humbur.” Pastaj urdhëroi që ta nxirrnin nga mexhlisi i tij dhe kështu u bë. (Dhehebiu thotë se kjo thënie është e saktë.)

- Ebu Theur el Kelebi tregon se e ka dëgjuar Shafiun të thotë: “Maliku, kur e takonin disa njerëz pasues të epsheve të tyre (bidatçinj), u thoshte: ‘Unë jam i qartë dhe i bindur në fenë time, kurse ti dyshon, prandaj shko te ndonjë njeri tjetër që dyshon si ti dhe dialogo me të!’”

- El Uelid ibni Muslim ka thënë: “I kam pyetur Euzanin, Malik ibnu Enesin, Sufjan eth-Theurin dhe El-Lejthin për hadithet në të cilat janë përmendur cilësitë e Allahut dhe të gjithë më kanë thënë: “Besojini siç kanë ardhur, pa u përshkruar formë apo mënyrën se si ato ndodhin.” (Dijetarë që janë përmendur në këtë transmetim, kanë qenë dijetarët më të mëdhenj të tabiut-tabiinëve.)

- Ham-mad ibni Zejd ka thënë: “Ata duan të thonë se në lartësi nuk ka të adhuruar.”

Në lidhje me këtë transmetim, Dhehebiu ka thënë: “Besimi i të Dërguarit, sahabëve dhe i mbarë besimtarëve, është që Allahu ndodhet në lartësi, mbi Arsh dhe Arshi është mbi shtatë qiej, por Allahu i Lartësuar zbret deri në qiellin e Dynjasë. Argumentet e tyre që i vërtetojnë këto cilësi, janë tekstet e Kur’anit, të hadithit dhe gjurmët e të parëve, ndërsa besimi i xhehmijve është që ‘Allahu është në çdo vend’. I Lartësuar dhe i Pastër është Ai, larg nga thënia e tyre. Përkundrazi, Allahu është me ne kudo që të jemi, nëpërmjet Dijes së Tij.”

- Imam Shafiu ka thënë: “Besimi sipas Sunetit në të cilin unë jam dhe në të cilin kam parë ata qw kam njohur si Sufjanin, Malikun e të tjerë, është “Pohimi i dëshmisë që nuk ka të Adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut; që Muhamedi është i Dërguari i Allahut; që Allahu është mbi Arshin e Tij në lartësi (mbi qiej); që Ai afrohet ndaj krijesave të Tij si të dëshirojë; që zbret në qiellin e Dynjasë ashtu si dëshiron...”, dhe ka përmendur të tërë besimin. (Marrë nga “El Uluw” i Dhehebiut)

- Ahmed ibnu Hambel është pyetur: “A është Allahu mbi qiellin e shtatë, mbi Arshin e Tij, i ndarë (i shkëputur) nga krijesat e Tij dhe Dija e Fuqia e Tij janë në çdo vend?” Tha: “Po. Ai është mbi Arshin e Tij dhe me Dijen e Tij ka përfshirë çdo gjë.”

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

- Imam Buhari, në “Sahihun” e tij, në kapitullin e Teuhidit, ka vendosur tema të ndryshme që tregojnë për pohimin e cilësive si Lartësia, Të folurit, dy Duart, dy Sytë etj. nga ato që që i mohojnë xhehmijet dhe pastaj i ka mbështetur me mjaft ajete dhe hadithe. (Për më gjerë shih kapitullin e lartpërmendur.)¹

- Ebul Hasen el Eshari, pasi u pendua dhe hoqi dorë nga Akidja në të cilën sot vazhdojnë të jenë esharinjët (pasuesit e tij), deklaroi në librin “Mekalatul Islamiyne”: “Allahu i Lartësuar është mbi Arshin e Tij, sikurse Ai vetë ka thënë: **‘I Gjithëmëshirëshmi është Lartësuar mbi Arsh.’** Ne e kemi parë se të gjithë muslimanët kur luten, i ngrenë duart nga qielli, sepse Allahu është i Lartësuar mbi Arsh dhe Arshi është mbi qiej. Sikur Allahu të mos ishte mbi Arsh, ata nuk do t’i ngrinin duart e tyre drejt Arshit.”

Është e habitshme që këtë dijetar pretendon se e ndjek një pjesë e muslimanëve të cilët quhen “esharij” dhe e mohojnë shumicën e cilësive të Allahut, ndër të cilat edhe lartësinë.

Këtu duhet të theksohet se imam El Eshari, ka kaluar tri faza në udhëtimin e tij drejt besimit të vërtetë. Në fillim ai ka qenë muëtezil. Pasi e kuptoi humbjen e tyre në besim, kaloi në një fazë tjetër dhe i kundërshtoi ata në shumë çështje, duke u shkaputur pak, por duke mbetur përsëri në linjën e tyre për sa i përket mohimit të shumicës së cilësive dhe shumë prej çështjeve të Akides. Kështu që në raport me “ehli sunetin” ishte më afër muëtezilëve dhe në këtë fazë gjenden esharinjët e sotëm. Pastaj imam Eshariu kaloi krejtësisht në besimin e “ehli sunetit” dhe këtë e sqaroi në librat e tij “El Ibane” dhe “Mekalatul Islamiyne”.

Esharijtë duhet të kthehen nga besimi i tyre për në besimin e “ehli sunetit”, ashtu sikurse veproi imami i tyre. Madje edhe shumë prej dijetarëve të mëdhenj të esharinjve janë kthyer në besimin e “ehli sunetit”, një prej të cilëve është El Kadi ebi Bekër el Bakilami, për të cilin Dhehebiu thotë: “Nuk ka në mënyrë absolute, filozof (mutekelimin) më të mirë se ai.”

El Bekilani në librin “El Ibane” ka thënë: “Në qoftë se do të pyeteshim se ‘a themi që Ai është në çdo vend’, do të thonim: ‘Na ruajtë Allahu nga kjo fjalë! Përkundrazi, Allahu është i Lartësuar mbi Arsh, siç ka lajmëruar në librin e Tij: **‘I Gjithëmëshirëshmi është Lartësuar mbi Arsh.’** Për tek Ai ngjitet fjala e mirë:

¹) Për më gjerë rreth thënieve të dijetarëve, sahabëve, tabiinëve dhe dijetarëve që kanë ecur në gjurmët e tyre, kthehu tek libri “El Uluv” i Dhehebiut.

Ibnul Kajjim ka vërtetuar se të Dërguarit, sahabët, tabiinët, tabiut-tabiinët dhe dijetarët që kanë ecur në gjurmët e tyre, kanë besuar unanimisht që Allau është në lartësi. Ai që e lexon librin e tij “Ixhtimaul xhujush el Islamijetu”, ku ka përmendur thëniet e tyre, bindet që konsensusi në këtë çështje është i padiskutueshëm, madje ai konsiderohet një nga më të madhërishtit e Umetit kundër xhehmijve dhe fraksioneve të tyre.

‘Apo ndjehen të sigurtë se Ai që është mbi qiell...’ (El Mulk: 16). Sikur të ishte në çdo vend, Ai do të ishte në barkun e njeriut, gojën e tij dhe në vendet e neveritshme, si dhe do të shtohet me shtimin e vendeve, kur të krijonte vende që nuk ekzistonin. Do të ishte e saktë atëherë të drejtoheshe gjatë lutjes nga toka, para, prapa, majtas e djathtas. Muslimanët unanimisht janë kundër këtij besimi.”

I Pastër dhe i Lartë është Allahu, larg nga ajo që thonë të padrejtët.

Bakilani gjithashtu ka thënë: “Ne e kemi sqaruar besimin e imamëve të “ehli sunetit” se ‘këto cilësi besohen siç kanë ardhur, pa i përshkruar formë dhe pa i kufizuar’.”

Pas transmetimit të fjalës së Bakilanit, Dhehebiu ka thënë: “Bota është e mbushur me njerëz të cilët nuk e dinë ç’janë selefët. Ata dinë vetëm të mohojnë cilësitë. Janë të shurdhët, memecë e të verbër (mohuesit e cilësive).”

Sa larg janë ata nga besimi i këtij imami! Ku ka njeri ndërmjet tyre që të krahasohet me të në dije, zgjuarsishte dhe në njohjen e feve dhe ideve të ndryshme!?

- Prej atyre që thonë se Allahu ndodhet në lartësi është edhe El Xhuuejni. Ai ka përpiluar një libërth të posaçëm për Lartësinë e Allahut mbi të gjitha krijesat.

- Ibnu ebi Iz-z el Hanefi dhe dijetarë të tjerë, kanë përmendur gjithashtu thëniet e shumë prej filozofëve skolastikë (ehlul kelam), të cilët janë penduar në fundin e jetës së tyre që janë marrë me këtë “shkencë”.

Argumentet logjike:

Arsyeja tregon që Allahu është në lartësi në disa aspekte:

a- Allahu i Lartësuar, kur e krijoi Universin, e bëri këtë në brendësi ose jashtë Vetes së Tij.

Mundësia e parë është e pasaktë dhe e pamundshme për dy arsye:

E para, të gjithë janë dakord që Ai e krijoi Universin jashtë Vetes së Tij.

E dyta, sikur ta kishte krijuar atë në brendësi të Vetes së Tij, kjo do të thotë që Allahu i Lartësuar të jetë vend (objekt) i gjërave të pista e të ulëta. I Lartësuar dhe i Pastër është Allahu, larg nga kjo.

Mundësia e dytë është që Universi është krijuar dhe ekziston jashtë Qenies së Allahut, pra është i shkëputur krejtësisht nga Ai. Padyshim që vetëm kjo është e saktë, sepse besimi që Ai nuk është i bashkuar (i njësuar) me Universin dhe as nuk është i shkëputur (i ndarë) prej tij, nuk mund të pranohet logjikisht.

b- Besimi që Allahu nuk është as në brendësi të Universit (Gjithësisë) dhe as jashtë tij, do të thotë të mohosh krejtësisht ekzistencën e Tij, sepse kjo është e papranueshme logjikisht. Pra, Ai, ose ekziston brenda Universit, ose jashtë tij. E para, siç e thamë, është e pasaktë. Atëherë, detyrimisht logjika tregon për të dytën, që Allahu është i veçuar nga Universi.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Universi është i rumbullakët, sipas shumicës së dijetarëve muslimanë. Ky fakt është transmetuar nga sahabët dhe tabiinët. Madje Ibn Hazmi dhe Ibn Xheuzi kanë thënë se: “Ndërmjet sahabëve, tabiinëve dhe të tjerë dijetarëve muslimanë, nuk ka kundërshtim në këtë çështje. Përderisa është i rumbullakët, në Univers mund të ekzistojnë vetëm dy drejtime: lart dhe poshtë, ku pjesa e sipërme është hapësira përreth Universit, ndërsa pjesa e poshtme është qendra në brendësi të tij. Për sa i përket përdorimit në terminologji dhe praktikë të gjashtë drejtimeve: lart, poshtë, majtas, djathtas, para dhe prapa, ato janë të mundshme vetëm për krijesat.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Është vërtetuar që Universi është i rumbullakët, lartësia absolute është mbi Univers dhe logjika tregon se Allahu është jashtë krijesave. Nga këto fakte, detyrimisht rezulton se Allahu është në lartësi.”

Pastaj ka shtuar: “Arsyeja e kësaj që vërtetuar është se, përderisa Universi është i rumbullakët, ka vetëm dy anë reale: lart dhe poshtë. Allahu i Lartësuar është i ndarë nga krijesat (jashtë tyre). Kjo tregon se Ai nuk mund të jetë poshtë (brenda) tyre, por detyrimisht është në lartësi, i ndarë (i shkëputur) nga ato.”

Në qoftë se do të meditoesh thellë rreth këtij sqarimi, do të dish si ta shmangësh mendimin që nxisin bidatçinjtë kur thonë se, meqë Toka nuk është e rrafshët por e rumbullakët, sipas tyre, ana e sipërme e atyre që gjenden në Veri të rruzullit, është ana e poshtme për ata që gjenden në Jug të tij dhe rrjedhimisht, ngritja e duarve gjatë lutjes lart, drejt qiellit, nuk tregon që Allahu është lart, sepse kjo që për ne është lartësi, në një pikë tjetër të Tokës nuk është e tillë!

Nuk ka dyshim se Toka është e rumbullakët, por ky mendim ka lindur si rezultat i konceptimit të gabuar të anëve në Univers dhe në hapësirën jashtë tij. Sikurse e vërtetuar, çdo pikë që mund të përfytyrosh që nga rruzulli tokësor drejt hapësirës përreth Universit, do të thotë të përfytyrosh nga poshtë lart, dhe çdo pikë që mund të përfytyrosh që nga jashtë Universit, drejt rruzullit tokësor, do të thotë të përfytyrosh nga lart poshtë dhe vetëm ky është konceptimi i saktë i anëve në Univers. Atëherë, në çdo pikë që gjendet njeriu në rruzullin tokësor dhe i ngre duart lart në lutje, ai i drejtohet pjesës së sipërme, pra lartësisë.

Prej gjërave që ndihmon të kuptohet më shumë kjo çështje, është fakti që universi ku gjenden galaktikat, qiejt e lartë, yjet dhe Toka, në Dorën e të Gjithëmëshirëshmit, janë si një farë mustarde në dorën e njeriut, siç ka transmetuar Abdullah ibn Abas.

Në Ditën e Gjykimit, Toka do të jetë e mbështjellë në Dorën e Allahut dhe qiejt do të jenë të mbështjellë (të shtrënguar) në të djathtën e Tij: **“Ata nuk e vlerësuan Madhësitinë e Allahut ashtu siç i takon që të vlerësohet. Në Ditën e Kijametit, e gjithë Toka do të jetë e mbështjellë në Dorën e Tij dhe qiejt do të jenë të**

mbështjellë në të djathtën e Tij. I Lavdëruar dhe i Lartë është Ai mbi gjithçka që ata ia ngjisin si të barabartë.” (Ez-Zumer: 67)

Buhari dhe Muslimi kanë transmetuar nga Ebu Hurejre se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Allahu i Lartësuar e shtrëngon (e kap) Tokën në Ditën e Kijametit, i mbështjell qiejt me të djathtën e Tij e pastaj thotë: ‘Unë jam Gjithësunduesi, ku janë sunduesit e Tokës?’”*

Pra qiejt, Toka dhe çdo gjë që gjendet ndërmjet tyre, në krahasim me madhësinë e Krijuesit të Lartësuar, janë ekstremisht të vogla.¹

Argumentet e kaluara si dhe fjala e Allahut: **“Vërtetë Ai e ka përfshirë çdo gjë.”** (Fusilet: 54), tregojnë se Allahu i ka përfshirë krijesat me Madhërinë, Dijen dhe Fuqinë e Tij. Kjo përfshirje nuk do të thotë që krijesat janë brenda Qenies së Allahut, I Lartë dhe i Pastër është Ai nga kjo gjë. Përfshirja që Allahu u ka bërë krijesave, është përfshirje madhësie, fuqie dhe dijeje, sepse siç e thamë, qiejt dhe Toka, në krahasim me madhësinë e Allahut, janë shumë të vogla (kujto thënien e Ibn Abasit të përmendur më lart).

Argumentet e “el fitrah” (natyrshmëria, frymëzimi instiktiv i krijesave):

Të gjithë njerëzit, sipas natyrshmërisë së tyre dhe zemrave të tyre të pastra, i ngrenë duart lart kur luten. Ata kthehen drejt lartësisë me zemrat e tyre kur i përkushtohen me lutje Allahut.

Muhamed ibni Tahir Emakdisi, ka përmendur se dijetari i nderuar Ebu Xhaferr el Hembedhani, prezantoi në kuvendin e Ebil Maah el Xhuuejnit, i cili njihet me pseudonimin “Imamul haramejn”. Ky i fundit po diskutonte rreth mohimit të cilësisë së lartësisë dhe po thoshte se Allahu ka ekzistuar kur Arshi nuk ekzistonte dhe Ai tani është siç ka qenë para krijimit të Arshit. Atëherë Ebu Xhaferr i tha: “Profesor, ç’mund të na thuash për këtë nevojë që ndjejmë në zemrat tona, duke e ditur se gjithmonë adhuresi i sinqertë, kur thotë: ‘O Allah!’, ndjen në zemrën e tij një domosdoshmëri e cila kërkon lartësinë dhe ai nuk kthehet as majtas dhe as djadhtas? Si mund ta shmangim këtë ndjenjë nga vetet tona?” Xhuuejmi goditi kokën me duart e tij dhe filloi të qante duke thënë: “Më hutoi El Hembedhani! Më hutoi El Hembedhani!”

Pra, kthimi drejt lartësisë me duar dhe me zemër gjatë lutjes, bën pjesë në natyrën sipas së cilës njerëzit janë krijuar.

Disa dyshime që çojnë në mohimin e lartësisë së Allahut dhe kundërpërgjigjja ndaj tyre

¹) Për më gjerë rreth kësaj çështjeje, shih dy librat e Ibn Tejmijes “Diru tearudil akël uen-nakl” dhe “Err-rrisaletul arshij-jetu”.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Shumë njerëz të kohëve të fundit, kur pohon këtë cilësi të Allahut, të quajnë përngjasues të Tij me krijesat, thonë që beson se Allahu është “trup” (muxhes-sim), ose thonë që i atribuon Allahut një vend ose anë të caktuar. Këto akuza që drejtohen ndaj “ehli sunetit”, nuk janë të reja. Që prej shumë kohësh bidatçinjtë e kanë akuzuar “ehli sunetin” me akuza të tilla, derisa Ebi Hatem err-Rrazi ka thënë: “Shenja e bidatçinjve është që ata akuzojnë ndjekësit e gjurmëve të të parëve, si p.sh. xhehmijtë që ‘ehli sunetin’ e emërtojnë ‘mushebihe’ (përngjasues); kaderijet që ‘ehli sunetin’ e emërtojnë ‘muxhbireh’ (që beson se robi është i imponuar në punët e tij) dhe ez-zenadika (munafikët që shtiren si muslimanë për të luftuar Islamin nga brenda ideologjikisht) që e emërtojnë atë ‘hasheuijeh’.”

Dyshimi i parë: Përngjasimi.

Përgjigje - Nuajm ibni Ham-mad ka thënë: “Kush e përngjason Allahun me krijesat, bën kufër. Kush i mohon cilësitë që Allahu ia ka përshtuar Vetes së Tij, bën kufër. Cilësitë që Allahu ia ka atribuar Vetes së Tij apo ia ka atribuar Atij i Dërguari, nuk janë përngjasim.”

Is’hak ibn Rahauj ka thënë: “Përngjasimi konstatohet në qoftë se dikush do të thotë: ‘dorë si dora ime’ ose ‘shikim si shikimi im’. Ndërsa, në qoftë se do të thotë siç ka thënë Allahu: ‘dorë, shikim, dëgjim’ etj., duke mos u përshtuar këtyre cilësive formë dhe duke mos i përngjasuar me cilësitë e krijesave, besimi është i saktë. Allahu ka thënë: **‘Asgjë nuk i përngjason Atij, Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëshikuesi.’**”

Sikur pohimi i lartësisë së Allahut të ishte përngjasim, atëherë kushdo që i pohon cilësitë e tjera: **Jetën, Fuqinë, Dëgjimin, Shikimin** etj., do të ishte përngjasues gjithashtu. (Për më gjerë shiko “Bazat e cilësive të Allahut”).

Ibnu Tejmije në “Minhaxhus-suneh” ka thënë: “Muëtezilët, xhehmijet e të tjerë mohues të cilësive, e konsiderojnë ‘muxhes-sim – mushebih’ (trupëzues - përngjasues) çdonjërin që i pohon cilësitë e Allahut. Ka prej tyre që i konsiderojnë ‘muxhes-sim – mushebih’, dijetarët e shquar: Malikun, Shafiun, Ahmedin dhe nxënësit e tyre, sikurse ka thënë Ebu Hatem: ‘Arsyeja që i bëri të akuzonin dijetarët e shquar, është se të gjithë ata i pohojnë cilësitë e Allahut, thonë që Kur’ani është fjalë e Allahut, i pakrijuar, dhe thonë që Allahu do të shihet në Ahiret.’”

Dyshimi i dytë: Ana.

Përgjigje - Ibnu Tejmije ka thënë në “Tedmuriyeh”: “Kur shprehet fjala ‘xhihetun’ (anë), mund të ketë për qëllim një objekt ekzistent përveç Allahut, d.m.th. mund të bëhet fjalë për diçka të krijuar si p.sh. për Arshin ose për qiejtë,

ose mund të këtë për qëllim inekzistencën përreth krijesave, përveç Allahut të Lartësuar, në qoftë se fjala ‘anë’ ka për qëllim atë që është mbi krijesat.

Dihet që në tekstet e Sheriatit, fjala ‘anë’ as nuk është pohuar dhe as nuk është mohuar, ndërsa ‘lartësia’ është pohuar. Gjithashtu, dihet që nuk ekziston gjë tjetër përveç Krijuesit dhe krijesave. Krijuesi është i ndarë (i shkëputur) nga krijesat. Qënia e Allahut nuk është e unifikuar me qeniet e krijesave, por sikurse e sqaruam, ajo është e ndarë prej tyre. Prandaj, atij që e mohon të qenwut e Allahut në anën e lartësisë, i thuhet se nëse ka për qëllim me fjalën ‘anë’, diçka ekzistente të krijuar, nuk ka dyshim se Allahu nuk është brenda krijesave, dhe nëse ka për qëllim atë që është pas Universit, nuk ka dyshim se Allahu është mbi Univers (mbi të gjitha krijesat).

Po kështu i thuhet edhe atij që thotë se Allahu është në anën e lartësisë. Nëse ka për qëllim që Allahu është mbi krijesat, kjo është e vërtetë, por nëse ka për qëllim që Allahu është në brendësi të krijesave, kjo është e pasaktë (e pavlefshme).’’

Pra, fjala “anë” për sa i përket Allahut, as nuk është pohuar dhe as nuk është mohuar. Prandaj as nuk duhet ta pohojmë dhe as nuk duhet ta mohojmë, sepse në të dyja rastet, ajo mund të nënkuptojë një domethënie ose të saktë ose të pasaktë. Kështu që ne as nuk e pohojmë dhe as nuk e mohojmë atë, por në qoftë se ndonjëri e pohon ose e mohon, qëndrimi ynë ndaj tij, duhet të jetë si në fjalën e mësipërme të Ibn Tejmijes.

Dyshimi i tretë: Vendi.

Në qoftë se është kuptuar përgjigjja e dyshimit të dytë (ana), është më e lehtë të kuptohet përgjigjja ndaj këtij dyshimi.

Përgjigje - Fjala “vend”, mund të nënkuptojë një pozicion të caktuar që ekziston brenda Universit, dhe pikërisht kjo i shkon nëpër mend shumicës së njerëzve sot, të cilët mendojnë se ky është qëllimi ynë, kur pohojmë cilësinë e lartësisë. Por Allahu është larg të qenit në ndonjë vend, sipas këtij kuptimi. Allahun e Lartësuar nuk e përfshijnë dhe nuk e kufizojnë dot krijesat, sepse Ai është më i Madhërishmi, madje “El Kursij” e Tij ka përfshirë qiejt dhe Tokën:

“Ata nuk e vlerësuan Madhërinë e Allahut ashtu siç i takon që të vlerësohet. Në Ditën e Kijametit e gjithë Toka do të jetë e mbështjellë në dorën e Tij dhe qiejt do të jenë të mbështjellë në të djathtën e Tij. I Lavdëruar dhe i Lartë është Ai mbi gjithçka që ata ia ngjisin Atij si të barabartë.” (Ez-Zumer: 67)

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Allahu i Lartësuar e shtrëngon (e kap) Tokën në Ditën e Kijametit, i mbështjell qiejt me të djathtën e Tij dhe pastaj thotë: ‘Unë jam Gjithë sunduesi, ku janë sunduesit e Tokës?’*” (Buhariu & Muslimi)

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Nga ana tjetër, fjala “vend” mund të nënkuptojë një pozicion të caktuar jashtë Universit (pra, mbi të gjitha krijesat), dhe pikërisht kjo është ajo që ne kemi për qëllim kur pohojmë cilësinë e lartësisë. Allahu i Lartësuar është mbi të gjitha krijesat dhe Ai nuk është në ndonjë “vend” brenda Universit, siç e sqaruam pak më parë.

Në qoftë se do të dëgjojmë ose do të shohim të shkruar ndonjë thënie të dijetarëve, në të cilën i atribuojnë vendin e lartësisë Allahut, duhet ta dimë se ata kanë për qëllim kuptimin e dytë (domethënien e dytë) të fjalës “vend”.

Dyshimi i katërt: Ajetet dhe hadithet që tregojnë se Allahu është me krijesat, si p.sh.: “Ai është i Cili krijoi qiejt dhe Tokën në gjashtë ditë, pastaj isteua (u lartësua) mbi Arsh. Ai di çfarë hyn në tokë dhe çfarë del prej saj, edhe çfarë zbret nga qielli dhe çfarë ngjitet në të. Dhe Ai është me ju kudo që të jeni. Allahu është Gjithëvëzhgues për gjithcka që ju punoni.” (El Hadid: 4)

Përgjigjen rreth këtij dyshimi do ta japim më poshtë, gjatë shpjegimit të cilësisë El Majjeh - Të qenët e Allahut me krijesat.

Dyshimi i pestë: Fjala e Allahut të Lartësuar:

“Dhe Ai është Allahu në qiej dhe në Tokë. Ai e di atë që ju e fshihni dhe atë që ju e shprehni, Ai e di çfarë ju fitoni dhe Ai është më i Urti Gjithëgjykses, i Gjithëdituri.” (El En Am)

“Dhe është Ai që është i Vetmi Ilah (i Adhuruar me të drejtë) në qiej dhe i Vetmi Ilah në Tokë.” (Zuhruf: 84)

Duke marrë si argument këto dy ajete, shumë njerëz të devijuar nga e vërteta, thonë se ato tregojnë që Allahu është në qiej dhe në Tokë.

Përgjigje - Kuptimi i ajeteve është: Allahu është Ai që adhurohet në qiej dhe në Tokë (me të drejtë), dhe jo që Allahu me Qenien e Tij është në qiej dhe në Tokë.

Nga gjithë kjo që sqaruam, del në pah humbja e madhe e xhehmijve dhe atyre që u ndikuan nga ideja e tyre, të cilët e mohuan që Allahu të jetë i Lartësuar mbi Arshin e Tij, përmbi krijesat.

Mohuesit e lartësisë së Allahut, u ndanë në dy mendime:

1- Xhehmijtw, të cilët thonë se Allahu është në çdo vend të krijuar.

Në librin “Err-rëdu al-el xhehmijeti”, imam Ahmedi e ka hedhur poshtë mendimin e tyre me argumente të qarta dhe të pakontestueshme. Ai ka thënë: “Nëse dëshiron të kuptosh që xhehmijtë janë gënjeshtarë ndaj Allahut në besimin e tyre se ‘Ai është në çdo vend’, thuaju atyre: ‘A nuk ka ekzistuar Allahu dhe para tij nuk ekzistonte asgjë?’ Do të thonë: ‘Po.’ Atëherë thuaju: ‘Kur i krijoi gjërat, i

krijoi në brendësi të Vetes së Tij apo jashtë Saj?’ Ata do të detyrohen të japin një ndër tri përgjigjet që vijnë:

E para, në qoftë se do të përgjigjen se Allahu i Lartësuar i krijoi krijesat në Vetën e Tij, bëjnë kufër, sepse kanë menduar që xhindët, njerëzit, shejtanët dhe Iblisi, janë në brendësi të Qenies së Tij.

E dyta, në qoftë se do të thonë se i krijoi jashtë Vetes së Tij e pastaj u fut ndër to (u bë një me to), bëjnë kufër gjithashtu, sepse kanë menduar se Ai është futur në çdo vend, qoftë ai edhe i pistë e i ndyrë.

E treta, në qoftë se do të thonë se i krijoi ato jashtë Vetes së Tij e pastaj nuk u fut ndër to, kanë hequr dorë nga besimi i tyre dhe kanë pranuar atë që beson ‘ehli suneti’.”

Mendimi i dytë është mendimi i atyre që kanë kaluar në ekstrem gjatë mohimit të “lartësisë”. Ata kanë thënë se Allahu nuk është as lart, as poshtë, as djathtas, as majtas, as para, as prapa, as brenda krijesave dhe as jashtë tyre. Disa nga filozofët e tyre, shtojnë dhe thonë se Ai nuk është as i njësuar me Botën dhe as i shkëputur prej saj.

Kjo do të thotë që Allahu nuk ekziston dhe ky është mohimi më i madh. I Lartësuar është Allahu, larg nga kjo që thonë zullumqarët. Sa bukur i ka thënë Mahmud ibni Sebektekin¹ atij që e përshkroi Allahun kështu: “Na bëj dallimin ndërmjet këtij Zoti që ti e beson dhe ndërmjet inekzistencës (asaj që nuk ekziston)!”

Njëri prej këtyre dy mohimeve të pasaktë që u përmendën më lart, është i detyrueshëm për çdokënd që e mohon lartësinë e Allahut.

Për shkak të këtyre argumenteve të madhërishtme që tregojnë për lartësinë e Allahut dhe të “ixhmailt” të padiskutueshëm në lidhje me këtë çështje, imami i dijetarëve, Ibnu Huzejme, ka thënë: “Kush nuk pohon që Allahu është i Lartësuar mbi Arshin e Tij, mbi shtatë qiej, dhe që Allahu është i ndarë (i shkëputur) nga krijesat e Tij, ai është kafir.”² Prej tij kërkohet që të pendohet. Nëse e bën këtë, i pranohet pendimi, dhe në qoftë se nuk pendohet, vritet dhe hidhet në një vend me pleh, në mënyrë që të mos dëmtohen me erën e tij të keqe “ehlul kible”

¹) I pari i Damaskut në një kuvend dialogu ndërmjet Ibnu Tejmijes dhe kundërshtarëve të tij.

²) Kur konstatohen nga selefët e Umetit cilësime të tilla drejtuar atyre që pretendojnë qw janw muslimanw, duhet të kemi parasysh që kanë për qëllim cilësimin e thënies ose veprës që është kufër dhe të autorëve të saj në përgjithësi, ndërsa për sa i përket personave të veçantë që pretendojnë se janë muslimanë, nuk nxitohemi në bërjen e tyre kafirë kur bien në një vepër kufri ose thonë fjalën e kufrit, derisa të plotësohen kushtet dhe të eliminohen pengesat e “tekfirit” (cilësimit të një personi “kafir”).

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

(muslimanët) dhe as “hludh-dhim-meh”¹ (rezidentët kafirë që i pari i muslimanëve u ka dhënë besën për të qëndruar nën qeverisjen e tij).”

61- **El Ajnu** - العين - **Syri**.

Është cilësi “dhatijeh-haberijeh” e cila i është përshkruar Allahut përmes argumenteve nga Kur’ani dhe Suneti.

“Ehlus-suneh uel xhemaah” besojnë që Allahu shikon me sy, sikurse besojnë që Allahu ka dy Sy që i përshtaten Madhështisë së Tij: **“Asgjë nuk i përngjason Atij, Ai është Gjithëdëgjues, Gjithëshikues.”**

Argumente nga Kur’ani:

“Dhe ndërtoje anijen para Syve Tanë¹ dhe me Frymëzimin Tonë...” (Hud: 37)

“...Unë hodha prej Meje dashuri për ty në zemrat e njerëzve, që kush të të shikojë, të të dojë, me qëllim që të rritesh nën Syrin Tim.” (Ta Ha: 39)

“Prit me durim për vendimin e Zotit tënd, pasi ti me të vërtet që je nën Sytë Tanë...” (Et-Tur: 48)

“Duke lundruar nën Sytë Tanë, një shpërblim për atë i cili u mohua.” (El Kamer: 14)

Argumente nga Suneti:

Në hadithin e Ibnu Umerit, i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Vërtet ju e dini dhe e njihni Allahun, Ai nuk është me një sy (dhe Profeti bëri shenjë për tek dy sytë e tij). Kurse El mesihud-Dexhal vërtet nuk shikon me syrin e djathtë. Syri i tij është si një kokërr rrushi e dalë (e shfaqur).”* (Buhariu)

Fjala e Profetit (salallahu alejhi ue selam) në hadith: *“Ai nuk është me një sy”*, nënkupton që Allahu ka dy Sy.

Imam Buhari e ka përmendur këtë hadith në kapitullin e Teuhidit, duke pasur për qëllim se ai tregon që Allahu ka dy Sy.

Në shpjegimin e këtij hadithi nga “Sahihu” i Buharit, Abdullah el Gunejman ka thënë se fragmentin: *“Allahu nuk është me një sy”*, ka pasur për qëllim Buhariu në përmendjen e hadithit në atë kapitull. Ai tregon që Allahu ka dy Sy të vërtetë, sepse “el aueru” (në gjuhën arabe) është humbja e njërit prej syve ose e dritës së shikimit.

Ibnu Huzejme ka thënë: “Ne themi që Zoti ynë, Krijuesi ynë, ka dy Sy me të cilët shikon.”

¹) Ai që e zbaton këtë dispozitë penale ndaj këtij personi, është vetëm prijësi i muslimanëve dhe të autorizuarit e tij në gjykatat e Sheriatit.

Kanë mbetur edhe disa çështje të tjera për t'u diskutuar rreth ajeteve të kaluara të Kur'anit dhe hadithit të Ibnu Umerit.

E para, në ajetin e sures "Ta Ha", Allahu ka përmendur në numrin njëjës: "**nën Syrin Tim**". A bie në kundërshtim kjo me atë që sqaruam pak më parë?

Përgjigje - Këtu nuk ka kundërshtim, pasi në gjuhën arabe, shrehja "**nën Syrin Tim**" i përfshin të dy sytë që i atribuohen Allahut, sepse emri i numrit njëjës që i bashkangjitet përemrit, merr kuptim të përgjithshëm.

E dyta, ne e vërtetësojmë që Allahu ka vetëm dy Sy, atëherë si ta bëjmë bashkimin ndërmjet këtij fakti dhe ajeteve në të cilat sytë janë përmendur në numrin shumës?

Përgjigje - Në qoftë se do të marrim mendimin që numri më i vogël i shumësit është "dy", atëherë nuk ka mospajtim, sepse sipas këtij varianti gjuhësor, shumësi tregon për dy, kështu që nuk e kundërshton hadithin që tregon se Allahu ka dy Sy. Ndërsa po të marrim mendimin tjetër që numri më i vogël i shumësit është "tre", atëherë përgjigjja është që me këtë emër të numrit shumës nuk është synuar numri "tre", por është synuar madhërimi dhe përshtatja ndërmjet përemrit "Tonë" në numrin shumës dhe emrit që i është bashkangjitur.

E treta, domethënia e drejtpërdrejtë e fjalës së Allahut: "**nën Sytë Tanë**" është: nën shikimin, mbrojtjen e Syve Tanë, sepse kështu i kanë komentuar selefët këto ajete.

Përgjigje - Fakti që selefët e kanë komentuar kwtw shprehje: "**nën shikimin Tonë**", nuk do të thotë që e kanë ndryshuar kuptimin e drejtpërdrejtë të ajetit, sepse ky është kuptimi që të shkon menjëherë në mendje dhe pikërisht ky është kuptimi i drejtpërdrejtë.

E katërta, në hadithin e Ibni Umerit që tregon se Allahu ka dy Sy, është përmendur se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka bërë shenjë për tek sytë e tij.

Përgjigje - Në lidhje me këtë, Ibnu Haxher ka thënë se është pyetur nëse i lejohet apo jo lexuesit të këtij hadithi që të veproi siç veproi Profeti dhe ai është përgjigjur: "Në qoftë se është në praninë e atyre që bien dakort me besimin e tij, besojnë që cilësitë e Allahut nuk u përngjasojnë krijesave dhe që ai ka për qëllim thjeshtë të marrë për shembull Profetin, lejohet, ndryshe jo. Por më e mira është që gjatë përmendjes së këtyre cilësive të mos bëhet me shenjë, në mënyrë që të mos ngatërrohet ndonjëri dhe ta marrë si argument për përngjasimin e Allahut me krijesat (ndërkohë që Profeti nuk ka pasur këtë qëllim)." (Marrë në "Fethul bari")

62- **El Gadabu** - الغضب - **Zemërimi**.

Është cilësi "fi" lijev – haberijeh": "**Dhe (dëshmia) e pesta duhet të jetë: Zemërimi i Allahut qoftë mbi të (mbi gruan) nëse është ai (bashkëshorti i saj) që flet të vërtetën.**" (En-Nur: 9)

63- **El Galebetu** - الغلبة - **Dominimi, Triumfimi**.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Është cilësi “dhatijeh”: **“Allahu është dominues mbi çështjen e Tij, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”**

64- **El Giretu** - الغيرة - **Xhelozia.**

Cilësi “fi’lijeh” e cila i përshtatet Madhështisë së Allahut. Ajo nuk i përngjason xhelozisë së krijesave dhe ne nuk e dimë se si ajo është: **“Asgjë nuk i përngjason Atij.”**

Argument është hadithi i Ebi Hurejres ku i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Vërtet Allahu bëhet xheloz dhe Xhelozia e Allahut është që besimtari të veprojë atë që Ai e ka ndaluar.”* (Buhariu & Muslimi)

Gjithashtu edhe hadithi i Sad ibni Ubadete i cili ka thënë: “Sikur të vëreja ndonjë burrë me gruan time, do ta godisja me të mprehtën e shpatës.” Këtë që tha Sadi e mori vesh Profeti (salallahu alejhi ue selam) dhe tha: *“A habiteni nga xhelozia e Sadit? Uallahi unë jam më xheloz se ai dhe Allahu është më xheloz se unë, prandaj Allahu nga Xhelozia e Tij i ndaloi veprimet e ulëta e të shëmtuara që kryhen hapur ose fshehur. Asnjë nuk është më xheloz se Allahu, dhe asnjë person nuk e do më shumë arsyetimin sesa Ai. Për këtë arsye Allahu i dërgoi të dërguarit si përgëzues dhe paralajmërues. Asnjë person nuk e do më shumë lavdërimin sesa Allahu, për këtë arsye Allahu u ka premtuar robërve të tij Xhenetin.”*¹ (Buhariu & Muslimi)

65- **El Ferahu** - الفرح - **Gëzimi.**

Cilësi “fi’lijeh” e përmendur në hadithe të sakta. Abdullahi tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin të thotë: *“Allahu gëzohet më shumë me pendimin e robit të Tij besimtar, sesa një burrë në një tokë të shkretë, i cili ka me vete devenë e tij të ngarkuar me ushqim dhe pije. Atë e zë gjumi dhe kur zgjohet sheh që deveja i ka ikur. E kërkon derisa etet shumë për ujë dhe pastaj thotë me vete: ‘Le të kthehem atje ku isha dhe të fle derisa të vdes.’ Kështu që kthehet dhe e vendos kokën mbi parakrahun e tij për të pritur vdekjen. E zë përsëri gjumi dhe kur zgjohet sheh pranë vetes devenë e tij. Allahu pra, gëzohet më shumë me teuben e robit besimtar sesa gëzohet ky njeri që gjeti deven, ushqimin dhe pijen.”* (Buhariu & Muslimi)

66- **El Fatr** - الفطر - **Zanafilla e krijimit, Shpikja.**

Allahu i Lartësuar është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës:

“Gjithë lavdërimet dhe falenderimet janë për Allahun, i Vetmi Fillues (i Vetmi Krijues) i qiejve dhe i Tokës, i Cili i bëri melekët lajmëtarë me fletë nga dy, tri apo katër. Ai shton në krijim çfarë Ai do. Vërtet që Ai është i Zoti për të bërë çdo gjë.” (El Fatir: 1)

67- **Et-Tajju** - الطي - **Mbështjellja, Shtrëngimi.**

¹) D.m.th. duke qenë se Allahu u premtoi robërve Xhenetin, ata do ta lavdërojnë, do ta madhërojnë dhe do të kërkojnë Xhenetin, për të hyrë në të.

Është cilësi “fi’lijeh” e përmendur në Kur’an dhe në hadith të saktë: **“Ata nuk e vlerësuat Madhërinë e Allahut ashtu siç i takon që të vlerësohet. Në Ditën e Kijametit e gjithë Toka do të jetë e mbështjellë në Grushtin, Dorën e Tij dhe qiejt do të jenë të mbështjellë në të djathtën e Tij. I Lavdëruar dhe i Lartë është Ai mbi gjithçka që ata ia ngjisin si të barabartë.”** (Ez-Zumer: 87)

Buhari dhe Muslimi kanë transmetuar nga Ebu Hurejre se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Allahu i Lartësuar e shtrëngon (e kap) Tokën në Ditën e Kijametit, i mbështjell qiejt me të djathtën e Tij dhe pastaj thotë: ‘Unë jam Gjithësunduesi, ku janë sunduesit e Tokës?’”**

68- **El Kafi** - الكافي - Ai që u mjafton robërve të Tij.

“A nuk është Allahu më i mjaftueshmi për robin e Tij?” (Ez-Zumer: 36)

69- **El Kitabetu uel hat-tu** - الكتابة و الخط - **Shkrimi.**

Cilësi “fi’lijeh” që i është atribuar Allahut me argumente nga Kur’ani dhe Suneti. Allahu i Lartësuar shkruan çfarë të dëshirojë dhe kur të dëshirojë, ashtu siç i përshtatet Madhësisë së Tij dhe jo ashtu siç shkruajnë krijesat: **“Ne shkruam për të në pllaka mësimet për çdo gjë dhe shpjegimet për gjithçka.”** (El Araf: 145)

Në këtë ajet bëhet fjalë për Teuratin që Allahu ia shkroi Musait me Dorën e Tij.

Ebu Hurejre ka transmetuar se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Debatuan Ademi dhe Musai tek Zoti i tyre dhe secili paraqiti argumentin e tij. Musai i tha Ademit: ‘O Adem, ti je babai ynë që na nxore nga Xheneti (për shkak të gabimit tënd).’ Ademi i tha: ‘O Musa, ti je ai që Allahu të zgjodhi me mesazhet që të zbriti dhe Teuratin ta shkroi me Dorën e Tij. E si po më kritikon për një gjë që Allahu ma caktoi dyzet vjet para se të më krijonte?’ Kështu Ademi e mundi Musain me argumentet e tij (fjalinë e fundit Profeti e përsëriti tri herë).”** (Buhari & Muslimi)

Gjithashtu, Ebu Hurejre transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Kur Allahu i krijoi krijesat, shkroi në Librin që gjendet mbi Arshin e Tij: ‘Vërtet Mëshira Ime i paraprin Zemërimin Tim.’”** (Buhari & Muslimi)

70- **El Kurhu** - الكره - **Urrejtja.**

Cilësi “fi’lijeh” e përmendur në argumente të sakta: **“Por Allahu e urreu nisen e tyre...”** (Et-Teube: 46)

71- **El Kef-fu** - الكف - **Pëllëmba, Shuplaka e Dorës.**

Cilësi “dhatijeh - haberije” e përmendur në hadithe të sakta.

Ebu Hurejre transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Nëse ndonjëri jep sadaka nga pasuria e tij hallall - dhe Allahu pranon vetëm atë që është hallall - i Gjithëmëshirëshmi e merr me të djathtën e Tij, qoftë ajo edhe një hurmë (arabie). Kjo sadaka rritet e zhvillohet në Dorën e të**

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Gjithëmëshirëshmit derisa të bëhet më e madhe se një mal, ashtu siç rrit ndonjëri prej jush të voglin e devesë së tij.” (Buhari & Muslimi)

Në hadithin e transmetuar nga Ahmedi dhe Tirmidhiu ku thuhet se Profeti (salallahu alejhi ue selam) e ka parë Zotin e tij në ëndërr në formën më të bukur, ndër të tjera Profeti ka thënë: *“Unë e pashë të vendoste Shuplakën e Dorës së Tij ndërmjet dy supeve të mia, derisa ndjeva të ftohtin e majave të Gishtërinjve të Tij në kraharorin tim.”* (Shikoje këtë hadith në cilësinë **El Enamilu**.)

72- El Kefil - الكفيل - Ai që i siguron dhe i ruan robërit e Tij.

Kjo është një nga cilësitë që i atribuohet Allahut me argumente të sakta: **“Dhe tashmë ju keni zgjedhur Allahun dorëzanë, për siguri.”** (En-Nahl: 91)

Disa nga dijetarët e kanë futur **El Kefil** tek emrat e bukur të Allahut.

73- El Kelamu - الكلام - **Të Folurit e Allahut.**

“Ehlu Suneh uel xhemaah” besojnë se Allahu flet në qoftë se dëshiron, kur të dëshirojë dhe si të dëshirojë. Ai flet me fjalë dhe me zë që dëgjohet prej Tij dhe zëri i Tij nuk i përngjason zërave të krijesave.

Të folurit e Allahut, për sa i përket llojit, është i pafillim. Pra, Allahu ka qenë dhe vazhdimisht do të jetë folës. Kurse për sa i përket njësive të të folurit ose zërit në një moment të caktuar (në një bisedë apo thirrje), ai nuk është i pafillim. Ky është besimi i dijetarëve të Sunetit dhe hadithit.

Argumentet që tregojnë besimin e “ehli sunetit” në Të Folurit e Allahut

“Allahu i foli Musait drejtpërdrejt me fjalë.” (En-Nisa: 164)

“Disave Allahu u foli drejtpërdrejt...” (El Bekare: 253)

“Kur erdhi Musai në kohën dhe vendin e përcaktuar prej Nesh dhe atij i foli Zoti i tij, ai tha: ‘Zoti im, m’u shfaq që të shoh Ty hapur.’” (El Araf: 143)

“Kujto kur Allahu do të thotë Ditën e Ringjalljes: ‘O Isa, biri i Merjemes...”” (El Maideh: 116)

Këto ajete tregojnë se Allahu i foli Musait dhe disa të dërguarve drejtpërdrejt dhe në Ditën e Ringjalljes do t’i flasë Isait. Padyshim që E Folura e Allahut drejtuar të dërguarve të Tij është me zë të dëgjueshëm.

“...Dhe kush është më i vërtetë në fjalë se Allahu?” (En-Nisa: 87)

“Thuaj: ‘Sikur deti të ishte bojë (për të shkruar) fjalët e Zotit tim, padyshim që do të shterej para se të mbaronin fjalët e Zotit tim, madje edhe sikur të sillnin edhe një të dytë në ndihmë të tij.’” (El Kehf: 109)

“Kështu, kur ai e arriti atë (zjarrin), u thirr nga ana e djathtë e luginës së bekuar, nga pema: ‘O Musa! Sigurisht që jam Unë, Allahu, Zoti i të gjithë botëve.’”

“Zoti i tyre u thirri (duke u thënë): ‘A nuk jua ndalova atë pemë?’” (El Araf: 22)

“Kujto ditën kur Allahu do t’u thërrasë atyre e do t’u thotë: ‘Çfarë përgjigje u dhatë të dërguarve?’” (El Kasas: 65)

Ebu Said el Hudri transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“(Në Ditën e Gjykimit) Allahu thotë: ‘O Adem!’ Ademi thotë: ‘Të përgjigjem.’ Atëherë Ai i thërret me zë: ‘Vërtet Allahu të urdhëroi ty të nxjerrësh një pjesë prej pasardhësve të tu për në zjarr.’”*

Gjithashtu, në hadithin e Ebu Said el Hudrit, i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Vërtet Allahu i Lartësuar u thotë banorëve të Xhenetit: ‘O banorët e Xhenetit!’ Thonë: ‘Të përgjigjemi o Zot.’ U thotë: ‘A nuk u kënaqët?’...”* (Buhariu & Muslimi)

Argumentet e kaluara tregojnë se Allahu u thërret dhe u flet njerëzve me zë.

Abdullah ibn Abas transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam), gjatë kohës që Xhibrili ishte ulur pranë tij, dëgjoji zërin e një dere që hapej nga lart. E ngriti kokën e tij dhe tha: *“Kjo është një derë nga qielli e cila është hapur sot dhe nuk është hapur ndonjëherë tjetër.”* Prej derës që u hap zbriti një melek dhe Profeti tha: *“Ky është një melek që sot ka zbritur për herë të parë në tokë.”* Meleku që erdhi, dha selam dhe tha: *“Përgëzohu se të janë dhënë dy drita të cilat nuk i janë dhënë ndonjë Pejgamberi tjetër para teje, ‘Fatihatul kitab’ (surja ‘Fatihë’) dhe dy ajetet e fundit të sures ‘Bekare’. Nëse lexon me ndonjë shkronjë prej atyre të dyjave, patjetër do të të jepet ajo që kërkon.”* (Muslimi)

Ky hadith tregon se Allahu flet me anë të gërmave (d.m.th. fjalët që flet Allahu përbëhen nga gërma) sepse Kur’ani është fjalë e Allahut.

“Ehlu suneh uel xhemaah” besojnë se Kur’ani është fjalë e Allahut. Ai është i zbritur e i pakrijuar, tek Allahu e ka zanafillën dhe tek Ai do të kthehet.

Argumentet që vërtetojnë besimin e “ehli sunetit” në lidhje me Kur’anin

Besimi i “ehli sunetit” në Kur’anin e madhërishtëm bazohet në faktet e kaluara të cilat tregojnë se Allahu i Madhëruar flet si dëshiron, kur dëshiron dhe me mënyrën që dëshiron. Kur’ani është i folur nga Allahu, prandaj ai është cilësi e Tij e pakrijuar. Cilësitë e Allahut që janë atribute të Qenies së Tij janë të pakrijuara, kështu që të gjitha argumentet e përmendura më lart në lidhje me Të Folurit e Allahut, tregojnë se Kur’ani është fjalë e Tij.

Në lidhje me Kur’anin, kemi argumente specifike e të qarta që tregojnë se ai është fjalë e Allahut dhe i zbritur nga Ai:

“Dhe nëse ndonjëri prej mushrikëve (politeistëve) kërkon mbrojtjen tënde, atëherë siguroi atij strehim, me qëllim që të dëgjojë fjalën e Allahut (Kur’anin)

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

dhe pastaj përcilleni në një vend të sigurtë, se ata janë njerëz që nuk dinë.”

(Et-Teube: 6)

“Ata duan të ndryshojnë fjalët e Allahut. Thuaju: ‘Ju nuk do të na vini neve nga pas, kështu ka thënë Allahu më parë.’”

Fjalët e Allahut në këto dy ajete janë në Kur’an dhe përderisa Allahu ia ka atribuar ato Vetes së Tij, kjo tregon që Kur’ani është i pakrijuar.

“...muaji i Ramazanit në të cilin u zbrit Kur’ani për njerëzimin.”

“Vërtet që Ne e kemi zbritur atë (Kur’anin) natën e Kadrit.” (El Kadër: 1)

Në këto dy ajete Allahu i Lartësuar ka thënë se Kur’ani është i zbritur nga Ai.

“Padyshim që i Tij është krijimi dhe Komandimi (urdhërimi).” (El Araf: 54)

Në këtë ajet Allahu ka thënë se Atij i përket krijimi dhe urdhërimi. Kjo tregon se krijimi dhe urdhërimi (komandimi) janë dy gjëra të ndryshme. Kur’ani është padyshim pjesë e **El Emër** (Urdhërimit, Komandimit) dhe argument për këtë është ajeti: **“Kështu Ne të kemi shpallur ty udhëzim dhe mëshirë nga ‘emri’ (urdhëri) Jonë. Ti nuk e dije se ç’është Libri (Kur’ani) dhe ç’është Imani (besimi), por Ne e kemi bërë atë dritë me të cilën udhëzojmë atë që duam nga robërit Tanë.”** (Esh-Shura: 52) Përderisa Kur’ani është pjesë e urdhërit të Allahut dhe urdhëri është diçka e ndryshme nga krijimi, kjo detyrimisht tregon se Kur’ani nuk është i krijuar.

Unanimisht, selefët e Umetit e kanë bërë kafir atë që thotë se Kur’ani është i krijuar. Arsyeja që i ka shtyrë ata që të japin këtë gjykim, është se ai që thotë “Kur’ani është i krijuar” patjetër nënkupton njërën prej këtyre tri gjërave: 1) që Allahu e krijoi Kur’anin në Qenien e Tij, 2) që Allahu e krijoi Kur’anin në një trup (qenie) tjetër dhe 3) që Allahu e krijoi Kur’anin të shkëputur nga çdo qenie dhe të pavarur.

Çdonjëra prej tyre është kufër, sepse nëse thuhet e para, Qenia e Allahut konsiderohet si një vend ku ndodhen gjëra të krijuara.

Në qoftë se do të thuhet e dyta, kjo do të thotë që Kur’ani është fjalë e një qenieje tjetër (në të cilën ai u krijua). Pikërisht kjo është thënia e El Uehid ibnil Mugire, të cilën Allahu e ka përmendur në Kur’an: **“Pastaj tha: ‘Kjo është vetëm një magji nga ato të vjetrat. Kjo s’është gjë tjetër veçse fjalë e një njeriu!’”** (El Mudethir: 24-25)

Në qoftë se do të thuhet shprehja e tretë, ajo është mohim i ekzistencës së Kur’anit, sepse nuk mund të përfytyrohen fjali të vetëqëndrueshme, pa pasur një folës (që i flet), sikurse nuk mund të përfytyrohet dëgjimi pa dëgjues, shikimi pa shikues etj.

Pra, këto janë tri gjëra nga të cilat ai që thotë: “Kur’ani është i krijuar”, nuk mund të shmanget.

Disa thënie të Selefëve për atë që thotë se Kur'ani është i krijuar

Ahmed ibni Hambel: “Kush thotë se Kur'ani është i krijuar, ai sipas mendimit tonë është kafir.”

Malik: “Kush thotë se Kur'ani është i krijuar, rrihet rëndë dhe izolohehet derisa të pendohet.”

Sufjan eth-Theuri: “Kush mendon se fjala e Allahut: **‘Thuaj: Ai, Allahu është Një, Allahu është Samed.’** është e krijuar, ai është kafir.

Abdullah ibnul Mubarek: “Kush thotë se Kur'ani është i krijuar, ai është ‘zindik’ (munafik, kafir).”

Sufjan ibnu Ujejnetu: “Kur'ani është fjala e Allahut. Kush thotë se ai është i krijuar, është kafir dhe kush dyshon në kufrin e tij, përsëri është kafir.”

Kundërshtarët e “ehli sunetit” në lidhje me Të Folurit e Allahut

Kundërshtarët e “ehli sunetit” në këtë temë janë të shumtë, derisa mendimet e tyre të kundërta mund të kenë arritur në tetë ose më shumë. Këtu do të përmendim vetëm dy prej tyre:

1- Muëtezilët.

Besimi i tyre është që “Fjalët e Allahut janë të krijuara si të gjitha krijesat e tjera”. Sipas tyre, kur Allahu i foli Musait, i krijoi fjalët në pemë dhe Musai i dëgjoji ato. Ibnu ebi Iz-z el Hanefi, për të hedhur poshtë besimin e tyre, ndër të tjera ka thënë: “Të Folurit është cilësi e përkryer, ndërsa pamundësia për të folur është mangësi. Allahu i Lartësuar, për të hedhur poshtë adhurimin e viçit nga ana e Benu Israilëve, solli në Kur'an si argument mangësitë e viçit, të cilat tregojnë që ai nuk meriton të adhurohet, sepse i adhuruari duhet të jetë i përkryer. Një nga mangësitë që janë përmendur është pamundësia për të folur: **‘A nuk e shihnin se ai as nuk u fliste atyre dhe as nuk i drejtonte në udhë? Ata e morën atë për ta adhuruar dhe vërtet ata qenë të padrejtë.’** (El Araf: 148).

Adhurusit e viçit, megjithëse bënë kufër, e njihnin Allahun më mirë se muëtezilët, sepse ata nuk i thanë Musait: ‘Zoti yt gjithashtu nuk flet!’

Si përfundim, pamundësia për të folur është mangësi, dhe si rrjedhojë, ai që nuk flet nuk meriton të adhurohet. Kështu ka argumentuar Allahu në Kur'an për të hedhur poshtë adhurimin e viçit.

Muëtezilët kanë thënë se Kur'ani është i krijuar sepse ata nuk besojnë që Të Folurit është cilësi e Allahut dhe për të përligjur besimin e tyre, kanë futur disa

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

dyshime të cilave u ka dhënë përgjigje në mënyrë perfekte Ibnu ebi Iz el Hanefi në komentin e “Tahauijes”.

2- Esharinjtë.

Ata besojnë se fjalët e Allahut nuk përbëhen nga shkronjat e nuk kanë zë dhe se Të Folurit e Tij nuk varet nga dëshira, por është një atribut i domosdoshëm i Qenies së Tij, si Jeta apo Dija.

Ata bien në kundërshtim me “ehli sunetin” në disa pika:

E para, kanë thënë se Të Folurit është një atribut pa shkronja dhe pa zë.

E dyta, kanë thënë se Të Folurit është atribut i Qenies së Allahut që nuk varet nga dëshira e Tij, por është i domosdoshëm siç është Jeta apo Dija.

Në lidhje me këtë, “ehli suneti” thotë se “Të Folurit e Allahut varet nga dëshira e Tij, kur dëshiron Ai flet dhe kur nuk dëshiron hesht”.

E treta, kanë thënë se ajo që dëgjohej është e krijuar (si p.sh. zëri që dëgjoji Musai, ai që dëgjoji Muhamedi natën e Miraxhit, ai që dëgjojnë melekët etj.).

Ndërsa “ehli suneti” thotë se “ajo që dëgjohej prej Allahut, është cilësia e Të Folurit”.

Si rrjedhojë e kësaj që sqaruar në lidhje me esharinjtë, ata kanë thënë për Kur’anin: “Ajo që gjendet nëpër Mus’hafe (libra) është fjalë e barazvlefshme me fjalën e Allahut dhe jo vetë fjala e Tij.”

Ibn ebi Iz el Hanefi ka thënë: “Ai që e beson Kur’anin kështu, e ka kundërshtuar atë, ka kundërshtuar Sunetin dhe selefët e Umetit. Sigurisht që kjo humbje është e mjaftueshme për të.”

Disa dijetarë të esharinjve kanë thënë: “E vërteta është se ndërmjet nesh dhe muëtezilëve nuk ka ndryshim (për sa i përket besimit në Kur’an), sepse që të gjithë jemi dakort se fjalët e Allahut që gjenden midis nesh janë të krijuara. Por muëtezilët thonë se ato që janë të krijuara janë fjalët e Allahut, kurse ne themi që ato janë fjalë të barazvlefshme me fjalët e Tij.”

Shkaku që i çoi muëtezilët në këtë humbje, është fakti që ata i besojnë emrat e Allahut, por nuk i besojnë (i mohojnë) cilësitë e Tij. Ndërsa esharinjtë i çoi në këtë humbje, mohimi i veprave të Allahut që varen nga Dëshira dhe Vullneti i Tij.

74- El Kenefu - الكنف - Mbulimi i robit besimtar në Ditën e Gjykimit, kur Allahu e bën t’i pranojë gjynahet që ka bërë në Dynja, në mënyrë që të mos shfaqen ato dhe të mos poshtërohet.

Kjo cilësi e Allahut të Lartësuar ka ardhur në një hadith të saktë të transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi, në të cilin një burrë e ka pyetur Ibnu Umerin se çfarë ka dëgjuar të thotë i Dërguari i Allahut në ndonjë bisedë të fshehtë. Ai u përgjigj se i Dërguari ka thënë: “Çdonjëri prej jush (prej besimtarëve) do të afrohet te Zoti i tij,

derisa Ai ta mbulojë që të mos e shikojnë krijesat (me qëllim që të mos demaskohet dhe të poshtërohet përpara tyre me gjynahet e tij) dhe Allahu do t'i thotë: **'Ke punuar kështu dhe kështu?'** Thotë: 'Po.' I thotë: **'Ke punuar kështu dhe kështu?'** Thotë: 'Po.' Dhe Allahu e bën që t'i pohojë gjynahet e tij, pastaj i thotë: **'T'i kam mbuluar në Dynja (nuk të kam demaskuar) dhe Unë sot do të t'i fal ty ato.'**"

75- **El kejdu li a'daihi** - الكيد لأعدائه - Thurja e planeve kundër armiqve të Tij, të cilët thurin plane kundër fesë së Tij dhe besimtarëve.

Kjo cilësi i atribuohet Allahut në mënyrë të kufizuar, vetëm në rastin e shkatërrimit të kurtheve që thurin armiq të Tij kundër Islamit dhe muslimanëve: **"Vërtet ata po thurin plane kundër teje. (Por gjithashtu) Edhe Unë po bëj plane."** (Et-Tarik: 15-16)

76- **El-La'nu** - اللعن - **Mallkimi.**

Kjo është një cilësi "fi'lijeh" që varet nga dëshira e Allahut të Lartësuar: **"Mallkimi i Allahut është mbi zullumqarët."**

77- **El Musteanu** - المستعان - Ai që i kërkon ndihmë robërit dhe i ndihmon.

"Kështu që për Mua durimi shkon më mirë dhe vetëm ndihma e Allahut kërkohet kundër kësaj (prove të vështirë) që po pohoni." (Jusuf: 18)

78- **El Mes'hu** - المسح - **Prekja.**

Në një hadith të saktë, Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë se Allahu i Lartësuar e ka prekur (e ka kaluar Dorën e Tij mbi) shpinën e Ademit dhe prej saj kanë rënë të gjitha qeniet me shpirt të pasardhësve të tij.

Ebu Hurejre ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **"Kur e krijoi Allahu Ademin, e preku (e kaloi Dorën e Tij mbi) shpinën e tij dhe ra prej saj çdo qenie me shpirt që Allahu do ta krijojë deri në Ditën e Kijametit..."** (Trans. Tirmidhiu, shih "Sahihu Sunen Et-Tirmidhi".)

79- **El Maijetu** - المعية - Të qenët (shoqërimi) e Allahut me krijesat dhe kjo nënkupton: Dijen, Fuqinë, Dëgjimin, Shikimin, Pushtetin dhe rregullimin e çështjeve, kur **El Maijetu** është e përgjithshme dhe nuk favorizohet përmes saj një person ose një grup i caktuar (që kanë një cilësi të veçantë). Ndërsa në qoftë se favorizohet përmes saj një person ose një grup i caktuar, atëherë ajo nënkupton, plus asaj që përmendëm, edhe: Përkrahjen, Mbarësinë dhe Suksesin.

Në lidhje me këtë cilësi të Allahut, duhet të kemi parasysh këto gjëra:

E para, të qenët e Allahut me krijesat e Tij është vërtetuar me argumente nga Kur'ani, Suneti dhe "ixhmai" i selefëve.

Argumente nga Kur'ani:

"Ai është me ju kudo që jeni." (El Hadid: 4)

"Sigurisht që Allahu është me ata që i frikësohen Atij dhe që janë mirëpunues." (En-Nahl: 128)

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Argumente nga Suneti:

Ibnu Umeri transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue salam) ka thënë: *“Kur secili prej jush të çohet për t’u falur, të mos pështyjë përpara, sepse Allahu është përballë (drejt) fytyrës së tij, dhe as nga e djathta, por nga e majta ose poshtë, drejt këmbëve të tij.”* (Buhariu & Muslimi)

Nga hadithi del që Allahu është përpara fytyrës së namazfalësit. Por duhet të dimë se ai që e ka thënë këtë, gjithashtu ka thënë se Allahu është në lartësi, mbi qiej. Për këtë arsye, dy ajetet e kaluara, ky hadith si dhe dy hadithet që vijojnë, duhet të kuptohen sipas sqarimit që do të bëhet në lidhje me cilësinë **El Maijetu**. Për ta sqaruar më mirë këtë, po shtojmë këtu se dijetarët e kanë bërë pajtimin ndërmjet hadithit që thotë se Allahu është përpara fytyrës së namazfalësit dhe haditheve që thonë se Allahu është në lartësi, në tri pika:

E para, argumentet e Sheriatit i kanë bashkuar këto të dyja dhe ato nuk mund të bashkojnë asnjëherë dy gjëra që janë në kundërtënie.

E dyta, mundet që një gjë të jetë e lartë dhe ajo është përpara fytyrës tënde si p.sh. Dielli, megjithëse ai është lart në qiell. Përderisa kjo është e mundur në lidhje me krijesën, bëhet edhe më shumë e arsyeshme për sa i përket Krijuesit.

E treta, edhe nëse supozohet që kjo është e pamundshme (e paarsyeshme) në lidhje me krijesën, ajo nuk është e pamundshme për sa i takon Krijuesit, sepse Allahut të Lartësuar nuk i përngjan asgjë në të gjitha cilësitë e Tij.

Transmetohet nga Ebu Musa el Eshari se gjatë një udhëtimi me të Dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue salam), njerëzit filluan t’i ngrini zërat duke bërë tekbiere (duke thënë: Allahu Ekber). Profeti (salallahu alejhi ue salam) u tha: *“O njerëz! Më butë ndaj veteve tuaja (mos u mundoni duke ngritur zërin) sepse ju nuk po lutni ndonjë shurdh dhe as ndonjë që nuk është i pranishëm, ju po lutni Atë që është Gjithëdëgjues, Gjithëshikues. Vërtet Ai që po lutni është më afër çdonjërit prej jush, sesa qafa e kafshës së tij.”* (Buhariu & Muslimi)

Në mënyrë unanime, të gjithë selefët e kanë pohuar Maijetull-llah (të qenët e Allahut me krijesat e Tij).

Ky shoqërim i krijesave nga ana e Allahut (**Maijeh**), nënkupton përfshirjen e tyre me Dijen, Fuqinë, Dëgjimin, Shikimin, Pushtetin dhe rregullimin e çështjeve, përderisa është i përgjithshëm.¹ Si shembull për këtë kemi fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Ai është me ju kudo që të jeni.”**

Ndërsa, në qoftë se favorizohet nëpërmjet **El Maijeh**, një person ose një grup i veçantë që e karakterizon një cilësi apo një punë e caktuar, atëherë ajo nënkupton, përveç asaj që përmendëm, edhe Ndihmën, Përkrahjen, Mbarësinë dhe Suksesin.

Si shembull për **El Maijeh** që favorizon një person të caktuar, kemi fjalën e Allahut drejtuar Musait dhe Harunit: **“Padyshim që Unë jam me ju të dy duke dëgjuar e shikuar çdo gjë.”** (Ta Ha: 46), si dhe fjalën e Allahut për Profetin tonë (salallahu alejhi ue selam): **“Ai i tha shokut të tij: ‘Mos u mërzit, sigurisht që Allahu është me ne.’”** (Teube: 40)

Si shembull për **El Maijeh** që favorizon një grup njerëzish të veçantë me një cilësi të caktuar, është fjala e Allahut: **“Duron sepse Allahu është me durimtarët.”** (Enfal: 46)

Nga kjo që u tha deri këtu, u bë e qartë se ka dy lloje të **El Maijeh**:

Të veçantë - **El Maijetu has-sah** & të përgjithshme - **El Maijetul am-meh.**

Ibnu Rexhebi ka thënë: **“El Maijeh** e veçantë nënkupton: Ndihmën, Përforcimin dhe Ruajtjen, ndërsa **El Maijeh** e përgjithshme nënkupton Dijen, Shikimin dhe mbikqyrjen e punëve të robërve.”

El Maijeh nuk nënkupton që Allahu është i përzierë dhe i bashkuar (i unifikuar) me krijesat, ose i shkrirë (i shpërbërë) në vendet e tyre, siç besojnë panteistët, dhe kjo për arsyet që vijnë:

E para, sepse argumentet e Kur’anit, Sunetit, “ixhmait”, logjikës dhe “el fitrah”, tregojnë se Allahu është në lartësi. Si rrjedhojë, interpretimi i **El Maijeh** në kundërshtim me këto argumente, është i pasaktë.

E dyta, asnjë nga selefët e Umetit nuk e ka interpretuar këtë cilësi në këtë mënyrë, madje të gjithë ata e kanë mohuar përzierjen e Allahut me krijesat, bashkimin ose shkrirjen e Tij me to.

Ibnu Kethiri, në komentin e ajetit: **“Ai është me ta kudo që të ndodhen.”** (Muxhadele: 7), ka thënë: “Shumë dijetarë kanë vërtetuar ‘ixhmain’ e Umetit se kuptimi i **El Maijeh**, është të qenët e Allahut me krijesat nëpërmjet Dijes së Tij.”

Më poshtë do të përmendim disa nga thëniet e dijetarëve që vërtetojnë “ixhmain” e lartpërmendur:

Imam Ahmedi ka thënë: “Nëse ndonjë bidatçi do të marrë si argument për mohimin e lartësisë së Allahut, fjalën e Tij: **‘Ai është me ju kudo që të jeni’, ‘Ai është me ta kudo që të ndodhen’,** e të tjera prej ajeteve jo krejtësisht të qarta të Kur’anit, thuaji se Allahu ka për qëllim shoqërimin me anë të Dijes së Tij, pasi Ai është mbi Arsh, mbi qiellin e shtatë dhe di çdo gjë. Ai është i ndarë (jashtë) nga krijesat e Tij dhe me Dijen e Tij ka përfshirë çdo vend.”

Mukatil ibni Hajan, në komentin e fjalës së Allahut në suren Muxhadele: **“Ai është me ta kudo që të ndodhen.”**, ka thënë: “Ai është mbi Arshin e Tij dhe Dija e Tij është me ta.”

Sufjan ibni Ujejne është pyetur për fjalën e Allahut: **“Ai është me ju kudo që të jeni.”** dhe ka thënë se bëhet fjalë për Dijen e Tij.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Malik ibni Enes ka thënë: “Allahu është në lartësi (mbi Arsh) dhe Dija e Tij është në çdo vend (d.m.th. Dija e Tij ka përfshirë çdo gjë).”

Ibnu Abdil-Berr ka thënë: “Të gjithë dijetarët e sahabëve dhe të tabiinëve prej të cilëve është marrë komenti i ajeteve të Kur’anit, në komentin e fjalës së Allahut: **‘Ai është me ta kudo që të ndodhen’** (Muxhadele: 7), kanë thënë se Ai është mbi Arsh dhe Dija e Tij është në çdo vend. Në këtë çështje ata nuk i ka kundërshtuar asnjëri, të cilit mund t’i merret në konsideratë fjala e tij.”

E treta, ai që e njeh Allahun, e vlerëson Madhësitinë e Tij dhe e njeh kuptimin e **El Maijeh** në gjuhën arabe në të cilën ka zbritur Kur’ani, nuk mund të thotë se ajo nënkupton që Allahu është i përzierë me krijesat ose i shkrirë në to.

E katërta, **El Maijeh** nuk bie në kundërshtim me lartësinë e Allahut mbi krijesat e Tij dhe kjo për arsyt që vijnë:

a) Allahu i Lartësuar ia ka atribuar të dyja këto cilësi Vetes së Tij në Kur’an dhe Libri i Tij nuk ka kundërthënie. Sikur lartësia mbi krijesat dhe **El Maijeh** të ishin kontradiktore, Allahu nuk do t’i përmendte ato në Librin e Tij.

b) Përputhja e konceptit të të qenit në lartësi dhe atij të **El Maijeh**, është një gjë e mundshme dhe e arsyeshme për sa i përket krijesës. Udhëtarët p.sh., në netët e ndritshme me hënë mund të thonë: “Ne ecnim dhe Hëna ishte me ne.”, kur dihet që udhëtarët janë në Tokë dhe Hëna është lart në qiell. Përderisa kjo është e mundshme në lidhje me krijesën, si mos të jetë e mundshme dhe e arsyeshme në lidhje me Krijuesin?

Muhamed Halil el Herras ka thënë: “Përderisa kjo është e lejueshme në lidhje me Hënë, që është një nga krijesat më të vogla të Allahut, si të mos jetë e arsyeshme në lidhje me Atë që i ka përfshirë robërit me Dijen dhe Fuqinë e Tij?”

c) Bashkimi ndërmjet lartësisë dhe **El Maijeh**, edhe sikur të supozohej se është i pamundshëm për sa i përket krijesave, nuk është e detyrueshme të jetë i tillë edhe për sa i përket Krijuesit, sepse Atij nuk i përngjan asgjë.

d) Fakti që selefët e Umetit kanë thënë se **El Maijeh** nënkupton përfshirjen e krijesave me anë të Dijes, Shikimit, Dëgjimit etj., nuk do të thotë se ata e kanë ndryshuar domethënien e drejtpërdrejtë të argumenteve të saj, sepse pikërisht ajo që ata kanë thënë në lidhje me **El Maijeh**, është kuptimi i saj i drejtpërdrejtë. Pra, fjalët e selefëve janë thjesht komenti i kuptimit të saj të drejtpërdrejtë.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës ‘me’ (me) kur përdoret në gjuhën arabe, nuk është gjë tjetër vetëm se ‘shoqëri e pakufizuar’. Ajo nuk tregon detyrimisht për prekje apo ecje të njëtrajtshme nga e djathta ose e majta, sepse thuhet: ‘Ne ecnim dhe Hëna ishte me ne’ ose ‘dhe ylli ishte me ne’.”

e) Në lidhje me **El Maijetull-llah**, njerëzit janë ndarë në tri grupe:

- Grupi i parë thotë se të qenët e Allahut me krijesat, nënkupton shoqërimin me Dijen e Tij gjithëpërfshirëse kur bëhet fjalë për **El Maijeh** të përgjithshme, dhe Ndihmën, Përkrahjen dhe Suksesin kur bëhet fjalë për **El Maijeh** të veçantë, ndërsa me Qenien e Tij, Allahu është në lartësi.

Ky është besimi i selefëve dhe padyshim që kjo është e vërteta.

- Grupi i dytë thotë se të qenët e Allahut me krijesat, do të thotë që Ai është me to në Tokë, dhe për rrjedhojë e mohon lartësinë e Allahut mbi krijesat.

Në këtë grup bëjnë pjesë panteistët (el hululijeh). Besimi i tyre është i pasaktë dhe të parët tanë e kanë hedhur poshtë unanimisht, e kanë refuzuar dhe e kanë konsideruar kufër që të nxjerr nga feja.

- Grupi i tretë thotë se të qenët e Allahut me krijesat e Tij, do të thotë që të jetë me ta në Tokë, edhe pse është i Lartësuar mbi Arsh. Mendimin e këtij grupi e ka përmendur Ibn Tejmije në “Mexhmuul fetaua” dhe kufri i këtij grupi nuk është më pak i vogël dhe i rrezikshëm se kufri i grupit të dytë.

Ata që bëjnë pjesë në këtë grup, mendojnë se i përmbahen kuptimeve të drejtpërdrejta të **El Maijeh** dhe lartësisë së Allahut, por në të vërtetë janë gënjeshtarë dhe të humbur, sepse tekstet e **El Maijeh** nuk tregojnë për panteizmin e pretenduar prej tyre, për arsye se ai është i pavërtetë, dhe nuk mund të jetë i pavërtetë kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës së Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue salam).

80- **El Maktu** - المقت - **Mospëlqimi**.

Është cilësi “fi’lijeh - haberijeh”: “**Atyre që mohuan do t’u thuhet:**

‘**Mospëlqimi i Allahut është më i madh ndaj jush** (në Dynja ku ju vazhdimisht e mohonit besimin), **sesa neveria ndaj njëri-tjetrit** (tani, në zjarrin e Xhehenemit, pasi tani jeni armiq të njëri-tjetrit).” (Gafir: 10)

81- **El mekru ala men jemkuru bihi** - المکر علی من یمکر به - Thurja e planeve dhe kompleteve për ndëshkimin dhe shkatërrimin e atyre që thurin komplete ndaj fesë së Tij dhe muslimanëve:

“**Megjithëse kundërshtojnë dhe hedhin dyshime për Allahun, Ai është shumë i fuqishëm për të vendosur plane.**” (Err-Rrad: 13)

82- **En-Nuzul** - النزول - **Zbritja në qiellin e Dynjasë**.

Cilësi “fi’lijeh” që i atribuohet Allahut në hadithe të sakta të cilat arrijnë gradën “muteuatir”.

Ebu Hurejre transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue salam) ka thënë: “Zoti ynë i Lartësuar zbret çdo natë në qiellin e Dynjasë në një të tretën e fundit të natës dhe thotë: ‘**Kush më lutet Mua që t’i përgjigjem? Kush më kërkon Mua që t’i jap? Kush më kërkon falje Mua që ta fal?**’” (Buhariu & Muslimi)

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Në lidhje me këtë hadith të madhërishëm dhe këtë cilësi që ai përmban, do të përmendim disa sqarime të rëndësishme të Ibn Tejmijes në “Sherhu hadithin-nuzul”.

1) Dijetarët e Umetit e kanë pranuar unanimisht këtë hadith dhe e besojnë atë.

2) Kjo cilësi i atribuohet Allahut, ashtu sikurse i atribohet cilësitë e tjera që Ai ia atribuon Vetes së Tij si: Lartësimi mbi Arsh, Ardhja në Ditën e Gjykimit etj..

3) Pyetja “Si zbret?” është si pyetja: “Si lartësohet mbi Arsh?”, “Si dëgjon?”, “Si shikon?” etj.. Këtyre pyetjeve u përgjigjemi me thënien e imam Malikut në lidhje me **Isteua** (lartësimin mbi Arsh).

Thëniet e dijetarëve përputhen me thënien e Malikut, pra që ne nuk e dimë se si është i Lartësuar Allahu mbi Arsh dhe si zbret Ai, ashtu siç nuk e dimë se si është Qenia e Tij.

4) Zbritja e Allahut në qiellin e Dynjasë, nuk bie në kundërshtim me lartësinë e Tij të përhershme mbi krijesat. Lartësia e Allahut është cilësi “dhatijeh”. Ai zbret, edhe pse është lart, mbi krijesat. Zbritja e Allahut nuk nënkupton që Ai të ndodhet në qiellin e Dynjasë dhe mbi Të të jenë qiejt e tjerë, sepse Allahun nuk e kufizon dhe nuk e përfshin asnjë prej krijesave. Kufizimet e tilla lindin si pasojë e përfytyrimit të zbritjes së krijesave, ndërsa zbritja e Allahut është e ndryshme nga ajo e krijesave. Kështu, të njëjtin sqarim që bëmë për lartësinë e Allahut, e bëjmë edhe për Lartësimin e Tij mbi Arsh. Allahu i Lartësuar zbret në qiellin e Dynjasë, edhe pse është i Lartësuar mbi Arsh, sepse argumentet që tregojnë se Allahu zbret, janë po aq të qarta, sa edhe argumentet që tregojnë se Allahu është i Lartësuar mbi Arsh. Kështu që ne besojmë se Ai është i Lartësuar mbi Arsh dhe njëkohësisht zbret edhe në qiellin e Dynjasë, sepse cilësitë e Allahut nuk krahasohen me ato të krijesave.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Fakti që Allahu ka lajmëruar se zbret në qiellin e Dynjasë, nuk do të thotë se Ai zbret si krijesat që ne shohim, në mënyrë që të thuhet se kjo detyrimisht tregon se gjatë zbritjes lihet një pozicion i caktuar dhe zihet një tjetër.”

5) Disa njerëz, për të mohuar këtë cilësi, thonë se dihet që Toka është e rumbullakët dhe një e treta e fundit e natës, vjen në një vend të caktuar dhe jo në të gjithë rruzullin. Madje, një e treta e fundit e natës është e vazhdueshme në Tokë, pasi gjithmonë një pjesë e saj është në errësirrë. Atëherë, nëse do të pohonim se Allahu zbret në qiellin e Dynjasë, kjo do të thotë që zbritja e Tij është e vazhdueshme gjatë gjithë kohës për t’iu përgjigjur lutjeve të njerëzve që ndodhen në vende të ndryshme të Tokës, sepse një e treta e fundit e natës për ta, është e ndryshme.

Përgjigje - Cilësitë e Allahut nuk krahasohen me ato të krijesave. Allahu i Lartësuar zbret në qiellin e Dynjasë, edhe pse është i Lartësuar mbi Arsh. Kur vjen një e treta e fundit e natës në një vend të caktuar, për njerëzit që banojnë në atë vend, Allahu ka zbritur në qiellin e Dynjasë dhe u përgjigjet lutjeve të tyre. Përderisa ne besojmë se Ai zbret, edhe pse është i Lartësuar mbi Arsh, e njëjta gjë ndodh edhe me zbritjen e Tij më herët, më vonë, më shkurt ose më gjatë, sipas një të tretës së fundit të natës në Tokë, nëse do të marrim për bazë faktin se zbritja e Allahut nuk krahasohet me atë të krijesave.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Zbritja, e cila ndryshon nga ajo e trupave të robërve, mund të bëhet në të njëjtën kohë për shumë krijesa dhe të zgjasë për disa njerëz më shumë se për disa të tjerë. Madje, nuk është e pamundur që Allahu t’u afrohet disa krijesave dhe jo të tjerave, pra, t’i afrohet atij që i lutet dhe të mos i afrohet atij që nuk i lutet. E njëjta gjë ndodh edhe me afrimin e Allahut në pasditen e Arafatit në qiellin e Dynjasë për shkak të haxhinjve. Megjithëse mund të jetë ditë në disa vende dhe natë në disa të tjera, Ai nuk afrohet ndaj vendeve të tjera, por afrohet në qiellin e Dynjasë që përkon me haxhinjtë (Arafatin). Po kështu është edhe zbritja e Tij në një të tretën e fundit të natës.”

Një nga gjërat që na ndihmojnë ta kuptojmë më mirë sqarimin që bëmë, është çështja e Ditës së Gjykimit, kur Allahu i merr në llogari robërit e Tij në të njëjtën orë. Me secilin veçohet dhe e bën që të pranojë gjynahet që ka bërë në Dynja dhe ai që merret në llogari mendon se nuk po i kërkohet llogari ndonjë tjetri, por në fakt nuk është kështu.

Një herë, një burrë i tha Ibnu Abasit: “Si u kërkon llogari Allahu robërve në të njëjtën orë?” Ai u përgjigj: “Ashtu siç i furnizon (u jep rrizkun) në të njëjtën orë.”

Gjithashtu, duhet të dimë që Allahu i përgjigjet çdokujt që falet kur ai lexon suren “Fatiha”. Muslimi ka transmetuar nga Ebu Hurejre dhe ky nga i Dërguari (salallahu alejhi ue selam) se Allahu thotë: **“E kam ndarë namazin ndërmjet Meje dhe robit Tim në dy pjesë. Gjysma më takon Mua, gjysma i takon robit Tim dhe atij do t’i jepet ajo që kërkon.”** Më tej Profeti (salallahu alejhi ue selam) vazhdoi: “Kur rob i thotë: *‘Elhamdu lil-lahi rabil alemin’*, Allahu thotë: **‘Më lavdëroi rob i Im...’**”

Atij që falet, Allahu i përgjigjet sa herë që lexon suren “Fatiha”. Në atë kohë falen aq shumë njerëz, saqë askush nuk e di numrin e tyre përveç Allahut dhe Ai i përgjigjet çdonjërit prej tyre.

Ata që nuk e vlerësojnë Madhësitinë e Allahut, i imagjinojnë cilësitë që i Dërguari ia ka atiribuar Atij, të ngjashme me ato të krijesave. Ata mendojnë p.sh. se zbritja e Allahut do të thotë që Arshi dhe qiejtë janë mbi Të dhe Ai është i kufizuar ndërmjet tyre dhe ndërmjet qiellit të Dynjasë, gjithmonë duke e menduar

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

zbritjen e Allahut të njëjtë me atë të krijesave. Ata, si rrjedhojë e kësaj imagjinate, janë ndarë në dy grupe:

- Grupi i parë e di që kjo është e pasaktë dhe mendon se ky është kuptimi i drejtpërdrejtë i tekstit, prandaj ose e keqinterpretojnë atë, ose i bëjnë “tefuid”, thonë se nuk kuptohet asgjë prej tij dhe “tefuid”-in ia atribuojnë selefëve. Për të mësuar pasaktësinë e interpretimit dhe “tefuid”-it, mund të ktheheni në bazat e argumenteve të cilësive.

- Grupi i dytë e ka konceptuar kuptimin e drejtpërdrejtë të tekstit njësoj si i pari, por pasi e pa se thënia e grupit të parë është e papranueshme dhe hadithi i Profetit (salallahu alejhi ue selam) është i vërtetë, e përngjasi Allahun me krijesat. Të paditurit që bëjnë pjesë në këtë grup, thonë se disa qiej ndodhen mbi Të dhe njëri poshtë Tij, ose qiejt ngrihen (zhvendosen) e pastaj kthehen përsëri në vendin e mëparshëm e të tjera fjalë, pasaktësinë e të cilave e kupton cilido që e përdor sadopak logjikën.

Që të dy këto grupe janë në humbje. Kwta njerwz, sikur të meditonin pak në ajetin dhe hadithin që do të përmendim më poshtë, do ta njihnin Madhëshinë e Allahut dhe do t’u bëhej i qartë gabimi në të cilin kanë rënë:

“Ata nuk e vlerësuan Madhërinë e Allahut ashtu siç i takon që të vlerësohet. Në Ditën e Kijametit e gjithë Toka do të jetë e mbështjellë në Dorën e Tij dhe qiejt do të jenë të mbështjellë në të djathtën e Tij. I Lavdëruar dhe i Lartë është Ai mbi gjithçka që ata ia ngjisin Atij si të barabartë.” (Ez-Zumer: 67)

“Allahu i Lartësuar e shtrëngon (e kap) Tokën në Ditën e Kijametit, i mbështjell qiejt me të djathtën e Tij dhe pastaj thotë: ‘Unë jam Gjithë sunduesi, ku janë sunduesit e Tokës.’” (Buhariu & Muslimi)

6) Atij që e mohon zbritjen e Allahut dhe e keqinterpreton atë duke thënë se zbret Mëshira e Allahut, Urdhëri i Tij, ose melekët e Tij, i përgjigjemi si më poshtë:

E para, Profeti (salallahu alejhi ue selam) thotë: *“...zbret në qiellin e Dynjasë dhe thotë: ‘Kush më lutet Mua që t’i përgjigjem?’”* Dihet që askush nuk i përgjigjet lutjes përveç Allahut.

E dyta, fjalët: *“Kush më lutet”* që janë përmendur në hadith, nuk mund t’i thotë askush tjetër përveç Allahut. (Për më gjerë shih “Mexhmuul Fetaua”, 5/416.)

Si përfundim, Ibnu Tejmije ka thënë: “Ajo që duhet ta besojmë në mënyrë të prerë, është se Allahut nuk i përngjan asgjë në të gjitha cilësitë me të cilat e ka cilësuar Vetën e Tij. Ai që i mvesh Allahun cilësi të ngjashme me ato të krijesave, është padyshim gabimtar, si ai që thotë se Ai zbret e zhvendoset siç zbret njeriu nga taraca e tij për në shtëpi (pra e krahason mënyrën e zbritjes me atë të një krijese), ose si ai që thotë se gjatë zbritjes së Tij Arshi mbetet bosh, dhe kjo do të thotë se

me zbritjen e Tij lihet bosh një vend dhe zihet një tjetër. Të gjitha këto janë të pavlefshme, dhe ne duhet të besojmë se Allahu është i Pastër prej tyre.”

83- En-Nisjanu - النسيان - **Harresa që nënkupton lënien.**

Kjo cilësi merr dy kuptime:

I pari: Të harrosh një gjë që e ke ditur më parë. Sipas këtij kuptimi, nuk lejohet t’ia atribuojmë Allahut këtë cilësi, sepse ajo është mangësi dhe Dija e Allahut është e përkryer.

I dyti: Lënia me dije dhe me dashje: **“Kështu që këtë ditë Ne do t’i harrojmë, siç e harruan ata takimin e kësaj dite.”** (El Araf: 51). Sipas këtij kuptimi, kjo cilësi mund t’i atribuohet Allahut.

84- En-Nefs - النفس - **Vetja, Qenia e Allahut.**

Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Zoti juaj ia bëri detyrë Vetes së Tij mëshirën.”**

Ibnu Huzejme, në fillimin e librit “Et-Teuhid” ka thënë: “Cilësia e parë e Allahut të Lartësuar me të cilën do të fillojmë këtë libër është **Vetja** (Qenia) e Tij. I Pastër dhe i Lartë është Allahu nga përngjasimi i saj me qeniet e krijesave.”

85- Et-Tenfis - التنفيس - Lehtësimi i vuajtjes, çlirimi nga brenga dhe pikëllimi.

Cilësi “fi’lijeh” e përmendur në hadith të saktë.

Nga Ebu Hurejre transmetohet se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Kush e çliron një besimtar nga një prej brengave të Dynjasë, Allahu do ta çlirojë nga një prej brengave të Ditës së Gjykimit.”** (Muslimi)

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë për erën: **“Mos e shani erën sepse ajo është prej nefsurr-Rrahman (d.m.th.prej gjërave me të cilat Allahu i çliron të brengosurit nga brengat e tyre).”** Fjala “nefes” në hadith ka kuptimin “tenfis”.

Ndërsa hadithi i Ebi Hurejres: **“Unë e gjej ‘nefese’ e Zotit drejt Jemenit”**, është i dobët, siç thotë Albani në “Ed-Daif”. Por, edhe sikur të supozohej se është i saktë, fjala “nefes” që është përmendur në të, ka të njëjtin kuptim si në hadithin e kaluar. Ibnu Tejmije ka sqaruar se Profeti (salallahu alejhi ue selam), ka për qëllim në këtë hadith, besimtarët nga Jemeni me të cilët Allahu u çliroi brengat muslimanëve dhe u lehtësoi vuajtjet.

86- En-Nuru - النور - **Drita.**

Cilësi “dhatijeh” e përmendur në Kur’an dhe hadith të saktë: **“Toka do të ndriçojë nga Drita e Zotit të saj** (kur Ai do të vijë për të gjykuar mes njerëzve).” (Ez-Zumer: 69)

Abdullah ibn Umer ka transmetuar se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: **“Allahu i krijoi krijesat e Tij në errësirë dhe u hodhi atyre nga Drita e Tij. Ai që e rroku drita e hedhur nga Allahu, u udhëzua, dhe ai që nuk e rroku ajo, humbi...”** (Ahmedi & Tirmidhiu, shih “Sahihu suneh Et-Tirmidhi”)

Ibnu Tejmije ka thënë: “Allahu ka lajmëruar në librin e Tij se Toka do të ndriçojë me Dritën e Zotit të saj. Përderisa do të ndriçojë nga Drita e Tij, si mundet të mos

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

jetë dritë?! Nuk lejohet të interpretohet Drita që i është atribuar Allahut në këto argumente, si një krijesë që i atribuohet Krijuesit të saj, i Cili e ka krijuar për disa aspekte...” dhe i ka përmendur më pas ato.

87- **El Herueletu** - الهرولة - **Ecja me shpejtësi.**

Kjo është një cilësi “fi’lijeh – haberijeh” e përmendur në hadith të saktë.

Transmetohet nga Ebu Hurejre se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë duke përsëritur fjalët e Allahut në një hadith “kudsij”: ***“Unë jam i Fuqishëm që të veproj ndaj robit Tim, atë që ai mendon se Unë do të veproj ndaj tij. Unë jam me të kur më përmend Mua. Nëse do të më përmendë me veten e tij (fshehurazi, jo në publik), Unë e përmend me Vetën Time; nëse do të më përmendë në një grup, Unë e përmend në një grup më të mirë se ai; nëse më afrohet një pëllëmbë, do t’i afrohem një krah; nëse më afrohet një krah, Unë do t’i afrohem një pash dhe nëse do të më vijë duke ecur, do t’i vij duke ecur më shpejt dhe më me nxitim (Herueleten).”*** (Buhariu & Muslimi)

Ibnu Utthejmini ka thënë: **“El Herueletu** është një nga cilësitë e Allahut, siç ka ardhur në hadith të saktë. Ajo është një nga veprat e Allahut, të cilat i kemi detyrë t’i besojmë pa u përshkruar formë dhe pa i përngjasuar me krijesat.”

88- **El Uexh’hu** - الوجه - **Fytyra.**

Cilësi “dhatijeh – haberijeh” që i atribuohet Allahut në Kur’an dhe hadithe të sakta:

“Gjthçka që është në të do të zhduket, ndërsa do të mbetet gjithmonë Fytyra e Zotit tënd, gjithë madhështi e lavdi.” (Err-Rrahman: 26-27)

“Çdo gjë do të shkatërrohet, përveç Fytyrës së Tij. Atij i takon gjykimi e vendimi dhe tek Ai të gjithë ju do të ktheheni.”

Në hadithin e Ebi Musa el Eshari, Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: ***“Perdja e Tij është dritë. Sikur ta zbulonte atë, madhështia dhe drita e Fytyrës së Tij do të digjte çdo gjë.”*** (Muslimi)

Në hadithin e Ibnu Umerit për tre personat që u bllokuan në shpellë, Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka treguar që secili prej tyre ka thënë: ***“O Allah, në qoftë se këtë e kam bërë duke kërkuar Fytyrën Tënde, na çliro!”*** (Buhariu & Muslimi)

Në lidhje me argumentet e kaluara duhet të bëjmë disa sqarime:

E para, shprehja: **“Çdo gjë do të shkatërrohet, përveç fytyrë së Tij”**, do të thotë se do të shkatërrohet çdo gjë, përveç Qenies së Allahut e Cila ka **Fytyrë**. Pra, Allahu ka përmendur **Fytyrën** sepse është një cilësi e Qenies së Tij dhe ka pasur për qëllim Qenien e Tij, duke cilësuar në këtë rast **Fytyrën**. Vetëm ky që sqaruam është kuptimi i saktë i ajetit, sepse në qoftë se do të nënkuptonte një qenie pa fytyrë, cila do të ishte dobja e përmendjes së **Fytyrës**? Fakti që është përmendur **Fytyra**, tregon se ajo është një cilësi e Qenies së Allahut.

E dyta, kur përmendet fjala “fytyrë” e cila i atribuohet Allahut, në Kur’an dhe Sunet, kuptimi fillestar i saj është cilësia e Allahut (**Fytyra**). Por në një ajet të Kur’anit, komentatorët kanë rënë në kundërshtim. Ky ajet është fjala e Allahut: **“Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, prandaj ngado që të drejtoheni, atje është Fytyra e Allahut”** (El Bekare: 115)

Disa dijetarë kanë thënë se kuptimi i fjalës “uexhh”, është ana që kur falemi drejt saj, Allahu na e pranon namazin. Kjo për arsye se ajeti ka zbritur për udhëtarin, i cili kur fal namaz nafile, drejtohet andej nga shkon kafsha e tij (mjete me të cilin udhëton), ose për një njeri që nuk e di me siguri se nga cila anë është Kibla, por përpiket për ta qëlluar atë dhe falet. Në këtë rast, edhe sikur të mos e gjejë me saktësi anën e Kibles, namazi i tij është i saktë.

Mendimi i dytë i dijetarëve, është se këtu bëhet fjalë për **Fytyrën** e Allahut. Atëherë, sipas këtij komenti, ajeti duhet kuptuar sipas asaj që sqaruam në fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selam): *“Kur secili prej jush të çohet për t’u falur, të mos pështyjë përpara, sepse Allahu është përballë (drejt) fytyrës së tij...”* (Për më gjerë shih cilësinë **El Majjeh** për të njohur nga afër kuptimin e hadithit.)

Sikurse dhe shumë cilësi të tjera, edhe këtë cilësi, grupet e humbura e kanë mohuar duke i keqinterpretuar argumentet që tregojnë për të. Ata kanë thënë se kuptimi i dy ajeteve që përmendëm është se “çdo gjë do të shkatërrohet, përveç **shpërblimit** të Allahut”. Mendimi i tyre hidhet poshtë për disa arsye:

1) Ky interpretim bie në kundërshtim me kuptimin e drejtpërdrejtë të tekstit, sepse kuptimi i drejtpërdrejtë është **Fytyra** dhe jo **shpërblimi**.

2) Ky interpretim bie në kundërshtim me konsensusin e selefëve.

3) A mundet të përshkruhet shpërblimi me këtë cilësi të madhërisme: **“Gjithë madhështi dhe lavdi”**? Kjo nuk është e mundur.

4) Për sa i përket fjalës së Profetit (salallahu alejhi ue selam): *“Perdja e Tij është dritë, sikur ta zbulonte, madhështia dhe drita e Fytyrës së Tij do të digjte çdo gjë”*, a mund të thuhet se **shpërblimi** ka gjithë këtë dritë që do të djegë çdo gjë!?

89- **El Jedani** - **اليدان** - **Dy Duart**.

Dy duart janë cilësi “dhatijeh – haberijeh”.

“Çifutët thonë: ‘Dora e Allahut është e lidhur (e shtrënguar, Ai nuk dhuron dhe nuk shpenzon nga begatitë e Tij). Qofshin të lidhura duart e tyre dhe qofshin të mallkuar ata për çfarë u nxori goja. Përkundrazi, të dy Duart e Tij janë gjerësisht të shtrira. Ai shpenzon nga begatitë e Tij siç do Ai.” (El Maide: 64)

“Ç”të ndaloi ty që të mos i biesh në sexhde atij që Unë e krijova me dy Duart e Mia?” (Sad: 75)

Në hadithin e Ebu Musës, Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Vërtet Allahu i Lartësuar e shtrin Dorën e Tij natën që të pendohet keqbërësi i ditës dhe e*

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

shtrin Dorën e Tij ditën që të pendohet keqbërësi i natës, derisa të lindë dielli nga perëndimi i tij.” (Muslimi.)

Gjithashtu, në hadithin e shefatit, ndër të tjera Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “...i vijnë Ademit dhe i thonë: ‘O Adem! Ti je babai i njerëzve, të krijoj Allahu me Dorën e Tij dhe fryu tek ti shpirtin e krijuar prej Tij...’” (Buhari & Muslimi)

Në lidhje me këtë cilësi, kemi për të bërë disa sqarime:

E para, argumentet tregojnë se Allahu ka dy Duar. Prej tyre janë dy ajetet e lartpërmendura si dhe hadithet: “*Allahu i Lartësuar i mbështjell qiejt me të djathtën e Tij dhe tokën me Dorën tjetër të Tij.*” (Buhariu & Muslimi) dhe “*Të dyja duart e Tij janë të djathta.*”

Të gjithë selefët e këtij Umeti kanë besuar se Allahu ka vetëm dy duar. Ndërsa për sa i përket fjalës së Allahut: “**Thuaj: ‘Kush e ka në Dorë të Tij pushtetin e çdo gjëje?’**” (El Mu’minun:), ku është përmendur “dora” në numrin njëjës dhe ajetit: “**A nuk e shohin ata se Ne kemi krijuar për ta nga ato që kanë punuar Duart Tona, bagëti, kështu që ato janë nën sundimin dhe nën shërbimin e tyre?**” (Ja Sin: 71), ku “duart” janë përmendur në numrin shumës, dijetarët kanë thënë se nuk bien në kundërshtim me faktin që Allahu ka dy Duar.

Për të parë se si e kanë bërë dijetarët bashkimin ndërmjet këtyre argumenteve, shih atë që është përmendur në një çështje të ngjashme me këtë në cilësinë **Dy Sytë**.

E dyta, fjala e Allahut të Lartësuar: “**A nuk shohin ata që Ne kemi krijuar për ta nga ato që kanë punuar Duart Tona, bagëti...**”, nuk tregon që bagëtitë i krijoj Allahu me Duart e Tij siç krijoj Ademin dhe kjo për dy arsye:

a) T’ia dedikosh punën dorës, megjithëse për qëllim ke të zotin e saj i cili e ka bërë këtë punë, është një stil gjuhësor i njohur. Si shembull kemi fjalën e Allahut: “**Nuk ju godet ndonjë fatkeqësi, veçse për shkak të asaj që keni punuar me duart tuaja.**” (Esh-Shura: 30)

Kuptimi i shprehjes “**keni punuar me duart tuaja**” është ajo që njeriu e ka punuar vetë, qoftë me dorën e tij ose me një pjesë tjetër të trupit. Ndërsa në qoftë se do të thuhet “**këtë e punova me dorën time**”, kjo padyshim tregon vetëm për atë që bëhet me dorë, siç ka thënë Allahu për Ademin duke iu drejtuar Iblisit: “**Çfarë të pengoi t’i bëje sexhde atij që e krijova me dy Duart e Mia?**”

b) Sikur qëllimi i Allahut të ishte që bagëtitë u krijuan nga Dora e Tij, atëherë teksti i ajetit do të ishte: “**Ne krijuam për ta me Duart Tona bagëti...**”, siç është thënë për Ademin: “**...atij që e krijova me dy Duart e Mia.**”

E treta, fjala e Allahut: “**Qiellin Ne e krijuam me fuqi. Sigurisht që Ne jemi të Zotët ta zgjerojmë hapësirën.**” (Edh-Dharijat: 47)

Në ajet është përmendur fjala “ejd” dhe është komentuar me kuptimin “fuqi”. Kjo fjalë, megjithëse është e ngjashme me shprehjen e duarve për sa i përket shkronjave, në arabisht kuptimin nuk e ka “duar”, por “fuqi”. Prandaj, nëse do ta konstatojmë këtë koment të selefët, të mos mendojmë se ata i kanë keqinterpretuar ajetet e cilësive.

E katërta, të dyja Duart e Allahut janë të djathta, pra ato cilësohen të djathta:

“Në Ditën e Kijametit e gjithë Toka do të jetë në grushtin e Dorës së Tij dhe qiejt do të jenë të mbështjellë në të djathtën e Tij.”

Ibnu Huzejme ka thënë: “Toka do të jetë në njërin prej dy Duarve të Allahut në Ditën e Kijametit, dhe qiejt do të jenë të mbështjellë në të djathtën e Tij, e cila është Dora tjetër e Allahut. Të dyja Duart e Zotit tonë janë të djathta dhe Ai nuk ka të majtë. I Pastër dhe i Lartë është Allahu nga kjo, sepse përcaktimi i njëres prej dy Duarve si e majtë, është një nga shenjat e krijesave. Allahu është i Pastër nga përngjasimi me krijesat e Tij.”

Abdullah ibni Amri transmeton se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Të drejtët tek Allahu do të jenë në minbere (vende të ngritura) prej drite në të djathtën e të Gjithëmëshirëshmit, dhe të dyja Duart e Tij janë të djathta. Të drejtët janë ata që mbajnë drejtësi në gjykim, në familjet e tyre dhe në çdo gjë që e kanë nën përgjësini dhe komandën e tyre.*” (Muslimi)

Ibnu Umeri transmeton se e ka dëgjuar të Dërguarin (salallahu alejhi ue selam) të thotë: “*Gjëja e parë që krijoi Allahu është ‘kalemi’. Ai e mori me të djathtën e Tij dhe të dyja Duart e Tij janë të djathta.*” (Hadithin e transmeton Ibn ebi Asim në “Es-Suneh” dhe Albani thotë se është i saktë.)

Ndërsa për sa i përket hadithit të Abdullah ibn Umer ku i Dërguari (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Allahu do t’i mbështjellë qiejt në Ditën e Kijametit, do t’i marrë me Dorën e Tij të djathtë dhe pastaj do të thotë: ‘Unë jam Sunduesi, ku janë sundimtarët e Dynjasë, ku janë kryelartët?’ Pastaj do t’i mbështjellë tokat me të majtën dhe do të thotë...*” (Muslimi), fjala “me të majtën” është “shadh” (gabim, e pasaktë), siç e ka sqaruar Albani, prandaj në “Sunenin” e Ebi Daudit thuhet: “me Dorën tjetër të Tij”. Pra, kjo nuk bie në kundërshtim me fjalën e Profetit (salallahu alejhi ue selam): “*Dhe të dyja Duart e Tij janë të djathta.*”

E pesta, fjala e Allahut të Lartësuar: “**Sigurisht ata që të japin besën ty, po ia japin besën Allahut. Dora e Allahut është mbi duart e tyre.**” (El Feth: 10), duhet kuptuar sipas domethënies së saj të drejtpërdrejtë, sepse Dora e Allahut është cilësi e Tij. Allahu është mbi të gjitha krijesat kështu që kur sahabët i dhanë besën Profetit (salallahu alejhi ue selam) në Hudejbije, Dora e Allahut ishte mbi duart e tyre. Pra, nga fjala e Allahut në ajet: “**Dora e Allahut është mbi duart e tyre**”, nuk kuptohet që Dora e Allahut ishte e ngjitur me duart e tyre dhe si rrjedhojë të interpretohet në këtë mënyrë.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

E gjashta, kundërshtarët e “ehli sunetit” i kanë keqinterpretuar argumentet e kaluara të cilat tregojnë qartë për Dorën e Allahut dhe kanë thënë se bëhet fjalë për fuqinë ose begatinë e Allahut.

Interpretimit të tyre i përgjigjemi në disa pika:

1) Interpretimi i dorës si fuqia ose begatia, bie në kundërshtim me kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës dhe përderisa është kështu, ai është i refuzuar.

2) Ky interpretim bie në kundërshtim me konsensusin e selefëve, të cilët kanë besuar të gjithë se bëhet fjalë për Dorën e Allahut në kuptimin e vërtetë të fjalës.

3) Është krejtësisht e pamundur që kuptimi i **El Jed** (Dora) të jetë “fuqia” ose “begatia”, në fjalën e Allahut: **“Atij që e krijova me dy Duart e Mia.”**, sepse në qoftëse do të ishte ashtu, atëherë do të thotë që të ketë vetëm dy begati ose dy fuqi, por në fakt begatitë - në kuptimin e mirësive me të cilat Allahu furnizon robërit e Tij - janë të shumta aq sa nuk mund të llogariten, dhe nga ana tjetër, fuqia është një dhe nuk mund të shumëhet.

4) Sikur kuptimi i fjalës “dorë” të ishte “fuqia”, Ademi nuk do të kishte ndonjë epërsi mbi Iblisin, madje as mbi kafshët e ndryshme, sepse të gjitha janë krijuar me fuqinë e Allahut. Gjithashtu, nuk do të ishte i saktë argumenti kundër Iblisit sepse Ai do të thoshte: “Edhe mua o Zot më krijove me Fuqinë Tënde, atëherë çfarë ka ai më shumë se unë?!”

5) Dy duart që Allahu ia ka atribuar Vetes së Tij, kanë ardhur në formë të ndryshme, të cilat tregojnë se është e pamundur që kuptimi i tyre të jetë “fuqia” ose “begatia”. Janë përmendur p.sh. në lidhje me dorën: gishtërinjtë, mbledhja e saj grusht, shtrirja e saj, pëllëmba, janë cilësuar duart të djadhta etj.. Të gjitha këto pra, tregojnë se nuk bëhet fjalë për “fuqinë”, sepse ajo nuk mund të përshkruhet me këto cilësi.

Fjalë dhe shprehje të cilat përdoren për të treguar diçka rreth Allahut

Shejhul islam ibnu Tejmije ka thënë: “Lajmërimi rreth Allahut nuk bëhet me fjalë që kanë domethënie të keqe, por bëhet me fjalë që kanë domethënie (kuptim) të plotë e të përkryer, si dhe me fjalë që domethënien nuk e kanë të keqe, edhe pse nuk mund të thuhet se e kanë të përkryer, si psh: Qenie, Ekzistues etj..

Ibnul Kajjim ka thënë: “Emrat dhe cilësitë që ia dedikojmë Allahut janë ‘teukifije’ ndërsa fjalët dhe shprehjet që përdorim për të treguar diçka rreth tij, nuk është e detyrueshme të jenë ‘teukifije’, si p.sh. **El-Kadijm** - ال قديم - **i Pafillimtë** ose **El Meuxhud** - الموجود - **Ekzistent**.”¹

Nga kjo që sqaruan Ibnu Tejmije dhe Ibnul Kajjim, kuptojmë se fjalët dhe shprehjet që përdoren për të treguar diçka rreth Allahut, nuk është kusht që të jenë përmendur në Kur’an dhe Sunet. Mjafton që shprehja të mos ketë kuptim të keq dhe të mos tregojë ndonjë të metë për sa i përket Allahut.

Më poshtë do të përmendim disa nga këto shprehje, të cilat i kanë përdorur dijetarët në librat e Akides.

1- **Edh-dhat** - الذات - **Qenia**.

Është e pranueshme dhe e saktë që t’ia dedikojmë Allahut fjalën “dhat”. (qenie). Për shembull lejohet të themi: Dhatullah (Qenia e Allahut) ose Edh-Dhatul-ilahijeti (Qenia hyjnore), jo duke pasur për qëllim që “dhat” është cilësi e Tij, por që “dhat” i diçkaje, ka kuptimin “vetja” e saj. Fjala “dhat” është përmendur në disa vende në Sunet, por këtu po përmendim vetëm hadithin që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre, nw tw cilin Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: “*Vërtet Ibrahim ka thënë vetëm tri gënjeshtër, ndër të cilat dy prej tyre kanë qenë për hir të ‘Dhatull-llah’ (Qenies së Allahut).*”²

Si përfundim, me shprehjen “Dhatullah” kemi për qëllim qenien e përshkruar e të cilësuar me atributet e larta që kanë ardhur në Kur’an dhe në Sunet.³

2- **Esh-shahsu** - الشخص - **Personi**.

¹) Shiko ndryshimin ndërmjet emrave të Allahut dhe lajmërimit rreth Tij në faqen 51.

²) Bëhet fjalë për atë që tha kur theu idhujt dhe la pa thyer më të madhin prej tyre: “**Jo, ky i madhi e ka bërë atë.**” (Enbija: 63) dhe fjalën e tij: “**Unë jam i sëmurë.**” (Safatë: 89). E treta është fjala e tij për Sarën: “**Kjo është motra ime.**” Për më gjerë shih hadithin në “Sahihun” e Buhariut dhe komentin që i ka bërë Ibn Haxher.

³) Për më gjerë shih në këtë libër dhe në “Mexhmuul fetaua”, 6/206, ndryshimin ndërmjet emrave, cilësive dhe lajmërimeve rreth Allahut.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Gjatë lajmërimit rreth Allahut dhe cilësive të Tij, lejohet të përdoret fjala “esh-shahsu”. Kjo shprehje është përmendur në hadithin e saktë të transmetuar nga Muslimi ku Sad ibnu Ubade ka thënë: “Sikur të shihja ndonjë burrë me gruan time, do ta godisja me pjesën e mprehtë të shpatës.” Kur Profeti (salallahu alejhi ue selam) e mori vesh këtë, tha: “A habiteni nga xhelozia e Sadit? Uallahi unë jam më xheloz se ai dhe Allahu është më xheloz se unë, prandaj Allahu nga Xhelozia e Tij i ndaloi veprimet e ulta e të shëmtuara që kryehen hapur ose fshehur. Asnjë person nuk është më xheloz se Allahu, asnjë person nuk e do më shumë arsyetimin sesa Ai dhe për këtë arsye Allahu i dërgoi të dërguarit përgëzues dhe paralajmërues. Asnjë person nuk e do më shumë lavdërimin sesa Allahu dhe për këtë arsye Ai u ka premtuar robërve të tij Xhenetin.”¹ (Buhariu & Muslimi. Me këtë version e ka transmetuar Muslimi)

Buhariu në “Sahihun” e tij, ka titulluar një nënkapitull “Thënia e Profetit (salallahu alejhi ue selam): *‘Asnjë person nuk është më xheloz se Allahu’*”. Kjo tregon se ai e konfirmon përdorimin e kësaj shprehjeje për të treguar diçka rreth Allahut.

3- Es-sifetu - الصفة - Cilësia.

Lejohet të përdoret fjala “sifetu” dhe t’i atribuohet Allahut. Pra të thuash “cilësia e Allahut” (sifetullah), “atributi i të Githëmëshirëshmit” ose “prej cilësive të Tij është...” etj.

Këtë e nëkuptojnë ajetet e Kur’anit dhe gjithashtu është përmendur tekstualish në hadith të saktë.

Argumenti i Kur’anit është fjala e Allahut: **“Lavdi Zotit tënd, Zotit të krenarisë dhe fuqisë! (Ai është i Pastër, i Dlirë) nga çdo e metë që ia mveshin Atij.”** (Es-Safatë: 180)

Në “Fethul bari” Ibnu Haxher ka thënë: “Allahu ka lajmëruar se është i Pastër, i Dlirë dhe i Lartë nga çdo cilësi e mangët që ia përshkruajnë Atij. Kjo nënkupton se përshkrimi (cilësimi) me cilësi të përkryera është i ligjshëm.”

Argument nga Suneti është hadithi i transmetuar nga Aishja, ku thuhet se Profeti (salallahu alejhi ue selam) emëroi komandant të një kompanie ushtarake një burrë, i cili sa herë që u printe shokëve të tij në namaz, e përfundonte leximin e Kur’anit me suren “Ihlas”. Shokët e tij ia treguan këtë gjë Profetit kur u kthyen në Medinë dhe ai tha: *“Pyeteni se përse e bën kaq shpesh këtë.”* Ata e pyetën dhe ai u tha: *“Për shkak se ajo është cilësia e të Githëmëshirëshmit dhe unë dua ta lexoj atë.”*

¹) D.m.th. duke qënë se Allahu u premtoi robërve Xhenetin, ata do ta lavdërojnë e do ta madhërojnë dhe do të kërkojnë Xhenetin, për të hyrë në të.

Profeti (salallahu alejhi ue salam) atëherë tha: *“Lajmërojeni se Allahu e do atë.”* (Buhariu & Muslimi)

Imam Buhariu, ka një nënkapitull të veçantë në “Sahihun” e tij për të argumentuar këtë që thamë. Ai që i studion librat e selefëve si “Kitabul Teuhid” të Ibn Huzejme dhe “Kitabul Teuhid” të Ibnu Mendeh etj., vëren se ata e përdorin shumë këtë shprehje.

4- **El kidem** - **القدم** - **Pafillimësia.**

Lejohet që të tregosh diçka rreth Allahut duke përdorur fjalën “kadim” (i pafillim). Në një hadith të saktë, Profeti (salallahu alejhi ue salam) e ka përdorur këtë fjalë për të treguar rreth Pushtetit të Allahut. Në “Sunenin” e Ebi Daudit është transmetuar se ai thoshte: *“Mbrohëm me Allahun e Madhërishëm, me Fytyrën e Tij të madhërishme dhe me Pushtetin e Tij të pafillim (kadim) nga shejtani i mallkuar.”* (Shih në “Sahih Sunen Ebi Daud”)

Pra, në këtë hadith, Profeti (salallahu alejhi ue salam) e ka përkshkruar Pushtetin e Allahut si të pafillimtë (kadim). Megjithatë, “el kadimu” nuk është emër i Allahut, edhe pse disa e kanë konsideruar si të tillë.

5- **El meuxhud** - **الموجود** - **Ekzistues.**

Ekzistenca e Allahut është e domosdoshme dhe logjika nuk mund ta pranojë inekzistencën e Tij. Allahu i Lartësuar është Vetekzistues dhe nuk e ka fituar prej askujt këtë ekzistencë, për shkak se inekzistenca nuk ka ekzistuar përpara Tij, por Ai ka ekzistuar gjithmonë. Ai është i Pafillim dhe i Pambarim: **“Ai është i Pari** (s’ka pasur asgjë para Tij, është i Pafillim) **dhe i Fundit** (s’ka asgjë pas Tij, është i Pambarim), **më i Larti** (s’ka asgjë mbi Të) **dhe më i Afërti** (nuk ka gjë më të afërt me krijesat sesa Ai me Dijen e Tij, nuk ka asnjë pengesë ndërmjet Tij dhe krijesave). **Dhe Ai është i Gjithëdituri për çdo gjë.”** (Hadid: 3)

Ndërsa ekzistenca e çdo gjëje tjetër përveç Allahut, ka ardhur pas inekzistencës, për shkak se asgjë nuk ka ekzistuar më parë dhe krijesat e kanë zanafillën nga Allahu, i Cili është i Pafillim dhe janë të gjitha të krijuara prej Tij. Pra, ekzistenca e krijesave nuk është e domosdoshme, por është e mundshme (d.m.th. logjika mund të pranojë edhe inekzistencën e tyre).

Allahu i Lartësuar ka thënë në Kur’an: **“A nuk u krijuan ata nga hiçi** (pa qenë fare), **apo ata vetë qenë krijuesit? Apo mos i krijuan ata qiejt dhe Tokën? Por ata nuk kanë aspak besim të qëndrueshëm.”** (Et-Tur: 35-36)

6- **Shej** - **شيء** - **Një gjë, diçka.**

Lejohet që të përdoret kjo fjalë në lidhje me Allahun, për të treguar diçka rreth Tij ose cilësive të Tij:

“Thuaj: ‘Cila gjë është më e madhe në dëshmi?’ Thuaj: ‘Allahu është dëshmues mes meje dhe mes jush.’ (En Am: 19)

“Çdo gjë do të shkatërrohet përveç Fytyrës së Tij.” (Kasas: 88)

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Fytyra është një cilësi “dhatijeh” dhe ajeti i mësipërm tregon se lejohet të përdoret në lidhje me të fjala “gjë”.

Sehl ibnu Sad ka transmetuar se Profeti (salallahu alejhi ue selam) i tha një burri: “A ke diçka (ndonjë gjë) nga Kur’ani?” Ai i tha: “Po”, dhe i përmendi disa sure. (Buhariu)

Kur’ani është fjala e Allahut. Ai është një nga cilësitë e Tij dhe në hadith është folur për të duke përdorur fjalën “diçka - ndonjë gjë”.

Imam Buhariu në kapitullin e Teuhidit në librin e tij, ka një nënkapitull të titulluar: **“Thuaj: ‘Cila gjë është më e madhe në dëshmi?’ Thuaj: ‘Allahu.’”** Pra, Allahu, duke folur rreth Vetes së Tij, ka përdorur fjalën “gjë”.

Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka përdorur në lidhje me Kur’anin fjalën “gjë” dhe Kur’ani është një nga cilësitë e Allahut. Gjithashtu Allahu ka thënë: **“Çdo gjë do të shkatërrohet përveç Fytyrës së Tij.”** Pastaj Buhariu ka përmedur hadithin e kaluar të Sadit.

Abdullah el Gunejman ka thënë: “Buhariu, me këtë nënkapitull ka dashur të thotë se në lidhje me Allahun përdoret edhe fjala ‘gjë’.”

Gjëra që i janë atribuar Allahut, por nuk janë cilësi të Tij

Në “Mexhmul fetaua”, Ibnu Tejmije ka sqaruar se gjërat që i janë dedikuar Allahut, ndahen në dy lloje:

1- Cilësitë që i janë atribuar Allahut, si për shembull: Të folurit e Tij, Dija e Tij, Dora e Tij etj..

2- Krijesat që i janë dedikuar Krijuesit të tyre për të treguar se ato janë nën Pushtetin e Tij dhe Ai vepron me to si të dëshirojë, si për shembull: shtëpia e Allahut (për Kaben), deveja e Allahut (për devenë e Salihut në suren “Shems”) ose robërit e Allahut (për njerëzit). Po kështu edhe shpirti¹ bën pjesë në këtë lloj. (El xheuabus-sahih”, 3/145 dhe “El fetaua”, 9/290.)

Në “El xheuabus-sahih”, Ibn Tejmije ka thënë: “Ato që i janë atribuar Allahut dhe nuk janë të shkëputura prej Tij (Qenia e Tij), janë cilësi të Tij dhe nuk janë të krijuara, ndërsa çdo gjë që i është atribuar Atij dhe është e shkëputur prej Tij (e ndarë nga Qenia e Tij), është e krijuar. Nuk është e detyrueshme që çdo gjë e dedikuar Allahut, të jetë cilësi e Tij.

Si shembull për këtë sqarim të Ibnu Tejmijes, po marrim tri gjëra dhe po i analizojmë ato.

Err-Rruhu - الروح - Shpirti.

¹) Bëhet fjalë për Xhibrilin, Isain (alejhi selam) ose shpirtin, siç ka ardhur me argument.

Ai është një nga krijesat Allahut dhe nuk i është dedikuar Allahut si atribut i Tij, por si krijesë që është krijuar prej Tij. Shpirti i është dedikuar Allahut në shumë tekste për tri arsye:

1- Është krijesë e Tij, kështu që kemi të bëjmë me dedikim të krijesës, Krijuesit të saj.

2- Shpirti është nën zotërimin dhe pushtetin e Allahut, Ai e merr, e kap dhe e lëshon kur të dëshirojë.

3- Për t'u vlerësuar dhe për të dal në pah, çështja e shpirtit i është dedikuar Allahut.

Për këto arsye, shpirti i është dedikuar Allahut në disa ajete kuranore si për shembull: **“Kështu që kur t'i kem dhënë formën plotësisht atij dhe t'i kem fryrë shpirtin nga Unë (që e kam krijuar për të), atëherë përkuluni para tij duke rënë në sexhde (me nderim).”** (El Hixher: 29)

Dhalil Arsh - ظل العرش - Hija e Arshit.

Në Ditën e Gjykimit, kur dielli do t'u afrohet krijesave, Allahu do të fusë nën hijen e Arshit të Tij, robërit që kryejnë disa adhurime të caktuara (punë të cilat bëhen shkak për arrijtjen e kësaj mirësie). Në disa hadithe, hija e Arshit i është dedikuar Allahut për të tërhequr vëmendjen rreth vlerës së madhe të kësaj mirësie në Ditën e Gjykimit dhe jo ngaqë hija është cilësi e Tij, si p.sh. në hadithin e Ebu Hurejres: *“Shtate grupe i fut Allahu nën hijen e Tij, në ditën kur nuk ka hijet jetër veç saj...”* (Buhariu & Muslimi)

E njëjta gjë vihet re edhe në hadithin e tij të transmetuar nga Muslimi ku Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Vërtet Allahu thotë në Ditën e Gjykimit: ‘Ku janë ata që e kanë dashur njëri-tjetrin për hir të Madhërisë Sime? Sot do t'i fus nën hijen Time, në ditën kur nuk ka hije tjetër veç saj.’”*

Në të dyja këto hadithe, bëhet fjalë për hijen e Arshit të Allahut, prandaj në “Musnedin” e imam Ahmendit dhe në “Sunenin” e Tirmidhiut, hija është përmendur si cilësi e Arshit të Allahut.

Muadh ibn Xhebel ka transmetuar se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: Të dashurit për hir të Allahut, janë nën hijen e Arshit në ditën kur nuk ka hije tjetër përveç hijes së tij...” (Trans. Imam Ahmedi dhe Albani e ka përmendur në “Sahihul xhami”).

Në “Sunenin” e Said ibn Mensur, nga Selmani me sened të mirë është transmetuar se Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Shtatë grupe do t'i fusë Allahu nën hijen e Arshit të Tij...”*

(Për me gjerë rreth hijes që është përmendur në këto hadithe dhe në hadithe të tjera, shih fjalën e Ibnu Haxherit në “Fethul bari”, gjatë komentit të hadithit të shtatë grupeve që do të futen nën hijen e Arshit.)

El xhenb - الجنب - Ana.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Disa kanë thënë se El xhenb - ana e trupit për sa i përket njeriut - është prej cilësive “dhatijeh” të Allahut, por kjo është e gabuar dhe elefët nuk janë dakord me këtë.

Ata që ia atribuojnë Allahut këtë cilësi, marrin për argument ajetin: **“Që të mos thotë dikush: ‘Medet për mua që kam lënë pas dore respektimin e urdhërave të Allahut dhe kam qenë prej atyre që talleshin.’”** (Zummer: 56)

Në këtë ajet është përmendur fjala “xhenb” e dedikuar Allahut, prandaj kanë thënë se ajo është cilësi e Tij. Kjo bie në kundërshtim me komentin e transmetuar nga selefët në lidhje me këtë ajet. Ibn Xherir, në komentin e tij ka thënë: “Qafiri do të thotë: ‘I mjeri unë që lashë pas dore veprimin e asaj që më urdhëroi Allahu dhe e neglizhova respektimin e Tij në Dynja.’”

Shejhul Islam Ibn Tejmije ka thënë: “Nuk njihet ndër muslimanët ndonjë dijetar i dëgjuar dhe as ndonjë grup i njohur islam, që t’i atribuojë Allahut anë (xhenb) sipas kuptimit që kjo fjalë ka për njerëzit. “Xhenb” është përmendur në fjalën e Allahut: **“Që të mos thotë dikush: ‘Medet për mua që kam lënë pas dore respektimin e urdhërave të Allahut dhe kam qenë prej atyre që talleshin.’”** (Zumer: 56). Nuk është e domosdoshme që çdo shprehje apo çdo gjë që i dedikohet Allahut, të jetë cilësi e Tij, sepse Allahut mund t’i dedikohen gjëra të krijuara dhe cilësi të gjërave të krijuara, të cilat - pa diskutim tek të gjithë njerëzit - nuk janë cilësi (attribute) të Tij, si për shembull: shtëpia (Kabja), devja (në suren “Shems”), robërit, po kështu edhe shpirti. Sipas selefëve, prijësve të tyre dhe shumicës së muslimanëve, kur i dedikohet Allahut diçka që i përket vetëm Atij dhe askujt tjetër, si për shembull: Të Folurit e Allahut (kelamullah), Dija e Allahut, Dora e Allahut etj, këto janë cilësi të Tij. Në ajetin e mësipërm të Kur’anit, ka elementë që tregojnë se nuk bëhet fjalë për “anën” e Allahut në kuptimin e anës së njeriut, sepse neglizhenca për të cilën flitet në ajet, nuk mund të bëhet në raport me ndonjë cilësi të Allahut. Kur dikush thotë se ka neglizhuar në “anën” e filanit, nuk do të thotë që kjo ka ndodhur vetëm në një pjesë të trupit të atij personi, por që ai ka neglizhuar në të drejtën e tij. Përderisa këtë gjë arrijmë ta kuptojmë në lidhje me krijesën, si mund të mendohet që kuptimi i drejtpërdrejtë i ajetit, për sa i përket Allahut, është që neglizhenca bëhet ndaj Qenies së Tij?!

Kundërpërgjigjja ndaj esharijve dhe të tjerëve që mashtrohen prej tyre¹

¹) Shumica e përgjigjeve që janë përmendur për esharijtë, janë të vlefshme edhe për maturidijtë.

Dikush mund të thotë se nga gjithë çfarë u sqarua më lart, u kuptua se ideja e atyre që i keqinterpretojnë cilësitë, është e pavlefshme dhe dihet që esharijtë janë pjesë e kësaj rryme, sepse mohojnë shumicën e cilësive dhe keqinterpretojnë shumicën e argumenteve të tyre, por në lidhje me këtë lindin disa pyetje:

1) Si mund të jetë i pavlefshëm drejtimi i esharijve, kur ata përbëjnë shumicën e botës islame?

2) Si mund të jetë i pavlefshëm (i pasaktë), kur ata marrin si shembull në këtë drejtim Ebil Hasen el Eshari?

3) Si mund të jetë i pavlefshëm ky drejtim, kur ndërmjet tyre ka edhe dijetarë që i kanë shërbyer fesë sinqerisht?

Përgjigjja e pyetjes së parë:

Së pari, nuk mund ta pranojmë apriori që përqindja e esharijve të jetë kaq e madhe në botën islame në krahasim me grupet e tjera të muslimanëve sepse ky është një pretendim që ka nevojë të provohet me anë të një statistike të hollësishme.

Së dyti, edhe sikur të provohej që janë kaq shumë, kjo nuk do të thotë se janë të mbrojtur nga gabimi, sepse kjo mbrojtje është siguruar për të gjithë muslimanët (unanimitetin e tyre) dhe jo vetëm për shumicën e tyre.

Së treti, “ixhmai” i muslimanëve të parë është në kundërshtim me idenë e mohimit të cilësive, sepse të parët e Umetit - të cilët janë sahabët, tabiinët si dhe dijetarët e udhëzuar pas tyre - i kanë pohuar unanimisht cilësitë e ardhura në Kur'an dhe Sunet. Ata i kanë kuptuar argumentet sipas kuptimit të tyre të drejtpërdrejtë dhe nuk i kanë keqinterpretuar. Ata janë njerëzit e shekullit më të mirë, siç është shprehur Profeti (salallahu alejhi ue selam) tekstualisht¹ dhe “ixhmai” i tyre është argument të cilin e kemi detyrë ta pranojmë, sepse për këtë tregon Kur'ani dhe Suneti.

Përgjigjja e pyetjes së dytë:

Së pari, Ebil Hasen el Eshari e të tjerë prej dijetarëve të muslimanëve, nuk janë të pagabueshëm dhe nuk pretendojnë që janë të tillë.

Së dyti, esharijtë e sotëm, nuk e kanë ndjekur imamin e tyre ashtu siç duhet, sepse Ebil Haseni ka kaluar tri faza në besimin e tij, të cilat i kemi përmendur edhe më parë në këtë libër.

Në fillim përqafoi drejtimin e muëtezilëve për dyzet vjet dhe pastaj hoqi dorë nga ideja e tyre dhe deklaroi se janë të humbur.

Faza e dytë është një fazë ndërmjet besimit të muëtezilëve dhe Sunetit të pastër. Në këtë drejtim ai ka ndjekur Ebi Muhamed ibnu Kulab.

¹) Në hadithin “muteuatir” që e kanë transmetuar shumë prej sahabëve, ndër të cilët Ibn Mesudi, Imam ibni Husejni etj.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

IbnuTejmije ka thënë: “Eshariu dhe disa të tjerë si puna e tij, janë në një ‘berzeh’ (fazë) ndërmjet selefëve dhe xhehmijve. Ata morën nga selefët fjalët e sakta dhe nga xhehmijtë parimet logjike, të cilat menduan se ishin të sakta por ato në realitet janë të pavlefshme.”

Faza e tretë është përqafimi i besimit të “ehli sunetit” (“ehlu hadithit”). Në këtë fazë ai mori për shembull Imam Ahmedin, siç ka sqaruar vetë ai në librin e tij “El ibanetu an usulid-dijaneti” që është prej librave të tij të fundit.

Në cilësinë e “lartësisë” kemi shkëputur disa thënie të tij që vërtetojnë se ai ka vdekur në besimin e selefëve.

Ata që sot i atribuohen esharizmit në Akide, kanë ndjekur fazën e dytë të besimit të tij dhe kanë mohuar shumicën e cilësive, me përjashtim të shtatë prej tyre. Por edhe në këto cilësi, kanë mosmarrëveshje me “ehli sunetin” për mënyrën se si i kanë pohuar, p.sh. cilësinë e **Të Folurit**.

Ibnu Tejmije ka thënë: “Qëllimi i tyre janë esharijtë që mohojnë cilësitë ‘haberije’, ndërsa ata që e pranojnë atë që shkroi Eshariu në librin “El ibane” dhe nuk kanë shfaqur ndonjë ide që bie në kundërshtim me të, konsiderohen si pjesë e “ehli sunetit”. Si përfundim, imitimi i tij i plotë, do të ishte t’i përmbahen besimit në të cilin ai vdiq dhe që është besimi i “ehlu hadithit”.

Përgjigjja ndaj pyetjes së tretë:

Së pari, e vërteta nuk njihet nëpërmjet burrave, por burrat njihen nëpërmjet së vërtetës dhe ky është kriteri i saktë. Kjo përshkak se njeriu, sado i ditur që të jetë, përsëri ka mangësi ose mund të jetë rritur në një rrugë ose ide të caktuar dhe ndoshta nuk njih tjetër përveç saj.

Së dyti, në qoftë se do të krahasojmë dijetarët e drejtimit të esharijve me ata të drejtimit të selefëve, do të shohim se të dytët janë më të mëdhenj, më të udhëzuar, më të drejtë dhe më të ditur se të parët. Këtë e vërteton edhe fakti që katër dijetarët e mëdhenj të medhhebeve të njohura, nuk kanë qenë në rrugën e esharijve, dhe gjithashtu nuk kanë qenë në rrugën e tyre as dijetarët e sahabeve dhe as ata të tabiinëve.

Ne nuk e mohojmë që disa prej dijetarëve të drejtimit esharij kanë dhënë një kontribut të madh në mbrojtjen e Islamit me interesin që kanë treguar për librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit (salallahu alejhi ue selam) dhe në përpjekjen që kanë bërë për t’i udhëzuar muslimanët, por kjo nuk do të thotë që ata kanë qenë të pagabueshëm, as nuk na e bën të detyrueshëm pranimin e çdo thënieje të tyre dhe as nuk na pengon ta sqarojmë gabimin e tyre dhe ta refuzojmë atë, pasi në këtë mënyrë sqarohet e vërteta dhe udhëzohen në të njerëzit.

Gjithashtu, ne nuk e mohojmë që disa prej tyre kanë pasur qëllim të mirë në atë që kanë besuar dhe atyre nuk u është bërë e qartë e vërteta, por nuk mjafton për

pranimin e një thënieje vetëm qëllimi i mirë i atij që e thotë atë. Që ajo të pranohet, duhet patjetër të jetë në përputhshmëri me Sheriatin e Allahut dhe nëse e kundërshton ligjin e Zotit, ajo duhet të refuzohet, cilido qoftë ai që e ka thënë. Profeti (salallahu alejhi ue selam) ka thënë: *“Nëse dikush punon një punë, e cila nuk është në përputhshmëri me rrugën tonë, ajo është e refuzuar.”* (Muslimi)

Pastaj, ai që e ka kundërshtuar Sheriatin, në qoftë se është i njohur për sinqeritet dhe çiltërsi në kërkimin e së vërtetës, justifikohet, në të kundërt, i japim gjykimin që meriton, për qëllimin e tij të keq dhe kundërshtimin e fesë.

Gjykimi ndaj mohuesit (keqinterpretuesit) të cilësive

Në lidhje me gjykimin ndaj tyre, duhet të kemi parasysh disa çështje:

E para, cilësimi i njeriut “kafir” ose “fasik”, merret nga libri i Allahut dhe suneti i të Dërguarit (salallahu alejhi ue selem), pra ky cilësim është prej rregullave të Sheriatit, për të cilat duhet t’i referohemi Kur’anit dhe Sunetit.

Në çështjen e tekfirit, është detyrë që të verifikojmë dhe të sigurohemi në mënyrë maksimale. Kafir bëhet vetëm ai, për kufrin e të cilit tregon Kur’ani dhe Suneti. Origjina tek muslimani, është që të thuhet për të se është musliman, derisa të vërtetohet në mënyrë të sigurtë që ka dalë nga Islami, sipas argumentit fetar.

E dyta, nuk lejohet neglizhenca në tekfinin e muslimanit sepse kjo ka dy pasoja të mëdha:

1) Shpifja e gënjeshtres ndaj Allahut, në gjykimin që e ka dhënë dhe ndaj të cilësuarit “kafir”.

2) Kalimi i cilësimit “kafir”, tek ai i cili etiketon me këtë cilësi vëllain e tij musliman, nëse ky i fundit nuk është i tillë.

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Abdullah ibn Umeri ka transmetuar se i Dërguari (salallahu alejhi ue selem) ka thënë: “Në qoftë se një person do ta cilësojë ‘kafir’ vëllain e tij, kjo fjalë do t’i kthehet njërit prej të dyve.” (Muslimi)

E treta, është detyrë që para se të cilësohet një musliman “kafir” të vërehen dy gjëra:

1) Të vërtetohet me argument të saktë nga Kur’ani ose Suneti, që një thënie ose një vepër është nga ato të cilat e çojnë njeriun në kufër.

2) Përputhja e këtij gjykimi me një thënës ose veprues të caktuar, d.m.th. të plotësohen kushtet e tekfirit dhe të eliminohen pengesat e tij.

E katërta, ndër kushtet më të rëndësishme është që njeriu të ketë dije (mirinformim) rreth thënies ose veprës së tij e cila i obligon të tjerët ta cilësojnë “kafir”.

Argument për këtë është fjala e Allahut të Lartësuar: **“Dhe kushdo që kundërshton të Dërguarin (alejhi selam), pasi t’i jetë treguar qartë atij rruga e drejtë dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne do ta mbajmë në atë drejtim që ai vetë ka zgjedhur dhe do ta djegim atë në zjarr. Dhe sa përfundim i keq!”** (En-Nisa: 115)

“Allahu kurrë nuk do ta humbë atë popull, pasi Ai e ka udhëzuar, derisa t’u bëjë të qartë atyre se nga cilat gjëra duhet të largohen. Vërtet Allahu është i Gjithëditur për çdo gjë.” (Teube: 115)

Prej pengesave më të rëndësishme, që e ndalojnë cilësimin e një muslimani i cili bie në kufër, “kafir”, është interpretimi dhe imitimi.

Këtu duhet bërë e qartë se jo çdo interpretim konsiderohet pengesë. Për të bërë dallimin ndërmjet interpretimit justifikues dhe atij jojustifikues, mund t’i referohemi thënies së Ibn Uthejminut në faqen 29, si dhe thëniet e Ibnu Tejmijs që do t’i përmendim në fund të kësaj çështjeje.

Ndërsa për sa i përket imitimit, bëhet fjalë për muslimanët e paditur të cilët pasojnë fjalët (mendimet) e dijetarëve pa e ditur argumentimin e tyre. Nëse njerëz të tillë bien në kufër për shkak të paditursisë ose imitimit të verbër që i bëjnë dijetarëve, nuk cilësohen “kafir”, derisa t’u bëhet e qartë e vërteta dhe me kryeneçësi e inat ta refuzojnë atë.

Pas gjithë kësaj që sqaruam, gjykimin ndaj atij që mohon një prej cilësive të Allahut të ardhur në Kur’an dhe Sunet, mund ta përmbledhim në tre rastet që vijnë:

1- Mohuesi i cilësisë të ketë dije (informim) rreth argumentit që pohon cilësinë e Allahut, qoftë nga Kur’ani ose Suneti dhe të mos ketë dyshime të cilat mund t’ia ndryshojnë metodën e të kuptuarit të tekstit, por të mohojë për shkak të kryeneçësisë, inatit, qëllimit të keq, sëmundjes së zemrës dhe kundërshtimit të të

Dërguarit (salallahu alejhi ue selam), pasi i është sqaruar e vërteta. Ky është kafir, sepse ka përgënjeshtuar fjalën e Allahut ose fjalën e të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selam).

2- Kur mohuesi i cilësisë njihet për çiltërsi e sinqeritet dhe përpiqet duke dhënë mundin e tij për kërkimin e së vërtetës, por ka gabuar në interpretim, ose për shkak të mosnjohjes së argumentit, ose për shkak të mosnjohjes së kuptimit të tij të saktë. Në këtë rast, ky njeri është i justifikuar dhe gabimi i tij është i falur, sepse ai nuk ka ardhur si pasojë e inatit, kryeneçësisë dhe qëllimit të keq.

3- Kur mohuesi i cilësisë ndjek epshin e tij, neglizhon në kërkimin e së vërtetës dhe flet pa dije, por nuk ka për qëllim kundërshtimin e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selam) dhe nuk i është qartësuar krejtësisht e vërteta. Ky njeri është gjynahqar dhe mund të cilësohet “fasik” (mëkatar i madh).

Ibnu Tejmija ka thënë: “Ndërsa, për sa i përket tekfirit, e vërteta është se cilido nga Umeti i Muhamedit (salallahu alejhi ue selem) që përpiqet për të vërtetën dhe e synon atë, por gabon, nuk bëhet kafir, madje i falet gabimi.

Ai që i sqarohet ajo me të cilën ka ardhur i Dërguari (salallahu alejhi ue selem), dhe ndjek një rrugë tjetër e jo rrugën e besimtarëve, është kafir. Ai që ndjek epshin e tij, neglizhon në kërkimin e së vërtetës dhe flet pa dije, është gjynahqar dhe mund të cilësohet ‘fasik’ (mëkatar i madh). Mundet që të mirat e tij të jenë më të shumta se të këqijat e tij. Pra tekfiri ndryshon sipas ndryshimit të gjendjes së personit. Nuk është çdo gabimtar, as çdo bidatçi, as çdo i paditur dhe as çdo i humbur ‘kafir’, madje as ‘fasik’ dhe as gjynahqar (kundërshtar).”

Gjithashtu ai ka thënë: “Unë, dhe ata që ulen pranë meje e dinë mirë, jam ndër njerëzit që më së shumti e ndalojnë cilësimin e një personi të caktuar ‘kafir’, ‘fasik’ ose gjynahqar, vetëm në qoftë se është bërë e ditur se i ka arritur argumenti fetar, të cilin kush e kundërshton mund të bëhet kafir, fasik ose gjynahqar (sipas kundërshtimit). Unë pohoj dhe konfirmoj se Allahu ia ka falur këtij Umeti atë që ndodh gabimisht. Kjo përfshin gabimin në çështjet e besimit dhe në çështjet praktike. Që prej kohësh selefët kanë pasur mosmarrëveshje në shumë prej këtyre çështjeve, por asnjëri prej tyre nuk ka dëshmuar kundër tjetrit as për kufër, as për fisk (mëkat të madh) e as për gjynah”, dhe pastaj ka përmendur shembuj nga jeta e tyre.

Më pas ka thënë: “Kam sqaruar se thëniat të cilat janë transmetuar nga selefët dhe dijetarët për cilësimin në mënyrë të përgjithshme ‘kafir’, të atij që thotë kështu dhe kështu, gjithashtu janë të drejta, por duhet të bëhet dallimi ndërmjet cilësimit ‘kafir’ në përgjithësi dhe cilësimit ‘kafir’ të një personi të caktuar.”

Besimi i Ehli Sunetit në Emrat dhe Cilësitë e Allahut

Ibnu Tejmije ka thënë gjithashtu: “Tekfiri është prej ‘ueidit’.¹ Megjithëse thënia është përgënjeshtër i asaj që e ka thënë i Dërguari (salallahu alejhi ue selem), i zoti i saj nuk cilësohet ‘kafir’, derisa t’i arrijë argumenti (të informohet mirë rreth asaj çështjeje me argument), sepse mund të jetë i ri në Islam, ose të jetë rritur në një zonë të largët e të veçuar nga qendrat e banuara. Ndoshta njeriu mund të mos i ketë dëgjuar ato argumente, ose i ka dëgjuar dhe nuk i vlerëson të sakta sipas mendimit të tij, ose sepse sipas tij i ka kundërshtuar një argument tjetër më i fortë, i cili e obligon interpretimin e tyre. Ai në këto mendime është gabimtar, por ato vlejnë për ta justifikuar. Unë gjithmonë kam përmendur hadithin që e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi, për atë personin që tha: ‘Kur unë të vdes, më digjni, më thërrmoni dhe pastaj më hidhni në det, se betohem në Allahun, në qoftë se Allahu do të ketë fuqi të më ringjallë, do të më ndëshkojë me një të tillë ndëshkim që nuk ka ndëshkuar me të asnjë tjetër përpara meje’. Vepruan me të ashtu siç i porositi. Allahu pasi e ringjalli i tha: ‘Çfarë të shtyu që ta bëje këtë?’ Tha: ‘Frika nga Ti.’ Allahu i Lartësuar e fali.

Ky burrë dyshoi në fuqinë e Allahut dhe në ringjalljen e Tij, pasi të thërrmohej dhe të hidhej në det, madje besoi se nuk do të ringjallej. Kjo është kufër tek të gjithë muslimanët unanimisht, por ai ishte i paditur dhe ishte besimtar. Ai kishte frikë se Allahu do ta ndëshkonte, por Allahu e fali. Interpretuesi i cili ka kapacitetin e duhur për të bërë ‘ixhtihad’ dhe është i interesuar për ndjekjen e të Dërguarit, ka më tepër përparësi që të falet, sesa personi që u përmend më lart.”

Po kështu ka thënë: “Kur’ani, Suneti dhe ixhmai, na tregojnë se është obligim që të themi për një vepër që është kufër se është kufër. Pra thuhet për të ‘kufër’, në mënyrë të pakufizuar, ashtu siç tregojnë argumentet fetare, sepse besimi është prej ligjeve që merren vetëm prej Allahut dhe të Dërguarit të Tij (salallahu alejhi ue selem). Besimi nuk është prej gjërave, për të cilat njerëzit gjykojnë me hamendjet dhe me epshet e tyre. Nuk është detyrë që çdo person që e thotë fjalën e kufrit, të cilësohet ‘kafir’, derisa të vërtetohen në të drejtën e tij kushtet e tekfirit dhe të eliminohen pengesat e tij.”

Pas gjithë këtij sqarimi, besoj se arrijmë të bëjmë dallimin ndërmjet thënies dhe thënësit të saj, si dhe ndërmjet veprës dhe vepruesit të saj. Jo për çdo vepër ose thënie që është kufër, vepruesi i saj cilësohet “kafir”.

¹) Paralajmërimin për ndëshkim.

